

Dr. Rubin Zemon

# Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve në Ballkan





**Dr. Rubin Zemon**

**ANTROPOLOGJIA SOCIO-KULTURORE E EGJIPTIANEVE NË  
BALLKAN**

Recensent:

**Dr. Veselin Popov**, Sofje, Bullgari

**Dr. Elena Marushiakova**, Sofje, Bullgari

**Dr. Milena Benovska Sebkova**, Sofje, Bullgari

**Dr. Mirella Decheva Stefanova**, Sofje, Bullgari

**Dr. Miodrag Kalendar Hadzi Ristić**, Shkup, Maqedoni

Përkthimi në gjuhën shqipe:

**Dorentina Dauti**, Ohër, Maqedoni

**Dr. Meleqe Shopi**, Elbasan, Shqipëri

Lektura dhe ballina:

**Fazli Stollaj**, inxh

Mbështetur nga:

**IRDK**

Dr. Rubin Zemon

**Antropologjia  
Socio-Kulturore e  
Egjiptianeve në  
Ballkan**

Prishtinë, 2013



"Do t'i shpërndaj Egjiptianët mes popujve dhe do ti valëvoj  
nëpër tokërat ..."

(Bibla, Dhiata e Vjetër, libër i profetit Jezekiil, dl.30, 23)



## **Përmbajtja**

Përmbajtja.....	i
Parathënie.....	v
HYRJE.....	1
QËLLIMET DHE DETYRAT E HULUMTIMIT .....	2
TERMINOLOGJIA DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	3
BURIME DHE LITERATURË.....	13
PËRFSHIRJE KRONOLOGJIKE DHE AREALE E HULUMTIMIT.....	18
EGJIPTIANËT E BALLKANIT/BALLKANO-EGJIPTIANË (ANALIZË E PËRGJITHSHME) .....	19
ETNONIME DHE TOPONIME .....	19
TOPONIME .....	26
SHPËRNDARJE GJEOGRAFIKE NË GADISHULLIN BALLKANIK-GRUPE OSE BASHKËSI ETNOGRAFIKE DHE ETNIKE.....	31
IDENTITETI ETNIK DHE MIMIKRIA ETNIKE E EGJIPTIANËVE TË BALLKANIT .....	41
TË DHËNA HISTORIKE, ARKEOLOGJIKE DHE TË TJERA PËR ARDHJE DHE PREZENCË NË VENDET BALLKANIKE.....	57
PERIUDHA E LASHTË.....	58
PERIUDHA ROMAKE .....	69
PERIUDHA BIZANTINE .....	71
PERIUDHA OTOMANE .....	78
PARAQITJA E IDENTITETIT ETNIK DHE NACIONALIZMI NË BALLKAN .....	83
LËVIZJA E EGJIPTIANËVE NË BALLKAN PËR PRANIM TË IDENTITETI DHE PARTICIPIM NË JETËN PUBLIKE .....	90
GJUHA .....	93
KULTURA MATERIALE E BALLKANO EGJIPTIANËVE.....	97
PROFESIONET .....	97
<b>Zanati i farkëtarisë dhe përpunimi i metalit .....</b>	<b>97</b>



<b>Bujqësi</b> .....	107
<b>Muzikë</b> .....	108
<b>Profesione të tjera</b> .....	110
LAGJE.....	112
SHTËPI DHE INTERIER I BRENSHËM SHTËPIAK .....	114
USHQIMI .....	117
STOLI DHE VESHJE .....	123
KULTURA SHOQËRORE .....	129
FAMILJA INOKOSE (NUKLEARE) .....	131
FAMILJA E ZGJERUAR (BASHKËSIA FAMILJARE) .....	133
LLOJE TJERA TË ORGANIZIMIT.....	135
KULTURA SHPIRTËRORE .....	139
DITURITË POPULLORE .....	141
<b>Për njerëzit, Tokën dhe gjithësinë</b> .....	141
<b>Për meteorologjinë, dukuritë natyrore dhe stinët e vitit</b> .....	144
<b>Për llogaritjen dhe matjen</b> .....	147
<b>Dukuritë tjera dhe kuptimet</b> .....	148
MEDICINË POPULLORE.....	152
<b>Medicina popullore animiste-magjike</b> .....	153
<b>Medicinë popullore medikale</b> .....	155
KRIJIMTARIA POPULLORE GOJORE .....	158
<b>Arti i zbatuar popullor</b> .....	161
VALLE POPULLORE DHE MUZIKË POPULLORE .....	164
<b>Vallet Popullore</b> .....	165
<b>Muzika popullore vokale dhe instrumentale</b> .....	167
BESIMET POPULLORE DHE PËRKATËSITË KONFESIONALE .....	171
DOKE POPULLORE .....	179
DOKET NGA CIKLUSI I JETËS .....	179
<b>Doke gjatë lindjes</b> .....	179
<b>Doket gjatë lidhjes të kurorës (martesës)</b> .....	183

<b>Doke gjatë synetit .....</b>	<b>187</b>
Doke gjatë vdekjesh .....	188
DOKE NGA CIKLUSI VJETOR (KALENDAR) .....	192
DOKE NË LIDHJE ME PUNËN .....	196
DOKE DREJTËSIE .....	197
DOKE TË TJERA .....	199
PËRFUNDIMI .....	201
SUMMARY .....	213
Bibliografia .....	225
Lista e informatorëve .....	241



## Parathënie

Zgjidimi kombëtar i bashkësisë etnike të Egjiptianëve të Ballkanit tani veç ka ndodh dhe është në rrugë të formësimit të identitetit të tij etnik. Ndjenja për veçanti etnike të pjesëtarët e Egjiptianëve të Ballkanit gjithmonë ekzistoi dhe u manifestua në forma të ndryshme, përkundër vështirësive me të cilat u ndeshen në periudha të vështira dhe sisteme të ndryshme politike në rajonin e Ballkanit. Popuj të ndryshëm, ndër të cilët edhe Egjiptianët e Ballkanit, lanë gjurmë në kohën që e lamë pas, me mënyrat e sjelljeve ndër njerëzore në familje, faretis, grup dhe më gjerë, përmes të cilave krijuan kulturën, traditën e veçuar prej të tjerëve. Veçantia etnike e Egjiptianëve të Ballkanit mbeti e ngulitur thellë në karakterin e secilit individ të këtij grupi etnik, edhe pse në periudha të caktuara u bënë përpjekje për cenimin e identitetit etnik. Ashtu siç thekson autori i librit se Historia nuk është çështje e së kaluarës por është përgjigje e nevojave të jetës moderne, pa dyshim se ky libër është përmbledhje e fakteve reale të veçorive të jetuara por të pa shkruara deri më tani, dhe sigurisht se do të shërbej për fuqizimin e dinjitetit njerëzor të pjesëtareve të Egjiptianëve të Ballkanit.

Pasqyrimi i së kaluarës së vërtetë në të gjitha periudhat, përmbledhja dhe interpretimi i të veçantave të grupit etnik, interpretimi shkencor i fakteve të njohura dhe prezantimi i fakteve të pa njohura për publikun, kundërshtimi i argumentuar i "argumenteve shkencore" që shkaktuan tollovi në opinionin publik, e bëjnë shumë të qartë identitetin etnik të Egjiptianëve të Ballkanit edhe për ata që kanë dëshiruar që të sfidojnë të vërtetën.

Autori i librit, përmes sqarimit të fakteve historike, arkeologjike dhe të tjera, dhe duke e vendosur bashkësinë e Egjiptianëve të Ballkanit në kontekst të ngjarjeve të ndodhura historike dhe zhvillimet shoqërore, arrin në përfundim se në kohën e Egjiptit të Vjetër, në Gadishullin Ballkanik erdhën kolonist Egjiptian me qëllim të eksploatimit të metaleve. Prezencën e kulturës Egjiptiane autori e argumenton edhe gjatë Perandorisë Romake, duke interpretuar zbulimet arkeologjike të cilat tregojnë prezencë kultesh nga Egjipti në Ballkan. Prezenca e Egjiptianëve në Ballkan gjatë periudhës së Bizantit ka lenë gjurmë ndër të tjera me gjykimin e monofizitizmit egjiptian, që me siguri ka pasur pasoja negative edhe mbi popullatën me prejardhje egjiptiane në Ballkan. Në shekullin e XIV u shkaktua konfuzion dhe paqartësi lidhur me Egjiptianët e Ballkanit për shkak se në këtë

periudhë në mënyrë masive erdhën romët në Ballkan dhe Evropë. Gjatë kohës së Perandorisë Osmane, ndodhi procesi i islamizimit të popujve të Ballkanit por paralelisht me këtë ndodhi edhe procesi i deetnizimit, gjë që kishte ndikuar në përkeqësimin e identitetit etnik të Egjiptianëve të Ballkanit. Autori i librit e trajton edhe çështjen e të ashtuquajturit “mendim shkencor” dhe ideologjinë e “progresit”, të bazuar në modelin Arian të cilët bënëin paragjykimet racore ndaj Egjiptianeve të Ballkanit. Gjithashtu në këtë libër janë vendosur fakte lidhur me lëvizjet e para të Egjiptianëve të Ballkanit, gjatë periudhës së komunizmit, atëherë kur u krijuan kushtet minimale të shprehjes së përkatësisë etnike atëherë edhe spontanisht pjesëtarët e bashkësisë e deklaruan identitetin e tyre etnik në mënyrë publike. Me shembjen e komunizmit dhe lejimin e sistemit pluralist në ish Jugosllavi, njëra prej lëvizjeve të para ishte edhe Lëvizja e Egjiptianëve të cilët me 24 Qershor 1990 në Ohër kishin mbajtur Kuvendin Themelues të Egjiptianëve të Jugosllavisë. Pas vitit 1990 Egjiptianët e Ballkanit në të gjitha shtetet e Ballkanit, dhe në Evropë nga mërgimtarët, themeluan shoqata, parti politike, Organizata jo qeveritare. Në Kosovë, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Egjiptianët kanë vend të rezervuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e Komuniteteve, Egjiptianët janë komunitet i cili tradicionalisht ka jetuar në Kosovë. Me gjithë përparimet që kanë pasur Egjiptianët e Ballkanit në mundësinë e deklarimit publik të identitetit të tyre etnik, pozita në shoqëritë e shteteve ku jetojnë lë shumë për të dëshiruar.

Autori i librit, duke qenë i pajisur me njohuri nga shkenca e etnologjisë, historisë dhe shkencat tjera, duke e njohur shumë mirë realitetin e Egjiptianëve të Ballkanit, me mjeshtëri e ka vendosur në letër identitetin e veçantë të kësaj bashkësie përmes përshkrimit të kulturës materiale, kulturës shpirtërore, dokeve popullore dhe veçorive tjera, të cilat në mënyrë të argumentuar i ka ndërlidhë me trungun e së kaluarës nga etapat e ndryshme të zhvillimit historik. Me këtë përshkrim, që është disertacion doktorature i mbrojtur me 17.02.2005 ne Akademinë Bullgare të Shkencave në Sofje të Bullgarisë, duke i shfrytëzuar normat dhe argumentet shkencore, autori na ofroj një pikturë të qartë për bashkësinë e Egjiptianëve të Ballkanit, në veçanti për ata të cilët këtë bashkësi etnike shpesh e kanë portretizuar gabimisht.

Fazli Stollaj

## **HYRJE**

Ky është hulumtimi i parë i plotë që në mënyrë shkencore e trajton problematikën e pjesëtarëve të komunitetit etnik të veçantë të Egjiptianëve të Ballkanit. Ndoshta për këtë shkak është zgjimi i vonshëm i vetëdijes për veçanti etnike tek pjesëtarët e kësaj bashkësie, e cila si proces masiv u paraqit në vitet e shtatëdhjeta të sh.XX, në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht në qytetet Ohër dhe Strugë. Vetëdija për veçanti etnike, ashtu si do të shikojmë nëpër historinë, ka ekzistuar edhe më parë, por nevoja për spikatje publike të veçantisë, e me të edhe të nevojës për shfrytëzimin e disa të drejtave komponentëve kolektive, në mënyrë masive paraqitet në këtë periudhë.

Me vendosjen graduale të proceseve të reja shoqërore në Ballkan d.m.th. demokratizimin dhe respektimin e disa të drejtave të njeriut si dhe ato minoritare, e sidomos me çintegrimin e shtetit të mëparshëm Jugosllav, pyetja e identitetit etnik të kësaj bashkësie, e cila jeton në pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik, fitonte interesim më të madh edhe në publik, ndërsa pjesëtarët e kësaj bashkësie dhe vendeve të tjera Ballkanike paraqiteshin me dëshirë edhe më të madhe për spikatjen e veçantisë së tyre.

Megjithatë, edhe në shkencë ekzistojnë konfuzione, por janë konstruktuar edhe “të vërteta shkencore” për pyetjen e Egjiptianëve në Ballkan. Kjo pyetje nga ana e shkencës etnologjike dhe asaj antropologjike, gjithmonë është trajtuar në kornizat e hulumtimeve të bashkësisë Rome, ndërsa në arkeologji një numër i madh i zbulimeve janë të trajtuara si

eliniste-romake. Në historiografi shumë dokumente arkiva në të cilat përmenden Egjiptianët janë vendosur në kornizat e “grupeve rome” ose “rryma”, ose janë injoruar ku janë trajtuar sipërfaqësisht dhe pasaktësisht. Megjithatë në literaturë ekziston një konfuzion tepër i madh, para së gjithash tek ata shkencëtar që duan pyetjen e Egjiptianëve ta shikojnë në kornizat e bashkësisë cigane/rome.

Që të sqarohet prezenca e Egjiptianëve në Ballkan, disa shkencëtarë kanë krijuar edhe një kuazi-tezë se Romët në Ballkan kanë ardhur nëpër Egjipt dhe brigjet e Levatisë, dhe për këtë shkak disa nga Romët quhen Egjiptianë d.m.th. me etnonime të cilat janë të lidhura me Egjiptin. Këtë kuazi-tezë mund ta hasim gati në çdo punim të autoreve të cilët këtë problem e shohin në kornizat e bashkësisë cigane/rome, duke mos ofruar asnjë dëshmi, argument ose material dëshmuës, qoftë nga historiografia, arkeologjia ose nga shkencat tjera. Por për fat të keq ky pohim pa argumente është përgjithësisht i pranuar si një “e vërtetë shkencore” me të cilën shërbehen edhe institucionet ndërkombëtare si p.sh. Këshilli i Evropës (2003:5- Historically the jevgj or evgjit (gypsy) have come to the Ballkans and to Albania from India through Egypt and this is the only connection with this country).

## **QËLLIMET DHE DETYRAT E HULUMTIMIT**

Në mendimin shkencor, por edhe në jetën shoqërore dhe atë politike, në mënyrë të pashmangshme paraqitet nevoja për hulumtim shkencor, që do të vendos bazë të re shkencore dhe argumentim, të liruar nga paragjykimet dhe qëllimet politike për ekzistimin e bashkësisë të veçantë etnike në Ballkan, e cila deklarohej se me prejardhje është nga Egjipti. Për këtë shkak domosdo haset në më tepër pyetje logjike: Vallë ekziston argumentim i mbështetur shkencëtarisht për shpërnguljen e njerëzve prej Egjiptit në Ballkan, që nuk do të bazohet në supozime? A ka kjo bashkësi gjurmë të saja për prezencë në Ballkan në kontinuitet ose a mund të bëhet rikonstruim historik nga periudha e shpërnguljes deri në kohën bashkëkohore? A ka kjo bashkësi që ndodhet në Ballkan elemente specifike të saja, në kulturën e saj shpirtërore, shoqërore ose materiale dhe sa ka kontribuar në formimin e “melting pot”-it etno-kulturor të Ballkanit.

Për përgjigjen e këtyre pyetjeve si qëllim i hulumtimit u vendos që kjo bashkësi nga pikëpamja historike shkencëtarisht të observohet prej shpërnguljes e deri në kohën e sotshme, por edhe nga pikëpamja etnografike/etnologjike nëpërmjet kulturës së tyre shoqërore, materiale dhe

shpirtërore. Kuptohet se domethënie kruciale ka edhe pyetja për identitetin etnik dhe kufijtë etnik. Për atë qëllim si detyre u parashtruan më tepër provokime, para së gjithash të shfletohet një pjesë e pasur dhe shumë e madhe nga lënda historiografike nga të gjithë pjesët e Ballkanit, pa pretendime për shterje në atë kuptim. Duke marrë parasysh se shkenca dhe publiku tjetër nuk kanë të dhëna të mjaftueshme dhe njohuri për etno-kulturën e kësaj bashkësie në Ballkan, si detyrë e dytë ishte të bëhet një prezantim i kulturës shpirtërore, materiale dhe asaj shoqërore, që tani ekziston, me retrospektivë të vogël sipas përkujtimit të njerëzve, të cilët i takuam nëpër terrenet hulumtuese, por edhe me përdorimin e literaturës ekzistuese.

## **TERMINOLOGJIA DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Një ndër problemet kryesore ishte emërimi i kësaj bashkësie në Ballkan me prejardhje nga Egjipti. Problemi është i koklavitur sepse pjesëtarët e kësaj bashkësie nëpër Ballkan dhe në gjuhë të ndryshme kanë emra (etnonime) të ndryshme që janë të lidhura me Egjiptin. Deklarimi i tyre oficial në të shumtën e shteteve Ballkanike është Egjiptian. Megjithatë, Egjiptianët që jetojnë në Ballkan, nuk kanë lidhje të mëdha dhe vija të përbashkëta me Egjiptianët që sot jetojnë në Republikën Arabe të Egjiptit, të cilët në numër më të madh deklarohen si Arabë. Egjiptianët e Ballkanit nuk kanë lidhje etno-gjenetike me Arabët, sepse migrimi i tyre ka ndodhur para sh.VII, kur feja Islame dhe Arabët hyn në Egjipt, por edhe etno-kultura e tyre sot është krejtësisht e ndryshme. Domethënë, nëpërmjet emërimit të kësaj bashkësie në Ballkan, duhet të bëhet edhe dallim i qartë dhe distinkcim me Egjiptianët që sot jetojnë në Egjipt, të cilët në numër më të madh deklarohen si Arabë.

Nga ana tjetër pjesëtarët e Egjiptianëve në Ballkan si bashkësi kanë disa elemente të përbashkëta, me të cilat këtu në Ballkan diferencohen si veçanti, e ato elemente nuk mund t'i përshkruhen një tërësie tjetër etnografike ose etnokulturore në Ballkan. Për këtë arsye vendosëm të përdoret termi Egjiptianët e Ballkanit (Ballkano-Egjiptiane) Balkan Egyptians, Balkanski Egipcani, që është i pranuar edhe nga shkencëtarët e tjerë (Courthiade M.2003-2004). Por gjithashtu duhet të merret parasysh se pjesëtarët e kësaj bashkësie jetojnë edhe jashtë vendeve Ballkanike, para së gjithash në Mediteranin Lindor mandej edhe në Gadishullin Apenin dhe Pirinej, por në ato krahina me siguri kanë disa elemente nga etno-kultura, të



cilat janë të ndryshme nga ato Ballkanike, por edhe të përbashkëta, për të cilat ndoshta do të flitet në ndonjë hulumtim të ardhshëm.

Problem i dytë është identifikimi d.m.th. si mund të identifikohen këta njerëz, kur në literaturën shkencore ekziston konfuzion i plotë, e në jetën publike “aut-sajderet” me vështirësi mund të bëjnë dallim. Menjëherë duhet të thuhet se për autorin si “in-sajder” në bashkësinë, problemi real për identifikim nuk ekziston. Megjithatë autori është i vetëdijshëm se është i ngarkuar me të ashtu quajturën “the double insider syndrom”, që në raste Ballkanike edhe më tepër vjen në shprehje, ndërsa përbëhet në atë se nga njëra anë hulumtuesi është përfaqësues i grupit që hulumtohet dhe i ndan gjuhën, traditat, interesat dhe vlerat fundamentale, ndërsa nga ana tjetër është pjesë e bashkësisë shkencore e cila detyrë themelore e ka të studioj, forcoj dhe të mbroj interesat e identitetit nga ana e vetë, ose me fjalë tjera hulumtuesi në Ballkan njihet edhe si avokat intelektual i atij objekti. (Hristov P.2004:5)

Si eksponent i parë dhe më i lehtë për identifikim është vetëdija etnike e disa grupeve njerëzish të përcaktuar, të cilët qartë dhe në mënyrë të padyshimtë e ndërtojnë identitetin e tyre etnik, nëpërmjet kufijve të tyre etnik dhe spikatjen e veçantive dhe cilësive të tyre etno-kulturore. Njerëz të tillë të cilët qartë deklarohen si “Egjiptianë” ka në pjesën perëndimore të Maqedonisë, Kosovë, Shqipëri, Malin e Zi, Serbi dhe në Rodopet lindore të Bullgarisë.

Identifikimi si problem serioz paraqitet tek ata që e fshehin përkatësinë e vërtetë etnike dhe preferojnë të deklarohen si përkatës të ndonjë bashkësie tjetër si Shqiptarë, Turq, Maqedonas, Serbë, Boshnjak etj. Këtu ballafaqohemi me pyetjen e mimikrisë etnike dhe identitetin e preferuar. Të identifikohet, në të vërtetë do të thotë të dallohet, përvetësohet dhe përcaktohet. Varësisht nga ajo se vallë si bazë të identifikimit e marrim kulturën, religionin, etnosin, fisin ose kombin, e lidhim edhe kuptimin e identitetit me ndonjë mbiemër (kulturor, religjioz, identitet etnik). Kuptimi identitet është i formuluar së pari në teorinë psiko-analistike dhe është kuptuar si bazë më e gjerë për ndjenja të përcaktuara individuale të përkatësisë. (Петровић, Е. 1989: 9). Formulim të kuptimit identitet etnik ka dhënë Erik Erikson në vitin 1968, i cili ka tentuar të caktoj mekanizma nëpërmjet të cilave individ identifikohet me grupin, dhe ka konkluduar se identiteti është veti e cila është e rrënjësuar në vetë bazën e njeriut. Megjithatë, vetë procesi i identifikimit etnik zhvillohet në hap me socializimin.

Etnosi si kuptim, lloj llojshmëria është definuar dhe zbatuar si koncept. Derisa definicione më të vjetra etnosin e kanë ndarë si kategori

statike kulturore me tregues objektiv të përkatësisë: doke, gjuhë, veshje, territor, religjion (Бромлей Ю, 1976: 37), në definicionet e reja kuptimi etnos lidhet me kuptimin identitet etnik dhe theksi kalon në manifestim të etnikes nëpërmjet kontakteve midis grupeve, duke analizuar sjelljen e anëtarëve në situata të përcaktuara (Mostwin D. 1972:2). Me vendosjen e kuptimit identitet etnik është vendosur edhe dimensionin subjektiv i etnosit, në përgjithësi. Megjithatë, studimi i identitetit etnik detyrohet të përfshij edhe treguesit objektiv dhe subjektiv të “etnitetit” (Петровић, Е.1989:9). V.Isajev (Isajiw W. 1974:117-119) mendon se etniciteti paraqitet në grupe jo qëllimtare njerëzish dhe pasardhësit e tyre të kulturës së përbashkët të cilët vetveten e identifikojnë dhe/ose të tjerët i identifikojnë si pjesëtarë të atij grupi. Anëtarët e një grupi mund të posedojnë shenja/cilësi të përcaktuara objektive, nëpërmjet të cilave personat jashtë grupit i caktojnë dhe dallojnë (ritual, dialekt, veshje), por nga ana tjetër, ekzistojnë edhe një varg shenjash tjera, nëpërmjet të cilave bëjnë identifikim me grupin të cilit i përkasin, ndërsa të cilat janë të papara për personat jashtë atij grupi. Vetëdija për domethënie simbolike të ndonjë shenje arrihet në prekjen me pjesëtarët e grupeve tjera. Me interakcion të grupeve të ndryshme etnike fitohet edhe identiteti d.m.th. ndërtohet ndjenjë përkatësie e grupit. Cilat shenja të identitetit etnik do të merren si simbole të një grup njerëzish, varet nga interpretimi i përbashkët i përvojave të përjetuara të anëtarëve të grupit.

Çdo bashkësi etnike karakterizohet sipas pretendimit kah konstituimi i modelit të bashkësisë “totale” përkatësisht kah modeli që të gjithë anëtarët të jenë të lidhur sipas të tri modeleve universale për bashkim “biologjik”, “ekzistencial” dhe “shpirtëror” (Бандић Д. 1982:49) për shkak të kësaj, llojet e bashkësive jo ekzistuese të ndonjë grupi etnik zëvendësohen me lloje të shpikura. Nëse pranohet ky mendim, atëherë identiteti etnik mund të definohet si identitet grupor, ku pjesëtarët e grupit dhe pasardhësit e tyre e ndërtojnë në shumë lloje të tilla të shpikura simbolike për karakteristikat e tyre të përbashkëta etnike dhe/ose të tjerët në bazë të tyre e identifikojnë si pjesëtarë të atij grupi (Павловић М. 1989:35).

Termi distancë etnike i dedikohet ndjenjës subjektive të afërsisë që e ndërton një person ose grup njerëzish ndaj një personi ose grupi tjetër. Largësia etnike, si studim i nivelit të afërsisë sociale (largësisë) në realitet flet për barrierat psikologjike që e lehtësojnë ose vështirësojnë interakcionin social.

Barrierat ose largësitë mund të jenë të ngritura në bazë të cilitdo kriterium, që për grupin është i rëndësishëm në situatë të caktuar (Петровић, Е. 1989:11).

Kufijtë etnik paraqesin barriera artificiale në komunikimin midis grupeve dhe mund të jenë të krijuar në fusha të ndryshme komunikimi. Kufijtë etnik vendosen dhe ruhen edhe përkundër kontakteve (Barth F. 1969: hyrje). Nëse një grup e ruan identitetin e vet edhe përkundër kontakteve dhe ndërmjet kontakteve, ajo doemos duhet të ketë kriteriume që janë mirë të definuar për sinjalizimin e përkatësisë. Anëtarët e grupit doemos duhet të jenë lartë të stereotipizuar që të mund të realizojnë komunikim me grupet e tjera. Karakteristikat kulturore nëpër mjet të cilave ata vetë-përcaktohen ose të tjerët i përcaktojnë duhet doemos të jenë stabile ashtu që dallimet do të mbahen edhe nëpërmjet prekjeve reciproke.

Identiteti etnik është vetëm një ndër identitetet e mundshme që njeriu e fiton gjatë jetës së vetë. Ai nuk është i pandryshueshëm, as edhe i dhënë njëherë e përgjithmonë, por sipas nevojave krijohet, theksohet, ndryshohet, fshihet, lëshohet ose zëvendësohet me të ri. Personi është “zgjedhës” duke bërë gjithmonë zgjedhje në strategjinë e ekspozimit ose fshehjes së identitetit. Për këtë arsye, me identitetin mund të manipulojnë edhe individë. Personi publikisht do të shfaq atë identitet që në situatë të dhënë mund të ketë dobi ose i cili është sinqerisht i vlerësuar. Gjithashtu ekzistojnë edhe më tepër identitete të ndërtuar mbi bazë etnike, që personi i ndjen dhe i shpreh, e ato të mos jenë në konflikt. Personi mund të përcaktohet së pari sipas fisit ose religjionit e mandej në mënyrë etnike, gjithashtu mundet edhe të ndjejë se njëllojshëm i përket dy etniciteteve. Identitete të ndryshme gjithashtu mund të manifestohen edhe në fusha të ndryshme të komunikimit. Në një grup komunikimi, pjesëtarët e grupit mund ta manifestojnë identitetin e fisit, në tjetrën atë regional ose etnik. Identiteti etnik krijohet me distinkcion midis klasave NE dhe ATA ose midis pjesëtarëve të grupit dhe atyre jashtë tij.

Një ndër karakteristikat e identitetit etnik është edhe dinamika dhe kontinuiteti i tij. Grupi e shpreh identitetin e vetë si përgjigje në një situatë shoqërore. E ruan nëpërmjet shenjave dhe simboleve, që iu japin domethënie dhe shpjegime personale.

Identiteti shoqëror, etnik dhe global mund të jenë në koordinim, por edhe në mospërputhje. Njeriu mund të jetë krenar që i përket ndonjë grupi etnik dhe njëkohësisht edhe krenar për pozitën që ai grup e ka në shoqërinë më të gjerë. Megjithatë, nëse pozita e grupit të tij etnik është inferiore e me të përkatësia e tij etnike paraqet hendikep për realizimin e pritjeve të tij, ndjenjat e tij ndaj atij grupi mund të jenë ambivalente por edhe krejtësisht negative (Тамева М.1996:8). Në situata kur ata janë të vetëdijshtëm për idealet e bashkësisë dhe kulturës dominuese, por janë të penguar të ndjekin, mund të arrij deri në lidhje të aspektit negativ të identitetit dhe ndjenjave

negative që për ata i bartin pjesëtarët e bashkësisë dhe kulturës dominuese. Rezultat i kësaj është formimi i identitetit negativ ose **“identiteti përkushtimi”** i cili në vete përfshin ndjenja inferioriteti dhe vetë-urrejtje.

Përpunimi teorik i dimensioneve themelore të identitetit etnik doemos duhet të nisë nga specifikat e popullatës që merret në shqyrtim, si edhe në kontekstin e dhënë kulturor dhe social në kornizat e të cilit ajo ndodhet. Pas dore nuk duhet të lihen as determinimet historike në zhvillimin e një grupi. Për këtë qëllim u munduam që në këtë punim të bëjmë një retrospektivë historike dhe kontinuitet historik, duke filluar nga njohuritë e para për vendosjen e kolonistëve Egjiptian në Ballkan e deri më sot. Kjo retrospektivë historike dhe kontinuitet, ishe e domosdoshme të kryhet që të mund të përgjigjemi në qëllimin e dhënë më parë. Publikimet e botuara deri tani për këtë problem historik (Ристески С.1991; Хаџи Ристиќ М.1992;1996) nuk japin përgjigje të mjaftueshme për këtë problematikë, sepse ishin të vendosura mbi bazën e supozimeve dhe mundësive. Duke përdorur metodën historiko-kulturore, nëpërmjet sqarimeve dhe vënies në kontekst të disa ngjarjeve të përcaktuara historike të proceseve shoqërore, u munduam të bëjmë një etno-histori të parë të Egjiptianeve të Ballkanit. Kjo për më tepër që sipas luftëtarëve të bashkëpunimit të etnologjisë me historinë, para së gjithash Zh.Ballandie, fenomene të përcaktuara të kulturës kanë qenë nën ndikim të fuqishëm të përbërësve historik. Edhe P. Mersie përfaqësonte konceptin se praktikisht vështirë mund të studiohet etnogjeneza e cilësdo bashkësi etnike nëse nuk njihet mirë e kaluara historike. Megjithatë, menjëherë duhet të theksohet se as e kaluara historike nuk mundet autentikisht të shpjegohet pa përdorimin e njohurive dhe rezultateve të arkeologjisë, etnologjisë dhe një varg shkencash tjera. Kundruall kësaj edhe kooperimi shkencor midis etnologjisë dhe historisë paraqet postulat (Константинов М. 1986:62). Kuptohet se në këtë rast, nuk kishim mundësi por as qëllim për shterjen e të gjitha burimeve historik të mundshme ekzistuese. Një ndër pyetjet kryesore për historinë e Egjiptianeve të Ballkanit është të locohet dhe datohet vendi dhe koha e ardhjes në Ballkan, që deri tani nuk është bërë. Duke i vënë në kontekst rrethanat shoqërore-politike, si dhe burimet historike, mendojmë se në këtë rast do ta zgjedhim dhe përfundojmë këtë pyetje.

Gjatë prezantimit të ashtu quajturve tregues objektiv të identitetit etnik d.m.th. aspekteve etnografike, përkatësisht etno-kulturën e Egjiptianeve të Ballkanit, e përdorëm ndarjen më të përdorur të kulturës në etnologji, materiale, shoqërore dhe shpirtërore. Ndoshta, prezantimi i diskripcionit në këtë mënyrë duket edhe “punë e tejkaluar” por duke pasur parasysh se ky është hulumtimi i parë gjithëpërfshirës i këtellë për bashkësinë

e Egjiptianëve të Ballkanit, shihet se është edhe i arsytuar. Nëse e pranojmë mendimin e Claude Levi- Strauss për evolucionin e shkencës të popujve ose bashkësive të ndryshme me zhvillimin e fazave etnografi-etnologji-antropologji, atëherë shkenca për Egjiptianët të Ballkanit ndodhet në fazën e etnografisë d.m.th. përshkrim, ruajtje dhe prezantim të etno-kulturës. Për shkak se kjo punë hulumtuese kryhet në mileniumin e III, kur industrializimi dhe proceset globaliste janë thellë të futura në Ballkan, elementet nga jeta kulturore dhe tradicionale janë qëmoti të zhdukura. Ky problem është crucial dhe mund të zgjidhet vetëm në domethënie të përcaktuar nëpërmjet rekonstruimit të kulturës tradicionale.

\* \* \*

Gjatë hulumtimit shkencor e nevojshme ishte të përdoren më tepër drejtime dhe metoda të njohura nga historia e shkencës etnologjike.

Kuptohet se teoria biologjike-racore dhe mësimi për popujt dhe grupet etnike “pasive” dhe “aktive” (Klemm G. 1843) është qe moti e tejkualuar dhe shkencërisht e padurueshme, por ajo teori kontribuoi që të rilind gati në çdo dukuri kulturore, duke mos marrë parasysh bartësit e tyre që i kanë klasifikuar në pjesën “pasive” ose “aktive” të popullatës. Në shoqëri por edhe në shkencë sot ende mund të hasen paragjykitime të vetëdijshme dhe jo të vetëdijshme, para së gjithash të bazuara në veçantitë somate-antropologjike të njerëzve d.m.th. paragjykitime racore dhe stereotipa, të cilat vetëdijshëm ose jo vetëdijshëm kanë pasoja të veta edhe në mendimin shkencor.

Përfaqësuesi i teorisë antropologjike-historike Teodor Vajc (Waitz Th.1859) i cili bënte komplot se në zhvillimin e kulturës nuk mund të ndahen momentet sociale dhe raportet historike, me studimin e të cilave më lehtë do të zbulohen shkaqet e numërta të hovit kulturor, gjithashtu është marrë parasysh gjatë hulumtimit shkencor. Teoria e “ideve themelore” me të cilat disponojnë të gjithë popujt, si fond fillestar i kulturës së tyre, që në një farë mënyre llogaritet si parakusht kryesor për krijim fenomenesh të njëjta ose të ngjashme kulturore tek bashkësitë e ndryshme etnike dhe në pjesë të ndryshme të botës (Bastian A. 1869), nuk arriti të përmbledh konceptet dhe ishte shpejt i shtypur nga drejtimi evolucionist.

Teoria evolucioniste sipas të cilës njerëzit kanë një prejardhje të vetme dhe gjenezë të njëjtë në zhvillimin e tyre, prej ku rrjedh se kultura materiale, shoqërore dhe shpirtërore nuk kanë vetëm zhvillim të vetëm, por kanë edhe lidhje të ndërsjellët në afirmimin e përfitimeve, gjithashtu hynte

në konceptin e analizës shkencore. Lëvizja e kulturës nëpër një rrugë të vetme “egërsi-barbarizëm-civilizim (Morgan L. 1877) si dhe rrëfimi se me klasifikim të kujdesshëm dhe të durueshëm të mbeturinave të “shkapërderdhura” të ndonjë kulture, fitohet tërësi e fortë dhe logjike, e cila mundëson të kuptohen principet themelore që drejtojnë zhvillimin e saj (Tylor E. 1871), janë realitet i pashmangshëm që duhet çdo etnolog ta ketë parasysh gjatë analizës shkencore.

Drejtimi difuzionistik në shkencë, i instaluar nga Friedrich Ratzel (1844-1904), me përfaqësim të madh është i zbatuar në këtë hulumtim. Kjo teori flet se përbërjet kulturore si njësi të përmbledhura nisen nga një qendër në drejtime të ndryshme, ndërsa përhapja e tyre krejtësisht ndodh nëpërmjet migrimeve, d.m.th. kontaktet deri tek të cilat arrihet midis bashkësive të ndryshme etnike. Me tej difuzionizmi e shpjegon zhvillimin e kulturës nën ndikimin e shpërndarjes vendore. Kjo domethënë se nëpërmjet migrimeve barten vlerat kulturore në të gjitha bashkësitë etnike. Duke filluar nga përcaktimet e tilla, difuzionistët kanë krijuar skemë në të cilën ishin të vizatuara disa lloje qendrash kulturore, prej ku fillonte përhapja e elementeve kulturore në drejtime të ndryshme, të shkaktuara me migrime. Si një nga këto qendra p.sh. ata e kanë llogaritur Egjiptin, prej ku niste distribuimi i vlerave kulturore. Në realitet, ata këtë tokë e kanë llogaritur si stëratdhe të kulturës, prej ku ajo mandej degëzohej në të gjitha drejtimit me ndihmën e lëvizjeve të migrimit d.m.th. nën ndikimin e faktorëve gjeografik. (Константинов М. 1986:181). Sipas këtij drejtimi, tërësitë kulturore rrjedhin nga elementet që shtresohen njëri mbi tjetrin, në rajon të përcaktuar, me kalimin e shekujve. Megjithatë, gjatë analizës shkencore duhet te kujdesemi se difuzionizmi nuk ju përkushton vëmendje ndryshimeve kohore që janë të provokuara nën dinamikën që e diktojnë epokat e ndryshme shoqërore, si dhe fakti se ky drejtim e shfaq njerëzimin si masë amorfe e cila është krejtësisht e pa interesuar për procesin e vetë.

Në hulumtimet tona në kundri të vëmendjes e kishim edhe shoqërinë, për çka përkrahje teorike hasim në drejtimin sociologjik. Këtë drejtim e karakterizojnë tri orientime të afërta socio-filozofike: a) solidariteti; b) aspektet ekonomike, drejtësie, politike dhe magjiko-religjioze (Mauss M. 1973); dhe c) mundësitë e ndryshme të menduarit midis bashkësive të zhvilluara dhe të pazhvilluara etnike.

Funksionalizmi si drejtim teorik i mëkëmbur nga Bronislaw Malinowski, ndërsa në masë të madhe i përfaqësuar nga A.R. Radcliff-Brown, me të cilin studiohen funksionet e dukurive kulturore, kushtëzimi dhe varësia reciproke e tyre, “si organet në organizmin dhe rrotat e orës”, është lidhje e rëndësishme në analizën shkencore. Megjithatë, duhet të

merret parasysh se çdo pjesë kulturore mund të kuptohet vetëm nëse shikohet si pjesë e pandarë e një sistemi të përmbledhur të kulturës. Malinowski është përfaqësues i studimeve komparative, që kontribuoi më ekzistencialitet të mbet në komponentët themelore të kulturës dhe se etnologu asnjëherë nuk duhet të tërhiqet nga njohuritë, sipas së cilave është i obliguar të interesohet për qëndrimet, pikëpamjet, mënyrën e jetesës, pikëpamjet dhe kuptimet e njerëzve që i studion. Sipas kësaj, punëtori shkencor më nuk ka nevojë të inkurajoj të rriturit që të shpjegojnë për atë se si ka qenë jeta e tyre dikur.

Duke u mbështetur pjesëshëm në funksionalizmin e pjesëshëm në mësimin për “pavetëdijshmërinë”, strukturalizmi është drejtim i cili kujdeset që nëpërmjet përbërjes dhe radhitjes së ndonjë dukurie kulturore, d.m.th. nëpërmjet kulturës së saj, të përcaktohet si ndonjë tërësi. Struktura ose përmbajtja e gjërave, konsiderohet si më themelore. Duke u nisur nga këto përcaktime, strukturalistët janë më tepër të interesuar për dallimet midis kulturave veças, se sa për tërësinë e tyre. Gjatë analizimit të disa elementeve nga gjuha, drejtimit artistike ose ndonjë lloj përfitimi kulturor niset prej “strukturës” së tyre dhe lëvizin mbrapsht kah natyra, deri në pikën ku paraqitet pavetëdijshmëria që lind në trurin e njeriut nën ndikimin e ndonjë “mekanizmi psikik”, me ndihmën e së cilit caktohen kuptimet, përkatësisht llojet embrionale të strukturës që kahezon si të qeveriset njeriu. Mirëpo, kryethemeluesi i strukturalizmit Claude Levi Strauss (Levi-Strauss C. 1958) insiston të tërhiqet kufi i trash midis natyrës nga njëra anë dhe kulturës nga ana tjetër. Një gjë send derisa është në natyrë përfaqëson gjë send të rëndomtë, por nëse hyn në përpunimin ose përdorimin e njeriut, ai tani është një lloj instrumenti primitiv.

\* \* \*

Hulumtimet në terren zgjatën në një periudhë më të gjatë (1995-2005). Të vizituara janë gati të gjitha vendet ku jetojnë pjesëtarët e kësaj bashkësie- Maqedoni (Ohër, Strugë, Resnjë, Kërçovë, Dibër), Kosovë (Fushë Kosovë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj), Serbi (Beograd), Mal i Zi (Bar, Ulqin, Nikshiq, Podgoricë), Shqipëri (Korçë, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Pogradec), Greqi (rrethin e Kosturit dhe Lerinit) dhe Bullgari (Madan). Për fat të keq nuk kishim mundësi të kryejmë hulumtime terrenore në pjesën me te madhe të Greqisë, para së gjithash në Peloponez, Atikë, bregu i Detit Egje, ndërsa kemi edhe njohuri nga literatura, por edhe nga lidhjet farefisnore, se atje ekzistojnë pjesëtarë të kësaj bashkësie. Gjithashtu nuk arritëm të zbatojmë hulumtime terrenore edhe në pjesën evropiane të

Turqisë, edhe pse kemi të dhëna, para së gjithash nga lidhjet farefisnore, se edhe atje jetojnë pjesëtarë të kësaj bashkësie. Për shkak mungesash financiare hulumtime terrenore nuk u bënë as në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Autori në gusht të vitit 2002 ishte në vizitë turistike edhe në Egjipt.

Gjatë hulumtimeve terrenore u përdorën edhe metoda klasike të etnologjisë- intervista të lira (të pa standardizuara), anketa foto, video dhe audio dokumentim, si edhe vëzhgim. Studimi fillonte me intervista të pa standardizuara me pyetje, për njohurit dhe legjendat për prejardhjen, deklarinimin etnik, kufijtë etnik, profesionet, jetën familjare dhe shoqërore, njohuritë popullore, besimet, këngët dhe vallet popullore dhe doket popullore. Intervistat ishin të pa standardizuara sepse, në disa raste para së gjithash në Shqipëri dhe Mal të Zi, kur nxirrnim diktafon ose formular me pyetje të parapërgatitura, informatorët bëheshin të pabesueshëm. Në Maqedoni në vitin 2001 me ndihmën e aktivistëve të Shoqatës së Egjiptianëve është realizuar edhe një anketë socio-etnologjike, në qytetet Ohër, Strugë, Kërçovë dhe Resnjë. Anketa është kryer në bazë të pyetësorit të parapërgatitur (pyetësi është në favor të pjesës hyrëse) nga ana e autorit. Pyetjet në anketë ishin me karakter socio-ekonomik, demografik (studim i migrimëve), si dhe nga karakteri etno-gjeneologjik. Në pyetësorin anketues kishte pyetje për zanatet tradicionale, si dhe për elementet e ruajtura nga kultura materiale (veshje, stoli, interier i brendshëm, fotografi). Të mbushur janë rreth 1500 pyetësorë të cilët ndodhen në arkivin e Shoqatës së Egjiptianëve në Maqedoni, ndërsa rezultatet nga anketa janë përdorur në hulumtimin shkencor. Rëndësi të veçantë gjatë hulumtimit terrenor kanë pasur edhe pyetjet për gjeneologjinë, me çka i kuptonim lidhjet farefisnore dhe shpërndarjen e mundshme gjeografike të pjesëtarëve të kësaj bashkësie. Nga foto dokumentacioni në terren tentuam të gjejmë edhe fotografi nga koha më e vjetër, p.sh. nga gjysma e parë e sh.XX para së gjithash për të fituar njohuri të përcaktuara për veshjen tradicionale por edhe për karakteristikat fiziko-antropologjike.

Hulumtimet terrenore për kufijtë etnik, posaçërisht janë zhvilluar me refugjatet nga Kosova dhe Maqedonia, të cilët ndodheshin në kampet e refugjatëve “Stenkovec” dhe “Shuto Orizar” në Shkup, “Majski Cvet” në Strugë, por edhe në Mal të Zi në kampin “Konjic” në Podgoricë. Këto hulumtime terrenore zhvilloheshin me bisedë të pastandardizuar si dhe me vëzhgim të marrëdhënieve ndëretnike midis refugjatëve Romë, Egjiptianë dhe “Ashkali” të ikur nga Kosova.

Metoda e vëzhgimit posaçërisht është zbatuar gjatë vëzhgimit të dokeve kremto-re, gjatë vizitës të vendeve të shenjta (Sh.Marena në



Shqipëri, Sh.Naum në Ohër, Imaret në Ohër, tyrbe në Kosovë), si edhe gjatë vëzhgimit të dokeve dasmore në Korçë (Shqipëri) dhe më tepër vende në Maqedoni. Por vëzhgime kryheshin edhe mbi lagjet, shtëpitë dhe interiorin e brendshëm shtëpiak, artit të zbatuar popullor gjatë gjithë hulumtimit terrenor.

Nga hulumtimet terrenore është mbledhur foto material i pasur, i incizuar nga autori, por edhe i fituar nga informatorët. Një pjesë e vogël nga ai foto-material është e paraqitur si shtesë e punimit.

Audio materiali është incizuar me këngë dhe valle të njohura popullore të Ballkano Egjiptianëve nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova.

\* \* \*

Me qëllim që të zbulohen relacione të përcaktuara në kulturën e Egjiptianëve të Ballkanit me gjurmët e lëna nga kultura e Egjiptianëve të Vjetër, por edhe që punimi të fitoj një karakter antropologjik, janë bërë relacione analistike. Nga kjo u arrit deri tek analogji të përcaktuara, që nuk do të thotë se edhe shkaku për ato analogji është shpërngulja dhe kolonizimi i Egjiptianëve të Ballkanit, sepse njëri nga principet e antropologjisë kulturore e sidomos i evolucionistëve është se “në vende të ndryshme, në kohë të ndryshme, nën kushte të njëjta mund të paraqiten dukuri të ngjashme ose të njëjta”. Ato ngjashmëri dhe analogji, janë posaçërisht të dukshme dhe prezente në kulturën shpirtërore, e cila më së shumti i kundërshton kohës dhe nëse elemente të përcaktuara përjetojnë ndryshim, ata ndodhin në formën, dhe shumë pak në përmbajtjen dhe porosinë që duhet të tejbartet Божовиќ Р. 1996:156) ose në funksionin që ka.

Ajo ngarkon edhe përdorim të shkencave tjera si histori, arkeologji, gjeografi, linguistikë, demografi, etnoonomastik etj. me çka përcaktohet karakteri interdisciplinor i tezës së ekspozuar. Vlefshëm është të potencohet përdorimi i rezultateve shkencore nga fusha e arkeologjisë.

Arkeologjia dhe antropologjia/etnologjia duhet që midis veti të plotësohen sikurse edhe me historinë. Fotografia e fituar për gjendje të përcaktuar me ndihmën e arkeologjisë definitivisht mund të rrethohet me përkrahjen e antropologjisë, e cila si shkencë është e detyruar nga aspekti i vetë të ndriçoj edhe më tepër idetë për kulturën shpirtërore, materiale dhe shoqërore dhe grupet e zhdukura ose të asimiluara etnike. Henderson (Henderson G.1971) spikat se arkeologu është e detyruar të respektoj etnologjinë dhe njohuritë e saj për lidhjen e popujve që me shekuj kanë jetuar në territor të njëjtë. Prej këtu shihet se ekziston nevojë e barabartë për

bashkëpunim midis arkeologjisë dhe etnologjisë. Por pavarësisht nga ajo, arkeologjia mund të arrij qëllim përfundimtar vetëm nën kushte nëse me shkathtësi i përdor njohuritë e etnologjisë dhe mundësitë që ajo i ofron.

Etnonomastika, mundëson që më mirë të zgjidhen një varg problemesh në ndriçimin e më shumë pyetjeve etnologjike, si dhe pyetje në lidhje me evolucionin e emrave dhe të titujve dhe prejardhjen e tyre në përgjithësi. Duke e marrë parasysh lashtësinë e çrregullt të materialit onomastik, ai në vete përmban informata të çmueshme që hedhin dritë më të madhe në migrimet, etnoinvazionet, intensitetin e kontakteve të lloj llojshme kulturore. Në etnonomastikë pjesë të veçantë përfaqësojnë etnonimet përkatësisht emrat e grupeve etnike.

Për shkak të specifikës të hulumtimit tonë, që mundohet ti studioj historinë, kulturën, proceset dhe dukuritë tek Egjiptianët e Ballkanit, do të duhet të përdoren hyrje të ndryshme studiuese. Në tekst do të duhet të jenë të përfaqësuar etnonimet dhe toponimet; të dhënat historike dhe arkeologjike për vendosjen dhe praninë e kësaj bashkësie në Ballkan; përhapjen gjeografike; grupet etnike etnografike të kësaj bashkësie; problemi i gjuhës; identiteti etnik dhe paraqitja e mimikrisë etnike dhe identitetit të preferuar; kultura materiale (profesion, lagje, shtëpi dhe interier i brendshëm shtëpiak, ushqimi, stolitë dhe veshjet) ; kultura shoqërore (familje inokose, familje e zgjeruar, lloje të tjera organizimi) dhe kultura shpirtërore (dijeni popullore, medicinë popullore, krijimtari gojore popullore, arti i përdorur popullor, valle dhe këngë popullore, muzikë popullore, besime popullore dhe përkatësi profesionale dhe doke popullore).

Krejt tezat janë të nënshtruara në metodat e hulumtimit etnologjik dhe analizës. Qëllimi është që proceset dhe dukuritë të jenë të paraqitura sa është e mundur edhe më objektivisht, të liruar nga paragjykimet dhe të vetëdijshëm për “the double insider syndrom” si dhe pa dhënie të mëparshme të çfarëdo qoftë skemash.

## **BURIME DHE LITERATURË**

Nga bibliografia që ishim duke e përdorur doemos duhet të theksohen disa autorë të cilët edhe më shpesh do të citohen në këtë punim. Kështu për ardhjen e Egjiptianëve, në ndihmë të madhe kishim punimin e “babait të historisë dhe etnologjisë”, Herodot, i cili ka jetuar në shekullin e V p.e.r dhe i cili ka udhëtuar nëpër shumë vende të botës antike, dhe na jep njohuritë e tij për popujt, historinë e tyre, kulturën e tyre dhe traditat, ngjarjet dhe personat. Nëpërmjet veprës së tij “Histori” arritëm të mësojmë

për periudhën e vendosjes të kolonistëve Egjiptian në Ballkan, të rekonstruktivisht procese dhe ngjarje të përcaktuara, si edhe ta krahasojmë etno-kulturën e Egjiptit të Vjetër, doket dhe besimet që janë “marrë” në Ballkan nga Egjipti, si thotë edhe vetë Herodoti, si dhe kontinuitetin e etno-kulturës të Egjiptianëve të Ballkanit ta ndjekim në nivel të përcaktuar.

Në ndihmë të madhe kishim edhe literaturën arkeologjike, para së gjithash hartën Arkeologjike të Maqedonisë, si dhe punimet e egjiptologut kroat Petar Selem, dhe veprat e tij “Kultet Egjiptiane dhe përmendoret e tyre në Ilirikun Romak” teza doktorature (Selem P.1969) si dhe “Gjurmët te Izides” (“Izidinot trag”) (Selem P.1997). Në Kroaci është i botuar edhe libri “Egjipti në Kroaci” (Tomorad M.2003), i cili na ndihmoi për disa njohuri në lidhje me stilet që janë sjellë në Ballkan ndërsa prejardhjen e kanë nga Egjipti. Publikime të ngjashme ka edhe në Serbi (Anhelkoviĥ B.1991), Maqedoni (Bitrakova-Grozdanova V.1978) dhe në Shqipëri (Stipçevic A.1974). Pasko Kuzman është arkeolog i cili ka kryer edhe hulumtime për zbulim gjurmësh arkeologjike të Egjiptianëve të Ballkanit, dhe i cili qartë tregon se ekzistimi i hraveve të zotrave Egjiptian në Ballkan duhet të tërheq edhe ekzistim i supstratit popullor nga Egjipti (Kuzman P.1996;1998).

Kuptohet se në dobi kishim edhe literaturën që i është dedikuar bashkësisë rome, sepse aty mund të hasen një numër i madh të dhënash dhe informacione të cilat u janë përkushtuar pjesëtarëve të kësaj bashkësie, vetëm nëse mbetet imun ndaj paragjykimëve të lloj llojshme, si dhe kritikisht t’ju drejtohet të padrejtave “shkencore”. Në atë kuptim të dhëna të rëndësishme për gjithë shtetin e mëparshëm Jugosllav na jep Tatomir Vukanoviĥ (Vukanoviĥ T.1983,Romi (Cigani) u Jugosllaviju), i cili edhe për kundër asaj që pa asnjë argument vërteton se Egjiptianët janë Romë, ka material të vlefshëm etnografik për Romët në Jugosllavi, në të cilin mund të gjendet edhe për pjesëtarët e bashkësisë së Ballkano Egjiptianëve. Rajko Gjuriĥ (Đuriĥ R.1987, Seobe Roma-krugovi pakla i venac sreće) gjithashtu mundohet të shpjegoj se shumë bashkësi (grupe) të cilët flasin “gjuhë tjetër” dhe që deklarohen si “të tjerë, të ndryshëm nga Ciganët/Romët, më saktë paraqesin ashtu si ai i quan, Romë të shqiptarizuar, bullgarizuar të maqedonizuar etj.- e kishim në dobi sepse mund të përcillet zhvillimi i mendimit shkencor dhe hulumtimet e Romëve, e me të edhe konfuzionet që paraqiten në lidhje me përmendjen e Romëve dhe Egjiptianëve. Gjurgjica Petroviĥ (Petroviĥ Ĵ.1975. Cigani u srednjovekovnom Dubrovniku) na jep materiale të çmueshme për përmendjen e Egjiptianëve në Arkivin e Dubrovnikut, si dhe për përmendje të ngjashme në Ballkan në shekullin e XIII dhe XIV, por sipas asaj shkaqet e njohura pas 600 vitesh, deklarimet e qarta të njerëzve si Egjiptianë në shekullin e mesëm të vonshëm ajo i llogarit

si “rrymë jugperëndimore Romësh/Ciganësh). Tihomir Gjorgjeviq në edicionin 12-vëllimor “Jeta jone popullore” në librin e VI dhe VII, të botuara në vitin 1932 dhe 1931 jep të dhëna për Ciganët në Jugosllavinë e mëparshme, ndërsa për ne të rëndësishme janë shkrimet e tij për “Farkëtarët” në Mal të Zi dhe “Ciganët e bardhë” në Bosnjë dhe Serbinë perëndimore. Në bibliografinë e Andrejiq (Andrejĥ Л.1970, Prilog bibliografii o Ciganima) mund të hasen një numër i madh autorësh që shkruajnë për pjesëtarët e kësaj bashkësie, duke i klasifikuar në Ciganë/Romë, posaçërisht për Kosovën, Malin e Zi, Bosnja dhe Hercegovinë.

Edhe pse pjesëtarë të kësaj bashkësie në Bullgari janë në numër të vogël, megjithatë literatura shkencore e autorëve bullgarë gjithashtu ishte në dobi të madhe. Hulumtimet e Kënçovit (Кѣнџовѣ В.1900 (1996), Македония, етнография, статистика) edhe pse paraqesin lëndë të rëndësishme etnike për të gjithë bashkësitë që kanë jetuar në tërësinë territoriale dhe natyrale në Maqedoni në fund të shekullit XIX, mund të gjenden të dhëna edhe për pjesëtarët e kësaj bashkësie, para së gjithash në Maqedoninë e Egjeut. Edhe Kënçov nuk ka njohuri të mjaftueshme që ti përkufizoj “Gjupcite” dhe “Ciganët”. Punimi i Primovskit (Примовски А. 1955, Ковачите Агупти в град Мадан), ka domethënje kapitale për Aguptët e Rodopeve. Na jep një dëshmi të mrekullueshme se Egjiptianë ka edhe në territorin e Bullgarisë, por edhe për pamundësinë e shkencëtarëve që në kornizat e hulumtimit për Ciganët/Romët ta shpjegojnë problemin e Egjiptianëve në Ballkan. Na jep një përshkrim të mrekullueshëm për zanatin e farkëtarisë në Madan, legjenda që kanë të bëjnë me prejardhjen e popullit, proverbat popullore, si dhe pasqyrim të jetës shoqërore të Aguptëve në mesin e sh.XX. Punimet e Elena Marushiakova dhe Veselin Popov për hulumtimin e Ciganëve (edicioni më shumë vëllimor Studii Romani, si dhe “Ciganët gjatë periudhës të Osmanlive”) janë bibliografi e rëndësishme shkencore për etnologjinë e Ciganëve në Ballkan dhe Bullgari. Problemi i përmendjes të Kibtinjëve dhe Çingene në dokumentet osmane, në tekstin tentuam ta zgjedhim nëpërmjet botimeve dhe qëndrimeve të tyre që janë të shprehura. Letra e “Një Egjiptiani” nga viti 1867 që është shpallur në botimet e tyre është lidhje e rëndësishme e cila ndriçon shumë paqartësi historike për Ballkano Egjiptianët. Në punimet e Marushiakovës dhe Popovit, për dallim nga shkencëtarët e tjerë të cilët merren me hulumtimet për Ciganët/Romët, mund të shikohet hyrje krejtësisht e ndryshme kah problemi i përmendjes të “Egjiptianëve” në burimet historike, me atë se nuk e pranojnë qëndrimin apriori se bëhet fjalë për Ciganë/Romë dhe se

hulumtimet e ardhshme duhet ta sqarojnë këtë problem (Marushiakova&Popov 2000:19,20).

Literatura nga Shqipëria është shume e dobishme. Atje ekzistojnë autorë të cilët që nga fillimi i sh. XX, qartë i ndajnë Ciganët/Romët dhe Evgjitët/Egjiptianët si dy bashkësi të veçanta, njëra me prejardhje nga India, e tjetra me prejardhje nga Egjipti (Frashëri S. 1988, vepra I; Shkodra Z. 1973, Esnafët Shqiptarë; Nathanaili A. 1975. Studime Historike nr.2) edhe Akademia e Shkencave në Tiranë nëpërmjet institutit të vetë gjuhësor del me qëndrim të njëjtë (Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë-Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”). Qëndrimi i tillë i shkencëtarëve sigurisht i është borxhli edhe numrit të madh të pjesëtarëve të kësaj bashkësie në Shqipëri, por gjithashtu edhe parafytyrimit të qartë dhe situatës të pastër midis Egjiptianëve dhe Romëve në Shqipëri. Por, disa shkencëtarë të huaj megjithatë bëjnë ngatërrim (Hasluck M. 1938 “The Gypsies of Albania”) dhe konfuzionet e veta j’ua tejbartin hulumtuesve të tjerë (Kovacs J. 1997, No Record of the Case European Roma Right Center).

Pyetja e identitetit ndoshta është edhe problemi thelbësor i Ballkano Egjiptianëve. Teoria e Bartit (Barth F.(Ed) Ethnic Groups and Boundaries) e cila është quajtur edhe si “evolucion i Kopernikut në problematikën” (Hristov P. 2004:6) për grupet etnike dhe kufijtë, të cilët janë të vetmit të vazhdueshëm, ndërsa elementet e kulturës janë të ndryshueshme, më së tepërmi na ndihmoj që edhe pyetjen e identitetit të kësaj bashkësie nga aspekti shkencor ta vendojmë në bazë të vërtetë. Punimi dhe hulumtimet e kolegut Nedelkoviç Sasha (Nedelkoviç S. 2000 ”Antropološko” istraživanje jednog “etnologa” u “domaćoj” sredini: Egipćani u Beogradu) i përdorëm si matricë gjatë përpunimit të këtij problemi në këtë tekst. Por edhe punimet e sociologëve që na sublimon Marija Tasheva (Ташева М.1996, Етничкиот идентитет и етничкиот статус: Амерички искуства) vlefshëm na ndihmon në studimin e fenomenit të mimikrisë etnike dhe identitetit të preferuar.

Literatura e cila e trajton këtë bashkësi si të veçantë gjithashtu na ishte në dobi të madhe, për plotësimin e disa zbrazëtive nga hulumtimet terrenore na shërbeu edhe si mbështetje për të ditura të përcaktuara. Para së gjithash punimi i Stojan Risteskit “Народните приказни, преданија и обичаи кај Египќаните/Егупците во Македонија” (Tregimet popullore, traditat dhe doket e Egjiptianëve/Egjuptëve në Maqedoni), i cili është i pari që këtë bashkësi e trajton si të veçantë, si dhe punimet e Miodrag Haxhi Ristiç që në shumë shkrime i ka vendosur themelet për hulumtime shkencore etnologjike të Egjiptianëve. Përmbledhja e punimeve për

etnogjenezën e Egjiptianëve në Maqedoni, publikuar në vitin 1996, është përmbledhje e parë e tillë që përfshin punime nga më tepër hulumtues nga lëmi të ndryshme (etnologji, arkeologji, lingvistik, demografi, folkloristikë). Këtu me punime të veta përveç Haxhi Ristiq u paraqitën edhe Rade Bozhoviq, Pasko Kuzman, Robertina Ashuri, Emin Mamudoski, Arslan Saliu si edhe autori i këtij teksti. Autori i këtij teksti ka publikuar në vitin 2001 edhe libër me titull “Ballkano Egjiptianët-e vërteta për Egjiptianët nga Kosova dhe Dukagjini”. Nga autorë të tjerë që kanë punime në këtë temë vlen të përmenden edhe Luan Dino dhe Agim Muçaj nga Shqipëria, Haxhi Halil Krasnici dhe Ali Tam Berisha nga Kosova.

Nga shkencëtarët perëndimor që e kanë trajtuar këtë temë, por të cilët u paraqitën në skenë si pasojë e krizës së Kosovës janë Ger Dujzings (Duijzings G. 2000 Making of Egyptians in Kosovo and Macedonia) dhe Pol Polanski (Polansky P. 1999, The Gypsies of Kosovo). Autori i parë që mjaftueshëm mirë i njeh rastet në ish Jugosllavi dhe konfliktin e Kosovës, nga shkaqet politike ose të tjera është tendencioz dhe insiston të sqaroj se “paraqitja e papritur e Egjiptianëve” është “fryt i politikës serbe dhe intelektualëve maqedonas” me qëllim që “ta zvogëlojnë numrin e shqiptarëve në Kosovë”. I dyti gjithashtu e përpunon vetëm problemin e bashkësisë “RAE” në Kosovë mbas luftës në vitin 1999, në pjesën hyrëse është tendencioz dhe me përfundim se “Egjiptianët dhe Ashkalinjt janë në të vërtetë Romë të cilët flasin shqip”.

Në vitet e fundit Marsel Kourtiade paraqitet me disa punime që publikohen në Paris, që e trajtojnë këtë bashkësi si të veçantë, edhe pse në raste të përcaktuara etnonimet lokale i përdor për rajone gjeografike jo përkatëse p.sh. “Ashkalinjë në Shqipëri”, si dhe për Kosovë e përdor emrin “Ashkalo-Egjiptianë”. Në vitet e fundit edhe shkencëtarë nga Kosova kryesisht u bashkëngjiten në hulumtimet për këtë bashkësi në Kosovë, para së gjithash Skënder Rizaj (Rizaj S. 2003, Me çfarë kuptimi po përdoren emrat Egjiptianë, Ashkalinj dhe Romë?! ) dhe Muhamed Pirraku (Pirraku M. 1999, Kush janë Shqiptarët Egjiptianë Albanofonë?). Këto dhe disa shkencëtarë të tjerë nga Kosova, në mes të cilëve edhe autori, merr pjesë me punimet e tij në tribunën e rrumbullakët shkencore në dhjetor të vitit 2003 e organizuar nga organizatat e Egjiptianëve nga Kosova. Gjatë asaj në këtë tavolinë të rrumbullakët përdoreshin edhe termi “Shqiptarë-Egjiptianë” me arsyetim se Egjiptianët e flasin gjuhën shqipe dhe se ata janë pjesë e pandarë e popullit shqiptar?! Kuptohet se termi i tillë dhe ky arsyetim nuk mund të jenë shkenctarisht të përmbajtura, nga shkak i thjeshtë se Egjiptianët e Ballkanit në disa pjesë të Ballkanit edhe fare nuk e njohin gjuhën shqipe.

Martin Bernal, shkencëtari i njohur Britanez i cili ka doktoruar në Cambirge, por jeton në SHBA ne Cornwel University, në tetralogjinë të njohur të tij “Athina e Zezë: Rrënjët afro-aziatike të civilizimit klasik” (Black Athena: Afro-Asiatic roots of Clasical Civilization), na jep një dritë të mrekullueshme në periudhën para antike dhe antike në Ballkan, për migracionet dhe lidhjet që i ka pasur Ballkani me Egjiptin dhe influencën kulturore të Egjiptit në civilizimin klasik në Ballkan dhe Evropë. Ai na shpjegon dhe pse të vërtetat lidhur me migracionet afro-azitike, sidomos nga Egjipti dhe influencën e tyre në Ballkan, e cila ka qenë shumë e njohur nga autoret klasik, dhe në shekullin XVIII prej national-romantikanët do të fshihet nga historia dhe memoria kolektive.

Për hulumtimin shkencor u përdorën edhe një numër i madh burimesh historike të publikuara në botime të veçanta dhe periodike, enciklopedi dhe fjalorë nga më shumë shtete dhe institucione, revizioni i të cilëve mund të shikohet në bibliografinë.

## **PËRFSHIRJE KRONOLOGJIKE DHE AREALE E HULUMTIMIT**

Meqë etniciteti është “materie e gjallë” dhe ka evolucion të tij të përndjekur me procese dhe dukuri gjegjëse, ndërsa e njëjta vlen edhe për elementet veçse të etno-kulturës, atje ku është e mundshme do të ishte kryer edhe përshkrim kronologjik i tyre. Për shkak të specifikës së hulumtimit, ndërsa me qëllim që të bëhen krahasime të përcaktuara të elementeve të kulturës midis Ballkano Egjiptianëve dhe asaj të Egjiptianëve të Vjetër e domosdoshme është që në vende të përcaktuara të tregohen mendime të përcaktuara dhe njohuri të cilat janë të lidhura me Egjiptin e Vjetër, sidomos në pjesën e lidhur për religjionin dhe mitologjinë e Egjiptianeve të Vjetër, por edhe me pjesët e tjera nga jeta e tyre.

Hulumtimet terrenore përfshinin areal të gjerë duke nisur nga Serbia, Mali i Zi, Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Greqinë veriore (Maqedonia e Egjeut) deri në Bullgari. Kuptohet më sistematike dhe në sasi më të madhe ishin në Maqedoni, prej nga edhe rrjedh autori. Megjithatë nëpërmjet literaturës në hulumtime i përfshijmë edhe vendet e tjera Ballkanike, para së gjithash Greqinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

Struktura e paraqitjes është standarde dhe e përputhshme me qëllimet dhe detyrat e hulumtimit, me hyrje, katër kapituj dhe përfundim. Si shtesa të tezës janë: bibliografia, lista e informatorëve terrenor dhe fotografi.

## **EGJIPTIANËT E BALLKANIT/BALLKANO-EGJIPTIANË (ANALIZË E PËRGJITHSHME)**

### **ETNONIME DHE TOPONIME**

Për Ballkano Egjiptianët ekzistojnë më tepër pyetje dhe probleme të pasqaruara shkencore dhe etnologjike, të cilat këtë bashkësi e bëjnë të jetë misterioze, e keqpërdorur por edhe e mohuar për shkaqe dhe interesa të ndryshme, të pakuptueshme, ndërsa disa herë edhe tejet të kuptueshme. Problematika me etnonimet është një ndër pyetjet më komplekse për këtë bashkësi etnike. Varësisht nga rajoni në Ballkan, gjuha dhe domethënia etimologjike, etnonimet mund të klasifikohen në më tepër mënyra.

Në radhë të parë këtu janë etnonimet të cilat tregojnë direkt në Egjiptin: Gjupci, Egiupci, Jupci, Ejupci (**Ристески, С.** 1991: 10), Ojupci<sup>1</sup> në Maqedoni; Aguptë (**Примовски, А.** 1955) në Rodopet në Bullgari; Gjup, Egiup, Evgjit, Jevg në Shqipëri, ndërsa Magjup në Kosovë sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, në gjuhën shqipe. Etnonimet e tilla të cilat janë të lidhura me emrin e Egjiptit ekzistojnë edhe në Greqi-"Giftoi"<sup>2</sup> Spanjë-"Gitanos", Francë-"Gîtans", Britaninë e Madhe dhe SHBA-"Gipsi"<sup>3</sup> (**Марушиакова, Е., Попов, В.** 1993: 9). Bash me këto etnonime në vendet e lartë përmendura në shoqërinë dhe literaturën shkencore janë të identifikuar edhe Romët. Shumë vështirë është që nëpërmjet etnonimeve të bëhet determinim dhe dallim, a bëhet fjalë dhe a mendohet për pjesëtarë të bashkësisë rome ose ballkano-egjiptiane. Pse, si dhe nga kush ka ardhur deri në këtë konfuzion dhe bashkidentifikim me këto etnonime të dy bashkësive të ndryshme vështirë është të konsolidohet, por ekzistojnë më

---

<sup>1</sup> Etnonimi Ojupci përdoret në rajonin Gollo Brdo, hulumtime terrenore.



tepër supozime. Tatomir Vukanović (**Вукановић, Т.** 1983: 15), dhe shumë autorë të tjerë nga vendet e mëparshme Jugosllave, nuk bëjnë fare dallim midis Romëve dhe Ballkano Egjiptianëve dhe apriori pohojnë se edhe përtej asaj se ekzistojnë dy dallime themelore midis etimologjisë të etnonimeve, bëhet fjalë për bashkësi të njëjtë. Edhe Vasil Këncov (**Кѣнчов, В.** 1996/1900: 144) nuk mund të bëjë dallim midis Ciganëve dhe Gjuptëve/Egjuptëve edhe pse në përshkrimin e tij të Ciganëve ka mjaft kontradikta parë nga aspekti i sotëm për këtë problematikë. Anastas Primovski, edhe pse e fillon temën për kontradiktat me etnonimet Aguptë dhe Ciganë, nuk ka mundësi dhe njohuri të mjaftueshme që ata ti shpjegoj (**Примовски, А.** 1955).

Megjithatë, në mendimin shkencor në Shqipëri, mund të hasim disa shkencëtarë që vërtetojnë se të dy etnonimet tregojnë në dy bashkësi të ndryshme. Zija Shkodra (**Shkodra, Z.** 1973: 129), i cili thotë se ekzistojnë grupe Evgjitësh (Ciganë) të cilët janë të ndarë në dy kategori: Arigjinjë Endacakë ose Gabel me prejardhje nga India dhe Jevgjitë joendacakë (Magjupë) me prejardhje nga Egjipti dhe Sudani. Diçka të ngjashme ka shkruar edhe Andrea Nathanaili (**Nathanaili, A.** 1975) i cili e citon edhe shkencëtarin grek Kosta E.Biris (**Biris, K.** 1954) për librin e tij me titull “Romët dhe Giftosët” dhe ku ka shkruar se Giftosët kanë ardhur nga Egjipti, ndërsa Arigjinjë kanë prejardhje indiane. Qëndrim të njëjtë ka marrë edhe Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë në Akademinë e Shkencave Shqiptare në Tiranë, i cili bën distinkcion dhe diferencim të qartë të etimologjisë të etnonimeve Evgjit dhe Cigan<sup>2</sup>.

Qëkur, në Maqedoni, e më vonë edhe në viset tjera Ballkanike filloj të zgjohet vetëdija etnike e Egjiptianëve edhe shkencëtarët filluan të mendojnë për të pathënat dhe kontradiktat e këtij fenomeni dhe problemi me etnonimet. Stojan Risteski (**Ристески, С.** 2000: 15) thotë se identifikimi i Egjuptëve/Egjiptianëve me Ciganët/Romet është që nga koha më e vjetër, është si rezultat i asaj që deri në sh.XVII nuk është ditur për prejardhjen e Romëve, a kanë ardhur nga Egjipti ose nga India. Për shkak të ngjyrës së lëkurës, të ngjashme me të Romëve/Ciganëve këto dy grupe kanë qenë të ngatërruara, më saktë të barazuara dhe të emëruara. Deri në

<sup>2</sup> Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, “Fjalor i gjuhë së sotme shqipe”, Tiranë, 1980,439: “Evgjit,/i m.sh./ë, /ët 1. Pjesëtar i një grupi banorësh të disa qyteteve të vendit tonë e të vendeve të tjera të Ballkanit, prejardhjen e të cilëve populli e lidh me Egjiptin...”. Në faqen 221, për fjalën “Cigan/ciganët- pjesëtar i një populli me origjinë nga India veriperëndimore, të cilat veten e quajnë “Rromë, jetojnë në mënyrë endacake në Evropë dhe në disa vende të Azisë dhe Afrikës.

konfuzion ka ardhur, ashtu siç thotë Risteski edhe për shkak të asaj që në sh.XIV në Egjipt të Vogël, në Peloponez ka depërtuar një pleme Romësh.

Rade Bozhoviq (**Божовиќ, Р.** 1996: 154) në vitin 1990 në mbledhjen shkencore për kulturën islame në Maqedoni, në lidhje me etnonimet del me këtë qëndrim: “Në literaturën që e shikua, pa pretendime për shterje të plotë, qartë rrjedh se në vise të ndryshme evropiane etnonimet “Egjiptianë” dhe “Romë” ose “Ciganë” janë thurur përkatësisht identifikuar. Shkaku për këtë edhe pse për ne paraqitje e çuditshme e sinkretizimit linguistik disa kanë tentuar ta shpjegojnë me ardhjen e Romëve nga Limanet Levatine dhe Aleksandria”. Tek ne, duke filluar nga letërsia e Dubrovnikut e deri tek etnologët, thuhet se “Ciganët emërohen edhe si Egjiptë sipas Egjiptit”, dukuri që nuk është karakteristike vetëm për pjesën bregdetare të Adriatikut, por është e vërejtur edhe në Dibrë. Nga onomastikoni i njëjtë, që është interesante, nxirret edhe emër (etnonim kushtor) për Egjiptianët e krishterë të sotshëm, që mandej ka dhënë emër që sot është përgjithësisht i pranuar-КОПТ. Megjithatë, ai emër me variant КОПТ në gjuhën turke përdoret që të tregohet etnosi Romë. Vetë kjo rrëmuje na kujton në këngën popullore epike “Banoviq Stahinja”, në të cilën kundërshtari trim i Strahinjës i paraqet nën tre emra të ndryshëm ose me fjalë të tjera etnonime. Rrëmuja, me gjasë, është paraqitur diku në sh.XIV, së paku sipas disa burimeve që merren me etimologjinë e kësaj fjale”. Mandej Bozhoviq nën fusnotë shpjegon më tepër se në dokumentet turke në Bosnjë nga sh.XVI përdorin etnonim Ciganë, ndërsa në rrethin e Manastirit në sh.XVII përdorin Kibt. Mandej flet se disa dokumente nga Jajce nga shekulli i njëjtë më kanë përdorur Kibt, i cili etnonim është shtrirë dhe përdoret edhe në sh.XIX.

Miodrag Kalendar Haxhi Ristiќ (**Хаџи Ристиќ, М.** 1996: 108) është i pari i cili trimërisht bën ndarje të qartë të etnonimeve midis Egjiptianëve dhe Romëve “...duke nisur nga studimet për etnologji, mandej deri në kohën e sotshme, e veçanërisht në kornizat e specialitetit më të ngushtë”-Etnologjia e popujve josllave në Ballkan, më tepër herë paraqitet dhe takohemi me faktin se ekzistojnë indikacione të vërtetuara absolutisht, për njëfarë grupi të veçantë etnik që dallohet nga Ciganët-Romët, por ka edhe emra-etnonime të tjera, të ndryshme, të cilat si emra popullor hasen dhe përdoren në Maqedoni, tek Maqedonasit dhe atë: Egjiptin-Egjupci, Gjupin-Gjupci, Ejup-Ejupci por edhe Kovaç-Kovaçi (Farkëtarë), Ashkali (jaglenarë-qymyrgjinjë edhe në Kosovë dhe Dukagjin, ndërsa edhe në një pjesë të Maqedonisë Perëndimore) mandej, Ciganë të Bardhë (edhe në Serbi) Kaur Ciganë (para së gjithash të krishterë-ortodoks), Meser Mangri (Meser në gjuhën turke është emër për Egjiptin), Kopt-Koptë (në gjuhën

arabe domethënë banor i Egjiptit)... Mandej, në Shqipëri ose tek Shqiptarët e Kosovës dhe në Dukagjin përdoren emrat-etnonimet Gjup, Egjup, Magjup...”

Imperativ për hapin e tillë guximtar nga rrethi i magjepsur i Haxhi Ristiqtit me siguri ka qenë qëndrimi i Institutit të gjuhësisë dhe letërsisë i Akademisë të Shkencave Shqiptare për përcaktuesit “Evgjit” dhe “Rom” i cili pasi i citon do të komentoj: “Padituria nuk arsyeton-ti dinim këto të dhëna edhe më parë do të qëndronim pas supozimit për ekzistimin e Egjiptianëve në Ballkan”. Në vazhdim Haxhi Ristiqt, konstaton se është e nevojshme të dilet nga shumë gënjeshtër, gabime, mashtrime që janë bërë me dëshirë ose pa dëshirë, e gjithçka për faktin që të kërkohet, të gjendet dhe të dëshmohet e vërteta shkencore, nëpërmjet ristudimit të literaturës më të vjetër, ashtu edhe literaturës bashkëkohore profesionale-shkencore historike dhe etnologjike, sepse kjo bashkësi etnike mund të parandjehet në monografi të ndryshme, si ekziston, por është e klasifikuar në të tjera-qoftë Maqedonas, qoftë Turq, Romë, Arnaut, gjatë asaj duke mos bërë fare llogari për jetën dhe doket, mjeshtrëritë dhe profesionet, shtëpitë dhe interiorin e brendshëm shtëpiak, veshjet dhe stolitë, ushqimin, elementet e tjera nga kultura materiale, shoqërore dhe shpirtërore (**Хаџи Ристиќ, М.** 1996: 109)..

Haxhi Ristiqt e përshkruan edhe konfuzionin që është paraqitur në sh.XIV me paraqitjen e grupeve “Të zinj” të cilët janë prezantuar në dy mënyra të veçanta: njëra si “Banorë të Egjiptit të Vogël të Peloponezit” me origjinë nga emigrantët Egjiptianë me ushtarët nga legjionet e Aleksandërit të Madh, si zanatçinjtë farkëtarë, e të cilët më vonë janë përzier me grupet nomade-endacake-cergare Cigane: ndërsa të tjerët të cilët lëvizin nëpër Ballkan kah Evropa e mesme në grupe më të vogla me karroca kuajsh dhe janë prezantuar si pleme, kontë dhe udhëheqës me letra mbrojtëse dhe me përmbajtje se kanë ikur nga Egjipti para pushtuesve osmanë, sepse nuk kanë dashur të pranojnë islamin dhe janë të mallkuar dhe të dënuar në endje dhe jetë mizore (**Хаџи Ристиќ, М.** 1996: 119-120). Legjendë e ngjashme e të dënuarit për jetë endacake dhe të mjerë është e lidhur edhe me Jezu Krishtin, me arsyetim se ata janë të mallkuar se i kanë farkuar kunjët me të cilat Jezu Krishti ka qenë i varur (**Божовиќ, Р.** 1996: 155).

Elena Marushiakova dhe Veselin Popov (**Марушиакова, Е., Попов, В.** 2000: 19-20) janë me qëndrim hipotetik, dhe propozojnë se në sh. XIV behet fjalë për dy migrime “cigane” njëra “Cigane” që ka ndodhur më parë dhe kalon nëpër Konstantinopol kundrejt Bullgarisë, Serbisë, Vllashkë dhe Moldovë, ndërsa tjetra e të ashtuquajturve “Egjiptianë” e cila kalon nëpër Egjipt të Vogël dhe më vonë vjen në Ballkan. Pasardhësit e

kësaj rryme ndoshta janë bashkësitë që i mbajnë etnonimet e varianteve të ndryshme “Egjiptianësh” të cilët e kanë humbur gjuhën e tyre dhe përkufizohen nga Ciganët e tjerë në Ballkan. Gjithsesi, Marushiakova dhe Popov, shpresojnë se zbulimi i burimeve të reja historike ose rileximi i burimeve historike tashmë të njohura do të dëshmoj se sa bazë ka që të propozohet përkufizim i tillë i migrameve në Ballkan.

Gjithsesi, në shkencë mbeti edhe më tutje e pavërtetuar pyetja përse vjen deri në përthurje të etnonimeve të lidhura me Egjiptin midis këtyre dy bashkësive të veçanta etnike. Disa autorë e kanë datuar periudhën e konfuzionit, e ajo është sh.XIV d.m.th. koha kur Romët masivisht hyjnë në Ballkan dhe Evropë, edhe pse ekzistojnë argumente se grupe më të vogla Romësh kanë qenë prezent në këto rajone edhe para sh.XIV. Marsel Kourtijade (**Courthiade, M.** 2002: 79; 2003: 64; 2003-2004: 3) në një statii të tij do të shkruaj se identifikimi i Romëve me etnonime të cilat janë të lidhura me Egjiptin, përkatësisht përbërja e legjendës për prejardhjen Egjiptiane, për romët kishte prestigj më të madh dhe kishin përparësi më të madhe në integrimin e tyre në vendet evropiane. Me kalimin e kohës, kjo legjendë edhe e zëvendësoj të vërtetën për prejardhjen indiane, deri në vitin 1770 kur prifti Valui Ishtvan nga Transilvania, nuk e parashtroj përsëri tezën për prejardhjen indiane mbi bazë të hulumtimeve komparative linguistike. Në fusnotë Kourtijade sqaron se sipas disa dokumentesh Vatikane që prej fillimit të sh.IV (viti 306-338) në Ballkan kanë ekzistuar popuj nga Egjipti.

Mendimi ynë për këtë rrëmujë në esencë është i ngjashëm me të Kourtiades. Në tekstin e mëtejshëm do të shihet se në Ballkan, Egjiptianët kanë ardhur dhe kanë ekzistuar shumë kohë para se të vinë Romët/Ciganët, dhe para sh.IV edhe dokumentet Vatikane që i përmend Kourtiade, të cilat kanë gëzuar respekt të përcaktuar midis popullatës të atij rrethi dhe i kanë banuar qendrat e qyteteve dhe fshatrave. Deri në këtë konfuzion me siguri ka ardhur nga këto shkaqe: Romët, me më tepër specifitete, si popull endacak në historinë dhe traditat e popujve nga shkaqe të ndryshme nuk kanë qenë aq mirë të pritur nga popujt, kur kanë mbërrirë në Ballkan dhe Evropë. Për atë ekzistojnë një numër i madh besimesh të kota popullore, enigma, përralla, paragjykime dhe stereotipe, por edhe ligje të sjella nga shtete të përcaktuara Evropiane (**Вукановић, Т.** 1983: 61-63), me norma diskriminuese. Romët që të mund t’ju largohen gjërave të panumërta të papëlqyeshme dhe të mund të integrohen dhe të afrohen deri tek populli me siguri kanë qenë të detyruar të prezantohen si Egjiptianë, sepse sipas ngjyrës së lëkurës janë të ngjashëm me to. Ky përvetësim i etnonimeve, mimikria etnike dhe prezantim i rrejshëm, deri në ditën e sotshme ka pasoja në

shoqërinë, shkencën, më së fundi edhe në politikën shtetërore dhe ndërkombëtare të shteteve të përcaktuara.

Në këtë kuptim, vlefshëm është të thuhet se etnonimet të cilat janë të lidhura me Egjiptin për pjesëtarët e Ballkano Egjiptianëve janë endonime, ndërsa për Romët ato janë egzonime d.m.th. ai emër ju është dhënë nga popujt e tjerë të rrethinës, e ata vetë nuk e kanë përdorur dhe nuk e përdorin.

Tek pjesëtarët e bashkësisë etnike të Ballkano Egjiptianëve ekzistojnë edhe emra etnik të cilat janë të lidhura me profesionin që kanë punuar. Ata emra janë Kovaçë (Farkëtarë), Ashkalinj dhe Esnafë.

Etonimi Kovaçë përdoret në Mal të Zi, dhe atë më së tepërmi në qytetet Ulqin dhe Bar. Ata emrin Farkëtar e përdorin si identifikim etnik si një lloj veçantie nga Romët, Malazetët dhe Shqiptarët. Tihomir Gjorgjeviq në vitin 1933 për ata ka shkruar: "Ne Ulqin p.sh. Ciganët e atjeshëm nuk kanë ditur gjuhë Cigane; flasin vetëm arbanisht dhe shumë pak serbisht... Ato nuk pranojnë se janë Ciganë dhe e marrin si ofendim kur dikush ashtu do ti quaj. Për shkak se e dinë se nuk janë as Serb, as Arbanas, ato thonë se janë Farkëtarë. Se janë Ciganë duket nga ajo se meshtarët i njohin vetëm si Cigane, i quajnë Magjup siç i quajnë edhe në shumë vende të tjera, ndërsa mëhallën e tyre Mëhallë Cigane (arbanisht Mëhalla Magjupe). As edhe Ciganët në Bar, nuk e tolerojnë emrin Ciganë, por deklarohen si Kovaçë..." (Ђорђевић, Т. 1933: 9-10).

Nga hulumtimet tona terrenore të kryera tek kjo bashkësi në Bar dhe Ulqin, në Shtator të vitit 2001 dhe Janar të vitit 2003 morëm vesh se teksti i tillë i Tihomir Gjorgjeviqit, në vitin 1933 ka qenë lëndë për protestë të pjesëtarëve të kësaj bashkësie të drejtuar kah Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, se krejtësisht gabueshëm është e prezantuar kjo bashkësi me atë se është e klasifikuar midis Ciganëve<sup>3</sup>.

Megjithatë, deri në një dëshmi të tillë me shkrim nuk arritëm të arrijmë. Në librin "Memoaret e Kralit Nikolla", përmendet se me Dekretin Krali Nikolla ndalon që këto njerëz të thirren Ciganë, por vetëm Kovaçë. Megjithatë, sot, nga hulumtimet terrenore pamë se gjeneratat e reja shumë pakë dinë pse ka mbetur emri Kovaçë në Ulqin dhe Bar, por kurrsesi nuk pranojnë se janë Ciganë/Romë. Ndaj terminin Egjiptianë nuk kanë refuzim por kanë rezervë.

Emri Ashkalinj përdoret në Fushën e Kosovës, por edhe në Maqedoni në Skopsko pole (Fushën e Shkupit) dhe Tetovë, me siguri sepse këta njerëz janë shpërngulur në këto vende nga Fusha e Kosovës. Para krizës Kosovare dhe ndërhyrjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë, etnonimi Ashkali ishte

<sup>3</sup> Nuro Behareviq, Bar, lindur në v.1925, hulumtimet terrenore, shtator v.2001.

i njohur vetëm në rrethet shkencore që merreshin me hulumtimet e Romëve dhe Egjiptianëve. Për etimologjinë e emrit Ashkali ekzistojnë më tepër sqarime por edhe non-sensa, duke filluar nga ajo se prejardhja është nga qyteti Eshalon, i cili ndodhej në Lindjen e Afërt, sipas disave se është gjendur diku në Iran, e deri tek non-sensi i tretë, i cili thotë se bëhet fjalë për popullatë e cila ka ardhur nga Italia, dhe fjala Hashkalij në gjuhën shqipe ka pas domethënien “Hajt shko në Itali”. Te gjitha këto sqarime non-sense janë të paramenduara menjëherë pas ndërhyrjes së UMNİK dhe KFOR në Kosovë, me qëllim që të sqarohet ekzistimi i veçantisë të Ashkalijve nga Romët dhe Egjiptianët. Rajko Gjuriq, thotë se etnikonet Ashkal, Ashkali janë përmendur nga shkrimtarët osiental dhe vizantologët në diskutimet për Sllovenët dhe Antët (Đurić, R. 1987: 68), megjithatë nuk jep asnjë lloj indikacionesh për atë. Diskutimet për Sllovenët dhe Antët në literaturë mund të datohen nga sh.IV-VI – Qëndrimi ynë për domethënien etimologjike të emrit Ashkali, është se ai vjen nga fjala Ashka ose Eshka, një lloj qymyr druri i cili është përpunuar për ndezje dhe djegie të zjarrit Farkëtar. Prej këtu është edhe emri Ashkali për njerëzit të cilët i kanë përpunuar eshkët.

E përmendëm ndërhyrjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë, si një lloj kthese. Një pjesë e madhe nga këta njerëz në Kosovë nga ai moment deklarohen për Ashkalinj si bashkësi e veçantë, e ndryshme nga ajo rome, por edhe nga ajo egjiptiane. Për identitetin do të flasim më vonë, ndërsa tani vetëm do të tregojmë kush dhe si e përdor këtë etnonim. Në terren ky etnonim përdoret vetëm në Fushën e Kosovës, ndërsa nuk përdoret në Dukagjin, ku përdoret etnonimi Magjup. Shpjegimi popullor është se Romët jua kanë dhënë këtë emër Egjiptianëve, sepse ata janë ndarë prej tyre, ndërsa kanë qenë të zi si Romët. “Ash” sipas shpjegimit popullor ka pasur domethënie “i zi”, ndërsa “kali”ne shqip domethënë kal (ash-kali: kal i zi). Megjithatë në gjuhën Rome “Kali” domethënë i zi, ndërsa “Ash” domethënë “ndalohu”, ashtu që fitojmë “ash-kali:ndalohu i zi”. Te popujt ballkanik pasthirrma “ash” më tepër përdoret si turqizëm që të thuhet se “nuk ka më” (p.sh. kur fëmija kërkon më tepër ushqim, si përgjigje është dhënë “ash” nuk ka më u harxhua) por “ash” përdoret edhe kur dikush përzihet (ash prej këtu-aj, shko, ik prej këtu).

Në shkencë vetëm Marsel Kourtijade doli me qëndrim të qartë për pyetjen e etnonimit Ashkalinj, në statinë e tij “Ju thoni Ashkali, unë mendoj Egjiptianë” nëpërmjet të së cilës qartë thotë se etnonimi Ashkali është një ndër etnonimet, e ndoshta pseudonimet për Ballkano Egjiptianët.

Emri Esnafë përdoret gati në të gjithë pjesët e Ballkanit. Sepse, numri më i madh i pjesëtarëve të kësaj bashkësie, në të kaluarën janë marrë

me zanate-mjeshtëri, të cilët e kanë përpunuar/shfrytëzuar metalin, me siguri ata i kanë takuar një zanati të njëjtë esnaf<sup>4</sup>, pra prej aty janë vetë identifikuar me emrin Esnafë. Nga ana tjetër te popujt ballkanik kur thuhet “njeri esnaf” nënkuptohet i ndershëm, punëtor dhe njeri shtëpiak. Prej këtu me siguri pjesëtarët e kësaj bashkësie me këtë emër kanë dashur të bëhet dallim midis tyre dhe Ciganëve, të cilët në të kaluarën më së shumti kanë qenë endacak-cergarë. Edhe me këtë emër si edhe me etnonimin Farkëtar në Mal të Zi, nëpër shekujt është dëshiruar që të ruhet bashkësia nga situatat e pa dëshiruara dhe të paparashikuara për barazimin e kësaj bashkësie me atë rome, si kufo etnik-psikologjik kolektiv dhe barrierë.

Në vendet Ballkanike ekziston edhe një etnonim i cili ka shkaktuar konfuzion dhe me të cilin janë shfrytëzuar edhe pjesëtarët e bashkësisë Rome. Ai është etnonimi Firaon, Farvan e diku përdoret edhe si Virga (**Ђорђевић, Т.** 1933: 122-144). Vet etimologjia e fjalës qartë tregon se ka prejardhje nga Egjipti d.m.th. Faraonët Egjiptianë, të cilët kanë qenë të vetmit në botë. Por, nga literatura ky emër mund të shihet si etnikon, në sasi të madhe është përdorur nga Romët, me siguri ashtu si sqaruam më parë me qëllim për status më të mirë të tyre në shoqëri.

## TOPONIME

Në vendet Ballkanike ekziston edhe një numër i madh toponimesh të cilat dëshmojnë për prezencë njerëzish me prejardhje nga Egjipti. Megjithatë, në literaturën shkencore dhe të tjera, një numër i madh i këtyre toponimeve janë përvetësuar dhe treguar se janë pjesë nga onomastikoni i bashkësive tjera etnike. Një shembull i tillë eklatant është autori T. Vukanoviç, i cili disa toponime, të cilat sipas logjikës së punëve nuk mund të bien në toponime Rome, ku edhe në disa raste deri diku edhe vetë autori tregon. Kështu p.sh. si përkujtim më të vjetër toponim Ciganësh e përmend “Kibti tash” që e komenton si “gur Cigan”. Në dorë më të vogël, sqarim i toponimit “Kibti tash” do të jetë “guri Koptik”, i cili si toponim ndodhet në Pollogun e Poshtëm në grykën e malit Devern, në hyrjen e lumit Vardar, ku ka pasur rrugë që nxjerr deri te kodra Kibti tash, ndërsa përmendet në Vakufnamin e xhamisë të Teqe Mëhallës në Tetovë, prej 20 Mars 1463. Nëpër gjithë konfuzionin e autorit T.Vukanoviç për sqarimin e lashtësisë të këtij toponimi, ndihet se edhe vetë autorit nuk i është e qartë si Koptët (të

<sup>4</sup> Në Ballkan nëpër qytetet kanë ekzistuar më tepër esnafë mjeshtër-farkëtarë, rrobaqepës, këpucëtar, kallajgji, etj.

cilët sipas tij kanë ardhur në sh.XIV!?) aq herët të marrin legjitimitet toponim. Përveç të tjera në Maqedoni e përmend edhe Kodrën Egjupte në fshatin Qolloshevë, Veles, dhe Kodër Egjupte në atë të qytetit Shkup. Në pjesët e tjera të shtetit të mëparshëm Jugosllav autori T. Vukanoviq i përmend edhe këto toponime”

-Në rajonin gravitacion të Nishit: **Kiptijan Mahallë** dhe **“Boraques des Egjipties”** në planin e qytetit Nish nga viti 1737.

-Në Poljanicë, Serbi, toponim **Jegjupkë**, në pyllin ahor dhe dushku në Golemo Sello (Fshat i Madh)

-Në Mal të Zi, toponim **Mazhgjan (Magjup)** në trevën Stijene, te fisi i Piperëvë.

-Në Banat, në vendin Jasha Tomiq, ndaj kufirit Rumun ekziston toponim **mahallë Faraone**.

Në literaturën shkencore mund të hasen edhe toponime tjera të panumërta, të cilat janë të shkruara në monografi të ndryshme dhe harta arkeologjike. Shembull në hartën arkeologjike të Republikës të Maqedonisë mund të gjenden këto lokalitete:

- Lokalitet **Kovaçilnica** (Farkëtari), 7km në lindje nga Berova, Maleshevi, majtas nga shtrati i lumit Bregallnic, në lartësi të fshehur në vendin malor, si lagje e konsoliduar nga koha e hekurit, e vonshme antike dhe shekulli i mesëm.

- **Kovaçka çuka** (Gur Farkëtarie), lokacion qyteti messhekullor, 4km në jug nga Berova, në majë guri të lartë me pozitë dominuese, e rritur me pyll pishor.

- **Varrezat e Arabëve**, fshati Budakovë, Manastir, nekropol nga koha romake dhe shekullit të mesëm.

- **Varrezat e Arabëve**, 1km në veri nga fshati Dobromir, Manastir, lagje nga koha e neolitit.

- **Rosulla-shtepi Egjupte**, lagje nga koha e vonshme antike, në lindje nga fshati Dvorci, Makedonski Brod.

- **Kovaçilnica** (Farkëtari), xeherore e shekullit të mesëm, në lindje nga fshatit Rabrove, Vallandovë.

- **Samakov**, lagje xeherore e shekullit të mesëm 3.3 km nga fshati Serbinovë, Gostivar.

- **Majdanishtë**, lagje dhe shkritore nga koha e vonshme antike, mbi fshati Zhvan, Demir Hisar.



- **Gjupski Rid** (Kodër Gjupte), lagje nga periudha e hershme Krishtere, 2km në lindje-veri nga fshati Drenovë, Kavadarç.
- **Star Zadel-Edjupski Doll**, depo e monetave të argjendit nga koha romake, fsati .Llazarovc, Kërçovë.
- **Kodër Cigane (?!)** lagje nga koha e neolitit, hekurit dhe Romake, në vetë hyrjen e fshati Orizar, Koçan.
- **Gjupski Grobishta** (Varrezat e Gjupve), nekropol e shekullit të mesëm, 500m.në lindje nga fshati Presil, Krushevë.
- **Jegjupka**, lagje nga koha e vonshme antike, fshati Orashac, Kumanovë.
- **Kovaçevac**, lagje nga koha e hekurit, fshati Pelinc, Kumanovë
- **Kovaçnica**, shkritore dhe farkëtari e shekullit të mesëm në 1.5km në perëndim nga fshati Slivovë, Ohër.
- **Kovaçevo**, lagje nga koha e vonshme antike, 3km në lindje nga fshati Vitolishtë, Mariovë.
- **Gjupsko kale**, kështjellë nga koha e imperializmit maqedonas, në 1.2 km nga fshati Slepçe, Demir Hisar, në lindje prej majës Sokolički Kamen, me mbeturina nga kështjellë e vogël.
- **Gjupsko maalo**, lagje nga koha romake, fsh. Staro Lagovo, Prilep.
- **Arapski Grobishta**, lagje me shkritore nga koha e vonshme antike, në rrëzën e Pelisterit, në 2 km nga fshati Podmoçan, Resnjë.
- **Arapski Grobishta**, nekropola e shekullit të mesëm, fshati Pokrvenik, Resnjë.
- **Ciganski grobishta**, bazilikë e vjetër krishtere dhe nekropola e hershme e shekullit të mesëm, në anën lindore nga fshati Ladorishtë, Strugë. Edhe përtej asaj që në vetë hulumtimet terrenore, te populli nga rrethina e Strugës, ky lokalitet është i njohur si **Varrezat e Egjupve**, nuk e dimë për cilat arsye, në literaturën arkeologjike, lokaliteti është emëruar në Varreza Cigane.
- **Arapski grobishta**, nekropola para kohës të Aleksandërit, në juglindje nga fshati Shum, Strugë.
- **Gjupski grob**, nekropol në fshati Ilinë e Madhe, Debërcë.

Në pjesën jugperëndimore të Republikës të Maqedonisë ekzistojnë edhe toponime të tjera që mund të lidhen me Egjiptianët, si p.sh.:

- **Egjupsko sredselo** (Mesfshat Egjupte)-vend, para hyrjes në klisurën e lumit Sateska, në anën e djathtë nga rruga Ohër-Kërçovë.
- **Egjupsko selo** (Fshati i Egjupve) -vend 500m.në lindje nga mesfshati Egjupt, në afërsi të së cilës në lartësi gjendet xeherore e braktisur hekurit.

- **Egjupski grobishta** (Varrezat e Egjupve) -nga ana e kundërt e spitalit ortopedik-traumatologjik Sh.Erazmo në Ohër, te parkingu i sotshëm.
- **Egjupski pat** (Rrugë egjupe) -rruga e vjetër midis fshatrave Bellçishtë dhe Ozdolen, Debërc.
- **Egjupstak**-lokalitet nën fshatin Crvena voda, Debërc.
- **Egjupnica** -vend në pjesën veriperëndimore prej fshatit Vishnje, Strugë.
- **Veliocë**-vend në fshatin Llaktinje, ku kanë jetuar familje Egjiptiane me mbiemër Veli.
- **Egjupsko selo** (Fshat i Egjupve) -përmendet në “Parusia ot Deborskia monastinja Ivan Preteqa” viti 1833, me siguri është gjendur në shpatin lindor të malit Stogovë.
- Në lokalitetin **Egjupski Grobishta** (Varrezat e Egjupve), në malin Stogovë në afërsi të xeherores për mangan, janë kryer edhe hulumtime arkeologjike, për çka do të flitet në tekstin e mëtutjeshëm.

Sigurisht se këto janë vetëm një numër i vogël i toponimeve në Gadishullin Ballkanik, që në ndonjë mënyre mund të vihen në relacioni me bashkësinë Egjiptiane. Në punimet e ardhshme shpresojmë që do ta zmadhojmë fondin e këtyre toponimeve dhe nga shtetet e tjera.



## **SHPËRNDARJE GJEOGRAFIKE NË GADISHULLIN BALLKANIK-GRUPE OSE BASHKËSI ETNOGRAFIKE DHE ETNIKE**

Bashkësia etnike e Egjiptianëve të Ballkanit është e shpërndarë gati nëpër gjithë Gadishullin Ballkanik. Në bashkësi më të vogla ose më të mëdha lokale ose regjionale, me vetëdije të zgjuar ose të pa zgjuar etnike, mund të takohen nëpër pjesën më të madhe të Gadishullit, ndërsa në pjesë më të madhe në pjesën jugore dhe jugperëndimore të tij.

Megjithatë, Ballkano Egjiptianët nëpër gjithë Gadishullin nuk janë një bashkësi koherente por janë më tepër grupe ose bashkësi lokale ose regjionale, me ose pa vetëdije etnike për prejardhjen e tyre dhe kolektivitetin nëpër krejt Gadishullin, si dhe me ose pa synim të diturisë për veçanti etnike. Mendimi i shkencëtarëve rreth përkufizimit të grupeve etnike nga ajo etnografike ballafaqohet në atë se vallë grupi ose bashkësia përcaktuese ka vetëdije për veçantinë e vet ose nuk ka (**Етнография на България I**, 1980: 25). Sipas Bromlej kriter themelor për përkufizimin e grupit etnik nga grupi etnografik është synimi ose jo synimi për të krijuar veçanti. Grupi ose bashkësia etnografike nuk synon kah një njohuri e tillë, ndërsa përkufizimi i tyre mund të arrihet vetëm nëpërmjet hulumtimit specifik etnografik (**Бромлей, Ю.** 1976: 26). Pikërisht për atë shkak e pashmangshme është që gjatë përshkrimit të shpërndarjes gjeografike të Ballkano egjiptianëve të paraqitet edhe ajo që a punohet për një grup lokal ose regjional, etnik ose etnografik të kësaj bashkësie.

Bashkësia e Ballkano egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë numëron rreth 350-400 mijëra banorë<sup>5</sup>. Në pjesë më të madhe jetojnë në

---

<sup>5</sup> Sipas të dhënave të Shoqatës të Egjiptianëve në Shqipëri “Nefreta” në Republikën e Shqipërisë jetojnë rreth 350-400 mijëra njerëz pjesëtarë të bashkësisë të Egjiptianëve.  
Numër

qytetet Tiranë, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Elbasan si dhe në qytetet tjera më të vogla. Një numër jo i vogël jetojnë edhe nëpër lagjet fshatare të Shqipërisë.

Bashkësia e Egjiptianëve në Shqipëri, është njëra nga më të mëdhatë në Republikën e Shqipërisë, ndërsa është e emëruar me emrat: Evgjit dhe Jevg në Shqipërinë jugore, Gjup, Egjup në Shqipërinë e mesit, Magjup në shqipërinë veriore, si dhe shumë rrallë përdoret Firaun.

Dallimi dhe determinimi shkencor dhe shoqëror midis Egjiptianëve dhe Romëve në Shqipëri është më i shprehur. Përmendëm se numër i madh shkencëtarësh eminentë në Shqipëri (Sami Frashëri, Faik Konica, Aleksandër Xhuvani, Ekrem Qabej, Zija Shkodra etj.), si dhe institucione shkencore (Instituti i gjuhësisë), bëjnë përkufizim të qartë midis këtyre dy bashkësive. Dallim i qartë bëhet edhe tek populli në Shqipëri, por edhe vetë romët dhe Egjiptianët në Shqipëri midis veti trajtohen si dy etnicitete të ndryshme. Problemin në literaturë e krijojnë udhëpërshkruesit e huaj të cilët nuk mund ta krijojnë kufirin etnik (**Hasluck, M.** 1938), por edhe hulumtues të përcaktuar të huaj bashkëkohor, të cilët përdorin literaturë nga udhëpërshkruesit e përmendur më herët (**Kovacs, J.** 1997). Por për dallim nga shtetet e tjera, organizatat e Ballkano Egjiptianëve dhe Romëve në Shqipëri, së bashku reagojnë në rastet e tilla të ngatërrimit të dy bashkësive të ndryshme, siç është p.sh. letra e organizatës “Barazi Dinjitet Drejtësi” organizata e Egjiptianëve dhe “Rromanë Baxht” organizata e Romëve, të dyja nga Tirana, e dërguar deri të Judit Kovacs dhe Qendrës Evropiane për të Drejtat Rome, për shkak se vrazhdësisë dhe tendenciozitetit barazohen të dy bashkësitë.

Për Ballkano Egjiptianët në Shqipëri, mund të themi se bëhet fjalë për bashkësi etnike, sepse ekziston vetëdije absolute për veçanti etnike, e ndryshme nga bashkësia shqiptare dhe rome, dhe sot ekzistojnë disa organizata joqeveritare të cilat punojnë në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit etnik dhe kulturës së Egjiptianëve në Shqipëri.

Edhe në Republikën e sotshme të Greqisë, ashtu si në Shqipëri jeton afërsisht numër i njëjtë pjesëtarësh të kësaj bashkësie. Në numër më të

---

i njëjtë ishte thënë edhe nga më shumë shkencëtarë të supozimit “bashkëjetesa etnike e Egjiptianëve në Shqipëri”, mbajtur në Tiranë, janar të vitit 1999, e organizuar nga e njëjta shoqatë dhe Shoqata e kulturës demokratike nga Tirana, Shqipëria, ndërsa e financuar nga ambasada e Britanisë të Madhe. INSTATI (Instituti i Statistikës i Shqipërisë) në dhjetor 2012 për herën të parë publikoi një të dhënë zyrtare për Egjiptianët, dhe sipas tyre në Shqipëri jetojnë 3368 Egjiptianë, qe sigurisht ishte e kontestuar si numër nga shumë organizata joqeveritare.

[http://census.al/Resources/Data/Census2011/Instat\\_print%20.pdf](http://census.al/Resources/Data/Census2011/Instat_print%20.pdf)

[http://census.al/Resources/Data/Census2011/Instat\\_print%20.pdf](http://census.al/Resources/Data/Census2011/Instat_print%20.pdf)

madh jetojnë në qytetet rreth brigjeve të Detrave Jon dhe Egje, por edhe nëpër qytetet dhe fshatrat e Maqedonisë të Egjeut.

Sipas një shënimi nga viti 1415, në Peloponez kanë jetuar këto bashkësi më të mëdha: Lakedemojë, Italianët, Peloponezët, Sllavët, Ilirët, Egjiptianët dhe Qifutët (**Fraser, A.** 1995: 49). Nga përmendja e Egjiptianëve në shtatë bashkësitë më të numërta të Peloponezit, mund të sillet përfundim se numri i tyre ka qenë me të vërtetë i mjaftueshëm nëse janë vendosur në rangun e bashkësive më të rëndësishme, sidomos në Metohi dhe Naflio (**ERRC** 2003: 31).

Nga të dhënat që na jep Vasil Kënçov prej hulumtimeve të tij nga fundi i sh.XIX në Maqedoni, sidomos ata nga Maqedonia e Egjeut, e cila nga viti 1913 do të hyj në kufijtë e Greqisë mund të përfundohet se një numër i madh pjesëtarësh të kësaj bashkësie jetojnë nëpër fshatrat e Maqedonisë së Egjeut, sidomos në Fushën e Selanikut, Serez, Drama, Meglen, Florina<sup>6</sup> dhe qytetet e tjera, që merren me farkëtari dhe bujqësi, por edhe kanë poseduar çifligje rreth Enigjes të Vardarit dhe Kara Azmak (**Кънчов, В.** 1996/1900: 114-115). Kuptohet se të dhënat e Kënçovit dhe hulumtimit të tij se bëhet fjalë për Ciganë, duhet të merren me vëmendje të madhe, duke e pasur në mëshirë pamundësinë e tij për ti identifikuar të dy etnicitetet.

Nga hulumtimet terrenore te Aguptët në Madan<sup>7</sup>, por edhe prej shkrimeve të A.Primovskit (**Примовски, А.** 1955: 220), fituam njohuri se pjesëtarët e kësaj bashkësie kanë lidhje farefisnore në qytetet Kesandi, Drama dhe Serez në Greqi.

Edhe në shkencën greke egzistojnë shkencëtarë që bëjnë dallim të qartë midis “Giftos” dhe “Tciganoi”, duke thënë se bëhet fjalë për dallim në prejardhjen etnike e jo vetëm në etnonimet e ndryshme (**Biris, K.** 1954: 43-45), me çka njëra është nga Egjipti, e tjetra nga India.

Për fat të keq, vetëdija etnike tek pjesëtarët e kësaj bashkësie në Greqi nuk është në nivelin që është në Maqedoni, Shqipëri ose Kosovë, për çka “meritë” ka politika shtetërore e Republikës Greke e cila kurrsesi nuk i afirmon të drejtat minoritare, jo vetëm të Egjiptianëve por edhe të pakicave të tjera që jetojnë në territorin Grek.

Egjiptianët në Greqi i përkasin dy religjioneve, religjionit musliman dhe religjionit të krishterë. Numri më i madh i tyre janë të krishterë ortodoks. Por për ata që i përkasin fes muslimane, ekziston edhe emri “Turko Giftos”, nga ana e popullatës të rrethit, si pasojë e barazimit të procesit të islamizimit me turqëzimit, gjatë kohës së qeverisjes Osmane. Në këtë rast duhet të

<sup>6</sup> Nga hulumtimet tona terrenore në Florina në gusht të vitit 2002, takuam Egjiptianë në fshatrat Palestra (Boreshnica e mëparshme) dhe Amhori (Pesoçnica e mëparshme).

<sup>7</sup> Beqir Sadekov Karamisirov, lindur 1941.

merret parasysh se këta Egjiptianë e flasin vetëm gjuhën turke, por edhe prezantohen si Turq.

Sipas kësaj në Greqi ekziston vetëdije për veçanti etnike, kryesisht tek Egjiptianët me fe të krishterë, ashtu që edhe këtu bëhet fjalë për bashkësi etnike, edhe pse nuk ka ndonjë organizate jo-qeveritare ose organizatë tjetër të Egjiptianëve. Por te Egjiptianët me fe muslimane mund të themi se bëhet fjalë për bashkësi etnografike, e cila nuk synon kah veçantia e saj dhe i bashkëngjitet identitetit Turk.

Në Republikën e Bullgarisë, Ballkano Egjiptianët jetojnë në pjesën e saj jugore, më saktë në lagjet e Rodopeve dhe atë më së tepërmi në lagjet Madan, Smiljan, Smoljan (Ustovë), Zllatograd, Devitkovë, Rudozem, Bel Izvor, Nedelin etj. Në këtë rajon numri i pjesëtarëve të Ballkano Egjiptianëve sillet rreth 5000 banorë.

Për lashtësinë e kësaj popullate të Rodopeve, deri tani nuk posedojmë ndonjë burim historik, por duke pasur parasysh se bëhet fjalë për popullatë që është marrë me zanatin e farkëtarisë dhe si xehetarë në këtë rajon të pasur xeheror, me siguri bëhet fjalë për periudhë shumë të gjatë, e për atë edhe ekzistojnë legjenda gojore dhe rrëfime nga vetë njerëzit e terrenit (Примовски, А. 1955: 219).

Për pjesëtarët e kësaj bashkësie në rajon përdoret etnonimi “Aguptë” nga popullata e atij rrethi, por vetë ata ofendohen me atë fjalë, ndaj edhe preferojnë të thonë se janë Egjiptianë (Примовски, А. 1955: 219), dhe nuk duan që ti ngatërrojnë me Romët.

Sipas kësaj mund të themi se vetëdija etnike te kjo bashkësi në Bullgari është në nivel shumë të lartë, për çka qartë bëhet fjalë për bashkësi etnike, edhe pse deri tani nuk ekziston ndonjë organizatë joqeveritare ose tjetër e Egjiptianëve në Bullgari.

Në Republikën e sotshme të Maqedonisë, sipas vlerësimit tonë jetojnë rreth 25 000 pjesëtarë të kësaj bashkësie. Megjithatë, pjesëtarë me vetëdije të zgjuar etnike që prezantohen si Egjiptianë kryesisht jetojnë në pjesën e saj juglindore, Ohër, Strugë, Kërçovë, Dibër, Resnjë dhe Manastir. Këtu kryesisht bëhet fjalë për popullatë me fe muslimane. Në këto qytete në regjistrimet e popullatës nga të dhënat oficiale shtetërore si Egjiptianë janë prezantuar rreth 3 500 banorë edhe pse numri real është dy herë më i madh<sup>8</sup>. Numër i madh pjesëtarësh të kësaj bashkësie në Maqedoni, gjatë

<sup>8</sup> Sipas të dhënave oficiale shtetërore të regjistrimit në vitin 1991 i shpallur ishte numri prej 3 307 qytetarë të deklaruar si Egjiptianë; në regjistrimin e çrregullt nga viti 1994-3 169, ndërsa sipas regjistrimit nga viti 2002 gjithsej janë deklaruar 3 713 qytetarë. Organizatat e Egjiptianëve në Maqedoni gjatë regjistrimit në vitin 1990 kishte rreth 4

kohës së regjistrimeve deklaroheshin si Shqiptarë, (Dibër, Tetovë, Fusha e Shkupit), Romë (Kërçovë, Gostivar, Dibër), Turq (Manastir, Prilep, Gjevgjeli, Strumic, Radovish, Veles), Maqedonas (Kumanovë, Kriva Pallank, Koçan, Shtip) dhe musliman-si identifikim etnik (Kërçovë, Strugë, Dibër).

Në Maqedoni përdoren këto etnonime: Gjupci, Egjupci, Agjupci, Jupci, Ejupci, Ojupci në gjuhën maqedonase dhe Gjup, Egjup, Magjup, Evgjit në gjuhën shqipe. Në Kumanovë dhe Kriva Pallankë ku janë me të krishterë quhen edhe Koptë. Në Koçan dhe Shtip për pjesëtarët e kësaj bashkësie përdoret edhe emri “Kërçecë” (nga gjuha turke.Kara-Karaci:I zi-Të zinj).

Sipas asaj në Republikën e Maqedonisë, në pjesën juglindore (Ohër, Strugë, Kërçovë, Resnjë dhe një pjesë nga Manastiri dhe Dibra) kemi bashkësi regjionale e cila është e vetëdijshme për veçantinë e saj si bashkësi etnike i cili regjion mendohet edhe si qendër kulturore dhe idesh eBallkano Egjiptianeve, por në pjesët e tjera të Maqedonisë bëhet fjalë për më tepër grupe etnike të cilat nuk synojnë kah veçantia e vetë dhe iu bashkëngjiten bashkësive të tjera të afërta sipas gjuhës dhe religjionit.

Numri i Egjiptianëve në Kosovë, sillet rreth 150 000 njerëz. Në Kosovë<sup>9</sup> Egjiptianët jetojnë nëpër qytete dhe fshatra, ndërsa më pak hasen<sup>10</sup>

---

000 anëtarë. Nga hulumtimet tona terrenore p.sh në Dibër ka rreth 2 000 përkatës të këtij etniteti, ndërsa të dhënat oficiale shtetërore thonë se në Dibër jetojnë rreth 40 Egjiptianë. Njëjtë ndodh edhe në Kërçovë ku në terrene faktikisht kemi rreth 1 500 pjesëtarë, ndërsa rezultatet oficiale shtetërore thonë se në Kërçovë banojnë rreth 350 Egjiptianë.

<sup>9</sup> Për praninë e kësaj bashkësie në Kosovë mund të vëshetrohet kjo literaturë: M. Bajraktarović, Rugova SEZb, LXXIV, 1960, 219 përmenden muzikantë, të cilët sillen nga Peja si dhe loja “Lojë Magjupi”.

Autoi i njëjtë, Tradicionalne drustvene zajednice na Kosovu i Metohiju, ZbFF libri X1, 1968, përmend për “Ciganë” nëpër fshatrat dhe qytetet të cilët tregohen si Serbe, Turq dhe Arbanasë, varur nga feja që i përkasin.

M.Veselinović, kroz Kosovo (Od Skoplja do Kosova), Beograd 1894, 305-311. Flet për toponim Asam-Eminovë Mahallë, ku më parë kanë jetuar “Ciganë” për të cilët thuhet se kanë prejardhje nga Koptët afrikanë.

T. Vukanović, Virgjine, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, libri VI, Prishtinë, 1961. Flet se virgjina tek popujt e sotshëm ballkanik janë paraqitur në kohën e Ilirëve. Ato janë vajza që jetojnë në Celibat dhe barazohen me meshkujt. Në krahinën e Drenicës tregon shembull të dy vajzave nga fisi Magjup, E dyta ka qenë nga Gjakova, me profesion muzikante.

Autori i njëjtë, Preshevo, Vranjski glasnik, knj.II 1966 popullata Cigane ndahet në muslimane dhe ortodokse. Ortodoksë jane Gjorgjovcë ose Karagjorgjovcë, e fshehin përkatësinë etnike dhe deklarohen si Serbë, me gjuhë amtare Serbe. Muslimanët (Ashkalinj) gjuhë amtare Shqiptare. Këto dy grupe nuk farefisohen.



në rrethinën e Ferizajt, Golesh, Magurë, Obiliq, Klinë, Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Vushtri, Mitrovicë, Shtime, Prizren, Krushë e Madhe, Landovicë, Therandë etj. (Земон, Р. 2001: 84-85).

Në Kosovë për këtë bashkësi përdoren etnonimet: Magjup dhe Ashkali, më saktësisht Ashkali përdoret në Fushën e Kosovës, ndërsa Magjup në Rrafshin e Dukagjinit. Me hyrjen e UMNİK dhe KFOR, pjesëtarë të përcaktuar të kësaj bashkësie etnonimin Ashkali dëshirojnë ta përdorin si identifikim për bashkësi të veçantë etnike të ndryshme nga ajo egjiptiane ose rome.<sup>11</sup> Nga ana tjetër institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, duke mos dashur të gjenden në konfuzionin e përgjithshëm, si dhe duke mos mundur ti përkufizojnë bashkësitë etnike të Romëve, Egjiptianëve dhe Ashkalijve, shpikën një, të themi surrogat racor “RAE” për identifikim të përbashkët të tre bashkësive. Ky akronim “RAE” nuk është e pranuar për përfaqësuesit e Romëve, Egjiptianëve dhe Ashkalijve në Kosovë.

Sipas kësaj, për Kosovë krejtësisht qartë bëhet fjalë për bashkësi etnike e cila synon kah veçantia e saj, por një pjesë e pjesëtarëve të kësaj bashkësie duan të deklarohen sipas etnonimit të tyre lokal dhe regjional “Ashkalij”, ndërsa pjesa tjetër sipas etnonimit tjetër “Magjupë” i cili tregon në Egjiptin, d.m.th deklarohen si Egjiptianë.

Në Serbi numri më i madh i Egjiptianëve jetojnë në kryeqytet, Beograd. Ata janë kryesisht emigrantë nga qytetet maqedonase, të cilët janë shpërngulur në Beograd gjatë kohës së shtetit të përbashkët Jugosllav. Më tepër jetojnë në lagjen Dorçoll, në pjesën e Vjetër të qytetit, por familje veçase ka edhe në lagjet e tjera. Numri i këtyre Egjiptianëve në Beograd sillet diku rreth 2 500 njerëz.

Në Vojvodinë gjithashtu jetojnë pjesëtarë të këtij etniteti. Ata janë kryesisht Egjiptianë nga Kosova që u vendosën në rrethin e Novi Sadit, lagjen Adice. Konfrontimet me identitetin nga Kosova ndihen edhe midis Egjiptianëve në Vojvodinë, ashtu që sot kemi dy grupe të organizuara të kundërshtuara.

---

M. Krasniqi, Orahovac-antropogeografiska monografija Varoshice, kapitulli MKM libri II, 1957,99-132. Ciganët kanë mahallën e tyre, por llogariten si Serbe, ndaj për respekt askush nuk i thirr Ciganë. Merren me zanatin e farkëtarisë të shpërngulur nga Prizreni. Ciganët e shqiptarizuar nuk e dinë prejardhjen e tyre, nuk din prej ku kanë ardhur paraardhësit e tyre ose kujt fisi i takojnë.

<sup>10</sup> Mendohet në periudhën para vitit 1999 dhe hyrjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë.

<sup>11</sup> Më tepër shiko: Minority Studies Society Studi i Romani, Identitety formation among the minorities in the Balkans: The case of roms, Egyptians and Ashkali in Kosovo.

Ballkano Egjiptianë ka edhe në Mal të Zi. Ata të cilët jetojnë në qytetet rreth bregut të Adriatikut për “të tjerët” janë Kovaçë si identifikim etnik si egzonim, ndërsa midis veti quhen Magjup. Më së tepërmi ndodhen në Bar-Stari Bar (**Вукмановић, Ј.**, 1932: 209-211) dhe në Ulqin. Numri i kësaj bashkësie në Mal të Zi, në këto dy qytete është diku rreth 3 000 njerëz . Për këtë bashkësi Tihomir Gjorgjeviq në vitin 1933 ka shkruar: “Në Ulqin, për shembull, Ciganët e atjeshëm nuk e njohin gjuhën cigane, flasin arbanisht dhe shumë pak serbisht. Nga ciganërija ju ka mbetur vetëm profesioni-të gjithë merren me zanatin e farkëtarisë (!). Por edhe nuk pranojnë se janë Ciganë, dhe e marrin si ofendim nëse dikush ashtu i thirr. Për shkak se e dinë se nuk janë as Serbë, as Arbanasë, ata thonë se janë Kovaçë. Ndërsa, se janë Ciganë, shihet nga ajo se meshtanët (qytetarët e vjetër ose popullata e vjetër) i njohin vetëm si Ciganë, i quajnë Magjup, ashtu siç i thërrasin Ciganët në viset tjera, ndërsa mëhallën e tyre të vogël Cigane (arbanakisht Mahalla Magjupve). As Ciganët në Bar “nuk e durojnë emrin Ciganë, por tregohen si Kovaçë”...” Teksti i tillë i Tihomir Gjorgjeviq, ka hasur në revolt të madh tek Farkëtarët nga Ulqini dhe Bar midis dy luftërave botërore, dhe kanë protestuar deri te Akademinë Serbe të Shkencave dhe Arteve, duke treguar se autori nuk ka pasur të drejtë t'i llogaris si Ciganë.<sup>12</sup>

Pjesëtarë të kësaj bashkësie ka edhe në qytetet Danillovgrad, Cetinje, Podgoricë, Nikshiq etj.<sup>13</sup> Në Nikshiq takuam edhe Egjiptianë të cilët janë të shpërngulur nga Kosova, dhe qartë deklarohen si Egjiptianë.

Megjithatë, vetëdija etnike se janë pjesë e një bashkësie më të madhe në Ballkan, tek të gjithë është në nivel shumë të ulët, sidomos tek Kovaçët të cilët preferojnë të deklarohen si Shqiptarë ose Muslimanë në kuptim etnik.

Duke marrë parasysh se grupi i Kovaçëve është i vetëdijshme dhe synon kah veçantia e vetë, mund të themi se ata ndodhen në proces konsolidimi si grup etnike, edhe pse një pjesë më e madhe preferon të deklarohet si Shqiptarë ose Muslimanë.

Për Egjiptianë në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk ka njohuri të mjaftueshme për identifikimin e tyre si Egjiptianë në historinë dhe në

<sup>12</sup> Nuho Beharoviç, nga Bar, lindur v.1920.

<sup>13</sup> Më gjerësisht për Malin e Zi shiko në këtë literaturë: R. Veshoviç, Pleme Vasojeviç, Sarajevo, 1935, 117. Thotë se për Jegjupë populli di vetëm se janë nga “ndonjë fe tjetër” ose ndonjë fis e largët dhe e huaj me qortim se ka marrë vesh se në Dukagjin ekziston një farefis i vjetër Jegjup me lagje mbi Deçan.

literatura të tjera, edhe pse bëhet fjalë për region të pasur me pasuri xeherore dhe hekur, siç do të shohim më vonë ka disa thënie të madhe për këtë bashkësi. Sot në këtë shtet nuk ekziston asnjë organizatë e Egjiptianëve, as edhe nuk kemi njohuri se disa ashtu edhe deklarohen. Por, duke e lexuar literaturën etnologjike mund të shihet se në Bosnjë dhe Hercegovinë ekzistojnë dallime të vrazhda midis të ashtuquajturve Ciganë të Zinj të dhe të ashtuquajturve Ciganë të Bardhë. Ashtu p.sh Milenko Filipović, në një rast do të shkruaj: “Ciganët e Bardhë dallohen nga Ciganët e Zinj para së gjithash nga ajo se janë diçka më të hapur dhe më kompleks, por ai dallim është shumë i vogël (dhe ndoshta vetëm nëpërmjet pastërtisë më të madhe dhe madhësisë të trupit), ndaj prej këtu vjen edhe emri. Megjithatë, ai nuk është dallimi kryesor midis tyre. Dallimi kryesor është në pozitën e tyre socio-ekonomike, dhe ai dallim është shkaku për ndarjen e përgjithshme midis tyre. Derisa Të Zinj të merren me papunë dhe lypje, e më parë kryesisht me vjedhje, të Bardhët janë më të pasur, shpesh shumë të pasur, njerëz që merren me zanat farkëtarie dhe me mishtari... Prandaj ata kanë mundësi që mënyrën e jetesës ta bëjnë më të mirë dhe në të përpiqen të barazohen me muslimanët qytetar. Veshja e Ciganëve të Bardhë meshkuj është kryesisht e njëjtë si të muslimanët e tjerë, dhe ka edhe prej atyre që vishen në mënyrë luksoze... Ka edhe lidhje martesë midis tyre dhe muslimanëve tonë, por janë shumë të rrallë, sepse muslimanët i urrejnë Ciganët e Bardhë dhe i llogarisin si më të ulët prej tyre, edhe nëse janë më të pasur. Deri sa Ciganët e Zinj, dukshëm dhe vetëm sipas emrit i përkasin Islamit, të Bardhët mbahen në normat fetare të Islamit. Përveç asaj, Ciganët e Bardhë nuk e njohin ose nuk duan ta dinë gjuhën Cigane”. (Filipović, M. 1932: 45) Përshkrim të ngjashëm për Ciganët e Bardhë të cilët nga Bosnja kanë kaluar nëpër qytetet Shabac dhe Krupanjë në Serbinë perëndimore, jep edhe Tihomir Gjorgjeviq (Ђорђевић, Т. 1932: 92-99). Sipas disa dokumentesh nga Jajce nga sh.XVII është përdorur etnonimi Kipt, i cili është shtruar dhe është përdorur deri në sh.XIX (Божовиќ, Р. 1996: 154). Në raportin e kontit francez Charl nga viti 1806, thuhet se në Bosnjë besohet se Ciganët Boshnjak janë me prejardhje nga Egjipti (Јелавић, В. 1906: 310). Dhe sipas Qiro Truhellka në rrethinën e Jajces është përdorur emri Kiptijan Tojfsi (Egjiptianë) (Трухелка, Ћ. 1918: 174-175).

Sipas asaj, në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, ekzistojnë indikacione të qarta etnografike për prezencë të kësaj bashkësie, por për shkak se nuk ekziston vetëdije as edhe synim kah veçantia e tyre, bëhet fjalë për grupe të definuara etnografike ose bashkësi të Ballkano Egjiptianeve.

E ngjashme është edhe situata me Republikën e Kroacisë, ku gjithashtu nuk kemi njohuri të mjaftueshme për identifikim të Ballkano Egjiptianëve, edhe pse për atë ekzistojnë indikacione të përcaktuara veçanërisht në Dalmaci dhe bregdetin Adriatik. Këto indikacione bazohen në numrin tepër të madh të zbulimeve arkeologjike me prejardhje Egjiptiane në Solin (**Selem, P.** 1969: 141-167),, mbi bazë të dokumenteve të arkivit të Dubrovnikut **Петровић, Ћ.** 1975: 124), por edhe vetë shkruarjës së shkrimtarit të shekullit të mesëm nga Dubrovniku nga sh.XVI Andria Çubranociq, që ka shkruar edhe poemën nën titull “Jegjupka” (**Чубрановић, А.** 1950).

#

## **IDENTITETI ETNIK DHE MIMIKRIA ETNIKE E EGJIPTIANËVE TË BALLKANIT**

Dukuritë shoqërore komplekse siç është identiteti etnik vështirë është e mundshme që sistematikisht të studiohen nëse në hulumtim niset nga një pikëpamje e vetme teorike.

Studimi i etnicitetit ka kaluar nëpër disa faza zhvilluese. Epoka moderne në studimin e etnicitetit sipas disave fillon në vitin 1923 me veprën “Etnos” e etnologut rus Sergej M.Širokogorov (Širokogorov S. M. 1998), i cili midis të parëve ka treguar në karakterin dinamik të identitetit etnik. Deri atëherë por edhe më pas, veçanërisht në Aleatën Këshilltare, theksi kryesisht është vendosur në hulumtimin e përmbajtjes dhe gjendjes të etnosit, si dukuri më tepër ose më pak statike, e cila gradualisht evoluon duke u ngjitur në stazë sa më shkallore (Nedelkovič S:2000).

Në përfundim, ka pasur disa tentime që etnosi përkatësisht, nacioni të shihet si “shpirt” përkatësisht si princip spiritual ose vetëdije kolektive. Veber mes të parëve ka treguar në subjektivitetin e identitetit etnik. Duke e definuar gurin etnik në bazë të besimit subjektiv në prejardhjen e përbashkët, ai nënvizon se burimi i etnicitetit nuk do të ishte dashur të kërkohet në të pasurit e këtyre ose atyre vetive, por në prodhimin, mbajtjen dhe thellësinë e dallimeve, rëndësia objektive e të cilëve nuk mund të matet në mënyrë të pavarur nga domethënia që ia japin disa individë në marrëdhëniet e tyre shoqërore. Identiteti etnik sipas tij ndërtohet mbi bazë të dallimeve. Tërheqja midis atyre që vetë përjetohen si pjesëtarë të një lloji, është e pandashme nga refuzimi ndaj atyre që përjetohen si të huaj. Vetëdija për përkatësi nuk realizohet fal izolimit, por përmes kundërshtimit reciprok

të dallimeve që njerëzit i shfaqin dhe i vendosin kufijtë etnik (Veber, M. 1976).

Revolucion të vërtetë në të menduarit për etnosin ka bërë Frederih Bart (**Barth, F.** 1969) në vitin 1969 në paraqitjen e tij të shkurtër por koncize për grupet etnike dhe kufijtë e tyre. Ai është shkëputur nga tradita në etnologji që etnosin e ka llogaritur për një model kulturor, në masë të madhe i bazuar në parametrat objektive. Bart ka treguar në kufijtë etnik si ai aspekt i etnicitetit që e përfaqëson thelbin e problemit.

Ajo që bartet me kohën nuk është arsenali kulturor por kufiri i një grupi të përcaktuar: përmbajtja e brendshme ndryshon ndërsa kufijtë mbesin. Kufijtë etnik implikojnë marrëdhënie inter-etnike: identiteti etnik formohet edhe ekziston pikërisht nëpërmjet prekjeve me grupet tjera etnike.

Nga ana e kulturës vëmendja është e kthyer kah procesi dhe marrëdhënia. Teoria për etnosin përjetoi ndryshim të madh me paraqitjen e librit “Nacioni-bashkësitë e imagjinuara” e Benedekt Anderson (**Anderson, B.** 1998). Edhe pse ai merret me nacionin, e jo etnosin, hyrjen që ai e kompletton mundet të përdoret edhe për studimin e etnosit. Sipas autorit, nacioni, por edhe çdo grup tjetër, e sidomos grupi etnik, është bashkësi e imagjinuar (por jo edhe e shpikur): ajo është e imagjinuar sepse pjesëtar i një grupi të madh asnjëherë nuk do ti njoftoj të gjithë pjesëtarët e grupit të vetë, por ata në vetëdijen e tij gjithsesi ekzistojnë dhe ai ndaj tyre merr njëllon qëndrimi të përcaktuar. Ky lloj qëndrimi bazohet në ndjenjë shoqërimi dhe solidarizimi i fuqishëm horizontal. Bashkësitë në radhë të parë dallohen sipas asaj se si janë të “imagjinuara”.

Vlen të përmendet edhe vepra “Etniciteti dhe nacionalizmi” e Tomas Hilland Erikson (**Eriksen, T. H.** 1993) nga viti 1993, i cili kthehet në problemet themelore në lidhje me studimin e etnicitetit: qëndrimin ndaj të Tjerëve, ndaj historisë dhe politikës. Ekzistimi i Të Tjerëve është element i pashmangshëm i identifikimit etnik: pa të Tjerët nuk është e mundur të përjetohet dhe kuptohet: “NE”<sup>14</sup>. Historia nuk është problem i të kaluarës

<sup>14</sup> Në këtë kuptim e rëndësishme është të përmendet edhe teoria e të ashtuquajturve Konfiguracionistë, të cilët duke u nisur nga qëndrimi se individi është i varur nga perceptimi i kontekstit shoqëror të tij-individi sillet në pajtim me kërkesat e grupit, dhe prej aty interesimi për studimin e identitetit etnik është i drejtuar kah studimi i lojalitetit in-grupor dhe armiqësisë ose out-grupor. Në lidhje me supozimin se lidhja e ngushtë midis identitetit individual dhe grupor, e studion in-grupin përkatësisht grupin i cili ka krijuar komunikacion intim midis anëtarëve të tij, të cilët përkatësinë e tyre e tregojnë me “ne“, duke e përdorur këtë term njëkuptimshëm. Me të teoria e cila në qendrën e vëmendjes së vetë i vendos in-grupet”, e paramendon ekzistimin e domosdoshëm të out-grupeve”. (Shiko:Gordon Allpord, Formation of In-Groups, në Dashevski Ethnic identity in Society, Chikago, 1976, 73.)

por përgjigje e kërkesave të sotshme: antropologut nuk i intereson çka ka ndodhur në të vërtetë, ai nuk dëshiron si historian të bëj dallim midis traditave “të vërteta” dhe “të paramenduara”, por dëshiron që të zbuloj në cilën mënyrë përdoret një përmbajtje e përcaktuar historike në procesin aktual të konstruktimit të identitetit.

Grupi etnik dhe etniciteti para së gjithash janë procese dhe marrëdhënie, e jo gjendje. Grupi etnik është kategori dinamike, historikisht e krijuar, e cila krijohet, ndryshon dhe e vazhdon jetën e vetë në kornizat e një ose më tepër grupesh. Kontinuiteti midis fazave të ndryshme në zhvillimin e grupit etnik janë kufijtë e tij (ndoshta edhe emri), dhe jo përmbajtja. Identifikimi në radhë të parë është proces “i brendshëm” subjektiv përputhshmërie dhe distancimi: ai është zgjedhje selektive e elementeve të përcaktuara kulturore me qëllim të formimit të identitetit personal. Disa elemente shprehen (shfaqen), ndërsa të tjerat shtypen dhe lihen pas dore. “Objektiviteti” i identitetit etnik, së bashku me historinë e atij identiteti, në masë të madhe është konstruksion, realitet virtual. Etnosi është përjetim subjektiv, paramendim i realitetit. Procesi i identifikimit më shpesh fillon nga brenda, kah jashtë, zhvillohet vetëdija e cila manifestohet me preken me të Tjerët, dhe kërkon pranim nga ana e popullit tjetër etnik.

Paraqitja e Ballkano Egjiptianëve në skenën etnike të Gadishullit Ballkanik në dekadat e fundit të sh.XX, hap disa probleme shkencore të rëndësishme teorike dhe praktike. Pyetja më e rëndësishme shkencore është: A është ai ndonjë grup i ri, deri tani jo ekzistuese ose është ndonjë grup i vjetër i cili pas “fjetjes” së gjatë etnik dhe politike përsëri u bë “i vetëdijshëm” për veten? Pyetje e rëndësishme është edhe pse ky grup u paraqit në skenë “para pak kohësh” përkatësisht cilët faktorë ndikojnë për “fjetjen” e saj të gjatë përkatësisht “zgjimin” e saj para pak kohësh, dhe si është zhvilluar ai krijim, më saktë “zgjim”.<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Që të jemi më afër përgjigjes të kësaj pyetjeje ndoshta është më mirë të shërbehemi me teorinë e Abraham Maslow, për hierarkinë e nevojave. Në vitin 1943 në *Psychological Review* u paraqit studimi Teoria e motivimit të njeriut (A theory of human motivation), ku thuhet se qenia njerëzore është e motivuar nga nevojat e pakënaqura, dhe atë së pari duhet të plotësohen nevojat e nivelit më të ulët, e mandej nevojat e nivelit më të lartë. Sipas Maslow ekziston hierarkia e ardhshme e nevojave duke filluar nga niveli më i ulët kah më i larti: 1) Sigurim (ekzistencë, siguri, ushqim, shtëpi/vendosje, punësim); 2) Identitet (përmjohje, respekt, pranim, liri në shprehje, afirmim i gjuhës dhe kulturës); 3) Bashkësia (përkatësi, lidhje, interakcion, barazi, pranim të dallimeve për bashkësi dhe pronë) 4) Vitalitet (profesion që plotëson, realizim të potencialeve të plota, shkollim i lartë, përforsim, parapranim. Duke pasur parasysh se pjesëtarët e bashkësisë të Ballkano Egjiptianëve, shumë vështirë kanë luftuar ti plotësojnë nevojat për sigurim, mund të supozojmë pse zgjuarja etnike e identitetit dhe shfaqja e bashkësisë fillon relativisht më vonë në krahasim me bashkësitë e tjera fqinje.



Historia më e re e paraqitjes të Ballkano Egjiptianëve përputhet me raste të përcaktuara shoqërore-politike, më saktësisht është pjesë e një zhvillimi më të gjerë shoqëror dhe kulturor, pra ka të bëjë me transformim. Periudha në të cilën Ballkano Egjiptianët paraqiten të organizuar është kohë menjëherë para fillimit të procesit të tranzicionit në Evropën Juglindore ose gjatë kohës të atij procesi.<sup>16</sup> Ai proces, sidomos në shtetin e mëparshëm Jugosllav ishte i lidhur me lëvizje etnike dhe nacionale, sidomos me ndeshje dhe probleme. Që në fillimin e viteve të tetëdhjeta, sidomos kah fundi i asaj dekade, vjen deri në revitalizim të lëvizjeve kombëtare në Jugosllavi. Në Serbi, në Kosovë, si edhe në Maqedoni veçanërisht është i shprehur problemi i kombit mazhorant me minoritetin Shqiptar, që solli deri në antagonizma dhe jo tolerancë reciproke. Relativisht në kohë të njëjtë në periudhë të viteve të shtatëdhjeta lëvizja ndërkombëtare Rome fitonte përkrahje të madhe ndërkombëtare dhe Institucionale Shtetërore me tendencë për ekspansion, pushtim dhe asimilim të grupeve tjera etnike ose etnografike nëpër Ballkan dhe Evropë në substratin etnik dhe politik Rom, ose “mellting poti” Rom. Në një konstelacion të tillë, zgjidhet dëshira për shfaqjen e kufijve etnik dhe veçantisë së vetë, tek pjesëtarët e Ballkano Egjiptianëve të cilët deri atëherë, e disa ende, deklaroheshin si Shqiptarë, Maqedonas, Serbë, Turq, Musliman dhe Romë.<sup>17</sup> Në këtë pjesë të Ballkanit Egjiptianët e përdorin gjuhën shqipe (qoftë Gegë ose Toskë) si gjuhë të tyre amtare. Ishte mjaft vështirë për një grup të përcaktuar në kornizat e korpusit gjuhësor shqiptar të ndahet dhe shpallet veçantia personale, sidomos në periudhën kur metoda shtetërore por edhe ajo e përgjithshme shoqërore për identifikim etnik ishte “cilën gjuhë e flet, atij populli i përket”. Për atë shkak pjesëtarët e kësaj bashkësie në Ohër dhe Strugë, me qëllim që ti vendosin kufijtë etnik ndaj Shqiptarëve dhe ta shfaqin veçantinë e tyre, në regjistrimin në v.1971 deklaroheshin si “Toskë” sepse Shqiptarët në këto vise e flasin dialektin Gegë, ndërsa Egjiptianët dialektin Toskë. Veçantia është dashur të shfaqet edhe nëpërmjet formimit të disa shoqërive kulturore-artistike, mir po përseri nga “të tjerët” ishin të perceptuara si “shoqëri shqiptare”. Anëtarët e atyre shoqërive, ishin të vetëdijshëm për veçantinë e tyre, por edhe për ata atëherë nuk ka qënë aq e rëndësishme plotësisht të shfaqen, por as

<sup>16</sup> Shiko: Minority Studies Society Studii Romani, Identity Formation among the Minorities in the Balkans: The cases of Roms, Egyptians and Ashkali in Kosovo, Sofija, 2001, 13-20.

<sup>17</sup> Robertina Ashuri/Rubin Zemon, Shqyrtim i shkurtër i historisë të lëvizjes së Egjiptianëve në Ballkan dhe në Maqedoni Zb TEEM, Shkup 1996, 9-85. Rubin Zemon, Egipetska etnička svest i pokret Egipčana na Balkanu, vo Balkanski Egipčani, Istina o Egipčanima sa Kosova, Beograd, 2001, 23-36.

edhe dinin si ta bëjnë atë, as edhe ka ekzistuar ndonjë ndikim minimal i jashtëm. Megjithatë, ky faktor “i pakënaqshëm” kishte edhe anën tjetër të tij, sepse Egjiptianët gjatë takimeve në këto shoqëri filluan vetëdijshëm dhe institucionalisht të distancohen, edhe pse ajo ka qenë në formë rudimentale. Vetë shoqëritë kulturore-artistike nuk luajtën rol vendimtar në homogjenizimin etnik, por paraqesin një ndër tentimet e para që vetëdija etnike të shfaqet dhe pavarësohet. Vetë fakti që njerëzit sot kujtohen në atë, dhe që ata në vetëdijen e Egjiptianëve kanë një far domethënie, tregon se të folurat për ata përfshihen në “konstruimin” historik, që do të zë edhe vend të rëndësishëm në “historinë e ardhshme të Ballkano Egjiptianëve”.

Në rrethanat e “përshtatshme” shoqërore-politike në vitet e shtatëdhjeta, faktor tjetër i rëndësishëm për zgjimin e vetëdijes të Egjiptianëve është paraqitja e elitës intelektuale midis vetë atyre. Ata deri para nja 40 vitesh ishin bashkësi, ndërsa në numër më të madh ende janë me status të ulët ose mesatar social: ata në rrethanat dhe rrethet e tyre tradicionale janë perceptuar dhe perceptohen, sipas statusit të tyre shoqëror mbi grupin rom, por nën atë shqiptar, turk, maqedonas, serb, bullgar dhe grupeve të tjera etnike. Ata kryesisht kanë qenë të pa shkolluar dhe janë me veprimtari shërbyese (mjeshtrë, farkëtar). Me paraqitjen e Nazmi Arifit dhe gjeneratës së tij, Egjiptianët në Maqedoni fitojnë elitën e tyre intelektuale, e cila paraqet faktor vendimtar për krijimin e lëvizjes etnike-nacionale. Ajo elitë ishte e aftë ti artikuloj synimet etnike të grupit të vetë, ti nxit, ti kanalizoj dhe tju japë një formë të pranueshme sociale.

Nga ana tjetër proceset e përmendura shoqërore globale të tranzicionit, ndikonin edhe negativisht në zhvillimin etnik të Ballkano Egjiptianëve. Bashkësia ndërkombëtare, duke pasur qëndrim patriak dhe mbrojtës ndaj Shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoni, ishte dhe është, mjaft e rezervuar ndaj kësaj, sipas tyre “paraqitje masive prej askund” të Egjiptianëve<sup>18</sup>, sidomos në Kosovë, dhe atë bash në kohën kur Serbëve më së tepërmi ju konvenonte, ndërsa Shqiptarëve më së pakti. Bile, paraqiten edhe disa “shkencëtarë” perëndimor (**Polansky, P.** 1999), të cilët tregojnë se Egjiptianët janë “vepër artificiale” e “politikës serbe dhe disa intelektualëve maqedonas” por edhe titujt e “punimeve të tyre shkencore” janë “Bërja e Egjiptianëve në Kosovë dhe Maqedoni” (**Duijizing, G.** 2000: 132-156)- “Making of Egyptians in Kosovo and Macedonia”). Ajo kishte domethënie se Egjiptianët ishin të detyruar për të pritur pranim ndërkombëtar, deri sa

---

<sup>18</sup> Public relation docemt on Roma, Askalie and EGYPTIANS-Booklet project of OSCE-Mik, 1999.

institucionet ndërkombëtare nuk mbikëqyrën se bëhet fjalë për vendim me të vërtetë të fortë të njerëzve që të ekzistojnë në identitetin e tyre etnik.

Megjithatë, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë të cilët më tepër ndikonin negativisht, përkatësisht e kanë ndaluar (dhe e ndalojnë) ose e pamundësojnë zhvillimin e plotë dhe pranimin e Egjiptianëve si grup me të drejta të plota etnike ose pakicë kombëtare.

I pari nga këto faktorë është mos posedimi i parametrave njohëse (signifikante) objektive të identitetit etnik. Ballkano Egjiptianët nuk kanë gjuhë të tyre personale, specifike dhe universale si dhe religjion të tyre personal, specifik bashkues nëpër gjithë Gadishullin. Pa këto dy elemente themelore të identitetit etnik, vetëdija etnike zgjohet vështirë. Egjiptianët në Ballkan flasin në gjuhën e rrethinës, për çka midis tyre hasim grupe të ndryshme gjuhësore. Në Maqedoni Egjiptianët flasin shqip, maqedonisht dhe turqisht. Në Kosove dhe Shqipëri flasin në gjuhën shqipe. Si janë vendosur në vende tjera ashtu edhe gjuha është ndryshuar. Shembull, gjenerata e mesme e Egjiptianëve në Beograd ende në shtëpi më tepër përdorin gjuhën shqipe se sa serbe. Gjenerata e sotshme e Egjiptianëve të rinj me prejardhje nga Maqedonia që jeton në Beograd, nuk flet në gjuhën shqipe por e kupton. Tani gjuhë e tyre amtare është gjuha serbe. Në rastin e Egjiptianëve të Ballkanit tregohet se mungesa e gjuhës së tyre, specifike mund të jetë rrëuese për ekzistencën (ose formimin) e identitetit etnik. Shumë pjesëtarë të këtij etnosi nëpër Ballkan janë identifikuar dhe identifikohen me atë grupe gjuhësore, gjuhën e të cilës e flasin. Për atë edhe sot midis Egjiptianëve mund të gjejmë njerëz që veten e konsiderojnë si Shqiptarë, Turq, Maqedonas, Muslimanë, Serb, Bullgarë, Grek. Kufijtë gjuhësor midis vetë Ballkano Egjiptianëve janë aq shumë të rëndësishëm, ashtu që ata që flasin p.sh. serbisht në Beograd ose shqip në Kosove, perceptojnë se Egjiptianët që flasin gjuhë tjetër janë më larg nga Serbët ose Shqiptarët. Për atë në masë të madhe faktore ishte edhe politika e regjistrimit të popullatës. Në periudhën derisa ende nuk mundeshin të deklarohen si Egjiptianë, ata ishin të klasifikuar nganjëherë edhe kundër dëshirës së tyre, në ato grupe gjuhësore, gjuhën e të cilave e flasin (**Ашури, Р., Земон, Р.** 1996: 9-17).

Ballkano Egjiptianët i përkasin disa konfesioneve, por në numër më të madh i përkasin fes Islame d.m.th. vetëdija më tepër është e zgjuar tek ata me fe Islame. Ekzistojnë specifika të përcaktuara religjioze të cilat nuk mundën ta dëshmojnë veçantinë e tyre, por mund të përdoren si bazë për ndërtim të mëtejshëm të vetëdijes etnike. Religjioniteti i tyre më së miri mund të quhet si “ndarje religjioze”:ata formalisht janë muslimanë, por shumë nga ata vizitojnë faltore ortodokse (si p.sh. Sh.Naum në Ohër,

Maqedoni; Graçanicë në Kosovë; Sh. Marena në Pogradec, Shqipëri etj.) luten në to dhe dërgojnë dhurata ose kurbane, por nuk kryqëzohen, festojnë festa ortodokse publike ose familjare (Sh. Atanas, Shëngjergj, Sh. Naum, Shënmeri, Shënmitër, Sh. Nikolla). Në çdo rast mos ekzistimi i religjionit të tyre personal ose i institucioneve të veçanta religjioze nën udhëheqjen e tyre, si dhe mungesa e institucioneve shkollore dhe edukative-religjioze me kuadër të tyre mësimor-shkollor, e ngadalëson shumë zhvillimin e tyre dhe nuk mundëson mirënjohjen e tyre të përgjithshme dhe shoqërore.

Ballkano - Egjiptianët nuk kanë as mit të tyre etno-kombëtar. Ata kanë disa mite, si p.sh. për farkëtarin e parë Azreti Daut ose David, por ai nuk është mit në kuptim të vërtetë etno-konstitucional. Përkujtimet e paqarta historike, legjendat më të vogla që nuk kanë ngjyrë etnike, nuk janë pjesë miti që emotivisht e angazhojnë qenien etnike. Ajo, megjithatë, nuk do të thotë se një mit i tillë nuk do të krijohet dhe që të krijohet miti i mundshëm është më tepër gjenerata p.sh. për Nazmi Arifin, si ideolog i zgjimit të vetëdijes etnike dhe luftimit të tij për të drejtat e Egjiptianëve për të cilin edhe tani shkruhen këngë<sup>19</sup> dhe përmendet si “Baba i Egjiptianëve”, ose të krijohet mit për epopenë e refugjatëve Egjiptianë pas krizës së Kosovës, shtëpitë e lagjet e tyre të djegura ose vuajtjet e tyre.

Në faktorët “negativë”, gjithashtu bën pjesë edhe problemi me tokën “matkë”. Ballkano - Egjiptianët nuk kanë tokë të tyre matkë. Edhe pse ka pasur disa kontakte me qeverinë dhe ambasadat egjiptiane, edhe pse është folur vetëm për njëloj bashkëpunimi të caktuar kulturor, qeveritë Egjiptiane deri tani nuk kanë marrë hapa konkrete për kujdes ndaj kësaj popullsie. Egjipti i sotëm, i cili identifikohet edhe si Republikë Arabe edhe në kuptim etnik nuk është ai Egjipt prej ku Ballkano – Egjiptianët kanë prejardhjen. Popullsia e vjetër Egjiptiane, para së gjithash popullsia hamite, me hyrjen e Islamit dhe Arabëve në shek.VII, u islamizua, por në të njëjtën kohë edhe u arabizua (Хити, Ф. 1976), ashtu si në Ballkan me hyrjen e osmanëve dhe Islamit, grupet e islamizuara “turqëzoheshin”, përkatësisht deetnizoheshin. Egjiptianët e vjetër, hamitë, të cilët nuk e pranonin Islamin dhe nuk arabizoheshin, mbeteshin në kornizat e kishës krishtere monofizite, e cila prej shek. VII e merr emrin kisha Kopte (Kolarić, J. 1982; Божовиќ, Р. 1996: 155). Antagonizmat fetare-etnike dhe mos-tolerancat në Egjipt midis Koptinjëve dhe Arabëve ose popullsisë së arabizuar, të cilat filluan prej shek.VII vazhdojnë edhe sot. Me atë Ballkano Egjiptianët nuk do të kenë lidhje të tyre etno-gjenetike me Egjiptianët e sotëm arabë në Egjipt, por me Koptët e sotëm në Egjipt. Kjo situatë gjithashtu krijon një rezervë të

<sup>19</sup> Për Nazmi Arifin janë të shkruara disa poezi nga poetë Egjiptian nga Kosova, me përmbajtje patriotike: shiko Glas Jugoslovenskih Egipčana, Priština, 1997.

përcaktuar tek organet zyrtare të Republikës Arabe në Egjipt. Përveç kësaj, distanca kohore, e cila na ndan nga shpërngulja e paraardhësve të Ballkano - Egjiptianëve në Gadishullin Ballkanik është tepër e madhe që të ekzistojë një lidhje emotive minimale. Përveç, distancës kohore ekziston edhe një distancë e madhe hapësinore nga “qendra” që e zvogëlon interesin e “matkës” për “emigracionin”. Prandaj, është e kuptueshme skepsa nga njëra dhe nga ana tjetër. Kjo më tepër dëm u bën Ballkano–Egjiptianëve, sepse nuk kanë politikë të forte te mjaftueshme, si dhe burim mjetesh financiare, si shumë grupe të tjera etnike. Në një situatë të tillë paraqitet edhe “tokë matkë sekondare”. Për Egjiptianët Kosovar dhe Egjiptianët Maqedonas, të cilët u banuan në Beograd dhe vendet e Evropës Perëndimore “matkë” përfaqëson Ohri. Atje së pari filloi procesi dhe tepër larg ka përparuar me zhvillimin ku janë të gjithë “autoritetet” politike dhe kulturore të Ballkano - Egjiptianëve, të cilët tani punën e tyre e përhapin edhe në vendet e tjera në Shqipëri, Bulgari e Greqi nuk kanë do një ndjenjë për Ohrin si “tokë matkë sekondare”. Egjiptianet që janë nga Kosova që u banuan në vendet të Evropës Perëndimore “toke matkë sekondare” është Kosova, sidomos pas proklamimit të pavarësisë së shtetit të Kosovës.

Si faktor i fundit “negativ” në kuptimin e zgjimit të vetëdijes etnike të Ballkano - Egjiptianëve do ta kishim numëruar edhe jo seriozitetin, me të cilin shtetet e mëparshme komuniste, por diku edhe në shtetet e sotme “demokratike” është shkuar drejt shprehjes etnike. Lëvizjet nacionale ose anti-nacionale dhe ideologjitë ishin dhe ende janë prezentë me çka përqeshen dhe ofendohen deklaratimet etnike ose nacionale dhe përcaktimet e njerëzve. Në rrethana të tilla dëshira që njerëzit të deklarohen si Egjiptianë është pritur me “ofendim” dhe përqeshje përcaktimi etnik ose nacional, e jo si shprehje e synimit të vërtetë. Situata e tillë në një masë të madhe edhe sot, deri edhe në disa rrethe shkencore, e dobësoi ashpërsinë e luftës për të drejta etnike të Ballkano – Egjiptianëve (Недельковић, С. 2000: 9).

Baza subjektive e identitetit të Ballkano - Egjiptianëve është jo konsekuente, ashtu siç dimë se atje ku paraqitet aspekti subjektiv më herët ose më vonë më siguri do të paraqitet edhe ai objektiv (Недельковић, С. 2000: 10). Rasti i kundërt është shumë më i rrallë. Me qëllim të objektivizimit të identitetit të Egjiptianëve punohet me të madhe. Në mbledhjet e tyre ashtu si edhe në organizatat e tyre politike dhe joqeveritare përdoren simbole nga kultura e lashtë Egjiptiane (fotografi të Tutankamonit, Kleopatërës, piramida etj.), por edhe simbole dhe elemente nga etno-kultura e tyre (çekiçi farkëtar, kudhër, gjerma). Ato janë elemente që theksohen, vendosen në vetëdijen dhe synojnë të bëhen simbole etnike. Me ndihmën e

atyre simboleve krijohet kufiri etnik ndaj grupeve të ngjashme etnike dhe fqinje.

Për shkak të pamjes së tyre somatike (ngjyrë më të errët të lëkurës) Ballkano - Egjiptianët nuk kanë problem të krijojnë kufi të tyre etnik ndaj bashkësisë shqiptare, maqedonase, serbe, turke, greke, bullgare, vllahe dhe bashkësive tjera etnike dhe popullore, por kanë problem të madh që “të Tjerët” t’i distancojnë nga Romët. Gjatë kësaj që shumë njerëz gjatë takimit të parë i konsiderojnë si Rromë, jo i rrallë është edhe rasti që t’i ngatërrojnë edhe me Arabët. Për këtë shkak është bërë një përpjekje e madhe nga “liderët” e lëvizjes etnike të Ballkano -Egjiptianëve ku para së gjithash do të përcaktonin dallimin midis Ballkano - Egjiptianëve dhe Romëve. Kjo nuk është e lehtë, sepse kufijtë etnikë ndaj Shqiptarëve, Serbëve, Maqedonasve, Turqve, Bullgarëve, Grekëve dhe të tjerëve barazohen në karakteristikat fiziko-antropologjike, derisa ndaj Romëve, doemos, duhet të përcaktohen sipas specifikave kulturore-sociale (**Хаџи Ристиќ, М.** 1996: 92-95). Egjiptianët janë të socializuar, të integruar në shoqëri, asnjë nga ata nuk jeton jetë nomade-endacake, si Romët. Kanë etnonime të shumëllojshme dhe janë marrë dhe merren me zanate si p.sh. farkëtarit. Fakti që edhe Romët zanatin e farkëtarisë e llogarisin si tradicional, ata nuk i bën konfuzë sepse konsiderojnë se Romët “e kanë vjedhur” atë zanat nga Egjiptianët, por edhe në kryerjen e këtij zanati ekzistojnë kufijtë etnikë. Egjiptianët punojnë në kudhër, duke qëndruar në këmbë, duke punuar punë më të vështira me hekur, ndërsa Romët punojnë ulur me këmbë të kryqëzuara, duke punuar punë më të lehta. Egjiptianët shtëpitë i kanë nëpër qendrat e qyteteve dhe fshatrave në të cilat janë totalisht të integruar që prej kohësh, ndërsa Romët janë bashkësi tradicionale endacake, ndërsa në kohët e fundit vendosen nëpër periferitë e qyteteve dhe jetojnë në geto (bashkësi të mbyllura).

Megjithatë, etnonimet e ndryshme, të cilat janë krejtësisht të qarta në kufijtë e brendshëm të bashkësive dhe me të cilat bëhet dallim dhe diferencim i qartë, të bashkësitë e jashtme ndodh konfuzioni dhe dyshimi më i madh. “Të tjerët” nuk mund të bëjnë dallim midis “Egjiptin” dhe Cigan, midis Evgjit dhe Gabelit, midis Giftos dhe Ciganoi etj. Për këtë shkak, edhe shkencëtarë të përmendur, duke mos mundur të shpjegojnë pse midis “Ciganëve” ekzistojnë edhe emërtime, lidhur me Egjiptin, “lansojnë” kuazi-teori se një pjesë e Ciganëve gjatë udhës së tyre nga India, në Ballkan dhe Evropë kanë ardhur nëpër Egjipt, duke mos ofruar asnjë fakt ose argument me vlerë shkencore dhe ajo kuazi-tezë e “lansuar” të bëhet “e vërtetë shkencore” përgjithësisht e pranuar.

Forma konkrete e etnonimeve të shumëllojshme, varet edhe nga rrethanat. Të gjithë pjesëtarët e Ballkano - Egjiptianëve kanë qenë të

vetëdijshëm se i përkasin një grupi të veçantë, me emër të veçantë, megjithatë të gjithë nuk ishin të vetëdijshëm se emri i tyre është “i nxjerrë” nga fjala “Egjypt-Egjiptianë”. Në disa pjesë të Maqedonisë, ende e dinë se janë “Egjyptin”, “Esnafë” ose “Koptë”, por ende nuk e dinë se janë Egjiptianë, ose Kovaçët në Mal të Zi e dinë se janë Magjup, si bashkësi e veçantë e ndryshme nga bashkësia Rome ose ato fqinje, por nuk e dinë se janë Ballkano - Egjiptianë. Kur për herë të parë disa pjesëtarë të kësaj bashkësie kanë dëgjuar se janë me prejardhje nga Egjipti, shumë e kanë marrë se kjo është një “marrëzi” (absurditet). Për këtë shkak shumë njerëz sot shmangen të deklarojnë si “Egjiptianë” së pari, duke u frikësuar se do të jenë të qesëndisur, së dyti duke u frikësuar se do të paraqesin probleme (p.sh. përzënie) dhe e treta edhe ata vetë nuk kanë informata të mjaftueshme që ta sqarojnë dhe mbrojnë identitetin.

Etnonimet përveç klasifikimit etnik, kanë pasur edhe një funksion social me vlera. Termet “Gjyptin”, “Evgjit”, “Magjup”, shpesh janë të përdorura që të shënohet një pjesëtar i shtresës më të ulët sociale. Ato emra kanë pasur domethënie ofenduese dhe përlulëse. Individë nga bashkësitë fqinje, të cilët i kanë njohur vlerat e pjesëtarëve të përcaktuar të Ballkano - Egjiptianëve, do të thonin: “Mos i thirr “Gjyptin”, ata janë Egjiptianë. “Gjyptët” janë ata të parregulluarit, të ndyrë, pa shtëpi”.<sup>20</sup> Ndërsa kuptimi “njeri esnaf” është përdorur midis Egjiptianëve për t’u mbrojtur nga etnonimet e tilla sociale me vlera, përlulëse dhe ofenduese: “Ai është njeriu ynë, Esnaf, mos i fol ashtu”.

Individët etnikisht më të vetëdijshëm, gjatë ballafaqimit me sfidat për njohje i formuan disa supozime ideologjike dhe i lidhën me sentimente masive me popullsinë ballkano-egjiptiane. Problemi i parë shkencor me të cilin takohemi në rastin e Ballkano - Egjiptianëve është identiteti etnik që bazohet në qëllimin negativ: “Nuk e di çfarë jam, por e di çfarë nuk jam”<sup>21</sup>. Ata nuk duan të deklarojnë në mënyrë që të mos i përshtaten ndjenjave të tyre etnike. Problem tjetër është edhe kategorizimi i tyre etnik: bashkësi e veçantë etnike ose etnografike të Ballkano - Egjiptianëve herë pas here tregojnë shenja të kategorisë etnike, ndërsa herë pas here shenja të kategorisë bashkësi etnike.<sup>22</sup>

<sup>20</sup> Jone Klenko, 65v. nga Struga, në emisionin dokumentar “Potomcite na Oziris” në televizionin maqedonas nga viti 2000, tregon për atë se si i ka edukuar gjyshi i tij.

<sup>21</sup> Sulejman Ademi, 85v. nga Mali Allash, komuna Lipjan, Kosovë.

<sup>22</sup> A.Smit 1998:39: Antoni Smit i dallon kategoritë: etni nga bashkësitë etnike. E para paraqet popullsi njerëzore për të cilën disa nga jo-pjesëtarët e tyre perceptojnë se përbëjnë një grup të veçantë kulturor ose historik. Por popullsia e shënuar në atë mënyrë mundet në atë kohë të posedojë një vetëdije të vogël, vetëdije të mjegullt për atë se përbëjnë kolektivitet të veçantë. Kështu, p.sh.deris në vitin 1900, Turqit në Anadoll,

Marrëdhënia ndaj kuptimit “Egjipt” është sekondare, dhe shpesh nuk ekziston asnjë marrëdhënie ndaj tij. Disa ndiejnë tërheqje të fuqishme, ndërsa të tjerët janë flegmatikë. Shumë dëshirojnë ta vizitojnë Egjiptin dhe të shijojnë se si jetohet atje, ta krahasojnë mënyrën e jetesës së Egjiptianëve në Egjipt me mënyrën e jetesës së tyre. Shumë të rrallë janë ata që do të kishin dëshiruar të shpërngulen atje. Problemi i burimit dhe modelit tradicional të kulturës së Ballkano - Egjiptianëve nuk është njëdimensional. Sipas mundësisë se në Egjipt jeta është totalisht e ndryshme merren dy lloj marrëdhëniesh: disa do të ishin gati ta ndjekin modelin e tokës “matkë”, modelin e jetës të “Egjiptianëve të vërtetë”, formën burimore të kulturës së tyre; ndërsa të tjerët nuk janë gati për një gjë të tillë, duke llogaritur se janë tepër të futur në modelin e kulturës që tani e pranojnë. Ndeshja midis egjiptianitetit ballkanik dhe atij të Egjiptit është shumë e ndërlikuar: i dyti edhe nuk ekziston, shpesh as në planin e jo-vetëdijshëm as edhe në planin emotiv. Ai përjetohet si diçka e largët, por si diçka që është e rëndësishme dhe në masë të madhe tërheqëse.

Ballkano - Egjiptianët zotërojnë më tepër identitete grupore. Ata zotërojnë identitetet kombëtar (shtetëror), lokal-gjeografik, etnik, gjuhësor, farefisnor. Ato janë Majovci, Kominovci, Berisha (farefisnor dhe/ose identitet plemor), Egjiptianë (identitet etnik-popullor). Ohrijanë, Vlonjat, Korçarë, Kosovarë (identitet territorial, kulturor) dhe Shqiptarë, Maqedonas, Jugoslovenë (më parë), Grek, Bullgar, Boshnjak (identitet kombëtar/shtetëror). Përjetimi i këtyre identiteteve është i ngjyrosur individualisht. Shumica identitetin e tyre etnik, Egjiptian e vendosin në vend të fundit. Zakonisht, për shembull tek Egjiptianët nga Beogradi së pari e vendosin përkatësinë e bashkësisë territoriale/shtetërore (më së pari Beogradas) mandej, përkatësinë e kulturës serbe, dhe në fund përkatësinë e bashkësisë Egjiptiane. Identiteti i tyre etnik shpesh është i kushtëzuar enkas nga motive ekonomike, për çka edhe shpesh deklarohen si pjesëtarë të identiteteve të tjera. Edhe brenda në popullsinë Egjiptiane ekzistojnë nivele të ndryshme identiteti etnik. Për shembull Egjiptianët nga Maqedonia në Beograd veten e konsiderojnë si pjesëtarë më të pastër të “rracës” së tyre nga Egjiptianët e Kosovës, edhe anasjelltas, dhe ndaj tyre ekziston një

---

kryesisht nuk ishin të vetëdijshëm për ndonjë “identitet” të veçantë “Turk”-i veçantë në kuptim ndaj identitetit universal islam ose zotërues Otoman-ndërsa identitetet lokale, farefisnore, fshatare dhe religjioze, ndaj asaj shpesh kanë qenë më të rëndësishëm. Për dallim nga kategoria etnike, përveç emrit kolektiv dhe një ose më tepër elementeve diferencuese të kulturës së përbashkët, që i posedon kategoria etnike, bashkësia etnike i ka këto attribute: mit për prejardhje të përbashkët, përkujtime të përbashkëta historike, lidhje me “atdhe” të përcaktuar dhe ndjenjë solidariteti tek pjesë të rëndësishme të popullsisë.



distancë. Identiteti farefisnor ekziston, por nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në sistemin e identitetit të individëve. Identiteti religjioz, i kuptuar si pjesë nga përkatësia etnike (egjiptiane), si pjesë e pandarë e identitetit etnik është mjaft i rëndësishëm për një kuptim të Egjiptianëve nga jashtë, por edhe për kuptimin e tyre brenda vetvetes.

Fakt është se Ballkano - Egjiptianët biologjikisht janë mjaft “të mbyllur” (endogamë). Ata edhe sot kryesisht janë të drejtuar nga pjesëtarët e bashkësisë së tyre, edhe pse ajo gjithsesi nuk do të mund të quhet etnocentrik në kuptimin negativ, as edhe nuk është një rregull i rreptë. Në plan të parë, në pikëpamje të lidhjes së kurorave, janë pjesëtarët bashkësisë së tyre etnike. Ajo nuk është vetëm dëshirë e pleqve, por edhe orientim i Egjiptianëve të rinj. Si shkak për një orientim të tillë është ngjashmëria kulturore, e cila nuk do të prodhojë në martesë ndonjë konflikt ndërkulturor. Ai është shkak praktik. Shkaku i dytë është “ruajtja e fisit”, “vazhdim të llojit”, ai është shkak ideologjik, etno-mitologjik. Vështirë është të besohet se ata sot janë më të mbyllur sesa para disa shekujsh, kështu që është e arsyeshme të llogaritet se ata shumë gjatë, nëse jo ose gjithmonë ose nga ndonjë kthesë shoqërore-politike në historinë e Ballkanit, gati janë bashkësi e plotë endogame. Gjithashtu ka ndikuar edhe fakti se ngatërrimi me bashkësitë e tjera ka tërhequr edhe ndryshime në statusin social, por edhe etiketimin si persona asocialë. Për këtë shkak ata nuk kanë qenë të dëshiruar si bashkëshortë, nga bashkësitë “e larta” (Shqiptarët, Turqit, Maqedonasit, Serbët, etj) deri sa edhe ata vetë kanë shmangur dhe shmangin martesat me Romët.

Identiteti etnik i Ballkano - Egjiptianëve mund të studiohet edhe me ndihmën e metodës etno-psikologjike. Tek një numër i madh Egjiptianësh kompleksi i vlerës së ulët është i përmendur në mënyrë indirekte, që bazohet në tre elemente: a) pashkollimi i tyre që është i kushtëzuar nga profesioni i tyre (zanatçinji), b) në moszotërimin e kulturës së tyre specifike, dhe c) në pamjen e tyre fizike që i ndan nga pjesa më e madhe e popullsisë (ngjyrë më të errët të lëkurës). Ky kompleks tregohet në dëshirën e të qenit i vlerësuar, i pranuar. Edhe pse ka shumë nga ata që si individë janë shumë të vlerësuar dhe me autoritet<sup>23</sup>, ata si bashkësi/kolektivitet në shkallën e ndarjes shoqërore janë mjaft ulët, sidomos në rrethanat tradicionale, ku ai klasifikim

<sup>23</sup> Një numër i madh rastesh Egjiptianët jo vetëm që vetë e kanë fshehur identitetin e tyre, por edhe kanë qenë të përvetësuar nga bashkësitë e tjera, me vlerat e tyre të pranuar dhe pozitive. Përvetësimet e tilla janë të shpeshta dhe të njohura, veçanërisht kur atë e kanë bërë popujt që kanë qenë në pushtet ose kanë qenë shumicë, e nuk janë marrë me zanat ose mjeshtëri të tillë. (Хази Ристиќ, 1996:95).

është më i fortë dhe më i qartë. Ata janë marrë më zanate, që është veprimtari shërbyese. Tek ata edhe sot është prezentë frika nga përlulja. Prandaj, shumë mundohen që ta shmangin atë sa më tepër është e mundur. Ata si individë zotërojnë vetëdijen për vlerën e tyre njerëzore, por janë të vetëdijshëm se karakteristikat e tyre kulturore-fizike dhe përkatësia e tyre grupore, mund të provokojnë situata të pa dëshiruara.

Për atë, te një numër i madh pjesëtarësh të kësaj bashkësie paraqitet **mimikria etnike dhe identiteti i preferuar etnik**. Fenomenin e quajmë mimikri etnike, sepse vetëdijshëm dhe me këmbëngulje e ruajnë identitetin e tyre edhe pse bashkësitë e “Tjera” dhe ato fqinje e dinë se ata nuk i përkasin asaj bashkësie dhe atij identiteti që preferojnë ta tregojnë (Shqiptarë, Turq, Myslimanë, Maqedonas, Serbë, Bullgarë, Grekë, Boshnjakë, etj).

Problemi i mimikrisë etnike dhe identitetit të preferuar edhe pse nuk është i panjohur në etnologji (**Haxhi Ristiç, M.K.** 1996:95)<sup>24</sup> ose sociologji deri tani nuk është përkatësisht dhe veçanërisht në shkencë i hulumtuar. Duke e marrë parasysh atë se mimikria etnike dhe nevoja për identitet të preferuar më tepër është dukuri sociologjike dhe etno-psikologjike dhe për këtë fenomen do të përdorim njohuri të përcaktuara të sociologëve.

Identifikimi etnik paraqet një aspekt të vetëdijes globale, përkatësisht të identitetit të njeriut. Ndërsa identiteti si organizim koherent qëndrimesh për veten si përkatës i shoqërisë ka dy burime: 1) rolet shoqërore që e përcaktojnë vendin e individit në sistemin shoqëror (statusin e tij shoqëror) dhe 2) historia individuale e jetës së tij. Këto dy burime ndikojnë mbi formimin e të dy aspekteve të identitetit-identiteti shoqëror i konceptit për veten (**Ташева, М.** 1996: 7). Identiteti etnik paraqet vetëdije për veten si përkatës i grupit ose bashkësisë së dhënë etnike. Ai përfshin dituri për prejardhjen dhe përkatësinë momentale në bashkësi të dhënë, përkatësisht dituri për paraardhësit e tyre dhe për veten si individë, që i trashëgojnë përvojat e tyre dhe që dituritë e tyre i lidhin edhe me të vetat. Megjithatë ai përfshin edhe vetëdijen për pozitën e pakicës në shoqërinë e grupit të tij etnik e bashkë me të edhe pozitën e vet minoritare (**Ташева, М.** 1996: 7).

Identiteti etnik dhe global shoqëror mund të jenë ose jo në koordinim me njëri-tjetrin. Njeriu mund të jetë krenar që i përket një grupi të përcaktuar etnik dhe njëkohësisht krenar për vendin që ai grup merr në

---

<sup>24</sup>Mimikria etnike është e njohur në etnologji, kur disa popuj, fise ose grupe etnike dhe bashkësi, nga shkaqe të ndryshme-për shkak të fshehjes dhe bërjes gabime, krim, janë fshehur, janë trembur, nga hakmarrja nga pjesëtarë të tjerë, ose nga turpi që disa nga pjesëtarët e tyre kanë kryer vepër të pandershme, ose për shkak dhune të qeveritarëve, okupatorëve, të cilët janë kërcënuar dhe kanë kryer gjenocid në ata ose situata të ngjashme.

shoqërinë më të gjerë. Megjithatë nëse pozita e grupit të tij etnik është inferiore dhe me të përkatësia e tij etnike përfaqëson një mangësi në realizimin e pritjeve të tij komplekse statute, ndjenjat e tij ndaj atij grupi mund të jenë ambivalente, por edhe plotësisht negative (Ташева, М. 1996: 8).

Në shoqërinë globale në të cilën ekzistojnë dallime të mëdha midis grupeve, të mëdha janë edhe mundësitë për theksimin e elementeve negative të identitetit të pjesëtarët e grupeve minoritare. Në situatën, kur ata janë të vetëdijshëm për idealet e bashkësisë dominuese dhe kulturës, por janë të penguar që t'i ndjekin, mund të vijnë deri në bashkim të aspektit negativ të identitetit dhe ndjenjat negative, që për ata i bartin pjesëtarët e bashkësisë vendase dhe kulturës. Rezultat i kësaj është formimi i identitetit negativ ose “identitet përkuftimi”, i cili në vetvete përfshin ndjenja inferioriteti dhe vet-urrejtjeje (Ташева, М. 1996: 11). Te bashkësitë minoritare ajo shkakton efekte që shikohen në fenomenin e mbajtjes së pozitës inferiore, që më shumë e kanë, anëtarët e atyre grupeve që e pranojnë pozitën e tyre pa ankesa, ndërsa pakënaqësinë e tyre e shprehin indirekt nëpërmjet muzikës, poezisë, aktiviteteve religjioze etj.

Grupi etnik me solidaritetin e tij të anëtarëve të vet u shërben si mbrojtje dhe përkrahje në sigurimin e ekzistencës dhe pastrimin e rrugës nga pozicionet më të qëndrueshme dhe më të larta shoqërore. Megjithatë, statusi pjesëtar i minoritetit etnik paraqet mangësi për bartësit e tij në rastet, kur ata kanë ambicie personale, të cilat dalin nga kornizat e grupit të tyre etnik, sidomos nëse ata janë të kahëzuar nga sferat, në të cilat dominon grupi i mazhorancës. Personat me interesa të veçanta personale, pjesëtarë të grupeve minoritare, duke i pasur parasysh aspektet kufizuese të etnitetit, zakonisht mundohen të mos e tërheqin edhe grupin e tyre etnik në përpjekjet për realizimin e interesave të veta. Megjithatë, ata zakonisht ballafaqohen me realitetin se ajo është vetëm pjesërisht realizuese.

Në stereotipet e përfaqësuesve të shtresave më të larta nga bashkësia vendase, për shtresat më të ulëta zakonisht etnikja dhe skamja janë të lidhura ngushtë. Kështu vargu i vetive që u përshkruhen pakicave etnike, nuk janë të kushtëzuara nga specifikat e kulturës së tyre, por nga kushtet e mjera në kornizat e të cilave i japin kuptim ekzistencës së tyre. Gjatë kësaj stereotipet ekzistojnë si etnike. Me të, me njohjen e përkatësisë etnike të individit, atij i përshkruhen karakteristikat, të cilat sipas bazës së tyre janë klasore<sup>25</sup>. Kur mundësitë për arritjen e pozitave më të larta të përfaqësuesve të një grupi të përcaktuar etnik janë direkt të varura nga ajo se sa është niveli

<sup>25</sup> Ташева М., 1996, pjesë e cituar nga: Nadel S.F., Theory of social structure, Gleonce Hill, Free Press, 1957.

i pranimit të tyre nga grupi dominues, ata më shpesh mundohen ta fshehin identitetin e tyre etnik (Ташева, М. 1996: 24).

Me të nevoja e pjesëtarëve të Ballkano - Egjiptianëve bëhet krejtësisht natyrale, të zbatojnë mimikri etnike ose identitet të preferuar përkushtimi, të cilët jetojnë si bashkësi të vogla minoritare nëpër qytetet, e diku vetëm si një ose dy familje në fshat, për integrim të tyre dhe arritje e pozita më të larta në rrethanat e ndryshme dominuese etnike nëpër Gadishullin Ballkanik. Ndërsa këto rrethe dominuese janë të ngarkuara me paragjykime dhe stereotype etnike dhe racore, të cilat prej shkaqesh sociale dhe racore Ballkano - Egjiptianët nuk i llogarisin si të tyret. Nga ato shkaqe kemi një numër të madh Egjiptianësh që preferojnë të deklarojnë si shqiptarë, ndërsa nuk janë të pranuar si shqiptarë, mandej ata që preferojnë të jenë turq ndërsa nuk janë të pranuar si turq etj. Por në rastin me Ballkano -Egjiptianët kemi edhe raste, kur “të Tjerët” ata i perceptojnë si Ciganë, por e dinë se nuk janë Ciganë ndaj preferojnë t’i quajnë “Ciganë të Bardhë” ose “Gjuptë tanë” etj., gjithçka me qëllim që të vendosin kufirin e vet ndaj tyre, i cili nuk mund të jetë gjuhësor, por vetëm antro-po-somaikt, shkaku i ngjyrës më të errët të lëkurës, për të cilin sinonim janë Ciganët ose Romët, por në të njëjtën kohë, duke bërë edhe dallimin nga Romët, ku nuk kanë etnonim adekuat, përveç që “të zezën ta zbardhojnë”, ose “të Tjerët t’i bëjnë Tonë”.

Në një konstelacion të tillë “identiteti i përkushtimit” i cili në rastin e Ballkano - Egjiptianëve arsyetohet me gjuhën e përbashkët dhe në masë të madhe me religjionin e përbashkët me bashkësinë dominante, ka ideologji të fortë, por edhe pragmatikë të dobët për mbajtjen e “NE”. Egjiptianët gjithmonë janë “Brenda të Tjerëve” për bashkësitë dominuese në Ballkan, që më mirë vërehet nëpërmjet asaj që ata rrallë, gati asnjëherë nuk lidhin kurorë me “të tonët e tjerë”. Kur rastet shoqërore do të ndryshohen dhe kur ideologjia e identitetit të preferuar nuk mundet më t’i sqarojë antagonizmat pragmatike midis “brenda të tjerëve”, “identiteti i përkushtimit” preferues, e humb kuptimin e tij dhe individët e bashkësisë minoritare ndiejnë nevojën për homogjeni dhe solidaritet sa më të madh në “in-grupin” e tyre në të cilin nuk ka “të brendshëm të tjerë”.



## **TË DHËNA HISTORIKE, ARKEOLOGJIKE DHE TË TJERA PËR ARDHJE DHE PREZENCË NË VENDET BALLKANIKE**

Në publikimet e botuara të deritashme për Egjiptianët e Ballkanit ekzistojnë disa punime, të cilat e trajtojnë problemin e datimit dhe locimit të migrimit nga Egjipti në Ballkan. Në ato punime flitet për supozime dhe mundësi ardhjeje Egjiptianësh në Ballkan (**Ристески, С.** 1991; **Хаџи Ристиќ, М.** 1996).

Problematika e datimit dhe locimit të migrimit nga Egjipti në Ballkan është shumë komplekse, d.m.th deri në përgjigjen e vërtetë duhet të hyhet rigorozisht me ndihmën e rezultateve të ndryshme shkencore nga disciplina të ndryshme shkencore dhe shoqërore.

Në këtë punim tonin ndaj problematikës hyjmë në mënyra më të ndryshme, meqë do t'i prezantojmë, do t'i sqarojmë dhe përpunojmë faktet dhe të dhënat e reja dhe atyre më të publikuara, duke i vendosur në kontekst të kohës dhe ngjarjeve të historisë, pa i etiketuar si supozime ose mundësi.

Në tekstin që vijon do të bëjmë një retrospektivë të historisë së Ballkanit dhe Mesdheut Lindor, nga kohërat më të lashta e deri më sot, sepse këto vise nganjëherë kanë qenë të afërta, e dikur i kanë takuar një tërësi të njëjtë shtetërore dhe kulturore, fakt që nuk duhet të lihet anash ose të harrohet.

## PERIUDHA E LASHTË

Deri në mesin e mijëvjeçarit të dytë p.e.r. në Mesdheun Lindor shteti i vjetër egjiptian dhe civilizimi ka qenë forcë më e fuqishme dhe më autoritare. Gjatë periudhës së gjatë kohore prej disa mijëra vitesh, shteti i vjetër egjiptian ballafaqohet me probleme të brendshme dhe të jashtme (kryengritje të brendshme, përlëshje, luftëra mitologjike, ndryshime të qendrave kryesore të qyteteve në Egjipt, ndërhyrje, sulmi dhe integrimi në institucionet shtetërore të Hiksëve etj.)<sup>26</sup>. Nga ana tjetër ajo është një periudhë e kohës së bronzit, ndërsa hekuri ka filluar të përdoret më tepër, që prej shek.XII p.e.r. masivisht deri në shek. V p.e.r. dhe periudha quhet kohë e hekurit, në literaturën shkencore. Fillimi i kohës së hekurit d.m.th. revolucioni i hekurit përputhet me qeverisjen e të ashtuquajturës Dinastia XIX, përkatësisht me qeverisjen e faraonëve Seti I (1294-1279 p.e.r.) dhe Ramzes II (1279-1213 p.e.r.) (Котрел, А. 1988: 31).

Hekuri është një ndër metalet me karakter mitologjik (prejardhje) në Egjipt. Sipas legjendës skeleti i Zotit Set, Zot i Erës dhe Rrufesë, zotëriu i shkretëtirës dhe armiku i Ozirisit dhe Horusit, ka qenë prej hekuri. Hekuri është quajtur “metal qiellor” (ajo çka ka rënë nga qielli), sepse gjatë kohës Egjiptianët e Vjetër e kanë njohur vetëm hekurin meteorik me pastërti të madhe dhe përmbajtje të madhe nikeli. Për shkak të prejardhjes së tij zotëruese, hekuri meteorik është përdorur veças për punimin e amuleteve mbrojtëse dhe modeleve magjike veglash, të cilat janë të nevojshme për ritualin e ashtuquajtur “hapje e gojës” në ceremoninë gjatë përgatitjes së mumjeve të vdekurve në jetën pas vdekjes (Scheel, B. 1989: 17).

Duke vështruar nevojën e përdorimit sa më të madh të hekurit, faraonët nga dinastia XIX, kanë filluar të importojnë hekur nga viset tjera të afërta dhe më të largëta të pasura me mineral të hekurit, para së gjithash nga Peloponezi, Mitani dhe Anatólisë Hetite<sup>27</sup>, dhe me siguri nga Kipra, sepse

<sup>26</sup> Shiko “Egypt from 3200 BC till present day”, Tableaux Synoptiques De L’Historiere (TSH), France.

<sup>27</sup> Lidhjet midis Hetitëve dhe Egjiptianëve të Vjetër në histori janë mirë të njohura. Hetitët janë popull, i cili ka ardhur nga viset e Ermenisë të sotme, i kanë kaluar malet Kaukaze dhe janë vendosur në Azi të Vogël në jug nga Deti i Zi. Përparësia e tyre mbi Sumerët, Egjiptianët dhe popujt e tjerë ka qenë në atë se të parët e mësuan përdorimin e hekurit i cili është më i fortë nga bronzi dhe shkrihet në temperaturë shumë të lartë. Hetitët të cilët të parët zbuluan sekretin e arritjes së temperaturës të lartë me shekuj e kanë ruajtur atë sekret. Në kohën e Ramzes II, Hetitët kanë luftuar me Egjiptin (e njohur është beteja te qyteti Kadesh), por mandej ka ardhur deri në pajtim (paqja në vitin 1275 p.e.r.) dhe afrim që është vërtetuar me lidhjen e martesës midis Ramzes II dhe vajzës së qeverisësit të Hetitëve, Hatushilisha II. Me të, Egjipti Hetitët i ka pasur si aleatë, ndërsa

sipas burimeve historike nuk mund të shihet se ka qenë e njohur ekzistenca, e më shumë eksploatimi i mineralit të hekurit në territorin e Egjiptit, deri në ardhjen e dinastisë së Ptolomedëve (Scheel, B. 1989: 17).

Revolucioni i hekurit, kërkimi i rezervave dhe eksploatimi i mineralit të hekurit, me siguri janë shkaku për çka Ramzes II është dhënë në pushtim të Mesdheut Lindor, Anadollit dhe Ballkanit, i cili vërtetohet edhe në shkrimet e Herodotit<sup>28</sup>. “...Do të kthehem në atë që ka qenë mbret para tyre, e emri i të cilit është Sesotrid ... Kur do të kisha hasur në guximtarë dhe në ata të cilët përzemërsisht kanë mbrojtur lirinë, në tokat e tyre ka vendosur shtyllë me mbishkrim në të cilën ka qëndruar emri i tij dhe prejardhja dhe se ata kanë qenë të nënshtruar nga ushtria e tij...”Mandej Herodoti vazhdon “...Duke e bërë atë,duke kaluar nëpër gjithë tokën, derisa prej Azisë nuk ka kaluar në Evropë dhe nuk i ka nënshtruar Skitët dhe Trakët. Mendoj se ato janë vendet më të largëta deri ku ka mbërritur ushtria egjiptiane... Nuk mund të themi me siguri se mbreti Sesotrid vet ka ndarë disa nga trupat e tij dhe atje i ka lënë të vendosen në atë toka ose disave nga ushtarët mbi kokë u ka ardhur nga hidhërimet e tij, ndaj mbetën...”

Për ekspeditën e njëjtë pushtuese të Ramzes II, përveç të tjerave ka edhe një mbishkrim tjetër interesant nga majori Mehmed Tefik, drejtor i gjimnazit ushtarak të Manastirit<sup>29</sup>, në librin e tij “Histori e shkurtër për vilajetin Manastirit” e shkruar në gjuhën turke në alfabet arab, e botuar në vitin 1911 (Константинов, А. 1982). Ai për këtë ekspeditë të Ramzes II thotë se në Veri ka prekur deri në Dunab, ndërsa në perëndim deri në Beratin e sotëm!

Nga e lartpërmendura rrjedh se që prej kohës së ekspeditës së Ramzes II në Ballkan kanë ardhur dhe kanë banuar, kanë ndenjur Egjiptianë. Duke pasur parasysh faktin, se bëhet fjalë për ekspeditë pushtuese me qëllim që të eksploatohet hekuri dhe minerali tjetër nga Ballkani, me siguri bëhet fjalë për njerëz që punojnë me metal. Për këtë gjejmë edhe një vërtetim të Herodoti i cili thotë: ”...Në Maqedoni edhe fenikasit e Vjetër e kanë

---

popujt e tjerë i ka nënshtruar. Meqë Hetitët kanë qenë zotërinj të zjarrit dhe shkrirjes së hekurit nuk është e përjashtuar mundësia që bashkë me Egjiptianët në Ballkan të jenë vendosur edhe Hetitët nën emrin Egjiptianë dhe patronazh të tyre. Por, edhe shumë para asaj gjatë kohës së krizës së dinastisë pas vdekjes të Tutankamonit (1336-1327 p.e.r.)mbretëresha egjiptiane ka kërkuar ndihmë nga sunduesi i Hetitëve të dërgojë ndonjë nga djemtë që të martohet me të dhe të shpëtohet troni. Gjatë kohës së luftës trojane, sunduesi i Hetit, faraonit të Egjiptit i është drejtuar me thënien “vëllai im”. (Хауи Пустук, М. 1992).

<sup>28</sup> Herodoti, Libër i dytë i quajtur Euterpa, 102,103.

<sup>29</sup> Në atë gjimnaz edukim ushtarak ka marrë Kemal Mustafa Pasha-Ataturk, babai i Republikës moderne Turke.



eksploatuar arin nga xeherorët që e kanë shkrirë në furra speciale, shumë para ardhjes së kolonistëve egjiptianë në Eladë...” Nga ky shënim shihet se Egjiptianët e kanë kolonizuar Ballkanin para jetesës së Herodotit. Kolonizatorët me siguri kanë qenë robër (midis kriminelëve të tjerë dhe të burgosur)dhe skllavopronarëve, të cilët me siguri e kanë bartur edhe sistemin e nxjerrjes të mineralit të arit,që është praktikuar edhe në Egjipt (Scheel, B. 1989: 12).

Sipas Martin Bernal (Bernal M., 2009:79), kur i analizojmë traditat Greke të kolonizimit, është e dobishme ti sistematizojmë në tri kategori: se pari, aty janë traditat e lidhura me personat mitologjik te mbretit Inah në Arg dhe Amfion dhe Zet në Tebë; e dyta ekzistojnë tradita për Kekropsin në Atikë ose për Radamantin në Kretë, për te cilët ka pasur edhe debate në periudhën antike; dhe e treta legjenda për Kadmon, Danaijin dhe Pelopën te cilat kanë qenë pranuar gjerësisht.

Sipas rrefimeve të autorëve të lashtë grekë në lidhje me themelimin e qytetit Athinë, mund të vërehet se “Egjiptianët janë të banuar në 12 mëhalla në Athinë, ku merren me zanatet e tyre, ndërsa më vonë këto mëhalla do të bëhen qendra të kësaj popullsie, që më vonë (Egjiptianët) ta pranojnë emrin e përbashkët Athinas ...”

Kolonizimi i Egjiptianëve të Vjetër në Ballkan nuk mundet të mos ketë ndikim në kulturën dhe civilizimin e popujve, të cilët në atë kohë kanë jetuar në Ballkan. Duke marrë parasysh këtë, se bëhet fjalë për një periudhë, nga e cila nuk ka të dhëna dhe burime të mjaftueshme historike ose më saktë asnjë lloj të dhënash dhe burimesh historike, përfundime të përcaktuara, si edhe për popujt e tjerë nga ajo kohë në Ballkan, mund të nxjerrim nga legjendat dhe mitet e popujve ballkanik, për të cilët kanë mbetur shënime te historiografët më të vonshëm. Për atë edhe periudha prej shek. XII deri shek. V p.e.r. quhet kohë mitologjike.

Sipas Homerit, Egjiptianët kanë marrë pjesë në luftën Trojane me Pajonët<sup>30</sup> dhe Maqedonasit kundër Ahajëve. Në një citat thuhet<sup>31</sup>:

“ Menjëherë Egjiptianëve fushat e bukura jua konfiskuan, gratë e tyre i morën dhe fëmijët jua rrëmbyen dhe ata i vrisnin, por zëri nëpër qytet u rrëzua shpejt.”

Homeri nuk i ka përmendur kolonizimet, por nuk ka pasur as arsye për një gjë të tillë. Ilijada është e plotë me përmendjen e Danajëve dhe

<sup>30</sup> Pajonët janë bashkësi plemore midis lumenjve Struma dhe Vardar. Me sundimin e këtyre rajoneve nga Filip II, Pajonët hyjnë në përbërje të popullit dhe shtetit Antik Maqedonas.

<sup>31</sup> Odise, Beograd 1977, në Itakë, Këndimi i katërt faq.360.

Kadmejët, të cilat eponime, Danaj dhe Kadmo, Grekët e vonshëm do ti njohin si emra që kanë ardhur nga Egjipti dhe Fenikija. Një autor, po ashtu i lashtë si Homeri, Hesiodi, ka lënë shumë gjurmë për Danajin dhe vajzat e tij, të cilat gërmojnë bunarë në qytetin Arg, si dhe për implikimet të forta të relacioneve të tij me Ajgipin. Dhe nëse duam të dyshojmë për lashtësitë e burimeve të Eskilit, Eurupidit dhe Herodotit, të dhëna të tjera janë arsyeja për mundësinë e madhe së traditat për Danajin dhe Kadmon shkojnë mbrapa deri në kohët epike.

Në tragjeditë Greke po ashtu mund të gjenden vepra që flasin për kolonizimin e Egjiptianëve në Ballkan. Mirëpo shembulli me dramën “Lutesit” e Eskilit është më reprezentativ për vendbanimin me popullatë nga Egjipti. Zesusi ka qenë i dashuruar të Io, vajza e mbretit Inah prej qytetit Arg. Hera, gruaja e Zeusit, në njërin prej shpërthimeve të xhelozisë, e transformoi Io në lope dhe e mundonte. Ajo ikte në shumë vende dhe më së fundi u vendos në Egjipt, ku e lindi djalin e Zeusit- Epahin. Në trashëgimtarët e Epafit dhe bashkëshortes janë të kyçura edhe Libija, Posjedoni, Beli, mbreti Agenor nga Tiri, babai i Kadmos dhe Europes, dhe vëllezërit binjakë Danaji dhe Ajgipi. Danaji ka pasur 50 vajza, dhe Ajgipi 50 çuna. Vëllezërit janë përçarë, por me vonë do të vijë deri në dasme masive, në të cilën, përveç një përjashtimi, vajzat e Danajit do të vrasin djemtë e Ajgipit. Në ndonjë mënyrë, Danaji më vonë do të vijë deri te froni i qytetit Arg. Versionet e shumta të legjendës së shumti ndryshojnë, sidomos rreth asaj se ku kanë ndodhur ngjarjet në Egjipt ose në Arg. Drama “Lutësit” e përshkruan një episode të kësaj legjende, arrijten në Arg e vajzave të Danajit, si lutës të ikura nga Egjipti prej qëllimeve të liga të bijve të Ajgipit. Atje do ti jepet strehim prej anës të mbretit Pellazg. Kur do të vije mesazhi prej Ajgipitit dhe djemtë të tij ku me arrogancë i urdhërojnë vajzave të Danajit të kthehen mbrapa, Pellazgu refuzon dhe drama mbaron me plane për vendbanim të Danajit dhe vajzave të tij me Pellazgun dhe njerëzit e tij në Arg (Bernal M., 2009:85).

“Si ka ndodhur Egjiptianet të arrijnë në Peloponez dhe çfarë kanë bërë që të bëhen mbretë në atë pjese të Greqisë, ka qenë e shkruar dhe prej shkrintareve të tjerë; prandaj unë nuk do të plotësoj asgjë, por do të vazhdoj të përmend mite të tjera, që asnjëri nuk i ka prekur” (Herodot, VI.55). Ky tekst tregon se Herodoti nuk ka shkruar shumë shkrime për kolonizimin, se ka besuar që ajo është e bërë në tjera libra. Mirëpo, në të njëjtën kohë dhe më intensitet të madh, tregon se Herodoti ka qenë fort i bindur se kolonizimi ka ndodhur. Libri i tij “Historia” është plotë me referenca të cilat drejtohen në to. (Bernal M. 2009:92).

Herodoti në librin e dytë Euterba me numër 50 do të thotë : ”Madje emrat e gati gjithë zotrave të Eladës kanë ardhur nga Egjipti”. Mandej sipas rrëfimeve të tij dhe sipas mitit për Persejin do të thotë: “atë që e thashë deri në Persej, e nuk shkova edhe më pas, ajo është për shkak se kur flitet për Persejin nuk përmendet emri i asnjë të vdekuri, siç është babai i tij ... Ndërsa kur do të ishin numëruar paraardhësit e Danajës, vajzës së Akrisij, kur me prejardhjen do të ishte shkuar edhe më pas, udhëheqësit Dorijan do të dalin Egjiptianë të vërtetë. Kjo është prejardhja e mbretërve Spartak<sup>32</sup>, sipas Helenëve ...” Sipas Herodotit të njëjtën gjë kanë vërtetuar edhe Persianët: “Ndërsa sipas asaj që tregohet nga Persianët, edhe vetë Persei, i cili ka qenë Asirian është bërë Helen. Por paraardhësit e Perseit, nuk kanë qenë Helenë, të cilët kur bëhet fjalë për farefisni nuk kanë asgjë me Persein, por, ashtu si në të vërtetë thonë edhe Helenët kanë qenë Egjiptianë”.

Nga këto rrëfime të Herodotit si edhe rrëfimeve të tjera të tij në lidhje me Pellazgët, mund të parandihet se në periudhën midis shek. VII-VI p.e.r. terreni i të ashtuquajturës Greqi Antike ka disa procese asimilimi. Nga përmendja e Persejit se ka qenë Asir nga babai, ndërsa egjiptian nga e ëma, mund të supozohet se disa prej fiseve Dorian kanë ardhur nga Asiria (për

<sup>32</sup> Siç është e njohur në varrezat e Mikenës ku janë zbuluar maskat e argjendta nga Shliman në vetë hyrjen ndodhet “posrta luanore” e njohur, mbi të cilën ka shfaqje të dy luanëve njëri ndaj tjetrit, dhe në mes kanë shtyllë. Shfaqja e tillë në Egjipt të Vjetër është shpjeguar si Aker-luan i dyfishtë. Zotrat që mbajnë emrin Aker janë tepër të numërt në tekstet e piramidave. Shumëfortshmëria e determinativave të tyre rregullisht shpjen në motive të vendosura të cilat përsëriten deri në kohën eliniste, e shumë nga ata do të vijnë në lidhje me kultin e Serapisit. Gjat kohës së MbretërisëSë Re (dinastia XIX) vërehet se Aker, fillon të luaj rol të rëndësishëm në ciklusin solar, dhe gjat asaj mos i humbë lidhjet me botën ndërtokësore. shfaqja e Akerit, bëhet vend ku qartë vërehet prejka e ciklusit solar me atë thonik: në kufirin midis botës qiellore dhe asaj tokësore (nëntokësore), ngrihet Aker i cili në mbrëmje e gëlltit Diellin, që në mëngjes përsëri ta lind. Në librin e të Vdekurve paraqiten dy luanë të kundërshtuar që e përmbajnë qiellin, ndërsa janë të identifikuar me shenjën **ht** (ahet-horizont)aker është diçka më tepër se rojtar i dyerve të botës pas-varrore, nëntokësore, ai është simbol i fuqisë, principi negativ, ai në të cilin i vdekuri, zot, njeri ose krejt natyra përsëri e fiton fuqinë dhe vitalitetin e vetë. Luani i dyfishtë Aker direkt lidhet me Oziris dhe shpesh përmendet me vendet ku ndodhet sekreti i formave të Ozirisit, ndërsa në realitet ato janë ata vende të rrezikshme dhe misterioze, ata të cilët duhet të motivojnë që shpirti ta realizoj lidhjen e fuqishme me trupin, ku duhet të shkatërrohet armiku i mundshëm. falas Akerit, zoti i vdekur Oziris përsëri fiton frymë, ai nuk është pas vdekjes i shkatërruar. Tejbartur në njeriun e thjeshtë, ndërsa e dimë se në fund çdo egjiptian pas vdekjes bëhet Oziris, ajo nuk është asgjë tjetër por garancion se shkatërrimi pas vdekjes të jetë i ignuar, se i vdekuri do ta jetoj jetën e dytë të tij, jetë pasvarrore (Petar Selem, Egipetski kultovi...,104-106).

çka ekzistojnë edhe mite dhe legjenda të tjera, të përcaktuara, p.sh. kulti Mitra) kanë pasur simbiozë etnike me Egjiptianët e Peloponezit.

Miti përkatësisht legjenda e ardhshme, e cila mund të sillet në lidhje me vendosjen e Egjiptianëve në Ballkan është legjenda për Kadmon dhe pasardhësit e tij. Pikërisht sipas legjendës Kadmo është vëllai i Evropës, i cili është rrëmbyer nga Zeus. Kadmoa, shkon në kërkim të Evropës dhe sipas legjendës ai e kërkon atë, së pari në Kretë, mandej në pjesën tokësore të Greqisë të sotme, dhe nëpër Lihnidit (Ohri), shkon deri në pjesët lindore të bregut Adriatik. Legjenda për Kadmon dhe Kadmejtë e tij e lidhin tokën e Egjiptit (Teba në Nil), me Teba në Beoti dhe në fund me Teba të bregut Adriatik (Tivati i sotshëm). Madje, edhe pjesë të rrugës e cila më vonë është quajtur Via Egnatia, është trasuar nëpër të ashtuquajturën Rrugë Kadmeje. Shumë emra të paraardhësve të Kadmos janë të njëjta me emrat dhe vendet historike: **Epaf**, djali i Zeusit dhe **Ia**, është i martuar me **Memfis**, vajzën e Nilit. Atyre u ka lindur një vajzë me emrin **Libija** (emër elin për Afrikën). Libija ka qenë gjyshja e **Kadmos, Evropës** dhe **Belit**. Bel është babai i **Danajës (Elada)** dhe **Ajgipit (Egjypt)**. Njëri nga djemtë e Kadmos quhet **Ilir (Robinson, H.S., Wilson, K. 1976: 167; Pinsent, J. 1969: 48)**. Sipas legjendës Kadmo ka qenë Fenikas, Zeusi e ka rrëmbyer Evropën nga Fenikia, i shndërruar në bik. Motivi i Zeusit i shndërruar në dem, i cili e ka rrëmbyer Evropën, shumë shpesh është i përdorur në artin e pikturës dhe parafytyrimet figurative të më shumë autorë në Evropë. Këtu mund të lidhen edhe rrethanat e shumëllojshme në legjendën për Kadmon dhe gruan e tij Harmonia, shndërrimin e tyre në formë gjarpri. Kadmo dhe lidhja e tij me Enhelejët (Enhalon-ngjalë), të cilët simbol të kombat kanë pasur gjarprin<sup>33</sup>. Nëpërmjet shndërrimit të Zeusit në dem(demi Apis është një ndër zotrat më të vlerësuar në Egjipt të Vjetër) dhe lidhja reminiscentore me zotreshën egjiptiane të gjarprit Uazit, mund të vërehet jehona dhe fuqia e civilizimit egjiptian, në mitin dhe legjendën për Kadmon, e me të edhe të tregohen disa lëvizje migrimi të Egjiptianëve në Ballkan.

Legjenda për Kadmon mund të hyjë në një kontekst arkeologjik të lidhur me zbulimet arkeologjike në Kretë, Mikenë, Trebenishtë dhe lokalitete të tjera arkeologjike<sup>34</sup>. Maskat e argjendta dhe e gjithë

<sup>33</sup> P.Lisiçar, Legenda o Kadmu i veze Lihnida s Egejom i Jadranim,248...Enhelejet ("anguillari seu piscatores",Muller) janë klan (fis), të cilët si shenjë e kishin gjarprin. Nuk është pa arsye ajo që për një egzeget helenistik emir emir Enhelej i është afër, ose emrin e tyre Butue-Budva e sjell në lidhje më Buto, më emrin që Greket e thirrnin Nije bez razloga neki helenistički egzeget ime Edhe perandorinë egjiptiane Uazit...

<sup>34</sup> Në literaturën e shumtë arkeologjike mund të vërehet prezenca e një numri të madh zbulimesh arkeologjike, të cilat identifikohen si "minojoska", "mikene" etj., ndërsa janë

“mbështjellësja e argjendtë” rreth princërve të vdekur në Mikenë, Trebenishtë dhe vendet e tjera, sipas arkeologëve i përkasin të ashtuquajturit princip Egjiptian dhe në rrethin e njëjtë religjioz dhe ideor si edhe piramidat dhe mumifikimi. Në Egjipt, në Kretë, në Mikenë dhe Trebenishtë gjejmë një konceptim të njëjtë eskatologjik, i panjohur në frymën racionale heliniste. Për këtë dukuri Lisiçar mendon se tregtarët “Grekë” në fillim të mijëvjeçarit të parë p.e.r. kanë ardhur në Maqedoni e nëpër të në Epir dhe bregun Adriatik në radhë të parë për furnizimin me mall dhe materiale dhe se këta tregtarë të interesuar shumë herët për arin dhe argjendin “maqedonas” për çka është e ruajtur dhe tradita në legjendën për Kadmon (**Lisicar, P.** 1953: 250). Kadmo, si Kamilos-Kasmilos, ka qënë edhe një ndër katër Kabirët, të cilët kanë qënë mbrojtës të zejtarisë, ndërsa kanë qënë të adhuruar nga Pellazgët, banorët e ndryshëm “paragrekë” dhe “parailirë” të këtyre viseve, të cilët kanë qënë zejtarë të mire (**Lisicar, P.** 1953: 250).

Sipas Herodotit, vajza e Kadmos, Semela, është nëna e zotit Dionis (**Herodot, II.145**). Sipas tij, faraoni Sesostrit, në Ballkan ka depërtuar deri në Thraki dhe Skiti. Kult i zotit Dionis, në Ballkan ka filluar të përhapet nga Thrakia (**Фрејзер, II. II.** 1992: 488). Megjithatë, mënyra në të cilën është festuar Dionisi, fabula dhe mesazhi i ceremonialit, vdekja e zotit që ai mandej përsëri të ngjallet, është e ngjashme me rrëfimin e zotit egjiptian Oiris (**Фрејзер, II. II.** 1992: 485-494). Si të parë që e ka sjellë kultin e Dionisit në Ballkan, Herodoti përmend Melampodin, djalin e Amiteonit (**Herodot, II.49**). Është ai që Helenëve u ka treguar për emrin e Dionisit, për sakrificën dhe procesin me Faustin. “E, megjithatë më së tepërmi besoj se Melampodi e mësoi atë kult të Dionisit prej Kadmos nga Tiri dhe prej atyre që erdhën bashkë me të nga Fojnikia në tokën që sot quhet Beoti”. E përmendim Dionisip sepse kult i tij, përkatësisht mesazhi gjallërimi i zotit Oziris, deri më sot jeton gati tek gjithë popujt në Ballkan, nëpërmjet ceremonive dhe dokeve që kryhen në periudhën e dimrit, të njohur si doke vasilike, përkatësisht doke maska-“kukere”, “suratë”, “babere” (lloje maskash), të ndjekura me çmenduri të mëdha, dehje dhe teatër vdekjeje dhe ngjalljeje, gjithçka me qëllim që të sigurohet mbrojtje, riprodhim dhe prosperitet i bashkësisë.

Sipas disa autorëve edhe emri i shtetit, kuptimi gjeografik Maqedoni vjen nga Egjipti. Pikërisht, sipas Diodorit nga Sicilia (historikan nga sh.I p.e.r.) Makedoni ka qënë djali i Ozirisit, i cili ka lindur në këtë vend, kur Ozirisi ka ardhur në këto vise, dhe i ka pushtuar (**Срејовић, Д.,**

---

zbuluar në rajone të cilat janë mjaft të larguara nga ato rajone, sidomos në Epir, Maqedoni, Dardani, Dallmaci etj. (Shiko: Milutin Garashanin, Nastanok i poteklo Ilira, Iliri i Albanci, Beograd, 1988, 27-51).

**Цермановић, А.** 1979: 243). Ai e ka lënë djalin e tij të qeverisë në këtë tokë, e cila është quajtur Maqedoni, ndërsa banorët Maqedonas. Që të fitohet një pikturë për këto rrëfime të Diodorit, duhet të merren parasysh edhe këta tregues: Diodori zotin Amon, zotin e Diellit e ka quajtur Oziris (**Фрејзер, Џ.Џ.** 1992:495), ndërsa në mitologjinë egjiptiane faraonët, sidomos ato nga Mbretëria e Re e Tebës, d.m.th. nga dinastia XIX kanë qenë trashëgimtarë direkt të Amonit, d.m.th. zotra të Diellit në tokë. Nga kjo mund të supozojmë se pushtimet e faraonit Sesostris, reflektohen dhe ndikojnë edhe në legendën dhe rrëfimin e Diodorit për prejardhjen e emrit Maqedoni. Duhet të përmendet edhe fakti se sipas mitologjisë greke Makedoni ka qenë djali i Zeusit.

Tukiditi, një historian i njohur Helen (460-395 p.e.r) i cili më së shumti shkruan për luftërat ndërmjet Spartës dhe Atenës (luftërat Peloponeze), nuk i përmendën Kadmon dhe Danajin dhe kolonizim e tyre, dhe mban pozicion së Danajet dhe Kadmejet janë emra e vjetra për Beotin. Tukiditi, si “një intelektual i cili mundohej ti prezantonte Helenët si një popull të vetëm” ka pasur prirje për ti nënvlerësuar të arriturat e mikenase dhe të theksoj jo stabilitetin dhe kaosin që zotëronin në “kohët të errëta”. Kjo shpjegon pse Tukiditi si “historian kritik i cili i braktiste legjendat”, shkruan për legjendën e Helenit si një person i pastër kombëtar, por jo dhe për njerëzit të huaj të civilizuar si Danaji, Kadmo ose Egjiptiani Kekrop. Ky lloj “nacionalizmi” si duket ka qenë tipik pas luftërave me Persinë në fillim të shekullit të V p.e.r. dhe në kohën e ekspansionizmit të fuqisë greke. Prej atëherë në shumë shkrime klasike mund të vërehen grada të ndryshme urrejtje dhe përçmimi ndaj “barbarëve”. Prandaj mund të kuptohet pse, për shembull, çdo lloj lidhje të Kekropsit me Egjiptin duhet të nderohet me autoktoni, dhe pse Tukiditi i braktisë legjendat për kolonizim të Egjiptianeve dhe Fenikasit, ose pse Greket duhet të sajojnë legjenda “të reja” për kolonizim dhe civilizim i të huajve. (**Bernal M.,** 2009: 95-97).

Në shekullin e IV p.e.r. oratori atenjan Isokrati, zëdhënësi i panhelinizmit dhe i krenarisë kulturore greke, edhe pse nuk i pëlqen kolonizimi i huaj, nuk dyshon në të vërtetën historike se kolonizimi ka ndodhur. (**Bernal M.,** 2009: 97)

Në shek. VII p.e.r. siç është e njohur në Ballkan zhvillohet shteti Maqedonas antik, i cili zenitin e tij do ta arrijë gjatë kohës së sundimit (qeverisjes) së Aleksandërit III, i cili për shkak të arritjeve të mrekullueshme në planin shoqëror, kulturor dhe luftarak do të quhet “i Madhi”. Kundërshtari më i madh i tij në qëllimin për “pushtim të botës” ka qenë mbreti persian Darije II. Pas disfatës në betejën e Is, Darije largohet në perandorin e tij dhe më vonë përsëri riorganizohet dhe mbledh një ushtri të

re për luftë kundër Aleksandërit. Megjithatë Aleksandri në vend që ta ndjekë Darijen dhe ta pengojë në qëllimin për riorganizim dhe që të mbledhë ushtri të re, ai vendos që me ushtrinë e tij të kthehet nga jugperëndimi, ta pushtojë qytetin Tîr dhe mandej të hyjë në Egjipt. Egjiptianët atë e presin si çlirimtar. Ai në deltën perëndimore të Nilit dhe në bregun e Detit Mesdhetar, do të ndërtojë qendrën e re të shtetit të tij dhe qendrën kulturore-shkencore në botë, në atë kohë, qytetin Aleksandria (Iskenderum). Aleksandri, shkon edhe në shenjtoren e zotit Amon në Oazën Siwa, ku do të jetë i proklamuar për trashëgimtar të faraonëve dhe pasardhës i zotit Amon. Pas vdekjes së Aleksandërit, gjysëm-vëllai i tij Ptolomei, do ta trashëgojë atë në fronin e Egjiptit, me çka rimëkëmbet edhe Egjipti faraonas me dinasti të re, Ptolomeidat.

A është krejt kjo rastësisht? A e ka bërë Aleksandri këtë vetëm për prestigj? Pse Egjiptianët e kanë pritur Aleksandrin si Çlirimtar e jo si Pushtues të ri? Vallë edhe priftërit e rreptë në profetësinë e Amonit i janë zbutur Aleksandrit, ndaj edhe e kanë lejuar të bëhet trashëgimtar dhe rimëkëmbës i Egjiptit faraonas, dhe pasardhës i zotit Amon?! A ekziston në këto të vërteta dhe fakte edhe diçka tjetër? A është Aleksandri me të vërtetë pasardhës direkt i zotit Amon, sipas legjendës për Maqedoninë dhe tokën e tij? A ekziston lidhje midis kësaj legjende dhe veprimeve të Aleksandrit, veprimet e popullit në Egjipt në atë kohë dhe veprimet e priftërve nga profetësia e Amonit?! Vallë rastësisht Aleksandri pas vdekjes do të jetë i varrosur në Aleksandri, Egjipt?

Në shkrimet për jetën dhe punën e Aleksandrit, “Aleksandritët” sipas disa shkencëtarëve janë të shkruara nga bashkëkohësit dhe ndjekësit e Aleksandrit, ndërsa sipas disa shkencëtarëve të tjerë ato janë të shkruara në mes-shekullin, bëhet lidhje më e ndryshme midis Aleksandrit dhe Egjiptit. Pikërisht, flitet për njeri të dëgjuar **Nehtenav**, i cili ka qenë mbret i Egjiptit, por edhe magjepsës, ndërsa e ka lënë Egjiptin për shkak të ardhjes së ushtrisë persiane të Darijut. Ai ka ikur nga Egjipti në Maqedoni, ku ka punuar si mjek i madh dhe magjepsës. Në atë kohë, në Maqedoni ka sunduar Filipi, ndërsa gruaja e tij Olimpia nuk ka mundur të mbetet shtatzënë. Filipi i ka dhënë fjalën Olimpisë para se të shkojë në luftë, se atë natë do të kenë marrëdhënie dhe kur do të kthehet nëse ajo nuk do të jetë shtatzënë, do të shkurorëzohen. Olimpia, duke mos ditur se ç’të bëjë, ka dëgjuar këshillën e një robëreshe të saj “...Ka në qytetin TONË një njeri Egjiptian, burrë i shkathët në fjalë dhe veprime, dhe krejt mendimet e zemrës tënde to t’i realizojë dhe mbreti Filip verërat dhe vitet do t’i gëzojë...” Olimpia ka thirrur Nehtenavin dhe ka kërkuar ndihmë nga ai, ndërsa ai i është përgjigjur: “Shoh zotra që me ty duan të jenë, Amon dhe

Fines dhe Jeruklie i Madhi, ndaj nëse u bën këtyre hyrje në veten tënde, atëherë do të jesh nënë e një mbreti të madh...”

Mandej nga Aleksandridet shkruhet: “...Pas kësaj e mashtroi gruan me një të ngjashme, sepse gënjeshtër i ngjan gruas, dhe vetë hyri në të me fytyrën e zotit Amon, ashtu si ishte fytyra e zotit Amon: kokë shqiponje dhe në të tufa borziloku dhe sy si të gjarprit dhe këmbë luani, supe të flatruara, të argjendta dhe të zeza, kështu ishte pamja e Amonit. Hyri në të vetë me ëndrrën e tij dhe ishte me të dhe doli përsëri me ëndrrën e tij...”<sup>35</sup>

Në tekstin e mëtejshëm thuhet se Aleksandri, kur është rritur disa aftësi i ka mësuar edhe nga Nehtenavi, por më vonë e ka vrarë. Nehtenavi para vdekjes i ka treguar Aleksandrit se ai është babai i tij dhe se për këtë e di vetëm ai dhe e ëma e tij Olimpia.<sup>36</sup> Nëna e tij më vonë do t’ia vërtetojë këtë, ndërsa Filip i për këtë asnjëherë nuk e mori vesh.

Nga shënimet e njëjta, thuhet se Aleksandri, kur ka ardhur para Egjiptit me ushtrinë e tij, i ka sulmuar Egjiptianët me shumë shigjeta dhe ushtri, ndërsa Egjiptianët kanë kërkuar që t’i falë me fjalët: “Mbret Aleksandër,

<sup>35</sup> Për lidhjen e Olimpisë me zotin Amon shkruan edhe Plutarh në biografinë e tij për Aleksandrin të Maqedonise (Plutarh, 1994:7): “Pas kësaj ëndrrë të çuditshme Filip i ka dërguar Heronin nga Megalopolisi në Delfi. Rrëfëhet prej zotit Apolon i është sjellë profetizëm me urdhër t’i dërgojë viktimë zotit Amon dhe më tepër ta respektojë atë zot. Mandej thuhet se ka humbur syrin me të cilin ka shikuar nëpër të plasurën e derës dhe e ka parë zotin me fytyrë gjarpi si qëndron i shtrirë pranë gruas së tij. Ndërsa Olimpia, siç rrëfen Eratosteni, duke e dërguar Aleksandrin në ushtri, vetëm atij ia ka zbuluar sekretin për prejardhjen e tij dhe i ka bërë vërejtje që të jetë trim ashtu edhe siç i ngjan prejardhjes. Në të vërtetë, të tjerë, thonë se ajo e ka mohuar atë dhe ka thënë: “Vallë Aleksandri nuk do të ndalojë të më shpif para Herës?”

<sup>36</sup> Për këtë është vërtetuar edhe në literaturën e huaj, shembull: Michael Rice, Who’s who in Ancient Egypt, Routledge, London, 1999, 143: Olympias, Queen, Macedonian Dynasty, c.370-316 BC. The princess of Epirus, daughter of King Neoptolemos I, Olympias was married to Philip II, the King of Macedonia... Her relation with her son (Alexander) was profoundly possessive. She encouraged the rumour that Alexander had been conceived as the result of her impregnation by the Egyptian god Amun, in the form of snake. There was also a story, derived from “The Romance of Alexander”, that his true father was Nectanebo II, the last native Egyptian king...; 128: Nectanebo II (Naktharheb), King Thirtieth Dynasty, Late Period, 360-343. After deposing King Teos, Nectanebo II, the great grandson of Nectanebo I, ruled for eighteen years, during a time when the Persian Empire was begging to disintegrate... According to some ancient sources it was believed that he was the true father of Alexander the Great, having visited Olympias, Alexander’s mother, during one of Philip II’s frequent absences; both Olympias and Alexander preferred to claim Amun as Alexander’s father. However, the precedent of Amun having adopted the person, the king, as witnessed by his assumption of the physical form of King Thutmose II to engender Amenhotep III, should not be forgotten.



djali i mbretit tonë Nehtenav i djeshëm, sepse nga ne iku dhe përsëri tek ne i ri paske ardhur...” nga këto fjalë Aleksandri ka ndaluar sulmin dhe ka pyetur se : “si i vjetër nga ju u largova, dhe si tek ju i ri erdha..” për çka ata janë përgjigjur se Nehtenavi ashtu ju ka porositur.

Ajo që është e rëndësishme dhe interesante është se edhe në këtë rast mund të krijojmë disa lidhje midis Egjiptit dhe Ballkanit, d.m.th. kësaj radhe kemi relacion të kundërt Ballkan-Egjipt, shkuarja e Aleksandrit në Egjipt, pranimi i tij në Egjipt si “njeri yni”, “Çlirimtar”, e jo “Pushtues”, “Pasardhës i Faraonëve”<sup>37</sup>, duke përdorur njohuri të dhëna të asaj kohe për lidhjet (ndoshta të gjakut dhe ato farefisnore) midis popullit të Ballkanit dhe Egjiptianëve të Vjetër. Këto njohuri ndoshta janë rezultat edhe të lidhjeve mitologjike, por edhe të ardhjes, vendosjes ose kolonizimit në Ballkan nga ana e Egjiptianëve të Vjetër, që prej kohës së Ramzes II. Në Ballkan, në kohën pas vdekjes së Aleksandrit, të datuara janë shumë të dhëna arkeologjike, të cilat flasin për përhapjen dhe prezencën e disa kulteve Egjiptiane, nga periudha e ashtuquajtur heleniste. Gjurmë hramesh, kushtuar zotreshës Izida dhe zotit Serapis janë zbuluar në disa vende të Ballkanit, si edhe statuja të zotrave të njëjtë, por edhe të Anibusit, Hermesit, Totit etj<sup>38</sup>. Në ornamente të stolive nëpër Ballkan nga kjo periudhë gjithashtu njihet figura e Skarabejit, insekt i cili zë një vend të rëndësishëm në simbolikën e Egjiptit të Vjetër. Skarabeji simbolizon kultin e Diellit, dhe është atribut i përhershëm në shfaqet primare të zotrave, khepri, babai i zotrave Egjiptianë. Në literaturën profesionale arkeologjike, këto zbulime klasifikohen si import nga Egjipti në Ballkan, që në masë të madhe (skarabeji, statujat) nga pikëpamja materiale, tregojnë se midis Ballkanit dhe Egjiptit në atë periudhë post-aleksandrike ekzistojnë edhe lidhje të përcaktuara ekonomike dhe kulturore. Por në rastet, kur kemi tempuj të respektimit të zotrave Egjiptianë, ajo në asnjë rast nuk mund të jetë import, sepse këtu bëhet fjalë për besim, kulturë shpirtërore dhe sakritet, që mund të vlejë edhe për shpirtësinë e Skarabejit. Ndërtimi i tempujve, respektimi i tyre si shtëpi të zotrave, ritualet, kushtuar këtyre zotrave dhe mirëmbajtja e këtyre tempujve para së gjithash dhe mbi të gjitha kërkon njerëz që e njohin këtë kult, historinë e zotrave, ideologjinë, filozofinë dhe domethënien e

<sup>37</sup> Sipas mbishkrimeve që janë zbuluar në Aleksandri, Aleksandri ka pasur këto tituj: “Horus” (që ka treguar suverenitetin e tij jashtë Egjiptit- i shpërndarë nëpër gjithë botën), mandej “princi i fuqishëm” me shtesë “ai që vendos dorë në tokërat e të huajve” , mandej “mbrojtës i Egjiptit” , “i dashuri i Amonit dhe i zgjedhuri nga Ra” dhe në fund “Djali Ra” (Ulrih Vilken, Aleksandar Makedonski, Mislja, Skopje, 1988, 146-163).

<sup>38</sup> Shiko: *Битракова-Грозданова, В.* 1978; *Анђелковић, Б.* 1991; *Selem, P.* 1969; *Selem, P.* 1997; *Tomorad, M.* 2003.

zotrisë. Me fjalë të tjera kjo do të thotë se nëse bëhet fjalë vetëm për zotra Egjiptianë, ata i kanë sjellë dhe i kanë mirëmbajtur në Ballkan, midis tjerash edhe nëpërmjet ndërtime hramesh Egjiptianë. Për këtë dukuri dr.Petar Selem do të shkruaj: "...Greqia që në epokën paraklasore, veçanërisht në të ashtuquajturën fazë jonike të arkaikësisë (sh.VII-VI para krishtit), ka pranuar ndikim të fuqishëm -kultura Egjiptiane, që posaçërisht është e dukshme në ikonografinë e Kursos dhe Kor. Sipas karakterit të popullatës Egjiptiane, çdo rrezatim i saj kulturor pranon forma kulturi ose fetarë. Mitet dhe legjendat që i lidhin zotrat dhe heronjtë grekë me Egjiptin, flasin për të qartë, por kur është fjala për ndikimin direkt të kulteve Egjiptiane në tokë greke, ajo mund të vërtetohet në shek.IV, kur në Pirejë zbulojmë një shenjtore private Izidine..." (Selem, P. 1997: 34).

Në periudhën heleniste, përmendja e kolonizimit egjipto-fenikase të burimet historike janë të shumta, që nuk mund ti tregojmë të gjitha në këtë libër. Debatet nuk kanë qenë a ka pasur ose jo kolonizime të tilla, por për specifikat e tyre: përkatësia fisi ose etnia e udhëheqësit, vendet nga janë nisur dhe në cilën periudhë. Për shembull Pausanias debaton për Kadmon a ka qenë Egjiptian ose Fenikas. (Bernal M., 2009:103, 476)

## PERIUDHA ROMAKE

Kultet egjiptiane dhe përmendoret e tyre në Ballkan, kanë qenë sidomos prezentë gjatë kohës së Perandorisë romake<sup>39</sup>. Kuptohet se

---

<sup>39</sup> Religjioni romak krejtësisht i pandryshueshëm u ofron ngushëllim ose guxim të zhvillojë një kuptim midis njerëzve ose dashuri. Kur ndonjë fetar ka vizituar hram romak, duke kërkuar ndihmë mbinatyrore, atë e ka bërë ashtu që ka lutur zotin për ndonjë përparësi në këtë tokë e jo lehtësim për shpirtin. Për mëshirën e zbrazëtirës së tillë shpirtërore, besimet orientale religjioze kanë krijuar kushte që vetë vetes t'i hapin rrugën. Gjatë kohës së Sulës, për nder të kultit të tij në Romë është formuar vëllazëri ose "kolegium", por më vonë, në vitin 53 p.e.r. tempulli i Izides me urdhër të Senatit është shkatërruar. Serapisi, zot i ri gjithashtu nga Egjipti, me mirëseardhje është pritur në Romë edhe pse Augusti nuk ka dashtur asnjë lloj zotrash egjiptian. Ovidie ju ka rekomanduar të rinjve të shëtisin në afërsi të tempullit të Izidës, sepse është populluar midis botës femërore të re. Tiberie e ka rënuar shenjtoren të Izidës dhe Serapisit në fushat të Marsit, por Kaligulla përsëri e ka rindërtuar, që shpejt pas asaj ta gëlltisë zjarri në vitin 80 p.e.r. Domiciani ka urdhëruar që ky hram të rindërtotet në një stil madhështor, sepse në një rast ju ka ikur armiqëve veshur si prift i perandorisë të Izidës. (Stari Svet (The Ancient World), Narodna Knjiga Vuk Karagjiq, Beograd,1983,faq.247).

prezenca e numrit tepër të madh të përmendoreve dhe kulteve egjiptiane të datuara gjatë kohës së perandorisë romake në Ballkan, nuk do të thotë se duhet të implikojë edhe prezencë të domosdoshme të popullsisë egjiptiane (Тачева-Хитова, М. 1982: 103), sepse bartësit e atyre përmendoreve dhe kulteve mund të kenë qenë edhe legjionarë romak, funksionarë udhëheqës romak, shërbyes doganorë etj., si fuqia lëvizëse për prezencë kultesh egjiptiane në Ballkan, si edhe qytetarët nga municipet dhe qytetet provinciale, të cilët më vonë i kanë pranuar dhe i kanë respektuar këto përmendore dhe kulte egjiptiane, por të cilët edhe që kanë pranuar forma respektimi Heliniste-romake (Selem, P. 1969: 141-167). Megjithatë, Petar Selem na tregon se gjatë kohës së Perandorisë romake, në Ballkan ka edhe egjiptianë të asimiluar në popullsinë qytetare të municipeve dhe kolonive provinciale, qoftë si robër ose si qytetarë me të drejta të barabarta. Sipas Maragrita Тацева- Hitova në epokën e hershme të shpërndarjes së kultit prifterinjët kane qene me prejardhje Egjiptiane (Тачева-Хитова, М. 1982: 105). Ka pasur edhe Egjiptianë që nuk janë asimiluar, të cilët nuk i pranojnë format heliniste-romake të zotrave të tyre, të cilët këmbëngulin që edhe ti mbajnë përmendoret në gjuhën e tyre burimore egjiptiane, të cilat në fakt kanë qenë në një situatë të ndarë shoqërore (Selem, P. 1969: 141-167). Kjo sidomos vlen për, Egjiptianët nga Salona dhe ishujt në afërsi, të cilët i kanë përkatur shtresave më të ulëta, që me siguri kanë qenë tregtarë dhe mjeshtër<sup>40</sup>. Kjo popullsi ka ditur të qëndrojë e izoluar, e mbyllur në rrethin e saj etnik dhe profesional, duke i respektuar format (burimore) të zotrave nga atdheu i tyre (Selem, P. 1969: 174).

Perandoria e madhe Romake, karakteri i saj shtetëror, religjioz, dhe konglomerator, kuptohet se ka pasur ndikimin e vet mbi popullsinë që ka qenë e nënshtruar. Në kohën e sundimit të Perandorisë Romake (dhe Perandorisë së më vonshme Bizantine), hekuri dhe çeliku në sasi të mëdha

---

Megjithatë, ekzistojnë edhe të dhëna që lidhen me udhëtimet e Aleksandrit të Maqedonisë në Gadishullin Apenin, se tempala të Izidinas në Romë dhe Gadishullin Apenin kanë ekzistuar edhe para pushtimeve të mëdha romake në lindje, përkatësisht në Egjipt d.m.th kanë ekzistuar në shek. IV p.e.r (Dr. Moikom Zeqo, Aleksandri, ose profeti i rremë, Koha jonë, Tiranë, 26/07/2003). Gjithashtu, në disa përmendore egjiptiane nga koha e faraonëve Menerptah dhe Ramzes III, Etrurët përmenden si popull me të cilin Egjiptianët kanë pasur lidhje të përhershme tregtare, të cilët i kanë njoftuar për formën dhe origjinën magjike të skarabejit. (Branko Gavella, Etrurci-istorija, kultura, umetnost, Beograd, 1978)

<sup>40</sup> Salona-Solin, afër Splitit, Dalmaci-mes më i rëndësishëm për Ilirikun Romak, Oktavijan August e intenzivon kolonizimin e qytetit, me çka bëhet kryeqytet i provincës Ilirike, përkatësisht Dalmaci.

janë përdorur dhe eksploruar në viset Ballkanike<sup>41</sup>, sidomos viset e pasura me xehe (Thraki, Maqedoni, Bosnjë etj.). Komunikacionet kanë qenë posaçërisht të rëndësishme në Perandorinë Romake, që i kanë lidhur qytetet dhe provincat. Gjatë kohës së Perandorisë Romake janë ndërtuar më tepër sisteme komunikacioni për qëllime ekonomike, por edhe për pushim dhe ushqim të udhëtarëve dhe kuajve, ka pasur edhe farkëtarë, në të cilat janë ndrequr patkonjtë e kuajve ose pjesë të tjera të mjeteve transportuese. Pikërisht, në rajonet ku kanë kaluar komunikacionet e tilla (si p.sh. Via Egnatia, Akfilej-Emona-Petoviona-Mursa-Ciballa-Sirmijum-Singidunum-Viminacium-Naisus-Thesalonika, Naisus - Serdika-Konstandinopoli etj), sot mund të hasim një numër të madh nga Ballkano - Egjiptianët, dhe në pjesën më të madhe deri para një kohe janë marrë me zanatin e farkëtarisë.

## PERIUDHA BIZANTINE

Paraqitja e krishterimit dhe zhvillimi i tij do të ketë pasoja të veta afatgjata si në Perandorinë Romake, por edhe në Perandorinë më të vonshme Bizantine. Edhe pse krishterët në fillim kanë qenë të ndjekur dhe të vrarë, ata më këmbëngulje kanë tërhequr besimtarë të rinj. Me porosinë e tyre për shpresë dhe ngushëllim, me urrejtjen e tyre ndaj punëve të kësaj toke dhe besimi në ringjalljen, krishterimi posaçërisht i tërhiqte pjesëtarët e shtresave më të ulëta dhe të varfra, por ngadalë me dëshirë për shndërrim paraqiteshin edhe qytetarë të pasur, të cilët kanë ndjerë nevojë për religjion më të përbërë nga religjioni pagan. Për shkak se të krishterët me urrejtje i kanë refuzuar doket e lashta edhe pse si idhull e kanë refuzuar kultin ndaj Izidës, Ozirisit dhe zotrave të tjerë lindorë, e me të edhe kanë mohuar të besojnë në zotrinë e perandorëve romakë, kështu që ata tërhoqën kundër vetes një urrejtje të përgjithshme<sup>42</sup>. Meqë krishterimi në Egjipt është rrënjësor që prej kohës së apostujve, ndërsa ungjillori Marko është themeluesi i patriarkisë Aleksandrike, të krishterët në Egjipt shumë herët i kanë përjetuar përndjekjet e vështira që gjatë kohës së imperatorëve romak Decija (249-251) dhe Dioklecijan (284-305) (Kolarić, J. 1982: 132).

Këto persekutime, mund të lidhen edhe me hulumtimet e historianit anglez Hjug Pulton në arkivin e Vatikanit, sipas të cilëve në periudhën prej

---

<sup>41</sup> Mašine, *ilustrovana enciklopedija*, Beograd, 1984, 28

<sup>42</sup> *Stari Svet* 1983: 25.

vitit 306-307 Egjiptianët kanë ardhur në Maqedoni me 150 000 ushtarë dhe 150 000 kalorës (**Poulton, H.** 1995; **Courthiade, M.** 2003-2004: 3)..

Shkrime të tilla të ngjashme mund të gjenden edhe në studimin “Burime greke për historinë Bullgare” (ГИБИ т. I, 1954) në dy kthime: a) gjatë kohës së luftërave për fronin midis Licinij dhe Konstantin në vitin 324, në të cilin thuhet se : “Egjiptianët me shpejtësi të madhe kanë dërguar 80 anije-triere me ushtarë dhe marinarë Egjiptianë”, si edhe b) gjatë kohës së Teodisij (379-395) ku thuhet se “kur Egjiptianët kanë arritur në Maqedoni kanë qenë të numëruar dhe të përzier në fushat e mëdha, ndërsa midis ushtarëve nuk ka pasur ndarje, dallim midis Romëve dhe Varvarëve<sup>43</sup>, por të gjithë kanë qenë të përzier. Ushtarëve Varvarë i lejonin të ktheheshin në atdheun e tyre ose të shpërnguleshin, ose zëvendësoheshin nga të tjerë...”

Organizimi shtetëror Romak, kultura greke dhe religjioni krishterë janë burimet kryesore të zhvillimit bizantin, ku pa këto tre elemente Bizanti nuk mund të paramendohet. Me bashkimin e kulturës heleniste dhe religionit të krishterë me formën shtetërore romake është krijuar ajo dukuri historike, të cilën e quajmë mbretëria Bizantine. Deri në atë bashkim ka ardhur në mes të lëvizjes të qendrës së perandorisë Romake në Lindje, të shkaktuara me krizën e madhe në shekullin III. Edhe më qartë ajo shihet në krishterizimin e Perandorisë Romake dhe themelimin e tronit të ri në Bosfort. Këto dy ndodhi, fitorja e krishterimit dhe më në fund zhvendosja e qendrës shtetërore të Lindjes së helenizuar, dukshëm shënon fillimin e Perandorisë Bizantine (**Острогорски, Г.** 1959: 48).

Meqë Kisha kishte fituar ndikimin e saj më të madh në Bizant, mbledhjet e mëdha kishtare, në të cilat diskutohej për tema dhe konflikte religjioze, në një farë mënyre ishin edhe konflikte politike, me pasojë afatgjata politike (**Острогорски, Г.** 1959: 77). Për shkak se në luftimin me erezin<sup>44</sup> Arian, është dogma e themeluar për përkryershmërinë e natyrës zotrore të Djalit, me natyrën e njëjtë me Babanë. Këtu shtrohet pyetja e marrëdhënies së natyrës zotrore dhe njerëzore e Krishtit. Sipas shkollës teologjike Antihohike, për Krishtin kanë ekzistuar dy natyra të ndara njëra pranë tjetrës: Zotria është gërshtetuar me Krishtin, njeri i lindur nga Maria, ashtu që sipas asaj Maria nuk është dashur të quhet Shën Mëri, por vetëm “lindësja e Krishtit”. Krejtësisht e kundërt nga ky kuptim racional ishte mësimi mistik aleksandrik për zot-njerinë, në të cilin natyra zotrore është bashkuar me natyrën e njeriut. Në vitin 428 në karrigen peshkope të Konstantinopilit ka ardhur Nestorie, përfaqësues i kujdesshëm i shkollës

<sup>43</sup> Në atë kohë për Varvarë janë llogaritur ata që nuk e dinë gjuhën latine ose greke, ndërsa në këtë shkrim historik me siguri mendohet në Egjiptianët.

<sup>44</sup> mësim fetar, kundër tezave themelore të fesë

antihohike dhe si peshkop i Konstantinopolit ka filluar ta përhapë shkencën antihohike. Megjithatë, në personalitetin e patriarkut aleksandrik Ciril, Nestorije ka hasur një kundërshtar të fuqishëm, i cili e ka tejkaluar atë edhe si teolog edhe si politikan. Me Cirilin ka qenë edhe monahija e fuqishme egjiptiane, ndërsa edhe Roma ka qëndruar në anën e tij. Edhe ndaj përkrahjes që ka pasur nga qeveria e Konstantinopolit, Nestorije në vitin 431 në Keshëllin e tretë Ekumene në Efes është dënuar si heretik. Cirili korr fitoren e madhe, si në pamje teologjike ashtu edhe në pamje kishtare-politike. E përmbysi kryeqytetin e patriarkut, e me të dha edhe goditje të fuqishme edhe në vetë qeverinë mbretërore. Patriarkia e Aleksandrit, autoriteti i të cilit prej kohës së Atanasijit i Madhi vazhdimisht është rritur, ka arritur të ri-qeverisë në kishën lindore.

Gjatë kohës së Dioskorit, trashëgimtar i Cirilit (i cili ka vdekur në vitin 444), Aleksandria në fillim e ka ruajtur gjendjen e saj të fuqishme. Qeveria mbretërore është pajtuar me disfatën e saj dhe më nuk i është kundërshtuar ndikimit aleksandrik. Arkimandriti Eutinije, përfaqësues i palës aleksandrike në Konstantinopol, ka qenë i gjithëfuqishëm në oborrin mbretëror. Megjithatë, kundër riqeverisë së Aleksandrisë janë bashkuar karriget peshkope të Konstantinopolit dhe Romes.

Pas pyetjeve dogmatike Eutinije, duke u nisur nga shkenca e Cirilit, shkoi një hap më tej, duke siguruar se të dy natyrat e Krishtit pas mbarsjes së tij u shndërruan në një natyrë zotrore. Kështu, në luftën kundër erezit nestorian, si kundërshtim i saj u paraqit monofizitizmi, shkenca për një natyrë në Krisht. Sinodi i patriarkisë në Konstantinopol e gjykoi Eutihijun si heretik, ndërsa papa Leon I, vendosmerisht u deklarua kundër monofizitizmit. Kështu Roma dhe Konstantinopoli u gjendën në një linjë në luftën kundër fuqisë së madhe të Aleksandrisë. Pala e Aleksandrisë edhe një herë triumfoi në të ashtuquajturën Këshillin Grabitëse në Efes (viti 449), ku nën kryesimin e Dioskorit, pas fitores së dhunshme mbi opozitën, monofizitizmi ishte deklaruar si fe e vërtetë. Megjithatë, menjëherë pas saj vjen një ndryshim i menjëhershëm, si pasojë e vdekjes të Teodisies II në vitin 450, dhe qeverinë mbretërore e mori Markian (450-457), i cili u martua me Pulherinë, motër energjike e paraardhësit të saj, e cila ka pasur rol të rëndësishëm në përgatitjen e Këshillin Halkedonite në vitin 451. Ky Këshill Ekumene i kishës krishtere, i katërti me radhë e pranoi dogmën për dy natyrat e Krishtit “të pandara por edhe të pabashkuara”, duke i gjykuar gjatë kësaj monofizitizmin dhe nestorianinë. Asgjë më e vogël nga dogma ishte edhe fitorja kishtare-politike e Konstantinopolit, me çka peshkopët e Romës dhe Konstantinopolit u bënë të barabartë, dhe u lajmërua edhe rivaliteti i këtyre dy meseve kishtare, që me kohë do të shndërrohej në luftë të hidhur

(Кернс, Ъ. 1998; Христијанската...1999; Толев, В. 2000; Golubović, M. 1970; Kolarić, J. 1982; Eljaded, M. 1991).

Krishterët e Egjiptit në atë dënim të hidhur të grekëve kanë parë luftë kundër Aleksandrisë dhe janë përpjekur që patriarku i Konstantinopolit qeverinë e tij të urreyer politike ta drejtojë ndaj një Kishe nga më autoritaret dhe më të vjetrat. Egjiptianët minofizitë kanë perceptuar se Grekët ose Bizantët nuk kanë ardhur deri në dogmën dhe pastërtinë e fesë, por vetëm deri në politikën (Kolarić, J. 1982: 132).

Me vendimin nga Këshilli i Halkedonit monofizistët janë përndjekur nëpër Perandorinë Bizantine, e në disa raste edhe janë vrarë. Megjithatë, mbesin të hapura shumë pyetje: Sa kanë pasur këto përpjekje dhe konflikte kishtare-politike ndikim mbi popullin me prejardhje egjiptiane në Ballkan, i cili ndërkohë me siguri është krishterizuar? A ka pasur midis kësaj popullsie të krishterizuar në Ballkan admirues të mësimit monofizistik dhe përfaqësim të madh? Duke e marrë parasysh atë që, ashtu siç thamë, kultura Greke dhe krishterimi paraqesin një ndër shtyllat kryesore të Bizantit, nëse Konstantinopoli nuk ka mundur që deri në fund të merret me monofizitët në Egjipt, a e ka bërë atë në Ballkan, me metoda të ndryshme dhe detyrime, e për krejt atë të mos lërë asnjë lloj burimi historik ose gjurmë të tjera (Пешћ, Р. 1996: 43). Nëse dihet se gjatë kohës së qeverisë Arabe në Egjipt (640-1517) dhe zhvillimit të fesë islame, monofizitët në Egjipt e marrin emrin Kopt, që në gjuhën arabe (Kibt) nuk do të thotë asgjë tjetër përveçse Egjiptian (Kolarić, J. 1982: 131), ndërsa etnonim i njëjtë (Kopt, Kibtian) përdoret edhe në Ballkan nga qeveria e mëvonshme islame Osmane (emri Kibtijan përdoret edhe në një Kanun nga viti 1530-Kanunnam-i Kibtijan-i Vilajet-i Rumeli), pyetjet e shtruara më lart, fitojnë aktualitet edhe më të madh dhe kërkojnë hulumtim më të detajuar historiko-politik. Kjo edhe më tepër që në kohën e lëvizjes shoqërore të besimtarëve në Maqedoni nën Patriarkinë greke dhe përpjekja për “kishë bullgare” të tyren, në korrik 1867 në gazetën “Makedonia”, që është publikuar në Istambul, është publikuar një letër e nënshkruar nga “Një Egjiptian” nga Prilepi, në të cilën akuzon fanariotët Grekë dhe njerëzit kishtarë për politikën e bërë të vetëdijshme të pashkollimit kishtar dhe marginalizimit të “Egjiptëve-Egjiptianëve” (Марушиакова, Е., Попов, В. 1995: 42-46, 48).

Pas Këshillit kishtare në Halkedon shumë pak të dhëna mund të gjejmë e të cilat mund të ndikojnë në popullsinë ballkanike me prejardhje egjiptiane, siç janë p.sh. regjistri i të vendosurve në vendet e Perandorisë nga shek.V, i përbërë nga Stefani nga Bizanti ku përmenden Egjipti dhe Egjipti i Vogël si rajone të Perandorisë (Пуксон, Г. 1974: 88).

Megjithatë në letrat e arkipeshkopit të arkipeshkopisë së Ohrit nga fundi i shek.XI dhe fillimi i shek. XII Teofilakti i Ohrit, i cili ka qenë i dërguar nga imperatori Aleks I Komnen (1081-1118), duhet ta plotësojë detyrën si arkipeshkop ku mund të zbulohen të dhëna të përcaktuara për Ballkano - Egjiptianët. Me fjalë të tjera, ai në letrat kushtuar Nikola Anemës, thotë se “hegemonët” përbënin qytet ndërtuesi (kastroktist), kapiteni dhe “ndihmësi i tretë, i cili në emër ishte i ngjashëm me faraonin” (ГИБИ, Произведения за Теофилакт Охридски 1994: 113). Sipas historianëve “faraoni” ka udhëhequr si strateg me temën e Pellaginisë dhe Ohrit (Панов, Б. 1971: 239) dhe me siguri këto organe shtetërore të qeverisë kanë qenë të udhëhequra nga “njerëz që kanë qenë me prejardhje jogreke” (Панов, Б. 1985: 348). “Faraoni” Teofilaktit i ka shkaktuar më tepër mundime, që mund të shihet nga një letër në të cilën Teofilakt thotë se pas ndërrimit të “faraonit” punët e tij kanë nisur të përparojnë (Панов, Б. 1985: 349). Gjithashtu Teofilakti në një letër për Taronitul, duka i Shkupit, përmend një “Egjiptian”<sup>45</sup> nga i cili ka qenë i mashtruar. Ndërsa në një letër tjetër, kushtuar peshkopit të Kerkirës, Teofilakti do të thotë: “...Për atë do të duhet të shkoj te mbreti, domethënë të kalojë përsëri afër Haridbës (udhëtim nëpër det) ose të udhëtojë nëpërmjet Egjiptit- rrugën e mundimshme dhe të vështirë...” (ГИБИ, Произведения...1994: 169). Meqë Teofilakti ka qenë në Ohër dhe i është dashur të udhëtojë te mbreti në Konstantinopol, me siguri mendon për rrugën tokësore nëpër Manastir dhe Selanikut. Edhe redaktori i botimit të letrave Ivan Bozhilov mendon se bëhet fjalë për “udhëtim nëpër vendet bullgare” (ГИБИ, Произведения...1994: 169). Nga kjo mund të supozojmë se rruga tokësore nga Ohri deri në Konstantinopol ose pjesë nga rruga e dikurshme Via Egnatia, ka qenë e banuar me shumë Egjiptianë, ndaj për këtë shkak edhe Teofilakti simbolikisht do të thotë se duhet të udhëtojë “nëpërmjet Egjiptit- rrugë e mundimshme dhe të vështirë”.

Me siguri, shembuj të tillë për përmendjen e Egjiptianeve në Ballkan, do të mund të gjenden edhe më tepër në hulumtimet e ardhshme historike. Por ajo, që është veçanërisht interesante janë të dhënat dhe burimet historike nga shek.XIII dhe shek.XIV, prej ku edhe fillojnë turbullirat dhe ngatërimi i banorëve të vjetër Egjiptianë, me pjesëtarët e bashkësisë rome. Kuptohet se fenomeni mimikri etnike i shkaktuar nga nevoja për prestigj sa më të lartë shoqëror, te pjesëtarët e bashkësisë rome, paraqitet në kohën kur ata vijnë në Ballkan dhe Evropë, duke pasur parasysh se nuk janë të

---

<sup>45</sup> ГИБИ, Произведения за Теофилакт Охридски 1994: 99; Nuk e kemi të qartë nga cilat shkaqe redaktori ka vendosur në fusnotë se Egjiptian është sinonim për djall, kur Teofilakt në këtë kontekst në letrën flet për probleme krejtësisht tokësore dhe konkrete.



mirëpritur dhe të integruar në shoqëri, disa me siguri edhe gabimisht janë prezantuar si Egjiptianë, duke e fshehur prejardhjen e tyre nga Penxhabi. Prandaj të dhënave të kësaj kohe duhet t'u afrohem me dozë të madhe vëmendjeje, gjatë sjelljes së përfundimeve nëse bëhet fjalë për pjesëtarët e popullsisë egjiptiane ose rrome.

Në dokumentet e patriarkut të Konstatinopolit, Grigorius II Kiprios (1283-1289) përmenden tatime speciale, të cilat duhet të mbledhen nga “ata të quajtur egjiptianë dhe ciganë” dhe për praktikën e përdorur për mbledhjen e atyre tatimeve (Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 17).

Mandej, në praktikonin e manastirit Ksiropotama e Atosit, nga viti 1325-1330, është vërejtur se Ana, vajza e Limocervulit, ka bashkëshort “Egjiptian” (Петровић, Ђ. 1975:124), ndërsa në tokat e manastirit Lavra ka jetuar “Egjiptiani Nikollaos” (Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 17). Në dokumentet nga 5 nëntori 1362 nga arkivi i Dubrovnikut përmenden Vllaho dhe Vitan si “Egjiptianë” (Петровић, Ђ. 1975:124), të cilët kanë kërkuar nga zyra e princit që argjendari Raden Bratoslaviq t'ua kthejë të tetë rripat, që kanë qenë të depozituara te ai.

Në versionin “bullgar” nga shekulli XIV në jetëshkrimin e Sh. Barbarus, i cili ka jetuar në gjysmën e parë të shek.IX, përmenden shumë “Egjiptianë”, të cilët jetojnë nëpër bregdetin shqiptar rreth Durrësit (Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 17). Kallëzimi i bazuar mbi shkrimet e Konstandin Akropilitisit nga shek.XIII thotë se Barbarus pasi ka mbetur pa prindër, u është bashkuar piratëve Saraçenë në një ekspeditë për Greqinë, gjatë kohës së qeverisjes të Mihail II (820-829) dhe anija e tyre është fundosur gjatë një stuhie të madhe. Të gjithë janë mbytur përveç Barbarusit, i cili ka dalë në Durrës dhe atje e kanë ndihmuar një grup njerëzish, të cilët kanë qenë të zinj si vetë ai dhe kanë folur gjuhë të njëjtë (Пуксон, Г. 1974: 88).

Një ngatërrësë e madhe në të dhënat historike ka ndodhur me lagjen “Egjipt i Vogël”. Numër i madh shkencëtarësh sot janë në pikëpamjen që “Egjiptin e Vogël” ta lokalizojnë në Gadishullin Peloponez, edhe pse ka edhe hipoteza të tjera të cilat flasin se “Egjipti i Vogël” ndodhet në rajonin Izmir në Azinë e Vogël ose në regjionin e Antiohisë (sot Antalia). Pikërisht, për “Egjiptin e Vogël” thuhet se kanë jetuar Romë “...të cilët kryesisht kanë qenë të varfër, burrat kanë qenë të njohur si farkëtarë, ndërsa gjithashtu janë marrë edhe me punime këpucësh dhe arnime. Von Harf jep përshkrim për llojin e kudhërit dhe makinat që i kanë përdorur, të cilat pas gjithçkaje duket se ende janë të ngjashme me ata që përdoren nga disa Rromë në Maqedoni. I është thënë se Romët kanë ardhur nga një rajon i quajtur Guppe-Xhipi, 50 km nga Modoni, i cili edhe vetë ka qenë i larguar 120 km nga Nauplia...”

(Пуксон, Г. 1974: 88).. Sipas Puksonit emri Xhipi ose Egjipt i Vogël, ndoshta ka ardhur, nga ashtu si thotë fakti, se Romët kanë ardhur nëpër det nga bregu Levant dhe Aleksandria (Пуксон, Г. 1974: 88). Sipas disa autorëve nga “Egjipti i Vogël” nisin edhe legjendat për Ciganët si “princër nga Egjipti i Vogël”, të cilët janë të shpërndarë gjerë gjatë hyrjes në Evropën Perëndimore në shek. XV (Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 18).

Ashtu siç mundëm të vërejmë nga shembujt e lartpërmendur, deklarime të qarta dhe regjistrimi i disave si “Egjiptianë”, shkencëtarë të përcaktuar i klasifikojnë si Romë, duke i vështuar nga një distancë kohore, prej më tepër se 600 vite. Gjatë kësaj, duke ndërtuar një hipotezë, e cila për fat të keq u bë dhe një sqarim përgjithësisht i pranuar pa argumente të forta ku bëhet fjalë për dy ose më tepër grupe të Ciganëve/Romëve me drejtime të ndryshme të lëvizjeve nga të cilat më e madhe është ajo e grupit të Romëve që vinin nga Azia e Vogël, duke kaluar nëpër Bullgari, Serbi, Vllahi dhe Moldovë, ndërsa tjetra nga Egjipti i Vogël ose Egjipti, të cilët deklarohen si Egjiptianë, dhe ndodhen në Peloponez, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi dhe Dalmaci dhe se gjatë rrugës e kanë humbur gjuhën Rrome (Петровић, Ћ. 1975:127; Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 20; Пуксон, Г. 1974: 86-88).

Nëse këto të dhëna historike i lexojmë si etnologë/antropologe dhe nëse e marrim parasysh etno-kulturën e Ciganëve/Romëve në shek. XIII-XV, faktin se në atë kohë ata në masë të madhe kanë jetuar jetë endacake-nomade, me mundësi të vogël ata janë asimiluar edhe me gjuhën edhe me antroponimet, në një numër të madh të rasteve do të shohim se bëhet fjalë për pjesëtarë të bashkësisë Ballkano-Egjiptiane, para së gjithash në pasuritë e manastireve në Lavra dhe Ksiropotama (d.m.th. bëhet fjalë për bujq), mandej rastet me Vllaho dhe Vitan, ku sipas vetë emrave krejtësisht është e qartë se bëhet fjalë për popullsi më të vjetër, e cila ka qenë gjithmonë e vendosur, është sllavizuar dhe e cila para vitit 1362 ka zhvilluar shumë ekonomi në Dubrovnik. “Egjiptianët” në rrethin e Durrësit, të cilët kanë mund të kuptohen me Barbarosin të cilët kanë jetuar në gjysmën e parë të shek.IX në një numër aq të madh, në asnjë rast nuk mund të ngatërrohen me Romët, të cilët në territorin e Shqipërisë së sotme vinë disa shekuj më vonë.

Vetë përmendja e rajonit Guppe-Xhipi si toponim, qartë tregon në atë se marrja e toponimit është proces mjaft i gjatë, i cili disa herë zgjat edhe me shekuj, ndërsa vetë emri Xhipi direkt tregon njerëz nga Egjipti, ndërsa rajoni “Egjipti i Vogël” thamë se përmendet në regjistrin e emrave në vendet e banuara në Bizanti që nga shek.V. Në realitet, nëse e pranojmë mundësinë se “Egjipti i Vogël” ndodhet në Peloponez shkrimet e Herodotit për

prejardhjen e udhëheqësve Dorianë, na tregojnë plotësisht qartë për lashtësinë e farkëtarëve nga Xhipi. Nga e gjithë kjo nuk mund të shmanget supozimi se ndoshta, në shek.XIV në Peloponez vijnë Ciganë/Romë , të cilët më vonë do ta përhapin legjendën se janë grofër nga “Egjipti i Vogël” për prestigj më të madh në shoqërinë e gjerë të Evropës, por ajo në asnjë rast nuk do të thotë se Egjiptianët, të cilët janë vendosur në Peloponez që nga koha e Hekurit janë zhdukur.

## PERIUDHA OTOMANE

Për fat të keq deklarimi i preferuar i Romëve si Egjiptianë në shek.XIV dhe XV do të ketë pasoja afatgjate, në ngatërrimin e Egjiptianëve me Romët dhe ngatërresat do të ndodhin më vonë. Ngatërresat shihen edhe në Perandorinë Osmane. Shteti Osman Romët edhe në legjislativin shtetëror i quan si Koptë ose Kibtinje. Si p.sh në regjistrin nga viti 1522-1523 i quajtur: “Defeteri-i mufassal-i esam-i mahsulat ve mersumat-i Kibtiyan-i vilayet-i Rum dhe ki der efkaf-i merhumve magfur sulat Bayazit Han...,ve efkaf ve emlak-i vuzera-i izam ve umera-i kiram ve Luva-i Kibtiyan ve zuama ve erbab-i timar vaki’side est” (Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 33), që paraqet përshkrim të gjerë të të ardhurave dhe tatimeve nga Kiptinjët në vilajetin e Rumelisë, të cilat hidhen në vakëfet e sulltanit të vdekur Bajazit Han dhe në vakëfet e sanxhakut Kiptinjas dhe në zijametet dhe timaret. Në v.1530 sulltani Sulejman i Madhërisëm do ta shpallë “Kanunname-i Kiptiyani dhe vilaet-i Rumeli” (Вукановић, Т. 1983: 101; Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 33) (Ligj për Kiptinjët në vilaetin e Rumelisë) ndërsa në v.1541 “Kanun-i ser’asker-i Liva-i Çingane” (ligj për komandantët e sanxhakut të Ciganëve). Kur lexohen këto dy ligje krejtësisht është e qartë se ligjëvënësi me termat Kiptijan dhe Çingene nuk bën asnjë dallim etnik, ndërsa normat ligjore i përkasin popullit me vend të paqëndrueshëm (Вукановић, Т. 1983: 101; Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 33). Për shkak të jetës së tyre endacake, Romët vështirë janë lidhur pas tokës dhe spahisë dhe për këtë rrallë kanë qenë raja dhe bujq edhe pse qeveria Osmane gjithmonë ka bërë përpjekje nga shkaqe fiskale, t’i detyrojë të lidhen në një vend, e mandej edhe ti shndërrojë në raja. Tipike për Romët

ka qenë se nuk ka qenë e lehtë t'i shndërrojnë në raja<sup>46</sup>. Romët i kanë paguar tatimet nëpërmjet kryetarëve të tyre, ndërsa nëse ndonjë Rom ka ikur nga xhemati i tij, kryetarët kanë qenë të detyruar t'i gjejnë garantët e tij që ta gjejnë të ikurin dhe ta detyrojnë të paguajë tatim (Матковски, А. 1978: 61-63).

Nga ana tjetër, Egjiptianët të cilët kanë pasur mënyrë të stacionuar jetese, me siguri janë midis të parëve që kanë qenë të lidhur pas spahisë dhe kanë qenë të bujkrobëruar. Një pjesë e madhe e Egjiptianëve është marrë me farkëtari, i cili ka qenë shumë i domosdoshëm për bujqësinë, e cila pa mjetet e saj për përpunimin e tokës dhe mbledhjen e fryteve, nuk mund të funksionojë pa farkëtarët, të cilët duhet t'i prodhojnë, rregullojnë dhe ruajnë mjetet bujqësore. Ndërsa, farkëtarët si dhe mjeshtrit e tjerë fshatarë siç janë qerrepuuesit, arabagjijtë, ujitësit etj., gjithashtu kanë qenë të trajtuar si raja dhe si të tillë kanë qenë të regjistruar në defterët regjistruese (Матковски, А. 1978: 61-63). Megjithatë, si raja nuk është trajtuar vetëm popullsia fshatare, por edhe ajo qytetare (Матковски, А. 1978: 61-63). kështu që edhe ata farkëtarë ose Egjiptianë të cilët kanë jetuar nëpër qytetet kanë qenë të trajtuar si raja.

Domethënë, edhe pse gjatë kohës së qeverisjes osmane, në legjislativin shtetëror nuk bëhet dallim etnik midis Egjiptianëve dhe Romëve, dallimet dhe kufijtë etnikë mund të shihen vetëm në atë a bëhet fjalë për popullsi të stacionuar ose endacake. Megjithatë, parashtrohet pyetja pse qeveria osmane e përdor termin Kibtian për identifikimin e njerëzve endacakë për të cilët sot me siguri dihet se nuk kanë prejardhje nga Egjipti?! A kanë kundërshtuar Egjiptianët në Ballkan, që në atë kohë ko-identifikoheshin me Romët, dhe a ka ndonjë dokument të ruajtur për atë?! Përgjigjen do të mundohemi ta gjejmë në proceset e reja që kryheshin në Ballkan në mënyrë paralele me sundimin e qeverisë osmane e ajo është **islamizimi dhe deetnizimi**.

Më saktë, për perandorinë Osmane, si shtet teokrat nuk është fare e rëndësishme përkatësia etnike, për ata është e rëndësishme vetëm ndarja dhe përkatësia religjioze, përkatësisht nëse bëhet fjalë për popullsinë myslimane (besimtarë të drejt, të kushtuar Zotit) ose popullatë jo myslimane (qafirë, jo mirënjohës të Zotit, jobesimtarë). Për shkak se popullata jo myslimane, përkatësisht ata që do ta pranonin islamin si fe, shfrytëzonin lehtësi të përcaktuara nga besimi për dallim nga jo-muslimanët, shtresa të përcaktuara nga popujt e nënshtruar krishterë e kanë pranuar islamin dhe janë islamizuar. Megjithatë, në popull ky proces i islamizimit më tepër është

<sup>46</sup> Raja dmth njeri që ka qenë i lidhur pas spahisë dhe tokës pavarur nga profesioni, përkatësia fetare ose etnike dhe pavarur nga madhësia e tatimeve dhe individ i cili ka qenë i regjistruar në defterët regjistruese me këtë status.

njohur si “turqizim” që vjen nga ndeshja religjioze integrale midis Turqve dhe popujve të nënshtruar ballkanikë. Më saktë, është kryer totalizim i krejt kundërshtimeve ekzistuese me aspektin religjioz. Për atë në sytë e popujve të krishterë, kalimi në Islam identifikohet me turqizimin, braktisjen e popullit të vet dhe bërja Turk. Ndërsa, nga ana tjetër, Turqit Osmanli meshekuallor veten e kanë përjetuar dhe janë ndjerë veten më tepër si myslimanë, se si Turq në kuptimin e sotëm të fjalës. Pikërisht për atë që kuptimi Turk është identifikuar me kuptimin mysliman, kalimi i popujve të nënshtruar në Islam, quhej turqizim, ndërsa myslimanët e rinj – Turq (**Лиманоски, Н.** 1993: 39).

Përballë dhe kundër saj, për Osmanët “urum-milet” ka qenë krejt popullsia krishtere, ndërsa patriarku i Rumelisë (patriarkia greke në Istanbul) ka qenë i njohur nga sulltanët për përfaqësues i të gjithë të dhënëve (besimtarë) ortodoksë, pas rënies së Konstantinopolit (Istanbul). Për atë, rajonet më të ndryshme dhe emrat etnike në tokat e nënshtruara, për osmanllijtë nuk kanë pasur kuptim real (**Лиманоски, Н.** 1993: 39).

Domethënë, sipas krejt kësaj, gjatë kohës së qeverisjes Osmane përveç islamizimit kemi edhe proces paralel deetnizimi, ku përkatësia dhe ndarja etnike e humbi rëndësinë, për llogari të përkatësisë dhe determinimit religjioze. Sistemi qeverisës Osman në perandori, duke u mbështetur në qëllimet tradicionale islame, edhe popullin e vet e la pa emër kombëtar, ndjenja dhe karakteristika të tjera etnike. Sulltanët Osmanlinj me shekuj e kanë mbytur çdo mendim të lirë të adhuruesve të tyre, ndërsa më tepër idenë etnike. Qeveria Osmane gjatë gjithë kohës është munduar ta fshijë dallimin midis religionit dhe etnosit, duke shpallur që të gjithë myslimanët të hyjnë kah një bashkësi myslimane (**Лиманоски, Н.** 1992: 46). Kjo situatë do të zgjasë deri në gjysmën e parë të shek.XIX, kur midis popujve ballkanikë do të zhvillohet ideja për rilindje dhe liri kombëtare.

Gjatë një konteksti të tillë, nëse përsëri kthehemi në ligjet për “Kiptinjët” dhe “Çingene” dhe përfundimin se me emrat Kiptian dhe Çingene sipas ligjeve të cituara në Perandorinë Osmane mendohet në njerëz me vend dhe jetë të paqëndrueshëm, përkatësisht me karakter nomad-endacak, dhe të cilët nuk llogariten si raja. Si mundësi më të besueshme për përdorimin e të dy termave, të cilat etimologjikisht nuk mund të kenë lidhje, përsëri mbetet nevoja e Romëve për autoritet më të madh dhe integrim shoqëror, si dhe shmangie të diskriminimit që është bërë mbi ta. Se sa ka ekzistuar nevoja e tillë për integrim shoqëror mund të shihet edhe nga një dokument nga viti 1634 ku banorët e fshatit Srpci Pasha, Manastir, ankohen nga “Romët-cergarë se shpesh vijnë në fshatin tonë, jetojnë nëpër shtëpi të zbrazta dhe kasolle, dhe na shqetësojnë, vjedhin pula, dele, shqerra, veshje

dhe i presin pemët e rrethit dhe i djegin. Dëm të madh kemi nga ata dhe ju lutemi t'i ndaloni të vijnë në fshatin tonë” (**Матковски, А.** 1978: 26). Romet një diskriminim të tillë kanë qenë të detyruar ta shmangin, e ajo ka qenë e mundur vetëm nëse deklarohen si pjesëtarë të ndonjë bashkësie tjetër me të cilën ata në mënyrë somate, sipas ngjyrës së lëkurës janë të ngjashëm dhe janë të integruar më mirë dhe të pranuar nga popullsia, d.m.th. të deklarohen si Egjiptianë. Ekzistenca e një kunfuzioni kaq të madh, ka ndikuar gjithashtu që popullsia Rome përveç më zanatet tradicionale që ka pasur, karakteristike edhe për jetën e tyre endacake (arrixhinj, koritarë, fallxhorë, muzikantë etj.) të merren edhe me zanatin e farkëtarisë, me të cilin Egjiptianët tradicionalisht janë marrë.

Gjatë një situatë të tillë të deetnizimit total të shoqërisë në Perandorinë Osmane, por në të njëjtën kohë një shoqëri me dallime të mëdha klasore dhe antagonizma fetare, termat për identifikim kolektiv duhet të merren me mjaft konsideratë. Kjo më tepër që edhe termi Vllah në këtë kohë ende nuk do të thotë edhe identifikim etnik, por do të thotë kategori sociale e njeriut, individ që nuk përket në raja, i cili nuk ka feudale të tij, por ka pasur vetë-udhëheqje dhe organizim të tij. Termi “Vllah” është përdorur edhe për shtresat e etnive të tjera (pjesë të popullit shqiptar, bullgar, maqedonas, serb, malazet dhe kroat) të cilët janë marrë me blegtori, ashtu kanë marrë përgjithësisht emrin blegtor, pa dallim të përkatësisë etnike (**Матковски, А.** 1978: 54). Si shembull për të vërtetuar këtë mund të na shërbejë edhe ajo që deri sot në gjuhën shqipe vllahët etnik thirren me termin “Çoban”, term, i cili në formë të pandryshuar përdoret kur mendohet edhe për blegtoribari.

Sipas asaj që thamë se me normat ligjore të Kanuneve, rregullohen detyrat dhe sjelljet e “Kiptinjëve” dhe “Çingene”, ku enkas mendohet për njerëzit, të cilët enden dhe kanë vendbanim jo të përhershëm, lirisht mundemi ta parashtrijmë edhe pyetjen për paragjykimet racore dhe stereotipet. Sipas asaj që elementi etnik është krejtësisht i neutralizuar, ajo nuk mund të bëhet edhe me ngjyrën e lëkurës. Paragjykimet racore ndaj njerëzve më të zinj, të cilët janë edhe me status më të ulët social nuk është mundur të klasifikohen. Me të arrihet deri në barazim racor dhe njëkohësisht identifikim të njerëzve me ngjyrë të errët të lëkurës pa dallim të prejardhjes së tyre etnike me termat “Kiptijan” dhe “Çingene”. Kur kryhet ky barazim racor stereotipet “për të tjerët” gjithashtu barazohen ndërsa paragjykimet edhe më tepër zmadhohen. Vlerat kulturore tradicionale dhe diferencimet e bashkësive të ndryshme për “të barazuarit” barazohen dhe hyjnë në “meltin pot” racor. Meqë gjatë kohës së qeverisjes Osmane është krijuar urrejtje dhe përbuzje ndaj shkencës dhe arsimit, populli por edhe

feudalët janë fundosur në paragjykime. Populli, por edhe feudalët janë fundosur në padituri dhe bestytini. Kurani (gabimisht i kuptuar dhe i shpjeguar) për ta ka qenë baza dhe burimi i ditorisë, por për fat të keq islamit që e kanë realizuar Osmanlijtë në Ballkan ka qenë i ngushtë, i ngurtë që nga shekulli i shtatë. Në një situatë të tillë edhe nuk mund të presim forca progresive që do të mund t'i përzgjedhin dhe tejkalojnë paragjykimet racore. Ndërsa fakti sesa paragjykime racore ekzistojnë midis popujve të nënshtruar nga Perandoria Osmane, krejtësisht qartë mund të shihet në legjendat dhe këngët epike për Kralin Marko, ku armik i tij i përhershëm ishte Arapi i Zi, personifikimi i së keqes dhe forcave të errëta.

Anarkia shoqërore dhe politike, e cila si rezultat i krizës së ashpërsuar ekonomike dhe politike në Perandorinë Osmane ka qenë karakteristikë për fundin e shek. XVIII dhe fillimin e shek. XIX, si rezultat i luftërave të gjata me Austrinë dhe Rusinë. Ajo jo vetëm që i ka lëkundur themelet e sistemit timaro-spahik, por në vitet e 30-të të shek. XIX, solli deri në abrigim të tij dhe shndërrim në sistem Çifligar, me shndërrim të timareve dhe zijameteve në çifligje private, ndërsa të spahive në çifliksajbe.

Në kushte krize të Perandorisë Osmane dhe fillimin e krizës së përkohshme shoqërore-politike dhe ekonomike (konflikte të brendshme, luftëra, kryengritje, reforma etj.) regjistrat shtetërorë për mbledhje tatimesh gradualisht humbin rolin që kanë pasur në strukturën e plotë shoqërore. Me të edhe të dhënat historike për “Kibinjët” dhe “Çingenet” në Perandori me karakter shtetëror-administrativ bëhen të copëtuara dhe të pasigurta. Në llogari të saj zmadhohet numri i të dhënave dhe shënimeve, puna e autorëve të huaj, udhëpërshkrues për shkaqe të ndryshme nëpër Perandorinë Osmane. Kuptohet se edhe këto burime historike nuk duhet të merren thjesht dhe pa kritikë, por në çdo rast na zbulojnë anë interesante nga jeta e njerëzve dhe mendimet në atë kohë.

Një shkrim interesant kemi nga udhëpërshkruesi austrian Johan Kempelen, i cili na ka lënë një shënim interesant për Nishin nga viti 1740 (**Марушиакова, Е., Попов, В.** 2000: 64):

“... Ciganët janë rreth 2000 familje, të cilat jetojnë në shtëpi të bëra prej plitash të thurura. Ata gjatë kohe janë vendosur në atë tokë, kështu që jeta endacake për ata nuk është aq karakteristike, si për jetën e egjiptianëve tonë. Gratë kujdesen për familjen dhe punët shtëpiake, ndërsa burrat nisur nga përvoja të ndryshme, por shumica edhe në zanate. Nga bujqësia largohen. Fenë e kanë ose myslimane ose të krishterë, ndërsa më së tepërmi të asnjë llojshëm... Prejardhja më e hershme e kësaj pleme mund ta dërgojë në kohën e Nikoforit rreth vitit 811... Prej atje siç duket, disi është fituar edhe emri për ciganët. Siç duket, një lloj, mase e madhe Egjiptianësh e

shpërngulur ose e mallkuar është lidhur me to. Në vazhdim të saj mund të thuhet, se emri Ciganë ose Egjiptianë për ata është sinonim... Ata krenohen me rrënjën e tyre (egjiptiane). Por, mandej nuk zbulojnë asgjë nga vetitë dhe gjuha e egjiptianëve, as edhe e halkedonëve, përveç se ca lloj parathëniesh e bestytnish..”

Nga sa u tha më lart mund të vërehet një pa-sqarim dhe konfuzion total i situatës faktike. Një situatë e komplikuar në përdorimin e termave Egjiptianë dhe Ciganë, prej ku nuk mund të nxirren përfundime të sigurta se për cilën popullsi bëhet fjalë. Ajo që është intriguese është se Kempelen i përmend Halkedonët, pa ndonjë sqarim, në kontekst të prejardhjes! A ka ky përcaktim ndonjë lidhje me Këshillin e Halkedonit nga viti 451! Mundemi vetëm të qëllojmë, pa ndonjë farë argumenti.

## **PARAQITJA E IDENTITETIT ETNIK DHE NACIONALIZMI NË BALLKAN**

Shekulli XIX është i njohur si “shekulli më i gjatë i Perandorisë” për shkak se realizohen reforma të mëdha (Tanzimati), por dhe fillojnë lëvizjet kombëtare dhe kryengritjet e disa popujve në Ballkan. Si një pjesë nga reformat e Perandorisë Osmane në vitin 1839 u publikua **Hatisherifi i Gjulhanit**, një ndër aktet më të mëdha reformatore të deriatëhershme, i cili ka paraqitur barazi të plotë të drejtave para ligjeve të të gjithë qytetarëve, pa dallim të fesë, popullsisë dhe gjendjes, si edhe siguri të plotë të jetës, nderit dhe pronave të fituara të të gjitha subjekteve (Ortaylı I., 2009:101). Këto të drejta edhe më tepër u përhapën me sjelljen e aktit të dytë mjaft të rëndësishëm, ai është **Hatihumajuni** nga viti 1856, me të cilin është premtuar barazi të drejtash nacionale dhe fetare e të gjithë bashkësive në Perandorinë Turke, liri në fe dhe liri në ndërgjegje, gjyqe të përziera, të drejta për të krishterët të cilët mund të hyjnë në detyra shtetërore, të shërbejnë në ushtrinë turke, por edhe të kenë përfaqësues të tyre në këshillin shtetëror. Gjatë një konstelacioni të tillë politiko-juridik, me mundësi për zhvillim të nevojave fetare dhe etnike, në 3 qershor të vitit 1867, në gazetën “Makedonija” që del në Stamboll në gjuhen Bullgare, do të publikohet letër me këtë tekst:



“Z. Redaktor i “Makedonija”!

Të gjithë e dinë pse më të qortuar nga krejt popullata e krishterë është populli Egjiptian, dhe ata, sipas udhëbeqjes së fesë as nga fanariatët nuk u ndryshuan me gjithë sekretet e fesë ortodokse. Por, për atë se cili është shkaku do të shohim më poshtë. Tani, nëse pyesni ndonjë nga fanariatët kush janë ata dhe si ata janë bërë ashtu, do ta dëgjoni përgjigjen e zakonshme, se janë udhëbeqës të fesë dhe se vetëm ata kanë të drejtë në atë, si trashëgimtarë të apostujve të Krishtit (kanë qenë). Por nëse merr të hulumtosh për punët e tyre, përveçse do të përballesh me përndjekës dhe shkatërrues të fesë dhe të rregullave të saj, dhe duke e përdorur bukurinë, thjeshtësinë shpirtërore dhe bukurinë e pastër të plemeve të tjera, duke i përdorur si mjet edhe intrigat dhe dinakërinë e tyre, në shërbim të ndalimit të krahës dhe t'i mbajnë nën jarem dhe robëri, duke i shkatërruar të gjitha drejtësitë, që janë dhënë vetë nga Zoti Ynë Jezhu Krisht, për të gjithë poshtë nën qiellin të cilët besojnë në të, dhe kryqëzohen në emrin e tij...Ata thonë rrufeshëm se të gjithë popujt që besojnë fenë krishtere dubet t'i nënshtrohen qeverisë shpirtërore të grekëve dhe askush nuk ka të drejtë të ketë parim të vetë shpirtëror ...Për habi!Si nuk turpërohen, kur shfaqin dhe shtypin pakuptime të tilla, kur edhe më të thjeshtët e dinë se Apostujt e Krishtit, të cilët kanë qenë të përcaktuar t'i arsimojnë popujt me fenë krishtere, nuk ka pasur asnjë Helen dhe nga ajo qartë shihet se nuk ka qenë e Helenëve, pas dëshirës së Shpirtshënjtut t'i arsimojnë popujt ... Tani, kur shohim se Helenët nuk kanë qenë të zgjedhur pas dëshirës së Shpirtshënjtut t'i edukojnë popujt, nuk kanë qenë vetë të pëlqyeshëm, të përshtatshëm për Zotin, sepse nëse kanë qenë mbështetësit e vërtetë të rregullave të Krishtit, të tregojnë, se kanë të drejtë të udhëbeqin në të gjitha kishat ortodokse dhe që intrigat e tyre t'i shpjegojnë saktësisht, për atë t'i mbajnë si robër të tyre ose turp është të them, si pronë të vet.

Prej këtu le të shikojë njeriu, në çfarë gjendje të mjerë ka qenë Kisha Madhështore. Por, ajo nuk është asgjë ndaj popujve të tjerë si për bullgarët për shembull, në krabasim me ne Egjiptët, të cilët arritëm deri në një ulje të tillë, të pikëllueshme dhe të mos kemi mundësi asnjëherë të drejtobemi dhe të rregullojmë gjë midis nesh, shkollimin e dëshpëruar sepse nga udhëbeqja me kishën, e cila me fjalë na vërteton se nuk i jemi të këndshëm Zotit. Cili është shkaku që një Egjiptian t'ia shërbejë njëkohësisht dy ose tri feve? Është sepse ai si i krishterë shikon se nuk është i përfshirë në të gjitha sekretet, për më tepër për atë mbetet i dyshimtë, ngaqë ka ikur nga fetë e tjera, duke ruajtur origjinalitetin. Dhe ashtu të shpërndarë Egjiptët, cili në gjemb, cili në zjarr, dhe në një dëshpërim të tmerrshëm nuk mund të krijojnë shoqëri dhe të kujdesen për një shkollim ...Atë që pamë në “Gajdë” nr.15 nga viti III ku duke vërtetuar për prejardhjen tone se jemi me lidhje fisnore me Egjiptianët e Vjetër, që e vërtetojnë jo vetëm përparësitë dhe aftësitë tona, por edhe vetë gjuha dhe vetë emri ”Egjiptë”, i ruajtur deri më sot, ndërsa nga të tjerët “atinianë-

atninganë”, ndërsa disa thonë se Sh. Gregorij Omiritski<sup>172</sup> na ka ndaluar veprimtarinë priftërore. Ajo që ne na kanë hedhur në dëshpërim dhe na kanë bërë ata që jemi sot, si është e mundur të jenë me fe gjysëmkrishtere ose gjysëmjokrishtere, ose cilin rregull gjeti Priftëria e Tij, të thotë se Egjiptët kanë qenë plotësisht të papëlqyeshëm nga Zoti?

...Tani të shohim cili është qëllimi i grekëve që të na japin ne popujve të tjerë, të drejta fetare dhe energjikisht t'i zhdrukun? ...Unë dua të dëshmoj për egjiptët, për të cilët deri sot asnjë nuk na ka kushtuar vëmendje, por as edhe dikush nga ne s'është kujtuar të flasë ku ndodhemi. Cili është shkaku që jemi aq të shtyrë fetarisht, nga çka mandej kanë rrjedhur edhe sëmundje shëndetësore. E dëshmuar është se para 1800 vitesh, para lindjes së Krishtit, në Eladën e sotme ka jetuar popull Elin, aq i egër dhe mizor, ka jetuar në pyje, kolibe dhe shpella, është ushqyer me rrënjë tokësore dhe disa bimë të egra, që ska ditur as ba, as tru.

Në atë kohë kur helenët kanë qenë trashanikë dhe si themi ne-frynin bar, egjiptët kishin arritur deri në një nivel të lartë shkollimi, por bënë disa “ngatërresa” në Egjipt, nga të cilat disa mijëra njerëz u shpërngulën dhe u vendosën në Eladë. Atje, në Eladë, bashkë me shkollimin sollën edhe përvojat e përjetshme, por edhe elinët-të egërit, me përpkjekjet e palodhshme të Egjiptianëve që t'i arsimojnë, por edhe me qëllim që të zbuten dhe ashtu gradualisht, duke u lidhur me mysafirët e arsimuar, të cilët u shpërngulën në Athinë, ku e bënë si lider Kekrepsin dhe kryeqytetin Athen (Athinë), prej ku mandej e morën emrin athinianë, acinganë, arritën nivel të mirë shkollimi krahasuar me popujt e tjerë. Dhe ashtu pas kësaj kohe, të shpërndarë me arsimin nëpër popujt e tjerë, për të cilin grekët e sotëm krenarë tregojnë se ata janë arsimues të Universit. Duke e pasur këtë në mend, grekët kur do qoftë, ngadalë ose shpejtë, dubet të kuptojë bota, se nuk është prej tyre i shpërndarë arsimimi, me të cilin krenohen, nëse dikur mbetën mbeturina të Egjiptianëve, të cilët përvojat nga një ndryshim i rrezikshëm i jetës shoqërore, çka u shpërndanë nëpër Universin, të cilët duke i përdorur kushtet, i kanë penguar të mos “shikojnë” dhe mandej me zgjimin e tyre zhvillues, t'i dëshmojnë botës, se Elinët gënjejnë me atë që thonë se janë arsimues të Evropës, ndërsa ne Egjiptët, që vetë ata i arsimuam, i zgjoj Elinët ta sulmojnë fenë besimin e Egjiptëve deri sa të urrehen dhe të hidhen në dëshpërim dhe u zhdrukën krejtësisht nga dega tokësore, që të mos pengojnë në sytë e Elinëve, për çka edhe patën sukses. Ai është shkaku që Sh.Gregorij Omiritski ka ndaluar që Egjiptianët të veprojnë si priftër... nëse deshën (grekët) të krenohen para Evropës se ata janë arsimues, le të vijnë së pari të përulen dhe përfulur para këmbëve

<sup>172</sup> Grigotij Omiritski (vdiq në vitin 552)-ka qenë shërbyes i kishës Madiolane dhe ka pasur më tepër privilegje, me mendimin zotëror është sjellë në Aleksandri, ku patriarku Proterije ndaj një zbulimi qiellor e ka dorëkaluar për peshkop Omiritski në Arabinë jugore. Sipas besimeve ai me lutje ka bërë mrekullira të mëdha, ndaj ashtu me lutje ka shkaktuar vizion për paraqitjen e Jezu Krishtit para Evrejëve jobsimtarë, me çka ata janë kryqëzuar.

*tona, që t'i rinjohin arsimuesit e tyre dhe ta plotësojnë detyrën, me të cilën do të tregojnë shembull autentik para të tjerëve, e mandej të kenë të drejtë të kërkojnë.”*

### Një Egjiptian

Letra e publikuar është dokument jashtëzakonisht i vlerësuar për zhvillimin e bashkësisë dhe vetëdijes etnike të Egjiptianëve në gjysmën e dytë të shek. XIX. I panjohuri “Një Egjiptian” nga Prilepi sipas mënyrës së të shkruarit duket se është mirë i shkolluar me drejtim fetar, dhe me vullnet lufton për shkollim social dhe për të drejtat fetare të Egjiptianëve. Autorë të përcaktuar, vlerësojnë se edhe në këtë rast bëhet fjalë për Ciganë/Romë (Марушиакова, Е., Попов, В. 1995: 42-49; Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 94-95). Megjithatë, duke pasur parasysh se autori flet për historinë e Egjiptianëve të Vjetër, ndihmesa që ata kanë dhënë për arsimimin e Helenëve gjatë periudhës antike, llogarisim se në këtë shembull kemi rast të pastër vetëdijeje etnike Egjiptiane, të autorit, i cili ashtu edhe është nënshkruar. Mbetet pyetja kush është “Egjiptiani” anonim nga Prilepi që e ka shkruar këtë letër. Sipas Elena Marushiakovës dhe Veselin Popov, duke u bazuar në materialet e publikuara të Marko Cepenkovit, me siguri bëhet fjalë për të caktuar Ilija Naumçev, berber, i cili ka pasur punëtori të tij. Tek ai kanë shkuar njerëz të arsimuar dhe nga dita në ditë u zhvillua dhe e njoftoi popullsinë dhe nuk është turpëruar të tregojë se është Egjiptian. Ai Ilija Naumçev ka pasur dëshirë të madhe që nga populli i tij të ketë një prift. Sipas M.Cepenkov, ai vetë ka mësuar dhe është bërë prift në Stamboll në Egzarhin (Марушиакова, Е., Попов, В. 2000: 94-95). Edhe Vasil Kënçov shkruan për një prift “cigan” nga Prilepi, i cili e ka mbajtur anën e Egzarhisë (Кѣнчов, В. 1996/1900: 115). Por mbetet pyetja a është ai njeriu i njëjtë, ose dikush tjetër duke e pasur parasysh dallimin kohor nga botimi i letrës në vitin 1867 dhe hulumtimet e Vasil Kënçov në Maqedoni të cilat janë kryer në dekadën e fundit nga sh. XIX, ndërsa botimi i librit nga hulumtimi është në vitin 1900. Ky shembull dhe kjo letër na jep mundësi të hapim edhe një dimension në lidhje me pyetjen e identitetit të Egjiptianëve dhe ngatërrimet dhe konfuzionet që zhvillohen tek rilindësit kombëtar, etnografët dhe udhëpërshkruesit që kanë hulumtuar dhe shkruar për popullatën në Ballkan. Te pak autorë, si për shembull tek vëllezërit Milladinovci<sup>176</sup>, Sami Fraheri<sup>177</sup>, Faik Konica<sup>178</sup>, etj, mund të parandihet se

<sup>176</sup> Dimitrija dhe Konstantin Miladinovci, Zbornik na Belgarski narodni pesni (orginal), Zbornik na narodni pesni-nën redaksi të Haralampie Polenakoviç dhe Todor Dimitroskit, Makedonska kniga, Skopje 1983: vetëm për shembull, në faqen 103, këngë me titull Rada i Cigançe, ku bëhet fjalë për pjesëtarë të bashkësisë Rome. Ndërsa në

bëhet ndonjë dallim ose përkufizim midis Egjiptëve (Jevgjit) dhe Romëve (Ciganëve). Por, në kohë të njëjtë ekziston një kanonadë tepër e madhe e autorëve tjerë të cilët këtij problemi i hyjnë sipërfaqësisht pa elaborim më detal dhe të cilët krejtësisht apriori nuk bëjnë asnjë dallim midis Egjiptianëve dhe Romëve, përkatësisht Egjiptëve dhe Ciganëve<sup>179</sup>. Por, nga ana tjetër, letra e publikuar në gazetën “Makedonija” më 3 qershor 1867 na dëshmon se midis Egjiptianëve të Ballkanit ekziston vetëdije e përcaktuar se prejardhja e tyre është nga Egjipti (dhe se në letrën si argument shkencor shërben vetëm mbishkrimi nga “Gajda”<sup>180</sup>), që është shpërngulur në Ballkan që nga kohërat më të vjetra antike, me çka tregon në atë se edhe përveç asaj që ata janë quajtur Egjiptianë-Egjiptë, me prejardhje nga Egjipti, udhëpërshkruesit e tjerë ose hulumtues nuk kanë ndarë më tepër vëmendje dhe kohë, e me siguri nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme shkencore që ti sqarojnë deri në fund dallimet dhe kufijtë etnik midis Egjiptianëve dhe Romëve.

Meqë lëvizjet nacionale në Ballkan sa më tepër forcoheshin në dekadën e shtatë të sh.XIX, e me të inicuarat kanë qenë edhe luftërat midis forcave të mëdha Ruse-Turke dhe aneksimi i Austro-Hungarisë mbi Bosnjë dhe

pjesën e gjëzave në faqen 511, nën nr.16 është gjëza: kam vrimë, rash në vrimë, nxorra një Egjupkë (Saljka), nën nr.44 gjëza: Egjiptin rrotulloheshte, Egjupka hapa bënte (saç dhe shkretëtirë), dhe nën nr. 103: Dripava Gjupka pred car izlegve (Komad, zellnik). Konstantin M. ka shkruar edhe një këngë për “Egjiptin Delija”, në të cilën me siguri të madhe mund të themi se bëhet fjalë për Egjiptian që është sjellë si Turk. (Shiko: K.Miladinov, Izbor, Misla, Skopje, 1980, str.39-42).

<sup>177</sup> Frashëri Sami, Vepra 1, Tiranë 1988, 252, 241, 243, 407, 409, 411, 421.

Enciklopedisti i madh shqiptar Sami Frashëri në veprën e tij për Afrikën, Egjiptin e quan Evgjitëria (Misir), ndërsa popullatën Evgjitë. Më tej, duke i përshkruar popujt dhe bashkësitë e Ballkanit ai i ndan Cergarët dhe Evgjitët.

<sup>178</sup> Shkodra Zija: “Esnafët Shqiptarë” Tiranë, 1973, 52. Në veprën “Esnafët Shqiptarë” akademiku Zija Shkodra e citon hulumtuesin e njohur shqiptar Faik Konica, i cili flet për formimin e qyteteve messhekullore në Shqipëri të sotshme dhe shkruan “përveç bashkësive jomuhamedase ka pasur edhe grupe evgjitësh (ciganë) të ndarë në dy kategori: arixhinjë, endacakë ose gabelë me prejardhje nga India dhe evgjitë, joendacakë ose magjupë me prejardhje nga Egjipti dhe Sudani...”.

<sup>179</sup> Vetëm për shembull: Марко Цепенков, Македонски народни приказни, кн. III, Скопје, 1959, 246-251; **Васил Кънчов**, *Македонија. Етнографија, статистика. Софија*, 1996

<sup>180</sup> Statia e publikuar në gazetën Gajda ka dalë në Stanboll, viti 3, nr.16, 256-258 (Studii Romani, tom II, 47) në të cilën përshkruhen disa “teza” dhe sqarime për prejardhjen e Ciganëve, ndaj njëra thuan se janë me prejardhje nga Egjipti, ndërsa tjetra nga India. Autori i letrës së botuar në gazetën “Makedonija”, mbahet fort vetëm pas varijantës së parë, për ardhjen e Egjiptianëve që nga koha antike, për shkrimet e Kekropisit në Eladë, dhe për 12-të Mahallat në Athinë, të banuara me Egjiptianë.

Hercegovinë, ishte e pashmangshme që të mbahet konferencë ndërkombëtare për rihartim të kufijve në Ballkan, e ajo konferencë u mbajt në Berlin në vitin 1878, me çka ishin formuar dhe pranuar edhe shtete të reja në Ballkan: Bullgari, Rumuni, Serbi dhe Mal i Zi. Greqia më kishte fituar pavarësi në vitin 1830. Me formimin e shteteve nacionale në Ballkan, identiteti etnik që gjithë kohës ishte i fshehur gjatë kohës së qeverisjes Osmane, gjithnjë më tepër fitonte në domethënie. Por, pyetja për mbrojtjen e pakicave etnike dhe fetare, përdorej për përzierje në punët e brendshme të shteteve fqinje, sidomos në pjesën e mbetur të shtetit Osman në Evropë. Nga ana tjetër karakteri nacional i shteteve ballkanike mundësonte që etnosi mazhoritar ose konstitutiv të marrë edhe veprime të përcaktuara kulturore-asimiluese ndaj bashkësive minoritare. Proceset e negacionit dhe asimilimit etnik në këtë periudhë kryheshin me intensitet të ndryshëm, varësisht nga ajo se në cilin shtet janë kryer, ndaj cilës bashkësi, si dhe a është interesuar toka matkë për pakicën e sajë në shtetet e tjera dhe marrëdhëniet ndërkombëtare a kanë qenë në gjendje të mirë ose të keqe.

Në një konstelacion të tillë, pjesëtarët e bashkësisë etnike të Ballkano Egjiptianëve nuk arrijnë të luftojnë për identitetin e tyre dhe për të drejtat e tyre kolektive në shtetet e reja të formuara ballkanike. Ata përsëri janë viktimë asimilimi dhe pushtimi. Meqë si përkatës të pakicës myslimane kanë gëzuar njëfarë mbrojtjeje, ata qëndrueshëm e kanë fshehur identitetin etnik dhe janë përkulur kah identiteti fetar dhe jo rrallë janë deklaruar si Turq. Megjithatë, ata që kanë qenë me fe krishtere plotësisht janë asimiluar në etnosin e mazhorancës në shtetet e reja të formuara nacionale. Megjithatë, përjashtime individuale ka pasur, por ata kanë mbetur si zëra të vetmuar, pa ndonjë rezultat të suksesshëm, si për shembull rrëfimi “ne jemi Kopt, kemi ardhur nga Egjipti”, në gazetën *Veçerna posta* nga 20 dhjetori 1905<sup>181</sup>.

Ballkano Egjiptianët që mbetën në kufijtë e Turqisë Europiane të atëhershme, gjithashtu ishin në pozitë shumë të pakënaqshme. Meqë lëvizja nacionale revolucionare në sasi të madh fitonte madhësi sa më të madhe në Maqedoni dhe Shqipëri, kjo popullatë që merret me zanatin e farkëtarisë, është nën goditje përvetësimesh dhe ndarjesh nga të dy anët e kundërshtuara, sepse në atë kohë farkëtarët i kanë punuar pushkët, shpatat dhe lloje të tjera armësh të ftohta dhe të zjarra. Vetëm për shembull farkëtarin Mustafa nga f.Llaktinje (rajoni Debërc, Ohër) ka punuar rrethe topat e qershisë për rebelët të kryengritjes të Ilindenit në 1903 (**Петровић, Ћ.** 1958: 157), ndërsa vetëm disa dhjetëra kilometra në lindje, farefiset e tij farkëtarë nga fshati Pribillcë (rajoni Zheleznik, Demir Hisar), të cilët kanë

<sup>181</sup> *Veçerna posta* viti VI, nr.1563,20.12.1905 f.2

punuar pushkë dhe municion për Forcat ushtarake Turke, kanë qenë të vrarë dhe të përzënë nga ana e komitëve<sup>183</sup>.

Pas luftërave ballkanike dhe përzënies të qeverisë shtetërore turke nga Maqedonia, Kosova edhe Shqipëria, politikat e shteteve kombëtare, për mospranim të bashkësive tjera, asimilim dhe përvetësim të bashkësive minoritare vazhdojnë deri në luftën e Dytë Botërore. Me formimin e këtyre shteteve dhe vënien e kufijve shtetëror, shkatërrohet edhe koherenca etnike, përkatësisht, numër i madh pjesëtarësh të kësaj bashkësie, për shkak se u gjendën në anën tjetër të kufirit, dhunshëm ju ishin ndaluar lidhjet e gjakut dhe farefisnore.

Në këtë pjesë duhet të ndalemi edhe të një fenomen i cili paraqitet së bashku me nacional-romantizmin të shekullit XIX në Evropën Perëndimore. Ajo është paraqitja e ashtuquajturit Model Arian i historisë. Ky model instalohet në të shumta universitete dhe shkolla në Gjermani, Britani, Francë dhe vendet e tjera. Në formën të hershme dhe “të gjerë”, ky model e mohon të vërtetën për kolonizimin egjiptian në Greqi dhe Ballkan si dhe ndikimin kulturor të Egjiptit dhe Fenikasit në kulturën Greke dhe Evropiane. Sipas modelit Arian, ka pasur ndonjë invazion nga veriu, e cila nuk ka qenë e evidentuar në traditat antike, e cila ka bërë epërsi ndër kulturës lokale “egeje” dhe “paraheliniste”. Civilizimi Grek shihet si rezultat e përzjerjes ndërmjet Helenëve të cilat kanë folur gjuhë indoevropiane dhe popullatës lokale të cilën e pushtuan. Për atë shkak Martin Bernal, në konstruimin e këtij modeli Arian, tregon për “fabrikim të Greqisë të lashtë” (Bernal M., 2009: 2).

Me zhvillim e ashtuquajturit “mendim shkencor” dhe ideologjinë e “progresit”, që e afirmojnë nacional-romantikët të shekullit XIX, e bazuar në modelin Arian, paragjykimet racore ndaj Egjiptianet të Ballkanit morën dhe dimension “shkencor”. Duke marrë parasysh se një numër shumë i madh të intelektualët e Ballkanit, prej shekullit XIX janë shkolluar në universitetet në Evropën Perëndimore, çështja e paragjykimeve racore dhe stereotipat ndaj Egjiptianëve në Ballkan, jo vetëm që nuk u përmirësua, por edhe prej memories kolektive në mënyrë “shkencore” ishte fshirë fakti se në Ballkan jeton popullate me origjinë nga Egjipti. Për shkak se shkencë hulumtoi dhe konkludoi së Romët/Ciganët e kanë prejardhjen nga Pendzabi, dhe ata i përkasin familjes Indo-Evropiane, mohimi i prezencës Egjiptiane dhe elementit semito-hamit në Ballkan dhe Evropë, dhe sistematizim e tyre në grupet e Rromeve, ishte dhe është princip

---

<sup>183</sup> Rrëfim i Mirka Kamberoski, lindur 1891, nga Resnja, dëshmitar i gjallë i ngjarjes. Për këtë ndoshi është e kënduar edhe këngë, e cila këndohet midis farkëtarëve në Resnjë.

epistemologjik i shkollave të shumta Evropiane, por dhe strategjia e politikave të disa shteteve dhe organizatave ndërkombëtare deri në ditët e sotme. Kjo epistemologji lindi rrymën eurocentrike në shkencë e cila i afirmon tezat se Evropa është djepi i kulturës dhe civilizimit, prandaj duhet të gjithë popujt në botë të jenë të nënshtuar kulturës evropiane. Protagonisti më ekstrem i modelit Arian ishte Adolf Hilter me doktrinë për të drejtën e Arianëve ta sundojnë dhe qeverisin botën. Ajo aventurë në Luftën e Dytë Botërore mori miliona jetë njerëzore. Si reaksion i Eurocentrizmit, sidomos në Shtete e Bashkuara të Amerikës, u lajmërua rryma Afrocentrike, e cila në shkencë i afirmon vlerat e Afrikës në civilizimin botëror, me theks të veçantë në civilizimin Egjiptian.

## **LËVIZJA E EGJIPTIANËVE NË BALLKAN PËR PRANIM TË IDENTITETI DHE PARTICIPIM NË JETËN PUBLIKE**

Pas luftës së Dytë Botërore kemi formë krejtësisht të ndryshme në lidhje me pranimin dhe trajtimin e popujve dhe bashkësive etnike në Ballkan por edhe në madhësitë botërore me përvetësimin e Deklarimit Univerzal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, por edhe konventat ndërkombëtare e të tjera. Njerëzve ju është garantuar liria dhe identiteti, liria e fjalës, shtypi, publikimi, feja, bindjet politike dhe mbledhja. Pjesa më madhe e viseve Ballkanike ishin me organizim totalitar socialist, (përveç Greqia dhe Turqia të cilat janë shtete kapitaliste, por edhe për ata nuk mund të themi se ishin respektuar përfitimet e lartë përmendura njerëzore, civilizuese dhe demokratike) ashtu që liritë dhe të drejtat e njerëzve kanë qenë të kufizuara. Por, shkencën edhe nuk e ndjek kurdoherë politikën shtetërore, ashtu që në vitin 1955 Instituti etnografik me muze në kuadër të Akademisë Shkencore të Bullgarisë në Sofje, do të botoj një punim të mrekullueshëm të Anastas Primovskit nën titull “Kovaçite Agupti v grad Madan” (Farkëtarët Aguptë në qytetin Madan), ku autori mjaft kaotik në përfundimet e tij, na jep një dëshmi të mrekullueshme për ekzistimin dhe vetëdijen kolektive etnike të Aguptëve nga Madani, të cilët qartë distancohen nga Romët-Ciganët dhe thonë se prejardhja e tyre është nga Egjipti që prej kohës antike (sipas legjendës i ka sjellë Gaj Julie Cezar!).

Me ndryshimet e Kushtetutës së Jugosllavisë së atëhershme nga viti 1974, nenet 166 dhe 170 ju garantonin qytetarëve lirisht të deklarohen ashtu

siç ndihen, sipas vetëdijes së tyre. Pikërisht këtë garancione kushtetuese pjesëtarët e kësaj bashkësie nga Ohri, Struga, Resnja dhe qytetet e tjera të pjesës jugperëndimore të R. Maqedonisë, e përdornin gjatë deklarimit të tyre etnik në regjistrimet e popullatës nga viti 1981, të deklarohen si “Egjiptianë”.

Por numri i të deklaruarve “Egjiptianë” nga ky regjistrim asnjëherë bujshëm nuk është shpallur. Inteligjenca e kësaj bashkësie nga Ohri, Struga dhe Resnja organizoi peticion të cilin e dërguan në Institutin për statistikë dhe mjetet për informim publik, me qëllim që të shpallet numri i Egjiptianëve të deklaruar. Ky aksion mund të themi se është aksioni i parë i organizuar në historinë e Ballkano Egjiptianëve, me qëllim të qartë të definuar dhe preciz dhe mision për pranim dhe ruajtje të identitetit të vetë etnik. Përgjigjja e Institutit për statistikë ishte se ata që në regjistrimin e vitit 1981 ishin deklaruar si Egjiptianë janë të numëruar në grafën “të tjerë” ndërsa ata që janë deklaruar si Egjiptianë janë vendosur në grafën “të panjohur”. Pas kësaj plotësisht qartë ishte se për regjistrimin e ardhshëm të popullatës në vitin 1991 Egjiptianët do të duhet të luftojnë për grafë të tyre personale në listat regjistruese<sup>184</sup>.

Pas kësaj ngjarjeje, në gazetat e Jugosllavisë së atëhershme mund të gjenden numër i madh artikujsh dhe informata që e informojnë publikun për “paraqitjen e Egjiptianëve në Maqedoni dhe Jugosllavi”.

Egjiptianët nga Ohri, Struga dhe Resnja në 22 mars të vitit 1990 deri në parlamentin e atëhershëm të Jugosllavisë dorëzuan peticion prej 1681 qytetarësh, me kërkesë që të hapet grafë të veçanta regjistruese për “Egjiptianët” në listat regjistruese për regjistrimin në vitin 1991, ndërsa të autorizuar ti përfaqësojnë regjistruesit ishin Nazmi Arifi nga Struga dhe Usni Zemoski nga Ohri. Më pas peticionin e përmbajtën edhe 13 mijë Egjiptianë nga Kosova. Krejt rasti mbaroi me atë që Instituti Federativ për Statistikë me Materialin Metodologjik nr.367 për regjistrimin e vitit 1991 krijoi grafë “Egjiptianë”, për deklarim sipas përkatësisë etnike.

Në 24 qershor 1990 në Ohër u mbajt Kongresi Themelues i Shoqatës të Egjiptianëve të RSF të Jugosllavisë. Më atë filloi dhe procesi i organizimit shoqëror-politik i anëtarëve të kësaj bashkësie në Ballkan, dhe kërkimi i realizimit e të drejtave të tyre.

Në ditën e 21 tetorit viti 1990 edhe Egjiptianët nga Kosova e formojnë shoqatën e tyre. Përfaqësuesi i kësaj Shoqate Qerim Abazi, në vitin 1999 mori pjesë në konferencën ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje dhe Paris, për të zgjidhur problemin e Kosovës, si përfaqësues i Egjiptianëve. Nga viti 2000 në Kosovë është regjistruar parti politike e

---

<sup>184</sup> Më gjerësisht shiko: Ashuri/Zemon, 1996:9-85.



Egjiptianëve- Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) e cila sot kishte dhe ka deputetë në parlamentin e Kosovës.

Në vitin 1992 në Korçë, Republika e Shqipërisë, mbahet kuvendi themelues i Shoqatës së Egjiptianëve për Shqipërinë, por shteti nuk e regjistron atë nën atë emër. Më vonë regjistrohet Shoqata nën emrin “Kaba”. Por në vitin 1997 në 1 tetor regjistrohet Shoqata e Egjiptianëve për R.Shqipëri. “Nefreta”, nga Tërana, pas fitimit të kontestit pas procedimit gjyqësor me shtetin.

Në 8 maj 1998 në Beograd u regjistrua Shoqata e Egjiptianëve “Esnaf” për RF Jugosllavi, ndërsa sot në Serbi ekzistojnë më tepër OJQ edhe të kësaj bashkësie në Beograd. Sipas Ligjit për mbrojtjen e pakicave, Egjiptianët në Serbi, kanë të regjistruar Këshillin Kombëtar të Pakicës Kombëtare të Egjiptianëve.

Prej vitin 2010 në Mallin e Zi janë formuar disa shoqata Egjiptiane ku më aktive janë shoqatat Egjiptiane nga Tivati dhe Ulqini.

Në 26 shtator 1998 në Ohër mbahet edhe Kongresi i parë i Bashkësisë së Ballkano Egjiptianëve, ku sipas eksponimeve dhe vlerësimeve u tha se në gjithë Gadishullin Ballkanik jetojnë mbi 1 milion qytetarë të cilët i përkasin bashkësisë të Ballkano Egjiptianëve.

Gjithashtu Ballkano Egjiptianët në emigrim kanë më tepër organizata në vendet e Evropës Perëndimore.

Në 10 vitet e fundit prej organizatave ndërkombëtare siç janë Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, por dhe Stejt Departamenti i SHBA, si dhe të tjerët, janë publikuar raporte dhe dokumente të vlershme për gjendjen më të drejtat e njeriut dhe të drejtat minoritare të Egjiptianëve në Ballkan. Prej tyre duhet të theksohen raportet e EKRIIt (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe jo-tolerancës) dhe të Komitetit këshillëdhënës i Konventës Kuadër për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshilli të Evropës<sup>47</sup>.

---

<sup>47</sup> [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/countrybycountry\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/countrybycountry_en.asp);  
[http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3\\_FCNDdocs/Table\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNDdocs/Table_en.asp)

## GJUHA

Gjuha është një ndër indikatorët dhe kategoritë themelore, por jo edhe vendimtare për veçantinë e një bashkësie etnike. Sipas hulumtimeve gjuhësore, siç është për shembull rasti me Romët, mund të gjenden rrënjët e një populli ose bashkësie etnike.

Megjithatë, Ballkano Egjiptianët sot nuk kanë gjuhë të vetme të tyre. Ata si gjuhë amtare ose shtëpiake e flasin gjuhën e mesit ku jetojnë ose gjuhën e rrethinës prej ku kanë emigruar në ndonjë të kaluar më të afërt. Ashtu për shembull, Egjiptianët e Maqedonisë në qytetet Ohër, Strugë dhe Resnjë e flasin gjuhën shqipe, në dialektin toskë ndërsa ata nga Dibra dialektin gegë. Në Kërçovë, Prilep, Veles dhe një pjesë të Manastirit, Kumanovës, Koçanit, Kriva Pallankës flasin vetëm gjuhën maqedonase. Në pjesën tjetër të Manastirit, Gjevgjeli, Strumicë, Radovish, Berovë flasin gjuhën turke.

Në Bullgari Egjiptianët në Rodopet, përveç gjuhës bullgare flasin edhe gjuhën turke.

Në Serbi, para së gjithash në Beograd dhe Vojvodinë, Egjiptianët të cilët janë shpërngulur nga Maqedonia dhe Kosova flasin në gjuhën shqipe, ndërsa gjenerata më e re praktikon të flasë në gjuhën serbe.

Egjiptianët në Kosovë flasin në gjuhën shqipe në dialektin gegë, në Mal të Zi, flasin gjuhën shqipe dhe malezeze.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, pjesëtarët e kësaj bashkësie, nga tjerët të quajtur Ciganë të Bardhë flasin në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke.

Në Shqipëri Egjiptianët e njohin vetëm gjuhën shqipe, në dialektin toskë dhe gegë, varësisht nga ajo se a jetojnë në Shqipërinë jugore ose veriore.

Në Greqi, në pjesën jugore flasin në gjuhën greke, por ka edhe nga ata që flasin gjuhën turke (Turko Giftos). Në Maqedoninë e Egjeut dhe Thraki,

përveç gjuhës greke dhe turke, Egjiptianët flasin edhe në gjuhën maqedonase ose bullgare.

Ky fenomen në shkencë nuk është i panjohur, kur një bashkësi etnike si gjuhë amtare, kushtimisht thënë, e përdor gjuhën e një populli ose bashkësie tjetër, ose kur është e ndarë në më tepër grupe gjuhësore. Vetëm për shembull gjithë Çifutët nëpër gjithë botën nuk e flasin gjuhën e tyre hebreje, përkatësisht ekzistojnë më tepër grupe gjuhësore Çifute (Ashkenaz, Sefardin, Jidish në Gjermani, Evrejët etiope etj.). Gjithashtu, ekziston numër i madh popujsh dhe bashkësish që flasin gjuhën arabe, spanjolle ose angleze.

Ky fenomen gjuhësor, te Ballkano Egjiptianët mund të shpjegohet me faktin që ata jetonin dhe jetojnë jetë të stacionuar si minoritet etnik i rrethuar me mazhorancë tjetër etnike, nëpër qytetet ose fshatrat, ku kontaktet ndëretnike janë të drejtpërdrejta, ndërsa pasoja e saj është asimilimi gjuhësor, me pranimin e gjuhës së mazhorancës.

Megjithatë gjuha e bën edhe dallimin dhe kufirin më të madh midis Egjiptianëve dhe Romëve. Pikërisht, Romët si bashkësi nomade-endacake, e cila e urryer gati në gjithë botën, e ka ruajtur gjuhën e vetë që është më prejardhje indo-arike, kuptohet me dallime të përcaktuara në dialekt. Gjuha është një ndër elementet kryesore që i mban Romët me kusht e thënë në një bashkësi nëpër botë, si bashkësi etnike nomade-endacake. “...Gjuha Rome është libri i vetëm që Romët kanë marrë me vete nga India. Ajo paraqet të mbajturit mend kolektivisht dhe paraqet dëshmi për vetëdijen e këtij populli për botën, për vete dhe për të tjerët. Në të më fortë është ruajtur forma e kulturës të Romëve...”<sup>185</sup> Nga ana tjetër Ballkano Egjiptianët, nuk e flasin, nuk e njohin, por as edhe e kanë njohur ndonjëherë gjuhën rome, për çka dëshmi gjejmë edhe tek shumë hulumtues të ndryshme dhe udhëpërshkrues, të cituara në këtë punim.

Në kohën e fundit ka disa shkencëtarë që nëpërmjet hulumtimeve komparative gjuhësore zbulojnë indikacione për prezencë të komponentëve gjuhësore të lashta egjiptiane në disa gjuhë ballkanike. Para së gjithash këtu është shkencëtari italian Gjuzepe Katapano, i cili në vitin 1948 ka botuar studimin e tij filologjik “Tot-tot<sup>186</sup> flet shqip”. Libri i njëjtë përsëri u botua në vitin 1984, ndërsa në vitin 1996 autori përsëri u paraqit me qëndrime të ngjashme në librin “Shqiptarët-popull i ndarë” në koautorium me Nerim Vlora Falaschi dhe Skënder Rizaj. Në këtë botim dy vëllimor Katapano

<sup>185</sup> Trajko Petrovski, Romite od pratatkovinata do denes, Nova Makedonija, Shkup, qershor-korrik, 2000.

<sup>186</sup> Tot-zot i vjetër egjiptian i shkencës dhe letërsisë

paraqitet me vepër nën titull “Lashtësia e gjuhës shqipe”, si pjesë e studimit të tij “Faraoni-fara jonë”. Argumentet e tij se në gjuhën e vjetër egjiptiane ka shumë elemente, që mund të shihen në gjuhën e sotshme shqipe i sqaron me atë se në periudhë para 4000 vitesh popullata nga territori i Shqipërisë së sotshme është shpërngulur në Egjipt të Vjetër, për çka nuk ka përkrahje reale historike ose shkencore. Marsel Courtiade, këtë qëndrim të Kapatanos e komenton si fantazi, sepse interpretimi krijohet mbi bazë të gjuhës së sotshme shqipe, e nuk bëhet mbi bazë të Gurit nga Rozeta me çka rrjedh se Shampilion ka qenë plotësisht i gabueshëm në deshifrimin e letrës të vjetër egjiptiane (**Courthiade, M.** 2003-2004: 4). Indikacione të ngjashme të tilla (ose nebuloza) për prezencë të elementeve të vjetra egjiptijane mund të ndjehen edhe tek autorë që hulumtojnë gjuhë të tjera ballkanike, si p.sh. tek Ollga Llukoviq-Pjanoviq, Tashko Bellçevdhe Risto Ivanoski (**Луковић-Пјановић, О.** 1993-1994; **Белчев, Т.** 1992; **Иваноски, Р.** 2000).

Marsel Courtiade ka vërejtur midis Egjiptianëve nga Shqipëria një kuriozitet, e ai është shprehja që përdorin **aspi çoçe** (hesht dëgjojmë) që sipas atij mund të afrohet gjuhës Kopte “aspe”-gjuhë dhe “gjogje”-i huaj, armik (**Courthiade, M.** 2003-2004: 6)..

Megjithatë që të fitohet fotografi më e qartë për problemin e gjuhës së Egjiptianëve, i nevojshëm është hulumtim shkencor me detal linguistik.



## **KULTURA MATERIALE E BALLKANO EGJIPTIANËVE**

### **PROFESIONET**

Ballkano Egjiptianët kanë disa profesione karakteristike tradicionale, që janë pjesë e etno-kulturës së tyre, dhe me çka e kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të kulturës dhe civilizimit në Gadishullin Ballkanik.

#### **Zanati i farkëtarisë dhe përpunimi i metalit**

Profesioni kryesor tradicional i numrit të madh të Egjiptianëve ka qenë përpunimi i metalit dhe zanati i farkëtarisë. Për atë se Ballkano Egjiptianët janë marrë me përpunimin e metalit që prej kohës më të lashtë marrim vesh nga Herodoti, i cili thotë se eksploatimin e xehes së arit, në Heladë, e kanë kryer kolonizatorët egjiptian (**Константинов, М.** 1992: 317). Meqë në pjesën historike, flisnim për ekspeditën pushtuese të faraonit Ramzes II, që ka qenë me qëllim që ti eksploatojë xeheroret e pasura me metal në Ballkan, krejtësisht është e qartë se kolonizatorët Egjiptian të cilët kanë ardhur më këtë ekspeditë pushtuese, në pjesë më të madhe kanë qenë punëtor, të cilët kanë ditur të punojnë me eksploatimin dhe përpunimin e metalit. Meqë koha e Ramzes II përputhet me periudhën e fillimit të përdorimit masiv të hekurit si zëvendësim i bronzës, me siguri përveç arit domethënie të madhe për shtetin e atëhershëm faraonas Egjiptian ka qenë edhe eksploatimi i përdorimit të hekurit (**Монтер, П.** 1946/1989: 139; **Бакс, К.** 1986: 227-228).

Për përpunimin e metaleve dhe sidomos për zanatin e farkëtarisë në Gadishullin Ballkanik ekziston material i vogël bibliografik. Paraqitja e metaleve paraqet një ndër periudhat më shqetësuese në historinë e njeriut. Në fillimin e mileniumit të dytë p.e.r., në periudhën e neolitit në kohën e hekurit (enolit) njerëzit tërësisht e kanë mësuar mënyrën e fitimit dhe përpunimin e metaleve. Më së pari është filluar me përdorimin e arit dhe bakrit të cilin lehtë është shkruar dhe ka qenë i butë për përpunim. Faktikisht epoka e metaleve fillon me shkruarjen e bakrit (enolitit) dhe mandej evoluon në kohë të bronzës (halkolit) dhe kah fundi i mileniumit të dytë p.e.r. fillon koha e hekurit (halshtat)

Një nga shkaqet kryesore që njeriut i është e nevojshme kohë më e gjatë që të mësoj ta përdor metalin është vështirësia gjatë zbulimit të tij. Përveç, arit dhe bakrit, metali në natyrë nuk paraqitet gati i pastër, por si pjesë përbërëse e xehes, kryesisht në komponim me oksigjenin dhe squfurin, të cilët duhet të shtrihen në procese tepër të mëdha që të ndahet metali. Për atë e kuptueshme është se pikërisht ari dhe bakri bëjnë pjesë midis metaleve të vjetra me të cilat njeriu është marrë (**Birget-Smith, K. 1960**).

Nuk dihet shumë se kur dhe si për herë të parë ka filluar të shkruhet bakri, por gjithsesi është zbuluar se nuk është e domosdoshme të kërkohet vetëm bakër i pastër, por metali mund të fitohet edhe nga xehja. Këtu ndodhemi para kthesës vendimtare, sepse pikërisht këtu ka filluar mundësia për përdorim të metalit në stil më të përparuar. Përveç sobës të vogël lëvizëse të argjilte, gypat për të fryrë dhe darëve nuk kanë qenë të nevojshme gjëra të tjera-çdo gur i volitshëm ka mundur të përdoret si çekiç, ndërsa tjetër për kudhër. Me mjete të tjera të thjeshta kanë shkruar Egjiptianët e Vjetër, si edhe Indianët në Meksikë dhe Peru. Derdhja kryhet proporcionalisht lehtë, ndërsa janë prodhuar vetëm kundrina të thjeshta (**Birget-Smith, K. 1960**).

Procedurë shumë më të komplikuar takojmë në Mesopotami në kohën më të lashtë Sumere. Këtu kundrina së pari është formësuar në dyllë, mandej është mbështjellë më mbështjellëse të argjilte, ndërsa kur bërthama e dyllit do të ishte shkruar ka mbetur vetëm shprazëti, që është mbushur me metal të shkruar. Që të lirohet kundrina e gatshme, e nevojshme ka qenë të thyhet kallëpi, ashtu që ai ka mundur të përdoret vetëm njëherë (**Birget-Smith, K. 1960**).

Bakri në skenën historike ka depërtuar nga vetë koha e gurit, hap pas hapi. Guri në sasi të madhe ende është përdorur njëkohshëm me bakrin, ashtu që nuk mundet çdoherë të bëhet kufizim i qartë midis kohës historike të gurit dhe bakrit. Megjithatë, edhe me bronzin që është zbuluar mjaft

herët, fillon koha e vërtetë e metalit, edhe pse atëherë guri dhe bakri edhe më tej janë përdorur (**Birget-Smith, K.** 1960).

Bronza fitohet me përzierje të bakrit dhe 10-12% zink, që është më i fortë se bakri i pastër. Nevoja për përdorimin e bronzës shpjegohet me atë që ajo më lehtë derdhet, sepse shkrihet gati në 900 grad celzius, përkundër bakrit i cili shkrihet në 1083 gradë.

Koha e bronzës ka filluar në kohën e lulëzimit të civilizimeve të vjetra, siç kanë qenë Vaviloni dhe Egjipti (**Scheel, B.** 1989: 14; **Бакс, К.** 1986: 79-87). Derdhja e bakrit dhe bronzës në kohën e sotshme mund të takohet edhe në Kinë, tek Inkët dhe Majët e kontinentit Amerikan.

Bronza është metal i çmuar dhe fisnik, me çka është paraqitur nevoja për metal me çmim më të lirë e ajo ka mundur të arrihet me përdorimin e hekurit, mundësia deri tek i cili në disa vende të tokës është e lehtë. Hekuri edhe e bëri metalin të jetë pronë e çdo njeriu dhe plotësisht e shtypi nga përdorimi veglën e gurit, që në kohën e bronzës ende përdoj. Hekuri pa asnjë lloj vështirësisë është bërë metal i Botës dhe Oqeanit para sh.XV (**Birget-Smith, K.** 1960).

Çudi është se si hekuri paraqitet aq vonë në historinë e njerëzve. Hekuri nuk është vetëm më i shpërndarë por edhe më lehtë fitohet nga bronza. Gjurma më e vjetër e hekurit të përpunuar është e lashtë si edhe njohja e bakrit, por këtu çdoherë është punuar për hekur meteorik, e jo për metal të përpunuar. Vegla më e vjetër e hekurit që e njohim është sëpatë nga rreth 1400 vitesh p.e.r. që është gjetur në qytetin e sotshëm të Sirisë, Ras Shama ose Ugarit në shekullin e Vjetër. Në Egjipt ajo ndoshta më vonë. Megjithatë, dëshmitë më të vjetra tregojnë se Azia e Vogël është atdheu i hekurit. Për këtë dëshmojnë traditat hebreje dhe heliniste. Tubat-kain, farkëtari i parë në Bibël, është stërbabai mitik i fisit të cilën helinët e kanë thirrur Tibarenas, ndërsa të cilët në realitet kanë jetuar në bregun verior të Azisë së Vogël. Nga përëndimi i Tibarenasve kanë jetuar Halbinjët, të cilin emër e gjejmë në fjalën helinase për çelik. Krejt kjo tregon se Azia e Vogël ka qenë toka e parë ku është fituar hekuri dhe që koha e atij zbulimi bien diku në mesin e mileniumit të II p.r.e. (**Birget-Smith, K.** 1960).

Procedura gjatë shkrirjes së hekurit domosdo në fillim është dashur të jetë shumë e thjeshtë. Në kohën e lashtë të hekurit në Danskë të sotshme, hekuri është shkrirë me qymyrin limonit në gropa të hapura dhe të cekëta me ndihmë qymyrduri, mandej është hequr balta, ndërsa kokrrat e metalta i kanë salduar-ngjitur me farkim. Edhe në kohën e re të hekurit janë përdorur gropa në formë lundre të mbushura me argjilë. Në Afrikë koftore të ngjashme të argjilit ndërtohen mbi tokë. Në Tanganjikë ato janë të gjata 3m. dhe mbushen me xehe të copëtuara dhe me qymyr druri. Lëndët e shkrira



mandej janë vendosur në enë më të vogla për shkrirje, ku është veçuar teprica e qymyrit. Në Azinë perëndimore dhe jugore koftoret e tilla kanë qënë gjithashtu të zakonshme (**Birget-Smith, K.** 1960).

Që të zmadhohet fortësia dhe ngurtësia e hekurit, në kohërat e lashta është zbuluar se me goditje me çekiç metali mund të hapet, mandej të lakohet dhe ajo procedurë të përsëritet më tepër herë. Në veglën primitive, që e kanë njohur nga teknika për bakrin, u shtua kaceku, në vend të gypave të thjeshta për të fryrje. Në Azinë lindore dhe Sudan ai përbëhet nga dy torba lëkure, të cilat reciprokisht shtypen dhe të cilat kanë gyp të përbashkët për dalje. Tipi i njëjtë takohet edhe në Azinë perëndimore dhe në atë qendrore, e në një lloj ndryshe edhe në Sibir. Përhapja tregon se kaceku kryesisht është i lidhur me teknikën e hekurit, por në Egjipt e kanë njohur që nga sh.XVI p.e.r. d.m.th. para kohës së hekurit. Në Azinë jugore dhe lindore takohen edhe kacekë të cilët përbëhen nga kallame çift vertikale dhe horizontale, si p.sh. bambus, me lëfyte të lëvizshme (**Birget-Smith, K.** 1960).

Meqë Azia e vogël, Gadishulli Ballkanik, Gadishulli Pirinej dhe Apenin janë rajone me pasuri tepër të madhe xehesh, popujt e lashtë që kanë jetuar në këto rajone, me siguri i kanë shfrytëzuar pasurit xeherore për përpunim dhe përdorim të metaleve, sidomos bakrin, bronzën dhe hekurin (**Бакс, К.** 1986: 224-225). Për atë se a ka ekzistuar ndonjë mënyrë e veçantë e përdorimit dhe përpunimit të metalit, në periudhën e enolitit në këto vise, nuk disponohet me të dhëna historike ose të tjera. Sipas disa të dhënash dihet se disa fise Ilire dhe Thrakijase nga lumejt e shumtë të Gadishullit Ballkanik kanë nxjerrë rërë të argjiltë, ari dhe hekuri (**Дробњаковић, Б.** 1960: 34).

Duke e parë nevojën për përdorim sa më të madh të metalit, e sidomos të hekurit, faraoni Egjiptian Seti I, zhvillon dhe dërgon më tepër ekspedita hulumtuese, për të fituar të dhëna për mundësi të eksploatimit të metalit, në Azi të Vogël, Ballkan dhe rajone të tjera veriore-mediterane (**Монтет, П.** 1946/ 1989: 139). Duke i pasur njohuritë për pasuritë xeherore me metal, djali i faraonit Seti I, Ramzes II, jepet në pushtim të Mediteranit lindor, në luftë e mandej në bashkim me Hetitet, ndërsa mandej hyn dhe e kolonizon Gadishullin Ballkanik, sidomos në rajonet e pasura me xehe (**Zigler, Ch.** 2002: 45-69). Herodoti na informon edhe se Koltët që kanë qënë në Azi të Vogël, nëpër rrjedhën e lumit Fasis, janë Egjiptianë të sjellë nga Sesotriti d.m.th. Ramzes II (**Херодот II,** 1986: 139-140). Meqë Azia e Vogël, e posaçërisht rajonet në afërsi të Kaukazit janë rajone me pasuri tepër të madhe xehesh, teza jonë se Ramzes II, ka kolonizuar Egjiptianë enkas për

nevojat për eksploatim të pasurisë xeherore dhe përpunim të metalit, kompletohet.

Sipas kësaj, mund të thuhet se nga periudha e ashtuquajtur arkaike në Ballkan çdo kund ku ndodhen xeherore për metal, si edhe ku ka nevojë për përdorim përkatësisht shfrytëzim të metalit, me siguri të madhe mund të supozohet popullatë me prejardhje Egjiptiane, për çka indikacione gjejmë tek numër i madh autorësh, të cilët flasin për eksploatim dhe tregti me pasuritë xeherore dhe metalin në Ballkan (**Lisičar, P.** 1953).

Për praninë e kolonive me njerëz dhe familje të cilët e kanë përpunuar metalin, mund të dëshmojnë edhe shumë toponime të cilat janë të afërta ose të nxjerra nga emri farkëtar, ndërsa të cilat janë të datuara si lokalitete arkeologjike nga periudhat më të lashta, duke filluar nga neoliti, koha antike dhe mes shekulli, nga të cilët disa i përdorëm në pjesën e përgjithshme për etnonimet dhe toponimet.

Një ndër të parat arte-fakte arkeologjike për përpunimin dhe shfrytëzimin e metalit është zbulimi i njohur si “Farkëtari nga Vranishta” (**Popović, L.** 1975: 40) nga fundi i sh.VIII dhe fillimi i sh. VII p.e.r. i zbuluar në afërsi të Bella Pallankës të sotshme, nëpër rrjedhën e poshtme të lumit Nishavë, dhe derdhjen e lumit Moravë.

Në shekullin IV p.e.r. me hyrjen dhe pushtimet e Keltëve nga Perëndimi, në Gadishullin Ballkanik, të cilët kanë prekur deri në Azi të Vogël në lindje, si bartës së kulturës latine, bëhet revolucioni i përpunimit dhe përdorimit e hekurit. Keltët bartin drejtime të reja kulturore dhe ju'a imponojnë popujve të tjerë, sidomos armë të hekurit, me shpata të gjata dhe fibula karakteristike. Keltët arritën që nëpërmjet pushtimeve të tyre të vendosen në Ballkan, por edhe vetë të themelojnë institucione të tyre shtetërore. Mundet vetëm të parandjehet, a ka pasur dhe sa e fuqishme ka qenë ndeshja e kulturës që e kanë sjellë Keltët me kulturën e popullatës autoktone të cilët e kanë përpunuar dhe përdorur metalin, midis të cilëve marrin pjesë edhe Ballkano Egjiptianët sepse për atë nuk kemi të dhëna, por as edhe studime të veçanta.

Me rënien e Gadishullit Ballkanik nën Perandorinë romake, përpunimi dhe shfrytëzimi i metalit, posaçërisht hekurit marrin domethënie edhe më të madhe. Më tepër është zhvilluar bujqësia për llogari të blegtorisë, për çka i domosdoshëm ka qenë përpunimi masiv i veglave të bujqësisë nga hekuri. Ushtarëve legjionarë sipas meritës ju janë dhënë sipërfaqe tepër të mëdha bujqësore për përpunim dhe shfrytëzim. Xehetaria, gjithashtu është zhvilluar, dhe luante rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë romake. Me xehetarinë ka udhëhequr i ashtuquajtur “procurator metallorum”. Një ndër qendrat e xeheroreve të arit dhe plumbit ka qenë Domavija (tek

Srebrenica), ndërsa xeherore të tilla ka pasur në disa vende nëpër Ballkan (**Георгиев, Г.** 1953: 21). Hekuri masivisht është nxjerrë nga Bosnja, mandej në rrethinën e Novi Pazarit të sotshëm, Rameziane (Pallanka e Bardhë e sotshme), në Maqedoni, në Rodopet etj. Vëmendje e madhe ishte kushtuar komunikacionit. Ata kanë qenë të shtruar me pllaka, të matura dhe të shënuara me mbishkrime dhe miljotregues. Mbi lumenjtë kanë qenë të ngritura edhe ura guri. Në rrugët kanë ekzistuar edhe “mansiones” stacione të mëdha dhe në të cilat është mundur të merret ushqim dhe të kalohet nata dhe stacione të vogla “mutationes” për ndërrimin e kuajve. Edhe zanatçinjtë nëpër qytetet filluan të organizohen në shitore-esnafe (**Дробњаковић, Б.** 1960: 38).

Të gjithë këta faktorë të përmendur, kanë ndikuar mjaft pozitivisht për zhvillimin e përpunimit dhe përdorimit të metaleve, sidomos të hekurit, me çka në masë të madhe është zhvilluar edhe zanati i farkëtarisë, posaçërisht për nevojat e bujqësisë dhe për shërbim të udhëtarëve të cilët kanë udhëtuar nëpër komunikacionet e gjata romake, për riparimin e mjeteve të dëmtuara për udhëtim dhe mbathen e kuajve. Kur flasim për farkëtarët në periudhën e Perandorisë romake, Anastas Primovski tek farkëtarët Aguptë në Rodopet e Bullgarisë, ka vërejtur edhe disa tradita të tyre të cilat flasin se ata janë të sjellë si robër nga Romakët dhe si farkëtarë nga Egjipti (**Примовски, А.** 1955: 248-249).

Me shkatërrimin e Perandorisë romake, dhe themelimin e Mbretërisë Bizante, me çka në Ballkan instalohet sistemi shoqëror feudal, i cili sistem me ndryshime të vogla është i pranishëm edhe në shtetet të tjera messhekullore në Ballkan (Mbretëria Bullgare, e Samoilit, e Dushanit etj.) posedimi tokësor dhe bujkrobëria e fshatarëve është baza e ekonomisë (**Острогорски, Г.** 1969). Në sistem të tillë, rolin kryesor në ekonominë e ka bujqësia, e me të veglat bujqësore janë mjete kryesore për punë. Sipas kësaj, përpunimi i metalit, e sidomos zanati i farkëtarisë, janë një ndër profesionet elementare shërbyese, në secilin shtet messhekullor. Për domethënien e zanatit të farkëtarisë mund të na flasë edhe fjala e urtë “Pa kmet mundet, por pa farkëtar nuk mundet” (**Тенева, Н.** 2003: 69)..

*Rasti i njëjtë, është edhe gjatë* kohës së qeverisjes të Perandorisë Osmane, ku farkëtarët gjithashtu ishin të trajtuar si bujkrobër përkatësisht si raja, pa dallim a kanë punuar nëpër fshatrat ose nëpër qytetet (**Матковски, Н.** 1978: 26).

Me ardhjen e Osmanlive ose diçka para saj, në Ballkan hyjnë Ciganët-Romët, kryesisht si bashkësi nomade-endacake. Me siguri, për shkak të nevojës për integrim në shoqërinë dhe për prestigj më të madh shoqëror, identifikohen me Egjiptianët, dhe në disa raste e punojnë edhe zahnatin e

farkëtarisë. Në historinë dhe literaturën tjetër thuhet se zanati i farkëtarisë është zanat Cigan/Romë, që paraqet non-sens shkencor të vetëllojshëm, sepse nuk mundet një zahnat i cili kërkon stacionim të jetë karakteristik i një bashkësie nomade-endacake. Por, ekzistojnë edhe autorë (**Courthiade, M.** 2003-2004: 8), të cilët bëjnë dallime dhe kufij etnikë në atë se si e punojnë zanatin e farkëtarisë Ballkano Egjiptianët, e si Romët, me atë që thonë se Egjiptianët në kurdhë punojnë punë farkëtarie më të rënda duke qëndruar në këmbë, ndërsa Romët në kurdhë punojnë prej ulur në tokë me këmbë të kryqëzuara, duke punuar punë më të lehta.

Punëtorja farkëtare në Ballkan paraqet punëtore të thjeshtë, më shpesh e ndërtuar me plit të përlyer (në Madan është quajtur ”çatmo”, e mbuluar me tallpa, me teneqe-limë, dërrasa ose pllaka guri (tikla në Madan). Dimensionet e një punëtore farkëtarie, zakonisht janë me gjerësi prej 2 deri 4 metra dhe gjatësi prej 4 deri 6 metra. Punëtoritë nuk kanë tavan përveç çatisë. Në farkëtaritë më të shumta të Ballkanit në afërsi të derës ka edhe dritare d.m.th hapje me baxh. Dritaret asnjëherë nuk kanë xhame, por edhe nuk janë adekuate për to dhe mbyllen me baxhe druri.

Farkëtarja (kovaçilnica në maqedonisht dhe kuzne tek farkëtarët në Rodopet e Bullgarisë) tek Ballkano Egjiptianët, kryesisht përbëhet nga vatër, oxhak, kacek, gotatë me ujë dhe kurdhë.

Për vatrën rrëmohet dheu dhe bëhen mure në lartësi prej 50 deri 60 cm, si edhe bazë në formë katrori me dimensione 50x60 cm. Në murin e vatrës është shpuar vrimë që të mund të vendoset gypi i kacekut.

Kacekun farkëtarët në Maqedoni e kanë quajtur edhe mev (duvallo), ata të Bullgarisë kjo rrykë. Ka shërbyer për fryrjen e vatrës me çka është ndezur zjarri dhe është rritur temperatura që të nxehet hekuri. Disa e kanë përpunuar vetë ndërsa disa e kanë blerë. Kaceku bëhet nga lëkurë delesh ose lopësh dhe druri, në atë mënyrë që është i ndarë në dy gjysmë (dy kacekë) me një dërrasë që në mes ka vrimë, ndërsa gypi për të fryrë është në gjysmën e sipërme. Në kacekun e poshtëm ka dërrasë në të cilën ka vrimë me ndërprerës prej 5-10 cm për hyrjen e ajrit dhe kur me ndihmën e dorezës do të mbushet kaceku i lartë, ai menjëherë del nëpër gypin dhe kaceku zvogëlon nën shtypjen e rëndësisë të dërrasës që është në kacekun e sipër, e mandej përsëri kaceku mbushet me dorezën etj. Vrimat e dërrasë të poshtme dhe të mesme janë të mbuluara me lëkurë me ndërprerës më të madh nga vrimat dhe shërbejnë si pranues, ndalës të ajrit, që të mos kthehet teposhtë. Në fund të gypit ka inkë të metalt, e cila nën ndikim të temperaturës që krojet në vatrën, dëmtohet dhe zëvendësohet më të re. Sot midis farkëtarëve vështirë mund të gjehet kacek, sepse zjarri ndizet me ventilator që punon me rrymë elektrike.

Govata me ujë, është në afërsi të vatrës, shërben për uljen e temperaturës të hekurit të farkuar. Nga gjatësia është e njëjtë me vatrën dhe ka gjerësi rreth 30cm.

Kurdhën farkëtarët në Maqedoni e quajnë edhe “tezgav”, në gjuhën turke “jorz” tek farkëtarët nga Madani. Vendoset në trung prej gështenje të shpuar nga më parë. Bëhet prej çeliku, por tani të gjithë kanë kurdha të punuara fabrikisht. Ata mund të rëndojnë prej 35-70kg. Kurdhat më parë janë farkuar, ndërsa të njohura kanë qenë kurdhat e farkuara nga Drama, të cilat kanë qenë edhe më të rënda (Примовски, А. 1955: 226).

Veglat gjithashtu farkëtarët i kanë përpunuar vetë, ndërsa në kohën më të re prodhohen edhe fabrikisht.

Çekiça ka të më shumë llojshëm, varësisht nga ajo se për çka përdoren, dhe atë: çekiç i madh me të cilin godet çiraku (tokmak), çekiç i vogël me të cilin punon mjeshtri (çekiç); shpuese për bërje vrimash; teskë me sëpatë; gozhdë bërjen e gushores (fytyrë) e sëpatës; çekiç me të cilin kundërina mund të zhvendoset pa asistim; arës etj.

Darë gjithashtu ka më shumë llojshmëri, varësisht nga ajo se për çka përdoren dhe madhësia e metalit që përpunohet, por kryesisht dallohen tre lloje: darë të drejta, për përdorim të thjeshtë; darë të shtrembra, për farkimin e shatit; dhe zibeskë, për të kapur material për të shpuar.

Gërshtë për prerje hekuri. Edhe këto vegla mjeshtrit i krijojnë vetë, prej çeliku, të gjata deri 35cm, të gjëra deri 5cm. Mjete të tjera të cilat mund të takohen janë gozhdarë, kallëp për gozhdë (fillafçe në Bullgari), ose shuajtëse (spërkatëse)-për spërkatje me ujë e përbërë prej doreze të hekurt dhe kashte, lima (turpia, durbia) që mund të jenë të vrazhdta dhe të imta, gur për sprefje, kurdh i vogël (jors i vogël) për tu rënë gozhdave, prerëse për gozhdë etj.

Qymyr-drurin disa farkëtarë, nëpër krahinat e Ballkanit e kanë prodhuar vetë, prej dru gështenje të cilin e kanë prerë nga ndonjë vend që nuk e ka zënë dielli. Drurin e kanë prerë në pjesë, të cilat i kanë vendosur në një gropë, ku janë djegur afër 2 orë, e mandej i kanë shuajtur me ujë. Nga kjo mjeshtri Egjiptianët nga Kosova dhe Fusha e Kosovës e kanë marrë edhe emrin Ashkalinj (qymyrxhi).

Më parë si prodhime më të kërkuara farkëtarie kanë qenë veglat e bujqësisë, dhe atë kazma, shati, lopata, lemezh, dikel, plug, saçët, *draprit* etj. dhe kanë qenë prodhime të gatshme për shitje, ashtu që myshteriu aspak nuk ka pritur që të punohet prodhimi. Megjithatë, me zhvillimin e *industrializimit* bujqit pjesën më të madhe të veglave e blejnë në përpunim fabrikor, e ajo që nuk prodhohet plotësohet me prodhim farkëtarie. Sot farkëtarët, punojnë sipas porosive dhe atë më shpesh sëpata, plugje, brana

dhe lemezhi. Ajo që mund të vërehet si përpunim “serik” janë potkuat (potkovici, potkojv, nalçi) të kuajve dhe të gomarëve, mashat dhe lopatat.

Për mënyrën e përpunimit të sendeve mund të thuhet se për përpunim të *ndonjë prodhimi farkëtarie me të vërtetë* duhet të posedohet shkathtësi e madhe, *përvojë, forcë dhe durim. Mjeshtri* varur nga sendi që duhet të përpunohet, zgjedh pjesë të përshtatshme prej hekuri të vjetër, e vendos në vatër që të nxehet deri në skuqje dhe mandej e vendos *në kurdhë, e farkon dhe e formëson* hekurin derisa ai është i nxehtë dhe i skuqur. Kur hekuri ftohet deri në atë masë që më nuk mund ta ndryshoj formën, përsëri e kthen në vatër që të nxehet, dhe krejt procedura përsëritet derisa të fitohet forma e dëshiruar. Për punimin e sëpatave, kazmave dhe prodhime të *ngjashme*, tek të cilat duhet të bëhet gushore (fyt) për vënien e dorezave prej druri, pasi arrihet forma e dëshiruar, hekurit i hapet vrimë me çekiça special ose me kallëpe për atë kushtim, varur nga trashësia. Kur përpunohet sëpata, më saktë pjesa e buzës që duhet ti çaj drutë, e nevojshme është shkathtësi dhe përvojë e madhe që në momentin e vërtetë të ndalohej me farkimin dhe hekuri të vendoset në ujë që të ftohet, ndërsa edhe aty nuk duhet të qëndroj gjatë ndaj duhet edhe në momentin e vërtetë të nxirret nga uji, ashtu që buza e hollë dhe e mprehtë të mos plas, e mban në të thatë derisa hakuri ta fitoj ngjyrën e nevojshme të *përhimët*, e mandej përsëri e kthen në ujë që plotësisht të ftohet.

Më parë zierja e dy pjesësh prej hekuri është kryer në këtë mënyrë. Dy pjesët prej hekuri vendosen në vatër dhe nxehen derisa ta fitojnë *nuançën* e skuqshme të bardhë të nevojshme, dhe ju hidhet pak rërë e imët prej gëlqere, dhe mandej të dy pjesët farkohen të bashkuara. Në atë mënyrë janë bashkuar dy hekura. Sot bashkimi i dy pjesësh prej hekuri krijohet me shvajz-aparat.

*“Mësimi i zanatit të farkëtarisë, prej kobësh të lashta, ka qenë i kushtëzuar me doke të caktuara tradicionale. Ashtu, çiraku ka qenë i obliguar kur për herë të parë ka ardhur ta mësoj zanatin e farkëtarisë, që ta puth dorën dhe këmbën e mjeshtrit, si dhe kacakët, dhe në to të betohet se nuk do ta braktis zanatin e farkëtarisë...”* (Вукановић, Т. 1983: 169).

*Mësimi i këtij zanati ka qenë i gjatë dhe i mundimshëm, i cili ka zgjatur 10-15 vjetë. “...Atëherë është fituar e drejtë për kallfë (punëtor i kualifikuar). Provimi praktik është dhënë para mjeshtrëve dhe ustabashisë, ndërsa ai gojor para aubabës. Kur çiraku e ka dhënë provimin, aubaba (personi ofical, i cili ka ardhur nga Carigradi) i ka dhënë dokument të posaçëm (destur). Kallfa i ri në atë rast aubabës i ka dhënë bofshë, ndërsa anëtarëve të komisionit jua ka puthur dorën... ..Mjeshtër farkëtarie ka mundur të bëhet ai kallfë i cili i ka mbushur 30vjetë jete. Për mjeshtrë, kallfa gjithashtu*

është dashur që të jap provim, ndërsa dhënia e atij provimi është kryer rreth Sh.Ilija (2 gusht). Mjeshtri i ri ka marrë diplomë, ndërsa përveç asaj edhe *kacek farkëtarie që ka qenë shenjë se mund të hap punëtori të pavarur farkëtarie*. Në Prizren, Prishtinë, Gjakovë dhe Gjiilan, ai provim është para “shehut” i cili ka ardhur nga Konija, Azia e Vogël. Ai mjeshtrit të ri i ka veshur *skutinë, me çka ka hyrë në radhën e mjeshtërve*” (Вукановић, Т. 1983: 170).

Nga farkëtarët e sotshëm shumë rrallë mund të gjendet ndonjë që di të tregoj për doket *gjatë pranimit të çirakut në zanatin e farkëtarisë, si edhe për mënyrën e dhënies të provimit për kallfë dhe mjeshtër, në të kaluarën më të largët*. Farkëtar i Ibrahim Sulejman-Kapush<sup>221</sup>, i cili gjatë kohë pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë edhe anëtar i komisionit për dhënien e provimeve të çirakëve dhe mjeshtërve, pranë komunës të Komorës të zahnatlive në Dibër, thotë: “Çiraku së pari mësohet ta mbaj *farkëtarinë të pastër dhe e njoftojmë me masat që duhet ti marrë për sigurimin e tij personal, ashtu që nuk do të lëndoj gisht ose dorë, të mos digjet, si dhe për sigurinë e personave të tjerë, sepse në farkëtarë punohet me zjarr*. Mandej e mësojmë për shenjat tona gjatë punës, e ata janë nëse unë bie dy herë shkurtër në kurdhën-të vij të godas me tokmakun, ndërsa nëse njëherë bie në kurdhën-të largohet. Pas tre vjet punë çiraku jep *provim për kallfë në Komorën e zanatlive*. Kallfa tre vjet e punon me rrogë te mjeshtri, ndërsa mandej ka mundur të shkoj të jap provim në Ohër”.

Esnafet farkëtarë janë themeluar në gjithë qytetet ku ka pasur më tepër mjeshtër. Në krye të esnafit ka qëndruar ustabashija. Esnafet farkëtarë janë kujdesur për interesat e farkëtarëve para qeverive, si edhe për rregullimin e marrëdhënieve midis farkëtarëve. Sot, askush nuk di të tregoj asgjë për esnafin farkëtar, ndërsa kuptimi “Esnaf” midis disa Ballkano Egjiptianësh në Maqedoni, Kosovë përdoret edhe si identifikim etnik.

Në disa vise Ballkanike, është praktikuar farkëtarët të bëjnë pazar me myshterinjtë prej Shëngjergji deri në Shënmitër, dhe munda i tyre të jetë i paguar me *drithtë* dhe prodhime të tjera bujqësore (Миџрески, П. 1983: 91).

Me zhvillimin e industrializimit zanati i farkëtarisë e humb pozitën dominuese si zanat i strumbullar për përpunimin dhe përdorimin e hekurit. Veglat e bujqësisë si dhe mjetet e tjera, prodhohen nëpër fabrika, ndërsa prodhimet e hekurit blihen në treg. Për atë shkak edhe vdes zanati i farkëtarisë ngadalë por me siguri. Sot mund të gjenden një deri në dy farkëtarë në ndonjë qytet ose fshat nëpër Ballkan, të cilët kryesisht i ndreqin prodhimet e blera bujqësore të dëmtuara dhe prodhime të tjera prej metali.

<sup>221</sup> Hulumtime terrenore në Dibër, në vitin 1997.

Pasardhësit e farkëtarëve të cilët më parë zanatin e trashëgonin prej një brezi në brez tjetër, sot merren me zanate të tjera të cilat përsëri lëndë të përpunimit kanë metalin dhe hekurin: bravandreqës, makinë-bravandreqës, ujë instalues, automekanik, teneqepunues etj. por edhe me zanate të tjera të cilat nuk kanë të bëjnë me metalin si: elektrikist, xhamxhi, rrobaqepës, floktarë etj.

## **Bujqësi**

Zanat i përfaqësuar i dyti me radhë te Ballkano Egjiptianët është bujqësia. Gati gjithë Ballkano Egjiptianët janë marrë me bujqësi, e sidomos ata nga Kosova. Edhe farkëtarët, si profesion alternativ e kanë pasur bujqësinë me qëllim që ti plotësojnë nevojat e tyre familjare. Numri më i madh kanë pasur prona të tyre personale, ndërsa disa kanë punuar edhe si argat në prona tjera.

Nga Vasil Kënçov kuptojmë se pjesë e madhe, si thotë ai, “popullatë cigane” nga Maqedonia qendrore dhe jugore është çifligare, me arsyetim se bejët Turq e kanë detyruar këtë popull endacak që të punojnë në pronat e tyre! Gjithashtu ai përmend “ciganë” nëpër çifligjet e Enigje liqenit të Vardarit dhe ishullin e tij Kara Azmak (çifligjet Përgos, Çashulievo, Vërbeni), mandej rreth liqenit Amatovë në rrethinën e Kukushit, mandej në rajonin e Dermës, rreth liqenit Tahino, Gjolit Berektli dhe rreth grykës së lumit Mesta, mandej në rrethin e Strumicës, Fushën e Shkupit, në disa çifligje të Kumanovës etj. Kuptohet se termi i Kënçovit “ciganë”, duhet të pranohet me rezervë të madhe, sepse ai nuk kishte mundësi të krijoj kufijtë etnik midis Egjiptëve dhe Ciganëve, ndërsa në pjesën më të madhe të vendeve që i cek (si Strumicën dhe rrethin, Kumanovë dhe rrethin dhe Fushë Shkup) deri sot jetojnë Egjiptë bujq, me vetëdije të pazgjuar etnike, por nuk deklarohen si Romë, por si Turq, Maqedonas ose Shqiptarë.

Nga historia e shekullit të vjetër e kemi të njohur se zhvillim më të madh bujqësia e ka përjetuar në Mesopotami dhe Egjipt, ku ishin të vendosura edhe sisteme speciale për ujitjen e tokës të quajtura sisteme irigacione, sidomos gjatë lumit Nil, i cili me derdhjen e tij nga shtrati lumor dhe shkaktimin e reshjeve lumore, tokën e ka bërë shumë pjellore.



Kushtet klimatike në Egjipt kanë mundësuar edhe deri 4 korrije në vjet<sup>223</sup>. Ajo na jep mundësi reale të supozojmë se kolonizatorët Egjiptian, të cilët kanë ardhur në Ballkan me Ramzes II, me siguri me vete i kanë sjellë edhe përvojat dhe njohuritë për përpunimin e tokës pjellore. Tek Egjiptianët nga Kosova ekziston legjise “gjerami” i cili ende përdoret për ujitjen e tokës, është sjellë nga Egjipti i Vjetër, ku edhe është shpikur si aparat dhe atje është quajtur “gjerma”. Gjithashtu disa nga Egjiptianët e Kosovës para dhe pas luftës botërore janë identifikuar si “felasë”, ngjashëm siç i kanë quajtur fshatarët në Egjipt “fallah”, për çka ekzistojnë disa certifikata nga libri i amzës, në disa familje Kosovare.

Nga kulturat bujqësore Ballkano Egjiptianët më së tepërmi i kanë kultivuar ato drithërore dhe kopshtare. Kanë kultivuar misër, grurë, fasule, patate etj. Egjiptianët nga Resnja kanë pasuri tepër të madhe tokësore me pemishte dhe ruajnë molla dhe dardha. Pemishte sidomos molla të ëmbla kanë ruajtur edhe egjiptianët e Madanit. Egjiptianëve nga Ohri dhe Struga, në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore ju janë konfiskuar dhe nacionalizuar pronat e mëdha. Egjiptianët nga Kërçova si bujq argatë kanë punuar edhe në vende të tjera të Maqedonisë, si për shembull në Sopot dhe Rosoman, për çka të ruajtura janë edhe disa këngë për jetën e tyre të vështirë argate.

Edhe Egjiptianët në Shqipërinë e sotshme, kanë qenë të njohur si bujq, sidomos në rrethine Korçës, Elbasanit. Egjiptianët e Beratit kanë pasur edhe prona të tyre me vreshta.

## **Muzikë**

Muzikaliteti gjithashtu është një ndër profesionet e rëndësishme të Egjiptianëve në Ballkan. Numër i madh virtuozësh ballkanik rrjedhin nga kjo bashkësi etnike. Familja Majovci nga Dibra, të cilët luajnë në surle dhe daulle, në vitin 1949, bashkë me shoqërinë kulturore-artistike “Tanec” nga Shkupi, e kanë fituar vendin e parë në Festivalin Botëror Folklorik në Llangolen, Britani e Madhe. Gjithashtu, e larg-dëgjuara dhe masive Dasma Galicnike, tek Mijakët në Maqedoni nuk mund të paramendohet nëse në atë nuk luajnë Majovcët. Mërgimtarët Turq dhe Maqedonas nga rajoni i Dibrës

---

<sup>223</sup> Për mënyrën e përpunimit të tokës në Egjiptin e Vjetër, në mënyrë shumë plastike mund të informohemi edhe nga Herodoti, libri i dytë Evterpa.

në Turqi, deri në ditën e sotshme i thirrin Majovcët që tju luajnë në dasma dhe atë në: Izmir, Adapazar, Izmit dhe qytete të tjera. Por edhe mërgimtarët e Dibrës në Libi i kanë thirrur në dasmat e tyre<sup>224</sup>.

Edhe në Shqipërinë e sotshme numri më i madh i artistëve të muzikës i përket kësaj bashkësie. Mund të krijohet një listë e tërë e të ashtuquajturve “artistë popullor” dhe “artistë të merituar”, që i përkasin kësaj bashkësie, siç janë: legjendari Lavër Bariu, mandej Ali Berati, Bujar Qamili, Mentor Xhemali, Etem Qerimi, Petrit Lulo, Jashar Nazifi, Reshat Osmani, Afize Leskoviku e të tjerë, pa të cilët muzika popullore shqiptare nuk mund të paramendohet. Në Shqipëri Ballkano Egjiptianët luajnë si çallgia në klarinetë (gërnetë), violinë (qemane), harmonikë, def, ut, lahutë etj. Në Shqipërinë jugore Egjiptianët posaçërisht e këndojnë të ashtuquajturën muzikë vokale dy-tonësh të cilat janë kryer vetëm antifonisht, ku njëri e këndon melodinë, ndërsa të tjerët lidhen pas tij. Kjo muzikë është karakteristike edhe për Egjiptianët nga Ohri, Struga dhe Resnja në Maqedoni, i cili këndim sipas ekspertëve rrjedh nga shtresa e vjetër ballkanike kulturore. Në Shqipërinë Veriore, në rajonin rreth Kuksit, Egjiptianët luajnë në surle dhe daulle.

Në Kosovë, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit në Gjakovë dhe Pejë, Egjiptianët luajnë vetëm në instrumentet me kordha-lahutë, çifteli etj., ndërsa në Fushën e Kosovës me instrumentet frymore-fyell, surle si edhe në instrumentet rënëse-daulle.

Ko-identifikimi etnik nga bashkësitë e tjera të Ballkano Egjiptianëve dhe Romëve, janë rezultat i asaj që bashkësia Rome është gjerë e njohur si bashkësi e cila merret me fishkëllim, përkatësisht si muzikantë. Edhe për këtë problematikë duhet të afrohet më analitikisht, në disa nga hulumtimet vijuese etno-muzikologjike, para së gjithash nga aspekti se kush kanë qenë luajtësit e surleve, daulleve, klarinetave dhe instrumenteve të tjera para sh.XIV në Ballkan, sepse në shkencë më nuk janë të mbajtura kuazi-tezat se daullja dhe surla në Ballkan janë të sjella në periudhën Turke, ndërsa si bartës përmenden Romët. Për më tepër që vetëm si shembull: Në manastirin “Staro Nagoriçane” në rrethin e Kumanovës, në freskën “lindja e Krishtit”, e cila shfaqje figurative është nga sh.XIV, është shfaqur ansambël muzikor, në të cilin përveç instrumenteve të tjera ka edhe daulle. Mbi bazë të asaj mund të thuhet se daullja në Ballkan ka qenë e njohur që para sh.XIV (Линин, А. 1986: 9). gjithashtu edhe në freskën “Valle e të çmendurve” në manastirin “Sh. Gavril” në Lesnovë, në sh.XIV i shfaqur është daullisti (Линин, А. 1986: 9). Shfaqje figurative të daulles kemi edhe me datë më të re në manastirin “Sh. Jovan Bigorski” dhe “Sh. Naum” në Ohër (Линин, А.

<sup>224</sup> Informues Isakovska Lutvije, nga Dibra.

1986:11). Në mesjetën e hershme nga ana e kishës vizantike daullja është e vlerësuar si instrument me zë shumë të lartë dhe neveritshëm (Светиева, А. 1998: 10).

Surla gjithashtu është instrument shumë i vjetër muzikor. Në një relief guri hetit i cili ndodhet në Kapadoki, i paraqitur është një luajtës instrumenti frymor, i cili sipas formës, përpjesës, radhitjes të gishtave etj. është shumë i ngjashëm në surlën e sotshme (Джуджев, С. 1975: 72).. Surla është instrument i përfaqësuar gjerë dhe atë në Gadishullin Ballkanik, në Bullgari, Maqedoni, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosove, Shqipëri, Greqi, Romani, në Azinë e Përparshme dhe Qendrore tek Azerbejxhanët, Ermenët, Gruzijët, Avarët, Takhinjët, Uzbekët etj., mandej në Afrikën Veriore në tokërat në Magreb (Maroko dhe Libi), si edhe në Spanje dhe Francë ku është e bartur nga Mvarët (Джуджев, С. 1975: 73-74). Për atë se kur është e sjellë surla në Ballkan nuk disponohet me të dhëna të sigurta. Paraqitje figurative të surlës për shembull ka që nga sh.XII, në derën e gdhendur të kishës “Sh.Nikolla” në Ohër, me çka vërtetohet se surla në Ballkan ka qenë e njohur edhe para sh.XII (Линин, А. 1986: 112). Në ikonën “Lavdi Zotit” në kishën në fshatin Kuçevishtë, Karadag, nga sh.XVI, të paraqitur janë dy luajtës të surlës. Paraqitje figurative surlagjinjesh ka edhe në manastirin “Sh.Jovan Bigorski” si edhe në “Sh.Naum” në Ohër (Линин, А. 1986: 112). Paraqitje arti në ikonostasin e gdhendur në manastirin “Sh.Jovan Bigorski” nga sh.XVIII ku është e shfaqur skena “Loja e Sallomës”, ku Salloma vallëzon me shoqërimin e dy instrumenteve aerofonike dhe një daulle (Линин, А. 1986: 11), me siguri është paraqitje e surlave dhe daulleve të atëhershme në Dibër dhe rrethin.

### Profesione të tjera

Nga profesionet e tjera vlefshëm është të përmendet zanati për endjen e rogozeve, që është mjaft karakteristik për Egjiptianët nga Struga dhe Ohri. Bëhet fjalë për punim të gjërave të ndryshme prej kallami për përdorim shtëpiak. Edhe rrënjët e këtij profesioni mund të gjenden në Egjiptin e Vjetër ku ka pasur mjeshtër të mëdhenj për të bërë rogoze, por edhe me rogoz janë bërë edhe anije që kanë lundruar nëpër Nil (Салиу, А. 1996: 263-269).

Profesion i ngjashëm në atë me rogozinat është edhe ai me fshesat, me të cilin janë punuar fshesa për të fshirë nëpër shtëpitë dhe oborret.

Poçeria gjithashtu është profesion specifik i Egjiptianëve nga Kërçova-Maqedonia, Kavaja dhe Vlora-Shqipëri, të cilët kanë prodhuar prodhime të poçerisë dhe i kanë shitur për të holla ose i kanë ndërruar me mall.

Tullëria gjithashtu është një ndër profesionet specifike të Egjiptianëve nga regjioni i Prespës, të cilët kanë prodhuar tulla në pjerrësitë perëndimore të malit Baba dhe Pelister, ndërsa me këtë profesion janë të njohura disa familje Egjiptianësh nga Tërana.

Më tepër përmendëm për profesionin e qymyrit që është karakteristik për Egjiptianët nga Kosova, i cili rajon është i njohur me xehe qymyri. Qymyrxhi nga kjo bashkësi ka edhe nëpër rajonet me gurë në Ballkan, posaçërisht në Dibër, Shqipërinë Veriore, Bosnjë dhe Hercegovinë, ku pjesëtarët e kësaj bashkësie kanë prodhuar dhe shitur edhe gëlqere dhe gur gëlqereje.

Xehetaria tek pjesëtarët e kësaj bashkësie etnike është shumë pak e ruajtur, dhe atë vetëm tek aguptët e Rodopeve, në qytetet Madan, Rudozem, Zllatograd, Smoljan<sup>235</sup>. Gjatë vizitës tonë në këto vise në tetor të vitit 2003, xeheroret në këto rajone më nuk punonin me intensitet që kanë punuar më parë, ashtu që numër i madh i pjesëtarëve të kësaj bashkësie të cilët punonin si xehetarë ishin të lëshuar nga puna, dhe ishin të papunësuar. Si përkrahje se Egjiptianët janë marrë me xehetari mund të na shërbejnë edhe hulumtimet arkeologjike nga aksioni që ishte kryer në vitin 1990 nga një ekip i Institutit për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës dhe muzeve në Ohër, në lokalitetin “Varrezat e Egjupve” në malin Stogovë në Maqedoni, në lartësi mbidetare prej 2009m, ku u has në nekropolë, në afërsi xeheroreje të braktisur mangani. Sipas njohurive të para të arkeologut Pasko Kuzman me siguri bëhet fjalë për varrosje të cilat janë kryer në shekullin e hershëm ose në shekullin e zhvilluar të mesëm. Në pjesën veriperëndimore të pllatos janë gjetur tregues të cilët kanë treguar në një rrëhim të mëparshëm në një mogilë të vogël, në thellësi prej vetëm 0,20m. u zbulua pllakë e përpunuar e vrazhdë drejtkëndëshe me dimensione 1,30x0,60m dhe një më e vogël në afërsi me formë piramide, e thyer në dy pjesë. Edhe pse në pllato janë gjetur punkte të braktisura hulumtuese gjeologjike të legurës së hekurt mangan, me çfarë intervenimesh hulumtuese është marrë instituti gjeologjik

---

<sup>235</sup> Xehetaria posaçërisht ka qenë e zhvilluar në rajonin e Mërvës (mali Ali Botush me malet fqinje). Meqë Aguptët në Rodopet kanë lidhje farefisnore nga këto vende (A.Primovski: 1955:220), me siguri pjesë e madhe e kësaj popullate është marrë me xehetari, për çka nuk mund të nxirret përfundim nga punimi i Georgi Georgievit në edicionin Rudarstvoto vo jugozapadna Bugarija i jugoistočna Makedonija (Xehetaria në Bullgarinë jugperëndimore dhe Maqedoninë juglindore).

nga Shkupi në bashkëpunim me xeheroren Tajmishte nga Kërçova, deri tani nuk disponohet me informata për eksploatimin e pasurisë xeherore në këtë rajon në periudhat më të vjetra (**Кузман, П.** 1996: 178), që kuptohet se për shkencën tonë bashkëkohore është hendikep.

## LAGJE

Ballkano Egjiptianët jetojnë jetë sedentare dhe asnjëherë në historinë e vetë nuk kanë jetuar si nomadë-endacakë, por kurdoherë ka qenë popull i përhershëm në vende të banuara, në mëhalla të tyre ose kuarte, të cilat kryesisht janë në qendrat e lagjeve qytetare dhe nëpër fshatra.

Sipas shkrimeve të autorëve Helenas, Egjiptianët kanë qenë të banuar në 12 mëhalla në Athinë, të cilët janë marrë me zanatet e tyre specifike, ndërsa më vonë këta Egjiptianë e kanë marrë emrin Athinas (**Марушиакова, Е., Попов, В.** 1995: 39)..

Edhe gjatë Perandorisë Romake, në Ballkan është mundur të takohen lagje të Egjiptianëve, të cilët janë marrë me zanate dhe tregti, dhe të cilët kanë ditur të qëndrojnë të izoluar, të mbyllur në rrethin e tyre etnik dhe profesional, duke i respektuar format burimore të zotrave nga atdheu i tyre, siç është shembulli me Sallonën dhe ishujt dalmatik të Detit Adriatik (**Селем, Р.** 1969: 174).

Nga letrat e Teofillakt Ohridskit i cili ka jetuar në sh.XII mund të konstatohet se prej Ohrit e deri në Konstantinopol ka pasur aq shumë lagje të Egjiptianëve, që vetë Teofillakti atë rrugë e ka quajtur “rrugë e rëndë dhe e mundimshme nëpër Egjipt” (**ГИБИ** 1994: 169).

Në sh.XVI në Nish përmendet “Kiptijan Mahalla” në të ashtuquajturin “Nishi turke”, përkatësisht pjesët e qytetit Nish të banuara me popullatë turke, ndërsa në planin e qytetit Nish nga viti 1737 ekziston toponim “Baraques des Egiptiens” (**Вукановић, Т.** 1983: 18)..

Në vitin 1894 në Prishtinë nga Veseljnoviq është vërejtur mëhalla Asan-Emine në të cilën më parë kanë jetuar njerëz të cilët kanë pasur prejardhje nga Koptinjët afrikan (**Андреић, Љ.** 1970: 215).

Tihomir Gjorgjeviq përmend se Mahalla farkëtare në Ulqin quhet “Mahalla e Magjupve” (**Ђорђевић, Т.** 1933: 9-10). Në Bar Egjiptianët jetojnë menjëherë pranë kështjellës të Qytetit i Vjetër të mëparshëm ose siç quhet sot Stari Bar.

Në Dibër Egjiptianët jetojnë në dy mëhalla, Vakuf mahallë dhe Farkëtar mahallë. Vakuf mahalla gjatë kohës së qeverisjes Osmane ka qenë

qendra e qytetit, ndërsa sot qendër e qytetit është Farkëtar mahalla ose siç quhet sot “Vgjen”. Edhe në qytetet e tjera të Maqedonisë Egjiptianët jetojnë në qendrat e qyteteve, në Strugë “Mahallë e Egjiupve”, në Ohër “Sar mahallë” dhe “Voskë”, në Resnjë në çarshinë, ndërsa në Kërçovë më së tepërmi në lagjen e quajtur “Bella Kulla” (“Kulla e Bardhë”).

Në Shqipëri në të gjitha qytetet ku ekziston kështjellë ekziston edhe mahallë e Egjiptianëve. Ata gjithashtu jetojnë në qendrat e qyteteve, si për shembull në Tiranë në “Lagjja Tabakane”, “Lagjja Dibrane”, “Braka”, “Mahalla e Dursakve” dhe “Mahalla Pushtarinas”; në Korçë- “Mahalla e Kull e hirit”, në Berat- “Vakef malla”, Vlorë- “Mëhalla Loxhe”, në Shkodër “Mëhalla Lirija” etj.

Në Greqi sipas bibliografisë mund të përfundohet se Egjiptianë në pjesë të madhe jetojnë në Peloponez, posaçërisht në qytetet Naflio dhe Metoni, si dhe në Athinë në lagjen “Gazi”. Në Maqedoninë e Egjeut (Greqi) përmendëm shkrimet e Kënçovit të cilët i lokalizon në Seres, Drama, Meglen, Enixhe e Vardarit, Kukush dhe rrethin, ndërsa ne kishim rast të takojmë nëpër fshatrat e Florinës dhe Kasturit.

Në Bullgari në qytetin Madan ka ekzistuar kuart i tërë i Farkëtarëve Aguptë, në kodër diellore në anën lindore, ndërsa krejt çarshia me farkëtarët është quajtur “kuart industrial” (Примовски, А. 1955: 224). Në Smoljan më së tepërmi jetojnë në lagjen Ustovo, ndërsa ka edhe në Zllatograd, Smoljan, Devitkovë, Rudozem, Bell Izvor dhe Nedelinë.

Në Kosovë, Egjiptianët ndodhen nëpër qytetet: Ferizaj në lagjen “Sallahane”, ndërsa edhe krejt fshati Dubravë është i banuar me Egjiptianë (Ashkali), mandej në Golesh Magura dhe në fshatin Medvec, në Obiliq në lagjen Subotiq. Në Klinë, Gjakovë, Pejë. Në Podujevë është mëhalla e njohur “Hogjoviq mahalla”, ndërsa në lagjen Fushë Kosovë jeton numër tepër i madh Egjiptianësh. Në Vushtrri, Shtime, Istog gjithashtu jeton numër tepër i madh pjesëtarësh të kësaj bashkësie në mëhalla të veçanta. Në Mitrovicë është e njohur e ashtuquajtura “Sitničko naselje” ku më së tepërmi ka Egjiptianë. Në rajonin e Prizrenit të njohura janë fshatrat Dardhë e Vogël, Dardhë e Madhe dhe Llastovicë, ndërsa në komunën e Therandës (Suva Reka) në fshatin Glanc, jeton numër i madh i Egjiptianëve. Në Prishtinë ekziston e ashtuquajtura “Kiptisi xhamisi”-Xhamija e Koptinjëve, ndërsa rreth asaj xhamie ka rreth 50 shtëpi Egjiptianësh<sup>244</sup>.

<sup>244</sup> Dragan Gjukiq, Kosovo-znamenitosti i lepote, Prishtinë, 1971, 76:”...Në qytetin (në lagjen Proletere) ekziston një xhami me minare të ulët dhe të zgjeruar, ashtu si mund të gjihet në Egjipt. Ajo numërohet në xhamitë më të vjetra në Prishtinë...Quhet Kiptisi xhamia-Xhami Egjiptiane. Ekziston legjendë se Egjiptianët të cilët kanë qenë në përbërje të ndonjë njësie ushtarake turke e kanë ngritur gjatë një nate...”

Në Serbi në Beograd Egjiptianët nuk kanë ndonjë lagje ose mëhallë të tyre, më së tepërmi jetojnë në Dorçoll, ndërsa në kohë të fundit në lagjen Kotezh.

Në Vojvodinë, në Novi Sad, Egjiptianët nga Kosova më së tepërmi janë të banuar dhe banohen në lagjen Adice.

Në Bosnjë dhe Hercegovinëtë ashtuquajturit “Ciganë të Bardhë” jetojnë në geta në lagje të përcaktuara, të cilat nga të tjerët janë të quajtura Ciganlluk (në qytetet Çelîç, Kobash dhe Teshanj) ose Mëhallë Cigane në Dobo. Ky emër “ciganisht” llogaritet si i shëmtuar për këtë bashkësi, për dallim nga disa emra të tjerë, të “mëhallave”-Karanfil mëhallë në Bërçko dhe Përnjavor, Kalendar mëhalla në Banja Lluca dhe Mëhalla Kiptinje (Kiptijan mahalla) në Bjelinë dhe Srebrenicë. Në Sarajevë mëhalla të tilla nuk ka pasur, por mëhallët Gorica dhe Xheka kanë qenë të njohura si të tyret (**Hadžijahić, M.** 1985: 1313). .

Megjithatë, ka edhe një numër të madh familjesh veçase nga Ballkano Egjiptianët të cilët kanë jetuar nëpër lagje fshatare. Ato kryesisht janë farkëtarë dhe bujq. Një farkëtar ka mbajtur një ose më tepër fshatra të afërta. Farkëtarët në rrethanat e tilla kanë gëzuar status të lartë social dhe shoqëror. Ato kurdoherë kanë qenë pranë kryeplakut dhe priftit ose hoxhës, dhe për çdo pyetje më të rëndësishme për fshatin është kërkuar edhe mendim nga farkëtari (**Митрески, П.** 1983: 91).

## SHTËPI DHE INTERIER I BRENDSHËM SHTËPIAK

Shtëpitë dhe interieri i brendshëm shtëpiak i Ballkano Egjiptianëve në masë të madhe janë varur dhe varen, para së gjithash, nga kushtet natyrore-geografike dhe rajoni etnografik në Gadishullin Ballkanik, ku jetojnë. Dallime në shtëpitë dhe interierin e brendshëm shtëpiak ekzistojnë edhe midis Egjiptianëve me fe të ndryshme.

Megjithatë, si një karakteristikë kryesore e Ballkano Egjiptianëve të cilët jetojnë në lagjet qytetare dhe që janë marrë me zanatin e farkëtarisë ose zanate tjera, është se zakonisht shtëpitë e tyre janë në kat, ku kati përdhet iu shërben si punëtori zanatçie, shitore ose banesore për të jetuar. Por, edhe shtëpi me sipërfaqe më të madhe ku pjesa ekonomike nga pjesa për të jetuar është ndarë vertikalisht, ashtu që përpara pranë rrugës ndodhet punëtorja e zanatlive-shitorja për pjesë farkëtarie, ndërsa mbrapa ndodhet pjesa banesore për të jetuar. Në shtëpitë e tilla, hyrja në pjesën për të jetuar më shpesh është nëpër ose pranë shitores, dhe shumë rrallë ka hyrje të veçantë

nga ndonjë anë tjetër. Rasti i njëjtë me hyrjen është edhe për shtëpitë të cilat janë në kat.

Në Rodopet në Madan, shtëpitë kanë qenë të ndara nga punëtoritë e farkëtarisë. Shtëpitë janë në tip tradicional për këtë pjesë të Rodopeve, të ashtuquajtura shtëpi Rodope në kat ku përdhesa është bodrum ose siç quhet “plemnë” ku janë mbajtur gjërat dhe kafshët shtëpiake, ndërsa kati është me shkallë të jashtme të cilat çojnë në çardak për të hyrë në dhomat për të jetuar. Dhomat për mysafirë i kanë quajtur “qoshk”, sepse kanë qenë në njërin kënd të katit.

Dhoma të tilla dhe të ngjashme ka nëpër gjithë Gadishullin Ballkanik. Këto shtëpi të Aguptëve në Madan kanë qenë në një mëhallë në kodër diellore në anën lindore nga ana e sipërme, ndërsa punëtoritë e tyre kanë qenë në pjesën e poshtme të kodrës me çka kanë formuar një çarshi të tërë, të quajtur “kuart industrial” (Примовски, А. 1955: 224).

Në Kosovë, Egjiptianët të cilët kanë jetuar dhe jetojnë nëpër lagjet fshatare, kryesisht janë marrë me bujqësi. Shtëpitë e tyre janë bërë adekuate për kushte bujqësore, përkatësisht kanë shtëpi me oborr të gjerë dhe me tepër objekte ekonomike ndihmëse. Për shkak se Egjiptianët nga Kosova në numër të madh jetojnë në të ashtuquajtura familje të zgjeruara, ngjashëm me Shqiptarët nga Kosova, ku në një bashkësi të tillë mund të takoheshin me tepër gjenerata ku jetonin prej 10-20 anëtarësh, në një kompleks të rrethuar ku ka më shumë shtëpi banuese dhe objekte ndihmëse.

Nga ekspozimi shihet se Ballkano Egjiptianët mënyrën e tyre të jetesës e kanë përshtatur sipas nivelit dhe veçantive kulturore të popullatës mazhorancë në tërësi të përcaktuar etnografike, shtëpitë e të cilëve janë karakteristike për tërësinë përkatëse.

Interieri i brendshëm shtëpiak tradicional i Ballkano Egjiptianëve gjithashtu është i lidhur ngushtë me atë se ku jetojnë, si edhe me përkatësinë religjioze.

Dallimi në shtëpitë, e sidomos në interierin e brendshëm shtëpiak midis Egjiptianëve në Ballkan me fe të ndryshme mund të shihet në Republikën e Shqipërisë. Pikërisht, Egjiptianët me fe krishtere, të cilët zakonisht jetojnë në Shqipërinë Jugore, kanë shtëpi dhe interier të brendshëm shtëpiak të ngjashëm me popullatën e krishterë të rrethit, ndërsa ata me fe myslimane zakonisht në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore kanë interier të brendshëm shtëpiak të ngjashëm me popullatën myslimanë të rrethit.

Dikur interieri shtëpiak ka qenë shumë i thjeshtë, ndërsa në shtëpitë shumë të varfra gati edhe nuk ka ekzistuar, më përjashtim të disa gjërave më të domosdoshme. Nga interieri shtëpiak në shtëpitë mesatare është takuar:



sofra ose sinija-masë e ulët rrumbullake për të ngrënë; trekëmbëshe-karrike të ultë prej druri me tre këmbë; disa rrinin të ulur rreth sofrës dhe në pjesë të thjeshta prej trangu prej druri. Në shtëpitë myslimane minder, të gjatë dhe të ulët, deri në njërin mur të dhomës, të mbuluara me pëlhura shtëpiake-cergë, qilima (të vogla). Në disa shtëpi myslimane në vend të mindereve, pranë mureve ishin të radhitur jastëk të gjatë të mbushur me kashtë (ose me lesh ose pambuk, varur nga gjendja materiale dhe rajoni gjeografik). Në mur kanë qenë të vendosur doksade (dollapë) (ormanë të sotshëm) ku është mbajtur shtresa për të fjetur, dyshekë, jorgan, jastëk, mbulesa prej lëkure të përbëra prej pjesësh më të mëdha ose më të vogla lëkure me lesh etj. mangallët myslimanëve ju kanë shërbyer për të zier kafe në xhezve të vogla, për të ngrohur duart dhe për të ndezur cigaret në çibuk ose nargjile. Tek popullata e krishterë për ngrohje ka pasur vatra të hapura, oxhaqe të mbyllura ose stufa me dru (çube, soba). Këto mjete ngrohëse përveç mangalëve takohen edhe tek myslimanët. Më shpesh flinin në dysheme, mbi rogoze dhe mbuloheshin me batanije të trasha (prej leshi ose lesh dhie) ose sixhade. Shtretërit nëpër fshatra kanë qenë të rralla, ndërsa nëpër qytetet kanë qenë më se të thjeshta, prej druri zbukurime. Në shtëpitë më të pasura ka pasur qilima (disa prej tyre të endura në vek vertikal) të shtruara në dysheme ose përmbi mindereve. Në shtëpitë myslimane janë shtruar edhe poste d.m.th. lëkurë e tharë prej dele ose kafshe tjetër. Shtëpitë myslimane tek më të pasurit kanë qenë të ndara në pjesë femërore (haremllek) dhe pjesë meshkujsh (selamllëk).

Midis dy luftërave botërore në shtëpitë paraqitet edhe mobile bashkëkohore kryesisht komoda të vogla, që i zëvendësojnë dollapët e vendosura në mur, mandej tavolina, karrige, rafte për libra, gazeta, llamba të thjeshta në gazij etj.

Miellin e kanë mbajtur në noshve-sandëk, në të cilin është mbajtur por edhe është gatuar mielli, ndërsa enët kryesisht kanë qenë prej argjili, druri dhe metali, ndërsa më vonë prej qelqi dhe porcelani. Për të mbajtur ushqim, fryte dhe pije kanë shërbyer bure për verë, voze, kacekë prej lëkure (për të mbajtur vaj), si edhe qupallka prej kungulli për të mbajtur krip ose biber etj. veglëria për të ngrënë, lugët, pirunët etj., kanë qenë prej druri, ndërsa kanë qenë të njohura edhe veglëri prej metali, që janë përdorur më parë<sup>248</sup>, të cilat me siguri kanë qenë të punuara nga farkëtarët-Egjiptianë. Prej metali ka qenë edhe çerepi dhe saçi, ku është pjekur buka dhe ushqime të tjera. Çerepin dhe saçin me siguri i kanë punuar farkëtarët. Për shtypjen e prodhimeve të kokërrta janë përdorur edhe avanët të cilët kanë qenë prej

<sup>248</sup> Në manastirin në Lesnovë, R e Maqedonisë, në freskën “Darka e fshehtë” nga viti 1321 mund të vërehen lugë prej metali.

druri, metali dhe guri. Prej guri ka qënë edhe bunguri që ka shërbyer për të bluar kokrrat.

Kthinat për higjienë-për tu larë dhe për nevoja fiziologjike kanë qënë në ose jashtë objektit banesor ku ka pasur kazanë për ujë, tek më të pasurit me vatër, qupallka ose kova prej druri ose metali për të mbushur dhe për të derdhur ujë. Kthinat për nevoja fiziologjike kanë pasur gur ose pllakë guri me vrimë dhe ujë-përcjellës në gropë speciale, si dhe bure ose kazan në të cilin është mbushur ujë.

Interieri i brendshëm shtëpiak bashkëkohor i Ballkano Egjiptianëve është i modernizuar në përputhshmëri me mundësitë financiare-materiale të familjeve veçase, dhe në përputhshmëri me zhvillimet moderne. Gati çdo shtëpi në lagje qyteti është e elektrifikuar dhe e futur në sistemet e tjera infra-strukturale (ujësjellës, kanalizim, rrjetë telefonike etj.), ndërsa në disa fshatra, para së gjithash në Shqipëri, në momentin ai proces është në rrjedhje.

## USHQIMI

Ushqimi tradicional i Ballkano Egjiptianëve është varur nga shumë faktorë, siç janë kushtet natyrore-geografike, zhvillimi i përgjithshëm ekonomik i shoqërisë, mundësitë materiale të familjes, ndalimet dhe rregullat fetare, kontributet bujqësore etj.

Ushqimi në të kaluarën më të largët në Ballkan nuk është i njohur mjaftueshëm, sepse ka pak burime që mund të ndihmojnë në shpjegimin e këtij segmenti të domosdoshëm nga jeta njerëzore.

Me paraqitjen e bujqësisë, në ushqimin e njerëzve neolit nga ajo kohë, ka qënë i mundshëm jo vetëm prodhimi i ushqimit, por edhe paraqitja e tepricës që ka siguruar krijim rezervash për vitet jopjellore, e me të është mundësuar edhe vendosje e përhershme në vendbanime të përhershme. Ky proces më herët është paraqitur në Mesopotami dhe Egjipt të Vjetër, para së gjithash si meritë e sistemit të ri dhe veglave për përpunimin e tokës dhe kushtet klimatike dhe natyrore-geografike që mundësojnë disa korrije në vjet.

Periodha skllavopronare më sjell elemente të rëndësishme në pikëpamje të ushqimit, që i kanë takuar një pjese të vogël të popullatës. Megjithatë, zmadhimi i mirëqenies për pjesën më të madhe të popullatës në periudhën e formacionit shoqëror skllavopronar në përgjithësi nuk ndikon në postulatet themelore të ushqimit. Qullet dhe përsheshet, prej drithërash të lloj llojshme, qumështi dhe prodhimet e qumështit kanë qënë ushqimi kryesor dhe esencial i pjesës më të madhe të kësaj popullate në këtë

periudhë, derisa të pasurit në masë të madhe kanë konsumuar mish (**Zogovi**, C. 1997: 209).

Si në pjesët e tjera të botës së atëhershme, ashtu edhe në lagjet mikene në Shekullin e vjetër gatimi dhe pjekja e bukës ka qenë në domen të burrave, ndërsa edhe më vonë në të kanë marrë pjesë aktive edhe gratë. Në atë kohë grave ju ka rënë pjesa më e vështirë e punës, bluarja e miellit në gur-mulli dore (**Zogovi**, C. 1997: 209). Pas shkatërrimit të komunave qytetare mikenase në Gadishullin Ballkanik vazhdon të jetoj komuna fshatare e rimëkëmbur në kushte të reja dhe me popullata të reja, në të cilën sipas fjalëve të Hesiodit “shpërnetka dhe preshi” janë përkrahje më e mirë për të gjithë<sup>251</sup>.

Në periudhën e feudalizmit të zhvilluar ushqimi është kryesisht më i zhvilluar nga koha e sistemit skllavopronar, me atë dallim që qytetet çdoherë kanë qenë më të përshtatshme për të reja në ushqimin, derisa fshatrat kanë mbetur më tradicionale. Qytetet kanë qenë më të përshtatshme për të reja si rezultat i këmbimeve të zmadhuara tregtare të Evropës, Azisë dhe Afrikës, për çka Gadishulli Ballkanik ka qenë transversale e mallit tregtar, duke i përfshirë edhe produktet ushqimore.

Pas zbulimeve të mëdha gjeografike nga sh.XV, në tryezat europiane filluan të paraqiten misri, fasulja, patatja, specat, domatja, kafja, çokollata dhe shumë prodhime të tjera të cilat deri atëherë kanë qenë të panjohura.

Në periudhën e qeverisjes Osmane në Ballkan të dhëna për ushqimin e popullit mund të fitojmë nga udhëpërshkruesit të cilët kanë kaluar nëpër Ballkan dhe kanë hulumtuar për shkaqe dhe qëllime të ndryshme. Në një shënim të tillë nga mjeku francez Pjer Belon i cili ka udhëtuar nëpër Ballkan, i cili për vendet europiane perëndimore bëhet Orient (lindje), nga viti 1546-1549, do të shkruaj se orizi në ushqimin e popullit ka qenë shumë i përfaqësuar dhe se ka qenë i sjellë nga Egjipti. Nga Egjipti ka qenë i sjellë edhe një lloj perime që grekët e kanë quajtur avkos ” (**Богоески, К.** 1997: 131).

Ushqimi kryesor i Ballkano Egjiptianëve, si dhe tek popujt e tjerë ballkanik, ishte buka. Gjatë kohës është gatuar prej meli. Shumë më vonë ka filluar përdorimi masiv i llojeve të tjera të drithërave të bukës (thekër, elb, grurë). Ndërsa sipas Herodotit, në Egjiptin e vjetër për Egjiptianët turp më i madh ka qenë të bëjnë bukë prej miell misri ose elbi, dhe kanë bërë bukë prej ndonjë drithi të cilin popujt e tjerë e kanë quajtur “limec”, që me siguri është meli<sup>253</sup>. Më vonë gjatë gatimit të bukës janë shtirë patatet të ziera dhe të shtypura, në disa pjesë të Ballkanit, si për shembull në Rodopet. Buka është

<sup>251</sup> citohet nga Hesiod, Poslovi i dani, MH, Zagreb, 1970, 15 (41).

<sup>253</sup> Herodot, libri i dytë Evterpa, nr.36, faq.128.

gatuar në dy mënyra të njohura: me majë ose pa të, d.m.th. pogaçe e ardhur. Më vonë është paraqitur i ashtuquajtur i majallnik, i cili në vend me majë është zënë me farë prej sllatuni (lloj leblebie). Bukët e para kanë qenë të holla 2-3cm. Ashtu i kanë gatuar që të piquen më lehtë direkt në hi të nxehtë. Më vonë janë paraqitur somunet (peshnikët) që i kanë pjekur në saç. Formën e rrumbullakët buka e fiton me paraqitjen e furrave shtëpijake.

Në jetën e Egjiptianëve të Ballkanit vend i veçantë ju përket bukëve ceremoniale dhe të kulteve. Ato janë përdorur në qëllime dhe raste të ndryshme. Tek myslimanët ajo bukë është “qajja” ndërsa tek krishterët proskura-bukë të vogla me vulë (liturgite, panagite etj), si dhe varg bukësh tjera që gatohen në lidhje me doket për lindje, martesë dhe në lidhje me vdekjen, mandej për festat vjetore, për hyrje në shtëpi të re, dhe raste të tjera ritual (**Земон, Р.** 1997: 233-240).

Por, e njohur është se drithi i zier që është përdorur para bukës. Qulli prej meli është edhe para zierjes të drithërave. Prej atëherë është trashëguar zierja e kokrrave të drithit, para të cilave kanë qenë të pjekurat.

Nga mielli i zier mjaft përpara filluan të gatohen qullet e trasha, ndërsa pas shtirjes të miell-misrit në ushqim ka filluar zierja e kaçamakut (bakërdanit), të cilin Egjiptianët nga Shqipëria e Jugut dhe Ohri, Struga dhe Resnja e quajnë “memelike”.

Përveç bukës dhe kaçamakut, njerëzit kanë gatuar edhe lloje të tjera ushqimi nga miellra të ndryshëm, nga të cilat më të përdorura kanë qenë qullet. Duke e përzier miellin me ujë, vezë etj., janë bërë petulica, petulla, krofna, taranë, peta, jufka etj. si zëvendësim i bukës paraqiteshin edhe petanikët, pitet-të cilat janë gatuar në mënyra të ndryshme varësisht nga filli dhe ka emra të ndryshëm: zellnik, komad, tikvarnik, koprivnik, vitkallnik, lakror, petë etj. Në regjionin e Prespës, Ohrit, Korçës dhe në disa regjione të tjera ushqim posaçërisht popullor ka qenë “derdh-piq” ose “gjomleze”(me rende), që bëhet me fill prej arrash. Ushqime të tjera prej mielli të njohura nëpër gjithë Ballkanin janë byreku, gjevreku, mekica, pastërmali (pite të vogla të cilat në petën kanë pasur mis delesh, dhish “pastërma”), pinerlat, simitet etj.

Ushqimin e përbëjnë ushqime “të pa gatuar” dhe “të gatuar”. Të parat i përkasin konsumimit të bukës me krip, biber, specë, domate, rrush, shalqin etj.,ndërsa më rrallë me urda ose djathi. Në ushqimet më të thjeshta është edhe shëllira me biber, si dhe hudhra e shtypur e ëmbëlsuar me ujë dhe uthull që ngjyhej ose hurbehej në ditët e ngrohta verore për freskim.

Ushqimet e gatshme-gjellët mund të ndahen në të yndyrshme dhe të kreshme. Të kreshmët gatohen me ujë, e disa nga to edhe me vaj (zejtin, maslo, olio) dhe me artikuj me prejardhje bimore. Prej tyre më popullore

janë fasulja (grav, bobot) dhe leqea si dhe bunguri (kokrra të thyera misri dhe tërshëre që i përdornin si zëvendësim të orizit). Ndërsa sipas Herodotit, në Egjiptin e Lashtë fasulen (bobot) as nuk e kanë mbjellë shumë, as edhe e kanë grimtuar, as e kanë ngrenë të zier<sup>255</sup>. Në ushqimet e kreshme bëjnë pjesë edhe çorbat e lloj llojshme që gjithashtu zien në ujë. Në kategorinë e ushqimeve të kreshme bëjnë pjesë edhe peshku (i pjekur ose i fërguar ose i përgatitur në mënyrë tjetër në tavë me oriz etj.).

Ushqimet e yndyrshme janë të ziera, të pjekura ose të fërguara. Gatuhet me mish dhe dhjam (loj, mrs), që janë yndyra me prejardhje nga kafshët d.m.th. dhjam prej delesh, dhish, lopësh etj. Prej mishit tek Ballkano Egjiptianët më i përdorur është mish i deles, dhisë, lopës, i mëshqerrës, qengjit, pulës, miskës, si dhe mish shpendësh-pëllumbi, thëllëze, rose etj. Mish i derrit tek myslimanët është i ndaluar, ndërsa Egjiptianët me fe të krishterë e përdorin.

Në ushqimin, si tek popujt e tjerë Ballkanik ashtu edhe tek Egjiptianët rol të rëndësishëm kanë pasur edhe qumështi dhe prodhimet e qumështit-gjalp (mast), kos (kiselo mleko), djathë, kaçkavall (sirenje), lalte (mashatejnca) që e kanë blerë nga blegtorët gjerë rajoneve Ballkanike-Vllahët, Shqiptarët, Karakaçanët, Malazezet etj.

Për nevojat e ushqim dimëror njerëzit kanë konservuar perime, mish, fryte etj., në mënyra të ndryshme. Mënyra më e përfaqësuar e konservimit ishte me krip dhe shëllirë. Mishin e fërguar dhe dhjamërat e derrit (përshki) i kanë konservuar me mbushje me mish të shkrirë, në enë prej dheu. Pastërmanë (lardh, salamur) e kanë konservuar vetëm me kripje. Mish i është konservuar edhe me tymosje (mish i tymosur). Ballkano Egjiptianët prodhimet e tjera të domosdoshme të mishit për dimër siç janë :suxhukun e tymosur nuk e kanë përgatitur vetë, por i kanë blerë si të gatshme nga blegtorët ose kasapët.

Vezët gjithashtu kanë vend të veçantë në ushqimin. Ato më shpesh janë konsumuar të ziera ose të fërguara. Gjithashtu i kanë thyer si shtesa në gjellët dhe brumërat.

Ushqimet e ëmbla gjithashtu zënë vend të rëndësishëm në ushqimin e Ballkano Egjiptianëve, sidomos në ditët festive, në doket nga ciklusi i jetës, si dhe në raste solemne rituale. Meqë pjesa më e madhe i përket religjionit mysliman gjithë Ballkanit mund të hasen numër i madh ëmbëlsirash të përvëlura me sherbet, siç janë bakllava të ndryshme, tullumba, kadaif, sheqerpare, tatli etj. Në Strugë përgatitet edhe një bakllavë speciale (e ëmbël) që e bëjnë vetëm Egjiptianët ku copat kanë formë piramidash. Nga

---

<sup>255</sup> Herodot, II/37.

ëmbëlsirat e tjera të pranishme janë sutlijashi, ashuri-ashër (misër i zier me qumësht) të cilin më së tepërmi e përgatisin për festën Sulltan Nevruzit dhe shpërndahet nëpër shtëpitë e fisit, miqtë dhe fqinjët, e mandej hallvat e ndryshme prej miell-misri, që më së tepërmi gjatë përkujtimeve, tan-hallva, kaçan-hallva etj. Në gjithë këto ëmbëlsira si shtesë përdoren edhe arrat, lajthitë, bajamet etj.

Pemët gjithashtu kanë rol të rëndësishëm në ushqime, të cilat janë konsumuar qoftë si të gatshme nga natyra qoftë si shtesë në ushqimet e përgatitura ose të konservuara (me tharje ose zierje), siç janë molla, dardha, pjeshka, kumbullat, vishnja, qershitë, ftuat, shalqit, kungujt, malinat, thanat etj. Pemët janë përdorur edhe për të bërë pije-lëngje ose hoshaf, si dhe për përgatitje reçelesh. Rrushi është përdorur edhe për të fituar verë, raki, musht etj.

Lëngjet janë bërë edhe prej mëshktekre, trëndafilave dhe bimëve tjera. Boza, salepi dhe sherbeti gjithashtu janë përdorur si pije.

Ballkano Egjiptianët janë ushqyer dhe ushqehen në shtëpi, ndërsa ata që janë marrë me bujqësi, gjatë punëve bujqësore intensive janë ushqyer edhe nëpër arat. Në Ballkan zakonisht ka tre ngrënie- mëngjesi (pojadok, zakuska), drekë (ruçek) dhe darkë (veçera). Nganjëherë sidomos fëmijëve ju jepet edhe kafjalli (uzhuna). Më parë ushqimi është servuar në tryeza të ulëta-sofra. Të gjithë janë ushqyer nga një enë dhe përveç lugëve, veglëri tjetër nuk kanë përdorur. Nikoqiri (kryefamiljari) e ka prerë bukën, ndërsa nikoqirja e ka shtruar ushqimin. Ushqimi ka filluar pasi nikoqiri do ta kafshonte kafshatën e parë. Myslimanët pas ngrënies do të bënin Duva (lutje fetare), ndërsa krishterët para ngrënies do të kryqëzoheshin dhe do të bënin lutje. Para ngrënies njerëzit i lanin duart, ndërsa ujin e kanë pirë nga një bardak të përbashkët. Rregullisht gjatë ngrënies burrat i kanë hekur kapelat.

Kur flitet për ushqimin duhet të paraqesim edhe gjërat për tu kënaqur-tutuni dhe afioni. Me paraqitjen e tutunit filloj edhe përdorimi i të ashtuquajturve çargule, nargjile, çibukë. Afioni është përdorur më së tepërmi për ëmbëlsimin e dhimbjeve si mjete narkotike, ndërsa më parë iu janë dhënë edhe foshnjave për ti vënë në gjumë. Nga disa shkrime antike mund të ndjehet se konopi dhe afioni janë përdorur edhe për drogim, në kuptim të sotshëm të fjalës tek popujt Ballkanik.

Tek Ballkano Egjiptianët ushqimi është shumë prezent gjatë ceremonive dhe dokeve të ndryshme që quhet edhe ushqim ceremonial. Para së gjithash në ushqimin ceremonial shumë prezent është përdorimi i numrit 3, si p.sh. “Qaija” për Ramazan Bajram dërgohet në 3 shtëpi; kurbanit për Bajram ndahet në 3 pjesë; për festën Sh. Atanas gatuhen 3 bukë, në të cilat vendosen nga 3 qiri dhe 3 herë me duar plot me miell rrotullohet

rreth bukëve duke e lëshuar miellin. Gjithashtu duhet të ketë tre lloj ngrëniesh për këtë festë si edhe për Shëmitër. Egjiptianët nga Ohri, Struga dhe Resnja tre herë e rrotullojnë qengjin rreth manastirit Shën Naum, si kurban. Gjatë vënies së emrit të foshnjës vendosen tre qiri me propozime emrash, të cilat vendosen në pogaçen ceremoniale dhe foshnja tre herë dorëzohet prej dore në dorë midis gjyshërve të foshnjës mbi tepsinë me bukë të thërrmuar. Nuses kur hyn në shtëpinë e dhëndrit i vendosen tri bukë-dy nën sqetulla, një mbi kokë para vetë pragut.

Në ushqimin ceremonial tek Ballkano Egjiptianët shumë i pranishëm është kurban, gjeli për Shën Atanas, dhe dashi ose qengji për Bajram, synet.

Si tek popujt e tjerë që jetojnë në mënyrë të stacionuar edhe këtu është i pranishëm kulti ndaj pjellshmërisë, bereqetit, mirëqenies, i shfaqur nëpërmjet respektimit të ushqimit me kokrra dhe gatimit të bukëve ceremoniale-“qaija”, si dhe me praninë e rregullt të misrit, grurit ose orizit, si dhe ushqimet e tyre të gatuar, të cilat janë të pashmangshme në doket të lidhura për momentet më të ndjeshme në ciklusin e jetës-lindje, martesë dhe vdekje, si dhe gjatë hyrjes në shtëpi të re.

Ekzistojnë edhe rregulla të përcaktuara, ushqime të domosdoshme, si dhe tabu të përcaktuara (ndalime). Për Shën Atanas për darkë medoemos duhet të ketë gjel ose për drekë peshk, për Ditë vere (15 mars) fiq në të cilin ka lule prej thane, ndërsa për mëngjes vezë të fërguara. Për Shën Naum (3 korrik) duhet të gatohen ushqime të kreshme, por detyrueshëm edhe peshk. Për Shënmitër (8 nëntor) duhet të ketë doemos tre ushqime nga të cilat njëri ushqim duhet të jetë sarma, që të “kalohet dimri të mbuluar nga i ftohti”. Mandej për “vizitën e parë që i bëhet nuses nga prindërit e saj” (në gjuhën maqedonase “prviçe”) dhëndri dhe nusja hanë në dhomë tjetër, e jo me mysafirët, dhe atë vetëm vezë të fërguara dhe bukë, për dallim nga të tjerët që kanë darkë të pasur. Për shpirtin e të vdekurit hahet hallvë; gjatë hyrjes në shtëpi të re ushqimi doemos duhet të jetë i kreshmë dhe të ketë fasule dhe peshk. Kur blihet kurban, nuk duhet të bëhet pazar me shitësin dhe nuk matet pesha e kurbanit<sup>256</sup>. Gjatë fejesës nuk duhet të pihet kafe, ndërsa kur

<sup>256</sup> Kurban, përkatësisht sakrifikimi ka qenë i njohur edhe në Egjiptin e Vjetër. Egjiptianët e Vjetër kanë sakrifikuar dem dhe viç, dhi në Tebë, dele në Mendet, ndërsa lopë nuk kanë guxuar të sakrifikojnë, sepse ato i kanë qenë të kushtuara Izidës. Sakrifikimi i kafshëve ka qenë me qëllim për mbrojtje nga ndonjë fatkeqësi. Kurbanit, pasi e kanë therur, i ja kanë prerë kokën, trupin e kanë rrjepur, ndërsa për shkak se me atë kokë do të kishin mundur të pastrojnë shumë mëkate, e kanë çuar dhe e kanë hedhur në lum, me fjalët “Nëse duhet ti gjendet fatkeqësi ato të cilët sakrifikojnë ose gjithë Egjipti, ajo le të kthehet në këtë kokë”. Herodot II, 39-40, 129-130.

bëhen disa ceremoni islame asesi nuk duhet të pihet alkool (edhe pse janë myslimanë në shumë raste Ballkano Egjiptianët pinë alkool).

Për fund të kësaj pjese do të kishim shtuar se doket tradicionale transformohen dhe përshtaten në kushtet e jetës bashkëkohore, ndërsa kuptohet ajo ka pasoja të veta përkatëse edhe mbi ushqimin, duke e përfshirë edhe ushqimin ceremonial. Gjatë kësaj në traditat të cilat ndryshohen në lidhje me ushqimin ceremonial kujdeset që rregulla të përcaktuara themelore, tabu dhe ushqime të detyrueshme të mbahen, edhe pse ndoshta më nuk përdoren si ushqime në jetën e përditshme.

## STOLI DHE VESHJE

Meqë është e njohur se njerëzit prej kohërave më të lashta kanë pasur nevojë për stolisje, qoftë nga qëllime shoqërore ose magjike-apotropike, e më vonë u paraqit nevoja për veshje përkatësisht mbulim të trupit, së pari do të flasim për stolitë e mandej për veshjet, tek Ballkano Egjiptianët.

Duke pasur parasysh se stolitë e Ballkano Egjiptianëve mund të ndeshen që prej kohërave më të vjetra, nëpërmjet zbulimeve dhe varrezave të zbuluara arkeologjike, në të cilat takohen stoli, mund të themi se në Gadishullin Ballkanik kemi prani të dukshme ndikimi të ornamentit Egjiptian në stolitë, që prej kohës së hekurit, si pasojë e migrimit të substratit popullor egjiptian (**Кузман, П.** 1998: 283).

Kur në vitin 1876 arkeologu gjerman Henri Shliman, i zbuloj varrezat në agorën mikene, përkatësisht kështjellën në të cilën hyhet nga dera luanore, që padyshim tregon një dorë më e vogël në ndikim egjiptian, nëse jo edhe në popullatë egjiptiane, përveç maskës të artë, për çka Shliman mendonte se është maska e Agamenmonit, u zbuluan edhe shumë gjëra prej ari, duke filluar prej shpatave të arit dhe argjendit me zbulime të vogla prej gjuetie, luanë, zogj etj., të zbuluara janë edhe kurora dhe doreza në formë gjarpri (**Иустрована историја света** 1983: 103). Këto kurora dhe doreza mund të na dëshmojnë se si ka qenë stolia e popullatës së atëhershme në Peloponez, midis të cilave edhe e Egjiptianëve, të cilat stoli me siguri të madhe kanë qenë të prodhuara nga kolonistët egjiptian-mjeshtër, për çka na thotë edhe Herodoti.

Shumë zbulime të ngjashme në varreza mikene ishin të zbuluara nga arkeologu bullgar Fillov (**Филов, В. Д., Шкорпил, К.** 1927), në afërsi të fshatit Gorenc (rrethi i Ohrit) në vitin 1918, si dhe nga arkeologu serb Vuliq (**Вулић, Н.** 1932) në vitin 1930-1934 (**Кузман, П.** 1985: 11). Në lokalitetin e ashtuquajtur Trebenishtë, emri i të cilit është vendosur



gabimisht duke menduar se lokaliteti gjendet në afërsi të fshatit Trebenisht, ndërsa pikërisht gjendet në afërsi të fshatit Gorenc, si dhe nga shkaqë të panjohura ose tepër të njohura lokaliteti mandej është quajtur “Tri çelusti i vrtluka” ndërsa tek populli ky lokalitet është i njohur me toponimin “Egjupski grobishta” (Varrezat e Egjupteve), përveç maskave të arta të gjetura janë edhe doreza dhe sandale ari, unaza dhe stoli të tjera. Në një nga maskat prej ari nga rrënja ishte nxjerrë bletë, e cila në Egjipt ka paraqitur një ndër simbolet e para mbretërore. Nga ngjashmëria e zbulimeve të Mikenës dhe të ashtuquajturave Trebenishtase, mund të konstatojmë se në periudhën e kohës së hekurit, kemi fotografi krejtësisht solide të stolisë dhe ornamentikës e cila padyshim na jep dëshmi për ndikimin egjiptian dhe mjeshtrit të cilët e kanë punuar metalin përkatësisht stolitë.

Si një ndër ornamentet më karakteristike në stolinë e Ballkano Egjiptianëve në Shekullin e Vjetër në unaza të ndryshme paraqitet edhe skarabeu, të cilat unaza disa herë kanë shërbyer edhe si vula (gjene), mandej edhe në qaforet dhe fibulat. Skarabeje të tillë janë zbuluar në Serbi, lokalitet Trnjaci-Pilatoviçiq tek Uzhiçka Pozhega, në përbërje të një varri kinezor i datuar prej sh. VI p.e.r (Анђелковић, Б. 1991: 67). Ekspertiza e këtij skarabeu i cili sot ndodhet në Muzeun popullor në Uzhiçë, që ishte kryer nga konservatorët prej Luvri e daton gjatë kohës së dinastisë XX-XXII në Egjipt, ose përafërsisht prej viti 1190-720 p.e.r. Në sipërfaqen e këtij skarabeut përveç shfaqjes së dy kobrash-ureuse dhe krokodil të vendosura në mënyrë simetrike, në pjesën qendrore është shfaqur vetë skarabei (khepri), ndërsa sipas arkeologut Zotoviç ajo shfaqje qendrore është zotesha Hator (Анђелковић, Б. 1991: 67). Duhet të shtohet se kobra është simbol, mbrojtëse e Egjiptit të Poshtëm, ndërsa krokodili simbol i zotit Sebek. Skarabeu-khepri ka vend më të shpesh në simbolikën religjioze egjiptiane, ai e simbolizon kultin diellor dhe është atribut i përhershëm i shfaqjeve të zotësisë supreme primare-babai i zotave Egjiptian. Rrënja nga emri i zotësisë “Khērp” tregon skarabei dhe ato bashkë janë të respektuar në një lloj zotrie të metamorfozës dhe ringjalljes. Ndryshe, skarabeu është një lloj insekti i cili vezët e veta i nxjerr në rërë duke i mbështjell me jashtëqitjen e vetë në topa të vogla, të cilat mandej i shtyn me këmbëngulje para vetes deri në vendet më të ngrohta me diell në afërsi që tju mundësoj të bëhen të pëlleshme. Kjo shprehi e jashtëzakonshme e skarabeut i ka inspiruar Egjiptianët e Vjetër që ta lidhin me zotin e tyre primar të diellit , i cili në mitologji është i njohur me deklaratën e vetë legjendare: “unë jam Khepri në mëngjes, Ra në drekë, Amon në mbrëmje”. Kushtimi i skarabeut si amulet-ajmali ose vulë është i njohur në lokalitetet nga periudha antike në Azi të Vogël, Kipër, Ballkan dhe në Apeninet (Jurkić-Girardi, V. 1981). Skarabeu

më shpesh është punuar prej guri, fajance (material prej qeramike i cili përmban një lloj deltinë të bardhë të përzier më gjips, kryp dhe hi prej bimësh) ose qelq. Skarabeu ndalon të përdoret gjatë kohës së perandorisë Romake dhe në kohën e përforcimit dhe dominimit të krishterimit (**Tomorad, M.** 2003: 1).

Stolitë kanë pasur edhe funksion mbrojtës-antropoik prej fuqive të këqija. Për atë shkak njerëzit kanë mbajtur amulete të ndryshme. Në Ballkan mund të takohen shumë hajmalia të cilat kanë prejardhje nga Egjipti i Vjetër. Egjiptianët e Vjetër kanë mbajtur hajmalia kryesisht për shkak të bindjeve të tyre religjioze. Njerëzit që kanë mbajtur amulete kanë besuar se me to do të fitojnë forca të ndryshme mbinatyrore dhe fuqi të mbrohen nga ashpërsitë. Gjëra të tilla i kanë quajtur meket, nehet, sa (mbrojtje), ndërsa është përdorur edhe emri vedja-njedjat (mirë është). Janë punuar prej metalesh të ndryshme, druri, fajance, terakoti dhe gurë (**Tomorad, M.** 2003: 1). Vedit më saktë paraqet sy i Horusit, simbol i shëndetit dhe vitalitetit, amulet mbrojtës për të gjallët, por është vendosur edhe gjatë përgatitjes së mumjave. Njerëzit syrin e Horusit e kanë vizatuar edhe te anijet (**Mc Dermott, B.** 2001: 31).

Me përforcimin e krishterimit në rajonet Ballkanike, edhe amuletet e humbin fuqinë, edhe pse janë të ruajtura deri më sot, në forma të ndryshme, ndërsa të karakterizuara janë si besim i kot ose besëtytni. Në stolinë funksionin mbrojtës antropoik e merr kryqi, i cili paraqitet në qafore, unaza etj. Por amuletet, në intensitet më të vogël ende ishin përdorur. Me paraqitjen e Islamit dhe procesit të islamizimit, kryqi si mbrojtës zëvendësohet me citate nga Kurani ose me gjysmëhënën, tek popujt dhe njerëzit e islamizuar. Por amuletet ende takohen edhe tek popujt e islamizuar në Ballkan, midis të cilëve edhe tek Ballkano Egjiptianët.

Stolisja për raste rituale ose solemne është edhe me bimë. Me çka krijohen aranzhmane të ndryshme lulësh nga qafore gjatë kohës së festave pranverore, mandej stolisje e nuses me kurora nga aranzhmane lulësh etj.

Edhe sot mund të takojmë se si fëmijëve, sidomos atyre që janë të vetëm ose njerëzve të sëmurë ju vendosen amulete (hajmalia) kundër “sysh të këqij”, sëmundje, më sysh etj., të cilat amulete zakonisht janë prej metali ose qelqi të ngjyrosur.

Egjiptianët në Gadishullin Ballkanik nuk kanë veshje të plotë specifike të tyre, por në rajone të veçanta etnografike mund të vërehet se si nëpërmjet veshjes bëjnë kufi etnik nga bashkësitë e tjera. Por edhe këto pjesë të veshjeve me të cilat krijohet kufi etnik, janë në harmoni me rastet natyrore-geografike në rajone të veçanta, si dhe me karakteristikat etnografike edhe të ndikimeve të jashtme në rajon të përcaktuar.

Duke pasur parasysh se nga pasqyrimet e piramidave, nga papiruset e ruajtura, në të cilët janë të pikturuar Egjiptianët e Vjetër, por edhe skulpturat nga ajo kohë, duket se nuk mund të vërehet ndonjë veshje e veçantë, ose lloje ose variante veshjesh në Egjiptin e Vjetër. Kjo edhe më tepër nëse merret parasysh klima në Egjipt e cila është me temperatura shumë të larta, si dhe sistemi organizues skllavopronar ku pjesa më e madhe e popullatës janë skllavë, pa mundësi për veshje të çfarëdo veshjesh të panevojshme. Nga ajo që shihet nëpër piramida, papiruse dhe skulptura Egjiptianët e Vjetër kanë pasur skutinë rreth belit, e cila më së tepërmi ka qenë prej leni dhe çdoherë freskët e larë dhe rreth saj më së tepërmi kanë bërë orvatje<sup>268</sup>, si dhe me prejardhje kafshësh prej lope, deve ose prej ndonjë kafshe tjetër të gjuajtur (gazelë, antilopë, luan etj.). Veshja e femrave është e përbërë prej këmishë e cila me siguri është prej pambuku dhe është e gjatë prej kraharori deri në nyje të duarve, pa mëngë, e ngjitur ngushtë për trupi. Në duar kanë vënë stoli. Në këmbët edhe gratë edhe burrat kanë veshur sandale prej lëkurë kafshe.

Me siguri, me një veshje të tillë të varfër Egjiptianët e Vjetër kanë ardhur në Gadishullin Ballkanik. Duke pasur parasysh kushtet klimatike-geografike dhe natyrore në Ballkan, Egjiptianët e Vjetër shumë shpejtë dhe lehtë i pranojnë veshjet e popullatës autoktone që e kanë gjetur në tërë Ballkanit, që ta mbulojnë trupin e tyre, sidomos në vendet e ftohta dhe muajt e dimrit. Kështu që veshja e Ballkano Egjiptianëve filloj të transformohet në pajtim me kushtet natyrore-geografike dhe klimatike në Ballkan, e ajo do të thotë se materiali i veshjes tani ka qenë prej konopi, leni, pambuku, leshi, egërsire të gjuajtur, lesh dhie më të trash etj. Edhe pse, sipas fotografive që rrjedhin nga periudha e Heladës Antike mund të shihet se shtresat më të varfra nuk kanë mbajtur ndonjë veshje të madhe. Veshjen në shekullin e vjetër e kemi të njohur se kryesisht ka qenë prej mbështjellëse pëlhure e cila është varur me fibula. Në viset malore veshja e meshkujve është përbërë prej pantolonave të ngushta, dhe me material me origjinë bimore (len, konop, pambuk). Këmishët kanë qenë pjesë përbërëse edhe të veshjes të meshkujve dhe të femrave qoftë malore ose ultësirë. Strukturat e tilla globale të veshjeve ballkanike, me shumë varietete me siguri kanë zgjatur me shekuj, me ndryshime të vogla varësisht nga proceset etnike, ndikimet e jashtme dhe rregullat e reja religjioze deri në gjysmën e dytë të sh.XX, kur masivisht braktiset veshja tradicionale dhe pranohet veshja e re, veshja bashkëkohore industriale që fiton madhësi globale.

---

<sup>268</sup> Herodot, II/37, 129.

Më parë në këmbë janë mbajtur opinga prej lëkure e diku edhe këpucë prej lëkure, ndërsa me hyrjen e Osmanlive, popujt e islamizuar, më saktë gratë e tyre kanë mbajtur papuçe dhe nallane. Me hyrjen e Osmanlive popujt e islamizuar filluan të veshin dimija, kapela, ndërsa gratë edhe ferexhe për të mbuluar fytyrën. Sipas rregullave të Islamit gruaja doemos duhet të jetë krejtësisht e mbuluar para meshkujve të tjerë (të huaj), prej koke deri te këmbët.

Pas Revolucionit Borgjez të Francës, në sh.XIX përfitimet e reja në veshjen europiane, e quajtur “alla Franka” ngadalë hyn edhe midis popujve Ballkanik, posaçërisht midis tregtarëve dhe zanatçive, përkatësisht popullatës qytetare, ndërsa këto veshje të reja vështirë depërtonin dhe pranoheshin nga popullata fshatare.

Në këtë kontekst do të ishte vërejtur edhe veshja e Ballkano Egjiptianëve. Nga ajo që mund të vërejmë në terren, mund të dallojmë më tepër lloje dhe varietete në veshjen e Ballkano Egjiptianëve varësisht nga rajoni i jetesës dhe përkatësisë religjioze. Megjithatë ajo që mund të tërhiqet si vijë gjenerale janë pjesët karakteristike të veshjes të farkëtarëve. E ajo është skutina prej lëkure për punë, pantallona të zeza (beçe) me tumane (pjesë e zgjeruar pas tek prapanica) dhe kapela e zezë karakteristike prej leshi të tjerrur, në formë cilindri të prerë me gropë në majë. Burrat kur kanë dalë në këmbë kanë veshur xhamadan (me ngjyrë të errët vishnjë ose kafe). Rreth belit kanë lidhur rrip të thurur prej leshi, të cilin e kanë lidhur rreth belit 4-5 herë, e në të kanë mbajtur kuletë me të holla ose çibukët dhe kuletë me tutun. Në njërin anë të brezit me doemos kanë pasur çaki (thikë e vogël). Në këmbë kanë veshur kundra (çevli, konduri) ose çizme. Disa burra në kokë kanë mbajtur edhe keçe ose fes të cilat kryesisht kanë qenë në ngjyrë të zezë ose të kuqe.

Gratë nga lagjet qytetare kanë mbajtur këmisha (mintane) prej pambuku ose konopi, e cila është e gjatë deri nën gjunjë, me mëngë të gjata kah fundi të prera dhe pak e hapur në pjesën e qafës. Në Kërçovë “mintani” ka qenë i bërë prej leni me skaje të thurura. Mbi këmbë kanë veshur zebën (zaban, zobun) që ka qenë prej leshi të tjerrur ose që ka qenë i gjatë deri mbi gjunjë, me mëngë të gjata, dhe rreth-qafe. Është mbërthyer me kopsa të thurura. Mbi këmbë në kohë verore dhe pranverore gratë kanë mbajtur edhe jelekë, të cilët ishin të qëndisur me argjend për raste solemne. Disa gra kanë mbajtur fustan prej basme ose porket të trash. Gjithashtu gratë kanë mbajtur edhe xhemperë të thurur. Skutina gjithashtu është pjesë e rëndësishme nga veshja, që ka qenë e punuar prej pambuku ose leshi me thurje ose endje, dhe e pasur me ornamente. Gratë Egjiptiane nga Shqipëria Jugore si dhe Ohri, Struga dhe Resnja nën skutinë kanë mbajtur edhe done

prej pambuku, të gjëra deri në nyjet, të cilat kanë qenë të qëndisura në fund rreth skajit, më shpesh në formë trekëndëshash të lidhur (ose piramida) me pe të kuq. Në kokë kanë mbajtur shamia (tilben), të cilat nëpër skajet kanë qenë të qepura me “oja” të thurura. Zakonisht shamitë kanë qenë me ngjyrë më të errët. Kur është lidhur shamia bishtat janë lidhur në nyje mbi veshë për raste solemne, ose janë lëshuar mbi kraharor që të shihen “oja” e qëndisura dhe të thurura të cilat njëkohësisht kanë kryer edhe mbrojtje apotropeike magjike. Më parë, në ditët dimërore gratë kanë mbajtur të ashtuquajtur derke, të cilat sot janë të zëvendësuar me kaputë (pallto). Në Rodopet në Madan gratë mbi kokë hedhin leckë e cila nuk lidhet dhe skajet e së cilës lirshëm zdërohen dhe e cila është me ngjyrë të bardhë (leckëbardhë). Në këmbë kanë veshur çorapë prej pambuku “të” dhe kanë veshur nalle ose papuçe. Veshja e nusërisë ka qenë me strukturë të njëjtë vetëm se më solemne dhe më e stolisur me qëndisje dhe stoli, ndërsa nusja ka qenë krejtësisht e mbuluar me shami me ngjyrë të kuqe, për mbrojtje nga sytë e këqij. Shumë gra si stoli në veshë kanë vendosur edhe “mangare” (pare argjendi) në kraharor qafore prej “rupesh” ose pare të argjendta.

Veshja tradicionale tek Ballkano Egjiptianët me fe myslimane shumë karakteristike është në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Sanxhak. Veshja e meshkujve është e karakterizuar me këmishë të bardhë, mbi të cilën vishet xhamadan me ngjyrë të zezë. Në këmbë kanë veshur beçva të zeza ose kafe, çorapë dhe opinga. Në kokë kanë mbajtur kapelë të zezë. Veshja e grave karakterizohet me këmishë të endur prej mëndafshi e stolisur me serm në pjesën e përparshme dhe në mëngët. Në këmbë kanë veshur dimija prej mëndafshi të bardhë. Mbi këmishën është jeleku me oja, gjithashtu i stolisur me serm. Në këmbë kanë veshur çorape të bardha dhe nalle. Kokën e kanë mbuluar me shami me ngjyrë të bardhë, ndërsa nuses i kanë vendosur kapelë të bardhë, të stolisur me tel (tel i thurur), e cila quhet “tas fes”.

Veshja e fëmijëve nuk karakterizohet me vija specifike të veçanta nga të rriturit, përveç se ka dimensione më të vogla. Fëmijët (vajzat) derisa nuk e kanë fituar menstruacionin e parë nuk kanë mbajtur shamia në kokë. Me vetë veprën e vënies së shamisë në kokë është llogaritur se vajza është e pjekur për të martuar (“hazër për të martuar”, “vtasalo za mazhenje”).

Që të përfshihet veshja popullore tradicionale e Ballkano Egjiptianeve nëpër krejt Ballkanin i nevojshëm është studim i veçantë ballkanologjik me çka do të ishin përfshirë të gjithë llojet dhe varietetet e veshjes, varësisht nga vendi i banimit, ndikimi i rrethinës, kushtet natyrore-geografike, profesionet (mjeshtrit), statusi social, moshë, ndikimet e jashtme, religjioni etj.

## **KULTURA SHOQËRORE**

Kultura shoqërore e Ballkano Egjiptianëve sot është e njëjtë ose e ngjashme me kulturat gjegjëse të popujve dhe bashkësive të tjera ballkanike nëpër Ballkan, varësisht nga rajoni etnografik. Është e krijuar një rrjedhë mileniumesh, shekujsh dhe dekadash pas ardhjes të tyre në Gadishullin Ballkanik. Në shtresën e vjetër Egjiptiane të kulturës shoqërore, nga çka sot ende mund të ndjehen gjurmë, të pranuar janë një varg i komponentëve nga ndikimet e jashtme, të shkaktuara nga kolonizimi dhe kalimi i popujve të tjerë në Ballkan, si dhe nga ndryshimet religjioze dhe shoqërore në këtë periudhë të gjatë kohore.

Zhvillimi i kulturës shoqërore të Egjiptianëve në Ballkan është zhvilluar nëpër disa etapa, përkatësisht faza dhe çdonjëra prej tyre karakterizohet me specifikat përkatëse, që paraqiten nën ndikime të ndryshme shoqërore dhe të tjera. Prej aty, në jetën shoqërore të Egjiptianëve me më tepër përshtypje ishin komponentët familjare dhe sociale-klasore, që në një farë mënyre fuqishëm është reperkuar gati mbi gjithë jetesën e njerëzve. Në këtë kuptim në literaturë mund të takohet, se si disa autorë, duke përshkruar elementet e përcaktuara nga jeta shoqërore e popujve veças Ballkanik, pa dijeni ose ndoshta me qëllim, nuk kanë dashur të thonë se bëhet fjalë për elemente të cilat janë analoge ose të ngjashme me ato në Egjipt, ndërsa edhe më pak se si kanë arrit ato elemente në Ballkan.

Sa për shembull, ta përmendim jetën e ashtuquajtur lakonike të Spartanëve. Pikërisht ata prej vitit të shtatë i kanë marrë fëmijët meshkuj prej nënave të tyre dhe shkollimi i tyre ka kaluar në kujdes të shtetit. Nga viti 14 deri në vitin 20 djemtë e rinj kanë qenë të ndarë në grupe nën mbikëqyrje të djemve më të mëdhenj dhe kanë shërbyer një lloj stërvitjeje paraushtarake, dobët të veshur, të ushqyer dhe të ekspozuar në testim mizor të durimit. Në fund të këtyre viteve ushtruese, nëse me sukses i kanë kapërcyer dhe ngadhënjyer aftësitë e parashikuara, djemtë e rinj në kuptim

të plotë janë bërë Spartak-kanë jetuar në kazerma dhe janë ushqyer në mensa të përbashkëta. Kur do të ishin martuar, nuk do të kishin mundur të krijojnë familje me gratë e tyre, por e kanë vazhduar jetën në kazernra, ndërsa gruan e kanë vizituar vetëm fshehtas (**Ilustrovana istorija sveta**, 1983: 120).

Për krahasim kur Herodoti shkruan për Egjiptin, e shkruan këtë: “Ai është rajon në Kalasiret, të cilët kur kanë qenë të më shumë-numërt, kanë qenë dyqind e pesëdhjetë mijë burra. Dhe atyre nuk ju ka qenë e lejuar të merren me aftësi të tjera, por vetëm me ato ushtarake. Shërbimin ushtarak e trashëgojnë djali nga babi. A e kanë pranuar atë Helenët nga Egjiptianët, unë me siguri nuk mund të vërtetoj, sepse e shoh se edhe tek Libianët dhe gati tek të gjithë barbarët ata që merren me zanate perceptohen si qytetarë më të ulët; edhe ata edhe fëmijët e tyre. Llogaritet se ata që nuk kryejnë punë zanati janë më fisnik, e posaçërisht ata që janë në shërbim ushtarak. Ajo është prezentë edhe tek të gjithë Helenët, ndërsa më së tepërmi tek Llakademojët...”<sup>270</sup>.

Nga Herodoti mund të marrim vesh edhe atë se edhe disa marrëdhënie demokratike dhe ligje në Athinë janë të marra nga Egjiptianët, siç është rasti me Sollonin i cili i ka sjellë ligjet e para të rrepta në Athinë në lidhje me pronën dhe mundin e ndershëm<sup>271</sup>.

Në shoqërinë e Vjetër egjiptiane, familja ka qenë njësia kryesore në shoqërinë. Burri dhe gruaja që kanë lidhur kurorë kanë krijuar amvisëri të pavarur. Monogamia siç duket ka qenë e zakonshme, edhe pse nuk ka ekzistuar ndalim që burri të ketë më tepër se një grua<sup>272</sup>. Kjo është krejtësisht e kuptueshme me konsideratë të kontratës martesore shumë serioze që i mbron të drejtat e pasurisë së gruas. Burri dhe gruaja bashkë kanë arritur pasuri dhe në mënyrë të barabartë kanë marrë pjesë në krijimin e amvisërisë të pavarur. Secila anë ka mundur ta ndërpres kontratën me shkurrëzim, dhe në atë rast gruas i është kthyer pjesa e sajë e pasurisë. Vetëm tradhtia është dënuar me përzënie nga shtëpia. Megjithatë, fëmijët në martesën në çdo rast kanë qenë të siguruar. Burri i cili nuk i ka kryer detyrat e martesës ka mundur të obligohet që të paguaj të holla për mbajtjen e fëmijëve. Edhe në martesë, gruaja ka mundur të kërkoj udhëheqje të plotë me pjesën e pasurisë që bashkë e kanë arritur. Nuk dihet a është festuar

<sup>270</sup> Herodot, II/166-167

<sup>271</sup> Herodot, II/177.

<sup>272</sup> Në përgjithësi për të drejtat dhe gjendjen e gruas në Egjiptin e Vjetër shiko: Schafik Allam, *Everyday life in Ancient Egypt-The status of women and marriages in Ancient Egypt*, Guizeh, 1990, 27; Michael Rice, *Who's who in Ancient Egypt*, London-New York, 1998, xxiv-xxv.

kurorëzimi edhe në ndonjë mënyrë tjetër përveç se me ligj, as se deri në cilën masë lidhja e kurorës ka qenë përjashtimisht kontratë e prindërve, edhe pse pas së gjithash duket se ajo ka qenë vetëm një dok i shtresave më të ulëta (**Ilustrovana istorija sveta**, 1983: 85).

Se Llakademojët d.m.th. banorët e Peloponezit, janë të ngjashëm me Egjiptianët e Vjetër, Herodoti na jep edhe një shembull:” Të rinjtë kur në rrugë takohen me njerëzit më të moshuar, largohen dhe ua lirojnë rrugën ndërsa kur këto do të hyjë diku, të rinjtë çohen në këmbë. Te asnjë Helen nuk takohet kjo: në vend që të përshëndeten, kur takohen në rrugë, Egjiptianët përulen duke i lëshuar duart deri në gjunjë”<sup>274</sup>.

Kultura shoqërore e Ballkano Egjiptianëve për shkak të një varg rrethanash historike dhe të tjera, ishte e kushtëzuar të zhvillohet në mënyrë paralele dhe e varur nga faktorët material dhe kulturor. Megjithatë, pavarësisht nga ajo, në kulturën shoqërore të Ballkano Egjiptianëve kemi edhe disa përcaktime më të diferencuara dhe atë në varg drejtimesh, sidomos në organizimin e jetës familjare, në ruajtjen e lidhjeve farefisnore, organizimin e jetës në bashkësinë, në asociacionet profesionale dhe të tjera.

Organizimi feudal ekzistues në Ballkan pas ardhjes të Osmanlive, filloj të lëviz nëpër skajet e tyre. Ashtu gjendja shoqërore e njerëzve ishte mjaft e ndërlikuar për shkak se në kundërshtimet e deriatëhershme klasore ishin të lidhura edhe ato nga natyra religjioze.

## **FAMILJA INOKOSE (NUKLEARE)**

Familja inokose, si qelizë e lashtë shoqërore që e njihnin të gjitha shtresat sociale, ishte e pranishme tek Egjiptianët e Ballkanit, posaçërisht tek ato që kanë jetuar dhe jetojnë nëpër qytetet, sidomos zanatçinjtë.

Familja e tillë, e cila me siguri është e trashëguar që nga Egjiptianët e Vjetër, krijohet për kuptueshmëri të jetës së tillë, për sigurimin e ekzistencës reciproke etj. por para së gjithash për vazhdimin e funksioneve biologjike, përkatësisht krijim brezi dhe ruajtje dhe edukim të tyre.

Me kalimin prej matriarkatit në patriarkat, përkatësisht me imponimin e religjioneve monoteiste (krishterimi, e më vonë islami), gruaja në familjen mori rol sporadik. Ajo e humbi të drejtën të kundërshtoj burrin. Ajo detyrohet që të pajtohet dhe të pranoj qëndrimet dhe vendimet e të shoqit edhe në situata kur thellë dhe intimisht nuk i arsyetonte. Mendimi i

---

<sup>274</sup> Herodot, II/80.



saj u bë jo relevant ndërsa në të shumtën e rasteve edhe nuk kërkohet. Thjesht ajo filloj të trajtohet si pronë më e mirë e burrit, si një lloj sendi. Situata me të drejtat e gruas, u bë edhe më e vështirë me ardhjen e Osmanlive dhe instalimin e religjionit islam në një pjesë nga popujt Ballkanik. Gruaja e islamizuar nuk guxonte as edhe një pjesë të trupit të saj të jetë e zbuluar para të tjerëve-njerëzve të huaj. Në disa raste, gruaja nuk kishte të drejtë që vetë të largohet nga shtëpia, edhe nëse dëshironte që t'i vizitoj prindërit e saj edhe kur ata kanë jetuar në fqinjësi. Megjithatë, në krahasim me bashkësitë e tjera ballkanike gratë tek Ballkano Egjiptianët kanë gëzuar autoritet diçka më të lartë dhe liri më të madhe, se sa të tjerët, si për shembull Shqiptarët, Turqit, Grekët, Maqedonasit, Bullgarët, Malazezet etj. Kjo edhe më tepër ka qenë e dukshme tek Ballkano Egjiptianët të cilët kanë jetuar në lagjet fshatare të maleve. Liria më e madhe tek gratë Egjiptiane mundet të shihet edhe nga ajo se ato rrallë kanë ven ferexhe, e ajo disa herë e ka zëvendësuar ose i ka ndihmuar burrit në punëtorinë farkëtare, kur është dashur të shiten prodhimet. Por gjithashtu, për dallim nga popujt e tjerë mysliman, tek Ballkano Egjiptianët gjatë dasmave gratë nuk kanë qendruar gjithmonë në dhomë të ndarë, por nganjëherë edhe në një dhomë të njëjtë me burrat, gjë që nuk mund të takohet tek popujt e tjerë të islamizuar ballkanik.

Trajtim të ngjashëm të padrejtë në familjen inokose kanë pasur edhe fëmijët. Pabarazia e tyre vinte deri në shprehje më të madhe edhe për shkak të moshës. Nga fëmijët kërkohet që punët e dhëna nga babai ti kryejnë pa vonesë. Ai nuk i pyeste fëmijët kur vendoste për zgjedhjen e gruas ose burrit të ardhshëm. Shumë të shpeshta kanë qenë dënimet për gjëra të pavlefshme. Pavarësisht nga ajo të dy prindërit, sipas normave tradicionale, kanë pasur obligim të kujdesen për edukimin e fëmijëve të tyre. Babi në këtë drejtim ishte më i angazhuar me djemtë, ndërsa nëna me edukimin e vajzave. Por, edhe nëna edhe babai janë kujdesur njësoj në procesin e edukimit, tek fëmijët e vetë ta thellojnë dashurinë për punën, më saktë që të jenë punëtorë. Gjatë kësaj, babai e këshillonte djalin për sekretet e zanatit të farkëtarisë ose zanat tjetër, për bujqësinë etj., ndërsa nëna i mësonte vajzat të jenë amvise (ta mbajnë higjienën dhe rregullimin e shtëpisë, të endin, të qëndisin, të gatujnë, të lajnë etj.). Edukimi i fëmijëve zhvillohet edhe në kahe tjera, veçanërisht kujdeseshin që fëmijët të jenë të ndershëm, të gatshëm të ndihmojë kur dikush ndodhet në situatë të pakëndshme, të sillen në mënyrë korrekte dhe me respekt ndaj më të vjetërve, të jenë të shoqërueshëm dhe tolerantë me të gjithë bashkësitë që në mes multikulturor dhe multilingual i kanë mësuar të gjitha gjuhët që janë përdorur etj. Vëmendje e madhe i është kushtuar edhe mësimi religjioz, me qëllim që

ashtu si duhet të respektohen detyrat që rridhnin nga konfesionit i krishterë ose islam.

Trashëgimi në familjet inokose në mënyrë të barabartë ju përkiste të gjithë djemve, ndërsa vajzat nuk kanë pasur të drejtë trashëgimi, përveç në rastet kur ndonjë familje nuk ka pasur pjellje mashkullore. Por, shumë herë trashëgimia nuk ka mundur të ndahet në pjesë të barabarta sa ka pasur djem, ndaj janë paraqitur edhe shumë probleme. Pjesë më të madhe nga trashëgimia megjithatë ka fituar djali i cili me familjen e tij ka qendruar të jetoj me prindërit deri në vdekjen e tyre.

## **FAMILJA E ZGJERUAR (BASHKËSIA FAMILJARE)**

Familja e zgjeruar e njohur edhe si bashkësi gjaku ose bashkësi familjare, si grup më madh njerëzish me lidhje të afërt gjaku, kishte vend të veçantë në jetën shoqërore të disa Egjiptianëve, sidomos në jetën e atyre që jetonin nëpër fshatra, në Kosovë, Shqipërinë Veriore, Mal të Zi dhe pjesë të tjera. Ajo paraqiste bashkësi më të fuqishme se sa familja inokose. Prej aty, familja e zgjeruar ose bashkësi familjare, në të cilën ishin të përfshirë më tepër bashkëshortë me pasardhësit e tyre (të cilët rrjedhin nga paraardhës të njëjtë nga vija mashkullore), paraqiste organizatë të rëndësishme shoqërore, përkatësisht institucion specifik shoqëror.

Bashkësi e gjakut gjatë kohës paraqiste mjet më të sigurt, për vetëruajtje të anëtarëve, ndërsa njëkohësisht ishte edhe më e fortë nga prodhimi se sa familjet veçase, sepse dispononte me dorë më të madhe pune, ndaj mund të merrej me sukses edhe me bujqësi, zanatçi por edhe me blegtori. Bashkësitë e gjakut nganjëherë kanë numëruar edhe 50 anëtarë, por më shpesh deri 25-vetë. Me këtë bashkësi udhëhiqte i zoti i shtëpisë (kesebashija, domaçinot na kuçata), zotëri, dhe zonja e shtëpisë (gospogjata na kuçata), gruaja e tij ose grua tjetër çdoherë më e moshuar, e aftë për udhëheqje me gratë tjera në bashkësinë. Gjithë anëtarët e bashkësisë së gjakut të hollat e fituara i shtinin në arkën e përgjithshme. Nga ana tjetër të gjithë anëtarët kishin të drejta të njëjta në bashkësinë, ishin krejtësisht të barabartë. Zgjedhjet më themelore nga interesi i përbashkët për të gjithë anëtarët e familjes së zgjeruar janë sjellë në udhëheqje të kryeplakut-zotit të shtëpisë. Ai ka kryer edhe shpërndarje të detyrave të punës, gjatë asaj duke bërë llogari për ngarkim të barabartë, por edhe për afinitetet ekzistuese të individëve ndaj lloje të veçanta të punëve.

Vënia hierarkike në familjen e zgjeruar i eliminonte marrëdhëniet demokratike. Ajo rridhte nga mosha dhe përkatësia gjinore. Për ndonjë lloj barazie ka mund të bëhet fjalë vetëm midis meshkujve me moshë madhore dhe atë nëse kanë qenë në moshë për afërsisht të njëjtë. Gratë kanë pasur status personash më pak të rëndësishëm, detyra e të cilave ishte që t’ju jenë të dëgjueshme bashkëshortëve të tyre, ti kryejnë punët shtëpiake dhe të lindin fëmijë. (Denich, B. 1974: 243-262). Në familjen e zgjeruar megjithatë disa persona kishin trajtim të veçantë. Pikërisht, ndryshe është vepruar ndaj më të moshuarve, ndaj të sëmurëve, grave shtatzëne dhe ndaj fëmijëve.

Në familjen e zgjeruar në pronë personale kishin numër të kufizuar gjërash. Kryesisht veshjen personale, ndërsa tek nuset dhe gjithë atë që ajo e ka sjellë me çejzin (mirazin).

Mënyra kolektive e jetës dhe ekonomisë, e përfaqësonte atë fuqi që e mundësonte ekzistimin e familjes së zgjeruar, deri në mesin e sh.XX. Edhe në ato rrethe ku familjet e zgjeruara më shpejtë u shuan, gjurmët nga jetimi i përbashkët i dikurshëm gjatë kohë nuk humbin

Ndarjen e familjes së zgjeruar e kushtëzonin dy shkaqe themelore. Njëra nga ato ka rrjedhur nga zmadhimi i numrit të anëtarëve, ndërsa shkaku i dytë për shkak të prishjeve më të rënda të marrëdhënieve reciproke (ndër-njerëzore).

Me ndarjen e familjes të zgjeruar (shkatërrimin e bashkësisë familjare), pavarësisht nga shkaqet, numri i njerëzve të lidhur me gjak farefisnor zgjerohet. Kështu krijoheshin familje inokose ose familje të zgjeruara të reja (më të vogla), që i lidhte prejardhja e përbashkët. Ato zakonisht jetonin në fqinjësi të drejtpërdrejtë, në një mëhallë ose në fshatra ose qytete fqinje. Ato janë përfaqësues të ashtuquajturave “soje” të përbëra nga numër i përcaktuar farefisesh ose ndarës. Prej aty si sigurim për sojin mund të dëgjohej edhe fjala “fis” (rod) ose “fise” (roda). Lidhja midis familjeve që i përkasin një soji ruhet nga ana mashkullore. Lidhjet në sojin më shpesh varen (ruhen) deri në brezin e tretë. Fëmijët nga brezi i katërt e më tej më nuk llogariten si soj, dhe midis tyre mund të lidhet kurorë, që ka qenë shumë shpesh edhe rast. Për atë Ballkano Egjiptianët, janë bashkësi për afërsisht shumë e mbyllur endogame.

Për atë shkak, edhe A.Primovski do të vërej se Egjiptianët në Madan e kanë ruajtur “pastërtinë rasore” të tyre. Farkëtarët nga Madani dhe nga lagjet e tjera të Rodopeve, midis veti familjarizohen. Djali dhe vajza nëse nga kolektivi i tyre madanas nuk mund të gjejnë shoq të përshtatshëm, ikin në grupet e vogla të pjemeve në fshatrat dhe qytetet e rrethit. Nëse kandidati për tu martuar edhe aty nuk ka mundur të gjejë grua vëmendje drejton kah popullata bullgare e vendit. Por këtu, djali Egjiptian-Agutp, has në

rezistencë serioze. Bullgarët myslimanë-Pomakët në Madan dhe fshatrat e afërta të Rodopeve, sado që të jenë të shoqërueshëm me bashkëbanorët dhe jetojnë me to që nga gjysh dhe stërgjysh, në asnjë rast nuk duan të familjarizohen me to. Shumë rrallë ndodh që vajzë e re dhe e bukur Bullgare e islamizuar të pajtohet të martohet me djalë Agupt. Nëse kjo ndonjëherë ka ndodhur ato janë gëzuar shumë dhe kanë bërë shaka me Bullgarët myslimanë. Disa herë ka ndodhur që, ndonjë grua ve ose vajzë të cilës “i kanë kaluar vjetët” ose ka pasur ndonjë të metë serioze fizike, të vendos të marrë burrë nga rrethi i “Farkëtarëve”. Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet familjare-bashkëshortore të Aguptëve duhet të thuhet edhe ajo se ata kanë dhënë vajzë beqare për grua të Bullgari mysliman (**Примовски, А.** 1955: 256). Situata e tillë me martesat e përziera të Ballkano Egjiptianëve, është gjendur në Ballkan. Vetëm në Republikën e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, pikërisht gjatë organizimit komunist, kemi numër të zmadhuar të martesave të përziera të Egjiptianëve me bashkësi të tjera, por në atë kurorë bashkëshortja ose bashkëshorti Egjiptian, në raste më të mëdha e ka fshehur prejardhjen e vetë etnike<sup>276</sup>-mimikria. Megjithatë, nga ana tjetër nëpërmjet të kësaj mos përzierje kurorash, Egjiptianët kanë arritur të ekzistojnë si bashkësi, por edhe të jenë një ndër katalizatorët themelor për zgjuarjen e vetëdijes etnike. Gjatë orvatjeve të ndryshme për përvetësimin e pjesëtarëve të kësaj bashkësie etnike nga ana e të tjerëve, do t’ju ishin përgjigjur “në rregull ne jemi të njëjtë, por a do të na kishe dhënë vajzën për djalin (ose relacione të ngjashme)”. Përgjigja çdoherë ka qenë “jo”, me çka kanë rënë shumë orvatje për përvetësim të Ballkano Egjiptianëve.

## LLOJE TJERA TË ORGANIZIMIT

Midis Ballkano Egjiptianëve, nuk ekzistojnë bashkësi të veçanta të cilat bazohen në princip territorial, edhe pse nga disa toponime<sup>277</sup> dhe nga literatura mund të shihet se më parë, kanë ekzistuar bashkësi të përcaktuara

<sup>276</sup> Në shtypin në vitin 1999 në Shqipëri kishte një mbishkrim interesant, për një ndodhi në të cilën burri Egjiptian (inxhinier) është martuar me një Shqiptare duke e fshehur prejardhjen e vetë dhe familjen e vetë. Por problemet janë paraqitur kur fëmija i tyre është lindur me ngjyrë më të errët të lëkurës. Kur gruaja ka marrë vesh se burri i saj është “Evgjit” menjëherë ka kërkuar që të shkurojëzohet.

<sup>277</sup> Toponimet si “Fshat i Egjupve” ose fshatra të cilat edhe sot ekzistojnë me emrin “Kovaç”, “Kovaçnica” tregojnë se kanë ekzistuar fshatra në të cilat në numër më të madh kanë jetuar pjesëtarë të këtij etnosi.

fshatare. Megjithatë nuk mund të gjenden materiale të cilat do të na kishin dhënë informata më detale për atë se si ka qenë organizimi në bashkësitë fshatare. Ndërsa, nga ajo që mund të shikojmë nga disa fshatra në të cilat jetojnë numër i rëndësishëm pjesëtarësh të kësaj bashkësie, si për shembull në rajonin e Strumicës, mënyra e jetës dhe organizimi në asgjë nuk dallohet nga ajo që e praktikojnë fshatrat e tjera në bashkësitë e rrethit.

Një ndër organizimet më karakteristike të Ballkano Egjiptianeve sidomos e atyre nëpër qytetet, ka qenë organizimi në organizata esnafe. Ato në periudhën e qeverisjes Osmane filluan të pranojnë norma të ndryshuara në lloj. Me aktin ligjor të Mustafa III në vitin 1773 ishte e rregulluar përbërja e drejtorisë esnafe. Në përbërje të saj përveç ustabashisë (kryeplak i organizatës), çaushit dhe gramatikut, hynin edhe 12 mjeshtër më të rritur, të zgjedhur në mbledhje të përgjithshme (përkatësisht longja), që ishte organi më i lartë i esnafit. Në çdo esnaf zgjidheshte edhe nga një “qaja” (ndërsa më parë për të gjithë esnafet ka ekzistuar vetëm një “qaja”, i cili ishte zgjedhur përjetshëm). Derisa ustabashija kujdesej për pajtimin e marrëdhënieve midis anëtarëve të esnafit “qaja” e përfaqësonte organizatën para organeve të qeverisë. Esnafet kanë pasur për qëllim ti mbrojnë interesat e veta, nëpërmjet mbajtjes së një lloj drejtpeshimi të tregut, ndërsa kundër konkurrencës jo lojale midis veti, në kohë kur një pjesë e zanatçinjve është marrë edhe me veprimtari tregtare. Esnafi veças është kujdesur për lartësi përkatëse të moralit të punës midis anëtarëve të vetë. Përveç detyrës për ndihmë midis veti, ata ishin të detyruar ndaj myshterinjve të sillen në mënyrë korrekte. Ishin të obliguar të ofrojnë shërbime dhe prodhime me kualitet, përkatësisht mall, dhe ti respektojnë çmimet kontraktuese.

Në kornizat e esnafit ka ekzistuar hierarki e rreptë. Kryepleqësia është respektuar në të gjitha bashkësitë. Në shputë më të ulët kanë qenë çirakët. Statusi i tyre ka qenë i pavarur sepse më tepër ju kanë shërbyer mjeshtërve, se sa e kanë mësuar zanatin. Secili çirak, në moshë prej 12-15 vjet, kryesisht pas stazhit dyvjetor, është bërë “kallfë i vogël”, ndërsa me kalimin edhe të dy vitesh “kallfë i madh” ose “bash kallfë”.

Çdo esnaf ka disponuar, përkatësisht ka mbajtur defter të tij esnafi (tefter). Në të ishin të shënuara të gjitha të dhënat më të rëndësishme nga jeta dhe puna e esnafit. Evidencë precize e veçantë është bërë për të ardhurat dhe të dalat e mjeteve të përbashkëta. Esnafi ka pasur edhe “vulë” të vetë (mur), kasafortë dhe shenja të tyre. Esnafi ka pasur edhe një lloj kompetence gjyqësore – ekzekutive. Ashtu, varësisht nga vepra e inkriminuar mjeshtrit janë dënuar me vërejtje gojore, paralajmërim publik, ndalim për hapjen e shitores për kohë të caktuar, deri në lajmërimin e dënimit dhe përjashtim nga esnafi.

Organizata esnafe përkundër fleksibilitetit të saj të mendimit dhe pamundësi që ti përshtat aktivitetet e veta në provokimin që e barte koha e re, luajti rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të forcave prodhuese dhe mbrojtje nga eksploatimi feudal, në periudhë të përcaktuar. Megjithatë, ajo nuk mund të ekzistonte pas skadimit të dy dekadave të para të shekullit XX, edhe pse shkatërrimi i esnafeve filloi më parë. Ata ishin të diskualifikuar nga legjislacioni zanateli, parë nga aspekti formal, ndërsa në realitet u shkatërruan nën goditje të prodhimtarisë të mallit të organizuar në princip më bashkëkohor.



## **KULTURA SHPIRTËRORE**

Kultura shpirtërore e Egjiptianëve të Ballkanit është tejet e pasur dhe e shumëllojshme. Kjo kulturë te kjo bashkësi në përqindje të madhe është e ngjashme ose e njëjtë me kulturën përkatëse të popujve të tjerë të afërt ose fqinjë dhe bashkësitë etnike nëpër të gjithë Gadishullin Ballkanik. Megjithatë në kulturën shpirtërore të popujve dhe bashkësive në Ballkan ekzistojnë numër i madh karakteristikash që janë analoge në disa përkatësi nga Egjipti i Vjetër, të cilat elemente me siguri në Ballkan në masë të madhe janë sjellë nga kolonistët egjiptian.

Me vendosjen e kolonistëve egjiptian në Ballkan është sjellë edhe mitologjia e vjetër egjiptiane, në formë burimore por edhe të transformuar, si edhe elemente të tjera nga kultura shpirtërore në Ballkan, për çka do të flasim më vonë. Pranimi i religjionit të krishterë në sh. IV nga era jonë ka qenë proces i pashmangshëm me ndikimet e veta pozitive, por edhe negative mbi Ballkano Egjiptianët, jetën dhe zhvillimin e tyre kulturor dhe shpirtëror në Ballkan.

Me integrimin e kulturës shpirtërore të vjetër egjiptiane me vlerat kulturore që i kanë gjetur dhe të sjellat më vonë në Ballkan, kultura shpirtërore ishte mjaft e pasuruar në varg drejtimesh. Ajo mund të ndjehet në dituritë për botën dhe popujt, në të ashtuquajturën matematikë popullore, astronominë popullore dhe meteorologjinë, medicinën popullore etj. ndikimi i jashtëm nuk e kaloi tërthorazi as krijimtarinë e pasur gojore popullore (proze ose poetike), me sizhe të reja ose më universale, por në disa raste kjo krijimtari e Ballkano Egjiptianëve është paskrupuloze dhe e refuzuar nga ana e popujve të tjerë ballkanik dhe e paraqitur si e tyre.



Ardhja e osmanëve dhe instalimi i religjionit islam në pjesë të caktuara popujsh dhe bashkësish ballkanike, midis të cilëve edhe Ballkano Egjiptianëve, ka pasoja të veta afatgjate me konotim pozitiv ose negativ, në kulturën shpirtërore dhe etno-kulturën tjetër, e cila zgjat me shekuj deri më sot. Ata sidomos ishin të fuqishëm midis atyre njerëzve që jetonin nëpër qytete. Ajo posaçërisht manifestohet në gjuhën, përkatësisht në fillimin e përdorimit të ashtuquajturave- turqizma, nga të cilat disa mbetën si pronë e përhershme edhe në gjuhën e sotshme letrare të popujve ballkanik. Në të ashtuquajturin ndikim oriental kulturor (Orient do të thotë Lindje) u vendos edhe në krijimtarinë popullore gojore (me marrje motive nga Orienti), në shpjegimin e fenomeneve të ndryshme natyrore si dhe në besime të ndryshme që ishin të mbarsura me varg manifestime të reja besëtyte (përdorim amuletsh të reja, shenja magjike, formula dhe gjëra të ngjashme).

Kultura materiale dhe shoqërore si dhe gjuha janë shumë të nënshtruara dhe erozive në ndikime dhe përshtatje ndaj trendëve dhe ndikimeve natyrore-geografike dhe të tjera sociologjike-shoqërore. Për dallim nga ajo, kultura shpirtërore, edhe përveç asaj që përjeton ndryshime të përcaktuara, megjithatë mesazhi që duhet të tejbartet në gjeneratat e ardhshme është i njëjtë ose i ngjashëm. Ceremonitë dhe doket edhe nëse përjetojnë ndryshime të përcaktuara në formën e realizimit, megjithatë qëllimi dhe funksioni për shkak të së cilit kryhen shumë vështirë ose gati asnjëherë nuk ndryshohet, për atë, me qëllim që nëpërmjet elementeve të caktuara të kulturës shpirtërore, të gjenden edhe disa relacione të mundura me kulturën e njohur shpirtërore të egjiptianëve të vjetër nga literatura. Në këtë kapitull do të bëhen komparacione dhe analogji të përcaktuara me kulturën shpirtërore të Ballkano Egjiptianëve. Një hapi krahasues i tillë na është i domosdoshëm që të improvizojmë kontinuitet të mundshëm të përcaktuar ose diskontinuitet në elementet veçse të kulturës shpirtërore tek Ballkano Egjiptianët.

Në asnjë rast nuk do të thotë se lidhjet e njëjta rastësore, ngjashmëritë dhe lidhjet analogjike të elementeve nga kultura shpirtërore nga kultura e Ballkano Egjiptianëve me ato të Egjiptianëve të Vjetër në Egjipt, automatikisht duhet të jenë edhe lidhjet etnogjenetike. Disa elemente të përshtatshme, pozitive dhe të pranueshme nga kultura shpirtërore shumë shpejtë përhapen nga elementet e kulturës materiale dhe shoqërore. Meqë në Gadishullin Ballkanik shumë popuj dhe bashkësi etnike kanë elemente të njëjta ose të ngjashme në kulturën shpirtërore, në asnjë rast ajo nuk do të thotë se ata të gjithë midis veti gjithsesi duhet të kenë lidhje etnogjenetike.

Në çdo rast lidhjet dhe relacionet në kulturën shpirtërore të bashkësive dhe popujve ballkanik, midis të cilëve edhe të Ballkano

Egjiptianëve, me elemente të përcaktuara të kulturës shpirtërore të Egjiptianëve të vjetër në Egjipt, por edhe të bashkësive të tjera antike në Mediteranin Lindor, që e kemi të njohur nga literatura dhe gjurmët e tjera të lënë, duhet të jenë lëndë të një analize më të gjerë interdisciplinare dhe hulumtimi shkencor.

## DITURITË POPULLORE

Dituritë popullore paraqesin shumë njohuri dhe besime për gjithçka që na rrethon d.m.th. për natyrën, si dhe për njeriun dhe jetën e tij si i vetëm ose anëtar i ndonjëres nga qelizat shoqërore. Për dukuritë plotësisht ose pjesërisht të pashpjeguara përgjigjet janë të pranuar nëpërmjet sugjestionëve të religjionit, më saktë shpjegohen si punë e Zotit, në të cilën njerëzit nuk kanë të drejtë të përzihen. Me zhvillimin e shkencave natyrore dhe të tjera, shumë gjëra që ishin të fshehura me perden e paditurisë, gradualisht zbuloheshin.

### Për njerëzit, Tokën dhe gjithësinë

Rrallë në cilëndo fushë nga dituritë popullore ka njohuri më fantastike, sesa është rasti me parafytyrimet për vetë vetveten dhe në përgjithësi për njerëzit dhe popujt, mandej për planetin në të cilën jetojmë dhe gjithësinë që na rrethon. Ajo është krejtësisht e kuptueshme kur shumë gjëra nga ajo sferë përfaqëson mister të madh, sqarimi i të cilit i inkurajonte njerëzit më tepër të besojnë në legjendat sepse vetëm në ato ofroheshin disa përgjigje, në kalimin e shekujve dhe shumë mileniumesh.

Shumica tepër e madhe e njerëzve në Ballkan, midis të cilëve edhe e Ballkano Egjiptianëve, pa dallim të besimit fetar, besonin dhe besojnë se “Zoti ose Allahu, i përjetshëm dhe pa fillim, i ka krijuar tokën, qiellin dhe njerëzit, të gjithë qeniet e pashme dhe të papashme. Njeriu është qenie e dyfishtë: trupi i tij është material, i vdekshëm dhe i shkatërrueshëm (i bërë nga dheu tek i cili kthehet), ndërsa shpirti ka qenë i përjetshëm”.

Në mitologjinë e vjetër egjiptiane krijimi i botës është besuar se ka dalë nga oqeani botëror NU, ku ka ekzistuar Neberçer (Zoti deri në kufijtë më të mëdhenj) ose Nëtër (**Volis Badž, E.A.** 1985: 13-14). Ai zot e mori formën e krijuesit-Khepri. Se pse e ka shqiptuar emrin e vetë dhe e ka vërtetuar vendin në të cilin do të qëndroj, Khepri ose Ra, zoti i Diellit, është bashkuar me hijen e tij dhe ashtu e ka krijuar Shu-në, zot i atmosferës së

thatë dhe Tifnutin, zot i ujit mbi qiellsinë. Mandej, ato dy kundërshtime janë bashkuar dhe e kanë fituar brezin Nut (qiellin) dhe Keb (tokën). Gjatë gjithë ditës, derisa Dielli e ka kaluar rrugën e tij prej lindjes kah perëndimi, ndërsa toka Keb ka qëndruar në vend, Nut ka qëndruar në vendin e vetë mbi Tokën, por derisa është lëshuar errësira, ajo gradualisht ka zbritur ka zbritur derisa nuk është ndaluar në kraharorin e Kebit, zotit të tokës. Keb dhe Nut janë prindërit e Ozirisit dhe Izidës, Setit dhe Neftidës (**Robinson, H.S., Wilson, K.** 1976: 7-8).

Në Gadishullin Ballkanik nëpër histori kanë ekzistuar më tepër parafytyrime për sqarimin e tokës dhe qiellit. Më i përhapuri ishte besimi se toka është një lloj pllake (tepsi) e mbuluar nga qielli, që ka formë saçi dhe se është e palëvizshme dhe rreth saj rrotullohet Dielli dhe Hëna, d.m.th. në mbrëmje Dielli lëviz nën të, ndërsa saçi (qielli) në të cilin janë të ngjitura yjet, ulet. ky besim është shumë i ngjashëm dhe analog në besimin e vjetër egjiptian për Nutin dhe Kebin, e meqë saçi dhe tepsia janë prodhime të farkëtarisë, është e mundur që ky besim në Ballkan të jetë i instaluar nga kolonistët egjiptian, përpunues të metalit. Për tokën të paramenduar si pllakë, në Ballkan besohej se ajo shtrihet në kurriz të kive, të cilët me lëvizjet e tyre i shkaktonin tërmetet. Duke pasur parasysh se edhe kau përkatësisht biku (demi) Apis është një ndër kafshët më të respektuar në Egjipt të Vjetër, mundësia për ndikimin e vjetër egjiptian në këtë besim është edhe më e madhe. Përndryshe thellë është e rrënjësor ndjenja për respekt ndaj tokës, të cilën, në Ballkan e quajnë “nënë tokë” sepse ajo i ushqen njerëzit, sepse lind drithëra, pemë, perime etj., i dhuron edhe gjëra të tjera (material për ndërtim shtëpish, xehe etj.).

Edhe pse mësimi për gjykimin e tmerrshëm për njerëzit në Gadishullin Ballkanik në masë të madhe është i instaluar me paraqitjen e krishterimit, nuk kemi njohuri për të se sa Ballkano Egjiptianët kanë arritur ta imponojnë tek bashkësitë e tjera në Ballkan besimin e tyre për udhëtimin e shpirtit pas vdekjes (shpirt në Egjipt të Vjetër është quajtur Ka), nëpër lumin, deri në gjykimin e tmerrshëm, ku është dashur ta gjykoj Ozirisi për mëkatet e tij gjatë kohës së jetesës, andaj sipas asaj që edhe njeriu të ringjallet, siç është ringjallur Ozirisi (**Фејзеп, И.И.** 1992: 463). Këto besime që kanë ekzistuar në Egjiptin e Vjetër, mund të takohen nëpër shumë shfaqje në piramidat, tempujt dhe papiruset, qoftë në formë figurative ose në formë tekstesh, që sot quhen “Libri i të vdekurve”. Ndërsa meqë në derën e hyrjes të varrezave në Mikenë, është i vizatuar luani i dyfishtë Aker, simbol i ringjalljes së Ozirisit, me siguri mund të themi se besimi i tillë ka ekzistuar në Ballkan në kohën antike, me siguri i sjellë në Ballkan nga kolonistët egjiptian. Meqë krishterimi, e mandej edhe islami

kanë inkorporuar besime nga civilizimet e mëparshme, pranimi i besimit në ringjalljen e Krishtit dhe besimit për jetë pas-varrore dhe gjykimin e tmerrshëm që e ka ofruar krishterimi për pjesëtarët e Ballkano Egjiptianëve nuk ka qenë i huaj, e ndoshta edhe për bashkësitë dhe popujt e tjerë ballkanik.

Për atë se si është krijuar ujtë në dituritë popullore meriton përgjigje konkrete. Megjithatë, gjerë është i përhapur besimi se më parë gjithçka ka qenë ujë, d.m.th. vërshim. Në mitologjinë e vjetër egjiptiane, thamë se oqeani botëror NU, e ka krijuar Neb-er-çer (Zoti deri në kufijtë më të mëdhenj). Përndryshe në Ballkan detet e mëdhenj dhe oqeanet më shpesh kanë qenë të shënuar si “ujera të mëdhenj”, që e rrethojnë tokën nga të gjithë anët.

Në Ballkan shumë ishin të përhapura dituritë për të ashtuquajturat “krijesa mbinatyrore”, si rezultat i fantazisë së njerëzve. Ashtu si të gjithë popujt Ballkanik edhe Ballkano Egjiptianët kanë besuar në lugate (vampir, gomrik, voper), si në krijesa të këqija-demone, të transformuar në njeri, i cili pas vdekjes është kthyer në macë ose ndonjë kafshë tjetër, ose nga personi që vetë e ka marrë jetën e tij (vetëvrasës). Në krijesa mbinatyrore bëjnë pjesë edhe xhindet (samodivite, samovilite), melaqet (trite nareçnici), dhimje (navite, napast), dragua (zmev, lamja, kuçeder), karakongjolët etj. Besimet në to në rajone të veçanta etnike nëpër Gadishullin Ballkanik ishin të ndryshme, por gjithkund ishin të bashkuara me disa vija të përbashkëta.

Në kozmografinë popullore, ndikim më të madh tek të gjithë popujt ballkanik, ndaj edhe tek Ballkano Egjiptianët shkaktojnë: Dielli, Hëna dhe yjet. Për Diellin përveç besimit se rrotullohet rreth tokës, në Egjipt të Vjetër ishte i respektuar si burim i gjithë jetës në Tokë, ndërsa në Ballkan si kult. Për lindjen e tij dhe perëndimin ekzistonte numër më i madh dokesh-çfarë duhet, e çfarë nuk duhet të bëhet. Tek farkëtarët ekzistonte besimi se hekuri më mirë ziet kur dielli është më i fortë gjatë ditës.

Në Ballkan shumë i përhapur është besimi se Dielli dhe Hëna janë vëlla e motër, që përherë bëjnë orvatje të takohen, por pa sukses, përkatësisht shumë rrallë (kur ka pasur të zënët (errësim) të Diellit dhe Hënës). Njerëzit ishin të vetëdijshëm se gjatësia e ditës është e varur nga Dielli, se dita zgjatet ose zvogëlohet pas kalimit të ekuinoksit dimëror ose veror Enica (Varvara) dhe Vërtollom. Ka ekzistuar besim se ekzistojnë dy diella: veror dhe dimëror. Kur vjen dielli veror natyra gjallërohet, ndërsa kur vjen dielli dimëror, ai shkon në pushim. Për dallim nga Ballkani, në Egjipt të Vjetër gjatë një ditë kanë dalluar tre dielle-Khepri në mëngjes, Ra në drekë, Amon nga mbrëmja.

Sipas besimeve në Ballkan, Hëna ndriçon por nuk ngroh shkaku i njollave për prejardhjen e të cilave thuhet se janë spërkatur me baltë nga Dielli, që të mos jetë një lloj konkurrence. Në jetën e popujve Ballkanik hëna është e njohur si treguese e kohës në të cilën disa gjëra duhet të fillojnë, ndërsa në lidhje me fazat e saja të ndërrimit (Hëna e re-Mlada meseçina; Hëna e plotë-Polna meseçina; Aet hëna-ginezh etj.). Ky trupi qiellor më së tepërmi ishte i lidhur me disa veprime magjike-besëtyte. Ashtu besohej se ndonjë punë e re duhet të fillohet kur ajo është e re, që puna të ketë sukses; njerëzit mjekohen kur ajo fillon të “ahet” me qëllim që sëmundja të zhduket. Mandej ekzistojnë edhe ndalime në jetën e Ballkano Egjiptianëve të lidhura me Hënë (lehona nuk guxon të dalë në Hënë, teshat (pelenat) e foshnjës kur thahen nuk duhet ti zë Hëna etj.). Gjithashtu janë marrë edhe disa veprime magjike në Hënë të plotë-të mjekohen lythat; të ndalohet shurrja e fëmijëve më të rritur gjatë fjetjes etj.

Për yjet (xvezdi), në Ballkan është besuar se përfaqësojnë një lloj kopje të botës tokësore. Në qiellin hyjnor ka çdo gjë që ka në tokë. Sa njerëz jetojnë në tokë, aq yje ka në qiell. Kur lind njeri, në qiell paraqitet yll i ri, ndërsa kur ai vdes, bie yll. Ndarja sociale që ekziston në tokë, ekziston edhe në qiell-yjet më të ndriçuar dhe më të mëdhenj i përfaqësojnë njerëzit më të pasur dhe më të fuqishëm.

Në besimet popullore Venerën, varësisht nga ajo se kur vëzhgohet, e kanë perceptuar për dy yje “e mbrëmjes” dhe “e agimit” (pikërisht njerëzit edhe nuk e kanë ditur se ajo është një planetë e njëjtë). Asaj të mbrëmjes i është përshkruar fuqi e madhe magjike. Nga yjet i kanë njohur edhe Ariun e Madh dhe Ariun e Vogël ose Shqerrë (Golemata Meçka i Malata Meçka ose Kola), me çka është caktuar veriu, mandej Udha e Qumështit e quajtur Kashtë (mleçen pat, slama), Kashtë e Kumtrit (kumova slama) etj.

### **Për meteorologjinë, dukuritë natyrore dhe stinët e vitit**

Dituritë popullore nga sfera e meteorologjisë, dukuritë natyrore dhe stinët e vitit tek Ballkano Egjiptianët ishin relativisht të pasura. Ato ndodheshin në nivel të ngjashëm me dituritë përkatëse tek popujt fqinjë. Ata besonin se mbi bazë të disa dukurive natyrore dhe meteorologjike mund të parashikohen disa gjëra, ndërsa edhe më tepër në atë se mbi bazë manifestimesh konkrete në botën bimore dhe atë shtazore. Ashtu për shembull nëpër fshatra njerëzit kanë pritur furtunë posa do të kishin vënë re shqetësim tek kafshët. Të njëjtën e kanë pritur edhe posa do të kishin vënë re se lejlekët para kohe janë grumbulluar nëpër foletë e tyre. Erë të fuqishme

kanë pritur nëse kafshët kanë filluar fuqishëm të tundin kokat, mandej nëse macja ka filluar të gërvisht mbi derën hyrëse, nëse çafkat fluturojnë lartë etj.

Njerëzit kanë pritur kohë të keqe edhe pasi të kenë vënë re “qiell të përgjakur”; zëra të qartë nga largësitë me të madhe; “lëmë” rreth hënës etj. Ndërsa kohë të mirë prisnin nëse vinin re se qentë flinin të shtrirë qetë, nëse gjelat këndojnë pas agimit të diellit; nëse në mëngjes mbi bimët vinin re vesë; nëse qielli nga mbrëmja në lindje është i tejdukshëm; nëse ka mjegull mëngjesi etj. Parashikime të ngjashme kanë pasur edhe për periudhë të gjatë nga viti si për shembull: nëse Dita e Verës (Mars) është ditë e bukur, ashtu do të jetë gjatë gjithë verës, ose e kundërta, mandej se dimri do të jetë i ashpër nëse pemët në vjeshtë lulëzojnë për herë të dytë etj.

Njerëzit më tepër janë interesuar për parashenjat që kanë paralajmëruar thatësisht, shira rrebesh, breshër, kohë të ftohtë, shtrëngata bore, akull etj. Prognoza është kryer edhe mbi bazë të reagimit të disa pjesëve të trupit, gjendja psikike e njerëzve etj.

Disa dukuri astronomike ishin të përdorura për parashikim të fatit. Atë e kanë bërë një lloj “astrologësh” popullor, të cilët kanë ditur ti “lexojnë” porositë nga gjithësia. E gjithë ajo ishte e qëndisur me besëtytni, siç ishte besimi në ditët me fat dhe pa fat ne javë; numra me fat etj. Ngjashëm në besimin me rëniën e yjeve, gjithashtu me çdo meteor të rënë ose kometë që ka kaluar, kanë besuar se është shenjë që paralajmëron vdekje të dikujt ose luftë. Edhe në parashikimet mund të gjenden relacione me Egjiptin e Vjetër<sup>281</sup>, por edhe me Heladën Antike, nga të cilat më të njohur kanë qenë priftëri të cilët kanë parashikuar në tempujt në Dellfi dhe Dodona.

Nga dukuritë atmosferike vëmendjen përveç erërave, i ka tërhequr edhe shiu, breshëri, mjegulla, vesa, ylberi. Për erërat ekzistojnë numër i madh titujsh lokal, varësisht nga koha në të cilën fryjnë, fuqia e tyre, vendi etj. Për shiun dihet se bie nga retë, por me atë udhëheq Allahu (Gospod) ose disa njerëz të shenjtë siç është Sh. Ilija tek krishterët. Ai, sipas besimit popullor i “hap”retë që të bie shi, ndërsa gjatë thatësirave besohet se ka qenë i sëmurë. Për borën besohet se është e krijuar prej mielli. Njerëzit i gëzohen mbulesës të trashë prej bore, me besim se viti do të jetë frytdhënës. Vesën e kanë llogaritur si mjekuese. Për atë shkak kanë menduar se nëse njerëzit e sëmurë rrokullisen në barin me vesë në mëngjes për Shëngjergj do të shërohen. Mjegullën e kanë llogaritur për të pashëndetshme dhe të papastër. Besojnë se ajo më tepër i përshtatet magjepsësve, qëllimi i të cilëve ka qenë që t’ju shkaktojnë kob njerëzve. Breshëri në numër të madh rastesh,

---

<sup>281</sup> E njohur është se edhe Aleksandri i Madh ka shkuar në Profetësinë e Amonit, në Oazën Siwa të përhimët që ti ja tregojnë fatin.

është shpjeguar si dënim i Zotit, shkak i sjelljes të keqe të njerëzve. Sepse ai ka mundur të shkaktoj dëme të mëdha, kanë marrë vepra magjike me qëllim që ta ndalojnë rënien e tij, kanë vendosur hithra në fushë, mbi bazë të besimit se breshër dhe rrufe nuk bie në hithra. Më larg shtëpisë është vendosur sëpatë me majën përpjete, që mund të tërheq rrufenë. Si mbrojtje preventive nga rrufeja, nga shtëpitë i kanë nxjerrë të gjitha gjërat prej metali. Për bubullimën dhe rrufenë gjithashtu ekzistojnë më tepër shpjegime. Tek krishterët i përhapur është besimi se gjëmimi ndodh në kohë kur Sh.Ilija me karrocën e tij kalon nëpër retë. Ndërsa tek myslimanët besohet se bubullimat i shkakton Allahu (Gospod) me atë që i rrokullis boshtet, në luftën kundër dragonjve etj. Për rrufenë kanë besuar se janë “gjuajtje” të Zotit që i hedh pas shejtanëve (gjavolite). Për atë edhe kanë besuar se të vrrarët nga rrufeja kanë qënë të keqpërdorur nga shejtani, pikërisht se ai është fshehur në to. Ylberi (vinozhito) - rrypi i Allahut (Gospod), si dukuri natyrore specifike, njerëzit e kuptonin si shenjë që e paralajmëron ndalimin e shiut. Besonin se ai zbret në tokë për “të pirë ujë”, dhe deri në atë shkallë është magjik që një mashkull nëse kalon në të bëhet femër dhe e kundërta. Për brymën kanë besuar se përfaqëson vesë të ngrirë.

Mënyra më e thjeshtë e ndarjes së vitit bëhej në dy stinë: verë dhe dimër, ndërsa ditë kufitare janë Shëngjergji dhe Shënmitri. Për mesverë është llogaritur Petrovdeni, ndërsa për mesdimër Sh. Tanasi (Tanasov den). Interesant është besimi për të ashtuquajturat “plaka” (“babi”) me të cilat tre ditë në muajin Prill përsëritet dimri, me mundësi për të rënë borë.

Vitin e kanë ndarë në 12muaj, për të cilët kanë pasur emra të ndryshëm popullor, lidhur me punën që e kanë punuar, ose me kushtet kohore. Sipas Herodotit, Egjiptianët e Vjetër nga të gjithë popujt, të parët e kanë krijuar vitin dhe e kanë ndarë në 12muaj, duke bërë llogari për ecjen e stinëve të vitit, ndërsa Helenët kanë pasur gabim me atë që në çdo tre vjet kanë shtuar nga një muaj, që të përputhet ecja natyrore e stinës. Për atë shkak Egjiptianët e Vjetër të parët kanë emëruar 12 zotra, ndërsa Helenët atë e kanë marrë nga to<sup>282</sup>.

E shtata tek popujt ballkanik ka shënuar një javë (nedela), me emra të ndryshme për ditët. Gjithashtu edhe dita ndahet në disa pjesë (agim, mëngjes, paradreke, në drekë, pas dreke, mbrëmje, natë, mesnatë). Dita është ndarë sipas fuqisë dhe rrugës të Diellit, ndërsa nata sipas këndimit të gjelave (gjelat e parë këndojnë rreth mesnate, të dytët diçka më vonë, ndërsa të tretët para agimit). Mesnata shënohet edhe si “kohë e shurdhët”.

<sup>282</sup> Herodot, II/4, faq.116.

## **Për llogaritjen dhe matjen**

Dituritë nga fusha e matematikës popullore, përkatësisht llogaritja dhe matja, të marra në tërësi edhe përkundër nevojës së madhe për to në jetën e përditshme, ishin relativisht modeste. Njerëzit më të shkathët kryesisht i njihnin katër operacionet themelore të matematikës (mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim). Ajo domethënë se pjesa më e madhe e njerëzve kishin dituri të varfra dhe prandaj llogarisnin në “gishta”. Zhvillimi dobët i diturive matematikore, kryesisht ishin falas arsimit animik.

Dituritë e përgjithshme nga matematika popullore ishin të domosdoshme për shkak të ekonomie së suksesshme, sidomos pas zhvillimit të ekonomisë së mallrave, të hollave si dhe me paraqitjen e defterëve tregtare, zanatlive dhe të tjera që paraqisnin një lloj evidence kontabiliste që kryheshin në mënyrë të thjeshtë. Me të diheshin rezervat, kërkesat dhe borxhet.

Me ardhjen e Osmanlive erdhi deri te zbatimi dhe përdorimi i të ashtuquajturave “numra arabe”, të cilët përdoren deri në ditën e sotshme.

Për matjen e gjatësisë janë përdorur drame dhe oka. Oka ishte edhe masë kryesore për lëngjet. Masë më e madhe prej okës, kur është matur lëngu ishte “nubeti”, që rëndonte 20 oka.

Për llogaritje më të konkretizuar, pa përdorimin e gishtave, ishin përdorur kokrra, gurë të vegjël, thupra të prera, ndërsa më vonë lapsi dhe letra, si dhe dërrasa dhe shkumësi “temeshur”.

Masat kryesore për gjatësi ishin: gishti, qeperi, pëllëmba, sazheni (hapsirë midis duarve të hapura rreth 1.5m), gjatësia e njeriut. Me kombinimin e tyre janë treguar gjatësitë e matura (për shembull tre pëllëmba dhe katër gishta, 10 sazhenë etj.). Me bërrylin ose “endezenë” (rreth 33cm) gratë e kanë matur gjatësinë e pëlhurës të endur. Dy bërryla ishin një arshin, ndërsa diku me këtë fjalë është caktuar vetëm një bërryl. Hapësirat më të vogla mateshin me këmbë, më të mëdhatë me hapa, ndërsa edhe më të mëdhatë në mënyrë tjetër, si për shembull: një ditë ecje, një ditë larim (për madhësinë e arës), një ditë gropim (për hardhi), një ditë kositje (për luadh) etj. Arat janë matur edhe sipas rëndësisë të forcës të domosdoshme për mbjelljen e tyre (3.5 ngarkesa drithë për përafërsisht një hektar).

Ena prej druri ishte masë për qumësht, por edhe për verë. Edhe “okarniki” është përdorur për qëllim të njëjtë.

Për matjen e kokrrave të drithit është përdorur: kutell (rreth 8 oka), shiniku ose buçuku (2 kutellë), osmaku (35 oka), dhe kiloja përkatësisht ngarkesa (2 osmak ose 70 oka). Megjithatë, rëndësia e këtyre masave ka qenë në varësi prej një skaji në skaj tjetër të Ballkanit.



Drutë për ngrohje janë matur me ngarkesa (të gomarit ose kalit). Edhe drutë e ngarkuara në karroca janë matur (llogaritur) sipas ngarkesa kuajsh (karrocë me dy rrota ose me katër rrota).

Në jetën praktike mbisundon sistemi i dymbëdhjetë. Ai përdoret si masë për varg prodhimesh që shiteshin në copa. Një duzinë kishte 12 sopa (1/2-duzinë-6 copa, 1/4- 3 copa). Gjithë copat më të vogla prej 3 janë shitur në çifte.

Gjatë sundimit Osman kryesisht kantarët kanë matur në oka. Më vonë janë paraqitur kantarë të cilët njëkohësisht kanë matur edhe oka edhe kilogramë.

Gratë të cilat shpesh kanë qenë të detyruara që midis veti të huazojnë disa artikuj ushqimor dhe të tjerë si masa i kanë përdorur: lugën (për kripë, biber etj.), filxhan (për vaj, uthull etj.), enë për miell. Gjatë huazimit të orizit, misrit etj. si masë kanë përdorur “një pëllëmbë” ose gjysmë grushti ose një grusht.

### Dukuritë tjera dhe kuptimet

Përfytyrimet demonologjike tek Ballkano Egjiptianët, si dhe tek bashkësitë dhe popujt e tjerë ballkanik, ishin mjaft të lloj llojshme dhe të shumta. Ato janë kryesisht të lidhura me magjitë dhe parafytyrimet e përmendura për krijesat e ndryshme demone.

Magjisë populli i jepte fuqi të veçantë. Njerëzit besonin se magjepsë më të fuqishme janë gratë (zakonisht më të moshurat dhe ata pa fëmijë) të fuqizuara nga natyra që të merren me të ashtuquajturën magji e bardhë (e dobishme) ose magji e zezë (e dëmshme).

Egjipti i Vjetër ka qenë tokë ku magjia e bardhë dhe magjia e zezë janë zbatuar në masë të madhe. Gjithë ato magji mund të takohen në përrallën dhe mitin për Ozirisin dhe Izidën, pikërisht ringjalljen e Ozirisit (**Фрејзеп, Ц.Ц.** 1992: 459-464). Nëpërmjet magjive të mira d.m.th. të bardha Izida ka arritur ta ringjall jo vetëm Ozirisin por edhe disa fëmijë, por edhe fëmijën e saj Hor. Egjipti është i njohur sipas magjive dhe sipas Biblës, domethënë në Dhiatën e Vjetër, para së gjithash rreth luftimeve magjike që Mojsiu i ka bërë me priftëri dhe magjepsët egjiptian. Edhe sipas Biblës, Egjipti është i dënuar që të merret me magji<sup>284</sup>. Edhe Herodoti përmend se

<sup>284</sup> Dhiata e Vjetër, Libri i profetit Isaija, 19

1. Profetësia për Egjiptin...Edhe para fytyrës së tij do të dridhen idolet egjiptian, ndërsa zemra e Egjiptit do të shkrihet me të.

në Egjipt në kohën e tij janë marrë me magji (mistere), dhe para së gjithash me to janë marrë gratë. Ai do të thotë: “...në atë liqe natën bëhen shfaqje për vuajtjet që i ka duruar Ai (Oziris). Egjiptianët atë e quajnë mistere. Për ato punë edhe pse di mjaftueshëm, le të më mbetet goja e pastër, si dhe për gjithçka që është e tillë...Flas vetëm për atë që është mëkat të flitet. Vajzat e Danajit kanë qënë ata që i kanë bartur ato mistere nga Egjipti dhe që i kanë mësuar gratë Pellazgase. Por, kur Peloponezin e kanë shkatërruar Dorinjët, u zhdukën dhe ato mistere. Nga Peloponezve ata e kanë mbajtur vetëm Arkadijët, të cilët kanë mbetur dhe nuk janë ngjitur prej atje”<sup>285</sup>. Nga ky citat i Herodotit, mund të përfundojmë se magjitë në Ballkan (në Peloponez tek Pellazgët) i kanë sjellë gratë kolonizatore egjiptiane. Magjitë e sotshme tek Ballkano Egjiptianët, pjesë e hulumtuar Rade Bozhoviq, dhe atë tek Egjiptianët në Ohër dhe Strugë. Ai bën analogji me magjitë e njohura nga Egjipti i Vjetër, në atë që edhe atje edhe në Ballkan përdoret hudhra, përkatësisht qepa në kombinim me kallamin dhe barin si amulet kundër sëmundjesh. Por ajo që është edhe më indikative është besimi se njeriu është i sulmuar nga hija e vetë, që është besim tipik i vjetër egjiptian. Hija në mënyrë të pazakonshme e mundon njeriun e sulmuar, me njolla të katërta nëpër trup, njolla etj. (Божовиќ, Р. 1996: 156-157).

Në magjinë e bardhë bëjnë pjesë aktivitetet, që në mënyrë joracionale, midis tjerash, duhet tju ndihmojnë pacientëve të shërohen nga ndonjë sëmundje e rëndë, ta mjekojnë sterilitetin, t'u alarminojnë ndjenjat e dashurisë tek ata që janë indiferent ndaj personave që i dashurojnë, ushtarët të kthehen gjallë dhe të shëndoshë nga lufta. Si “magji të bardhë” sidomos ato me besim mysliman kanë besuar në fuqinë e disa hoxhve dhe dervishëve, të cilët kanë bërë dhe bëjnë hajmali të ndryshme për mbrojtje, të cilave u janë dhënë fuqi tepër të mëdha. Hajmalitë i kanë bërë nga materiale të ndryshme, por më shpesh prej lëkure dhe në formë trekëndëshi, që mundej të mbahet e varur në qafë. Për hajmali ka mundur të përdoret edhe pe, rruaza, thelb prej hudhre etj. si dhe vath fëmijësh meshkuj. Prezenca e hajmalive që nga kohët më të lashta në Ballkan me elemente të cilat janë të rëndësishme për kulturën e vjetër egjiptiane flasin edhe stolitë që janë të

2. Do të armatos Egjiptianë kundër Egjiptianëve-dhe do të vriten vëlla kundër vëlla dhe mik kundër mik, qytet me qytet, mbretëri me mbretëri.

3. Shpirti i Egjiptianit do të lodhë në të, do ti shemb qëllimet e tij dhe do të ikin ata kah idolë dhe magjepës, kah ata që thirrin të vdekur dhe fallxhorë.

4. Do ti dorëzoj Egjiptianët në duar sunduesi të ashpër, mbret mizor do të sundoj mbi to-thot Zoti, Zoti Savaot...

<sup>285</sup> Herodot, II/171

zbuluara në shumë lokalitete arkeologjike në Ballkan, për çka folëm në pjesën për stolitë dhe veshjen.

Këtu mund të përfundojmë se magjinë e bardhë Ballkano Egjiptianët, si dhe të gjithë bashkësitë dhe popujt Ballkanik e nënkuptojnë me komponentë nga përbërja e medicinës, ekonomisë, dashurisë etj.

“Magjia e zezë” -e keqe, në kryesi ka qëllime anti-humane. E kanë kryer me ndihmë materialesh dhe gjërash të ndryshme me prejardhje nga trupi i kafshëve (eshtra etj.), gjak kafshësh ose njeriu, thuaj, flokë, qepalla etj. Kjo magji, pa përjashtim ka qenë e destinuar t’u shkaktoj dëm material ose dëm të madh njeriut të urryer (nusja të mos mund të lind fëmijë, të dashëruarit të ndahen etj.).

Tek Ballkano Egjiptianët, sidomos tek farkëtarët besohet se uji ku ftohet hekuri ka ndikim magjik dhe atë në dy rast. Ujti ashtu siç e ftoh hekurin, mund të “ftoh” edhe dashurinë midis dy të rinjve, të fejuarve ose bashkëshortëve, që midis farkëtarëve llogaritet si mëkat më i madh. Prandaj disa njerëz që kanë ndër mend të ndajnë çiftin, fshehurazi, pa mos i parë dikush, mundohen të vjedhin ujë nga govata. Rifat Sulejmani i cili ka punuar si farkëtar në fshatin Zhirovnice, rajoni i Dibrës, njëherë e ka zënë një gruan duke tentuar të vjedh ujë nga govata e tij dhe mandej e ka rrahur, gjest të cilin e kanë arsyetuar të gjithë fshatarët. Megjithatë, besohet se uji i njëjtë ka edhe fuqi të mjekoj sëmundje, përkatësisht të shërbej si mjek para së gjithash për disa sëmundje fëmijësh, posaçërisht mjekon sëmundjen e dhënëve. Në raste të tilla, farkëtarët ju japin prej ujit por, disa herë që uji të mos keqpërdoret vetë farkëtari shkon që ti jap mjek (ilaç) fëmijës të sëmurë.

Tek Ballkano Egjiptianët, si edhe tek të gjithë bashkësitë në Ballkan specifike janë dituritë për bimët dhe kafshët, sidomos tek ata që janë marrë me bujqësi. Në lidhje me atë ekzistonin besime të caktuara, ndalime (tabu). Ashtu me respekt të veçantë njerëzit janë sjellë ndaj druve të vakëfit d.m.th. drutë në oborret e kishave, xhamive, manastireve etj. është llogaritur për mëkat të madh prerja e druve të tillë.

Bimët kanë pasur rol të madh në të ashtuquajturën medicinë popullore, për çka do të flasim në vend të përshtatshëm.

Sipas popullit kafshët ndaheshin në të dobishme dhe të dëmshme. Ndaj të parëve kanë treguar vëmendje dhe respekt të madh. Midis të cilëve më të respektuar ishin kaçt<sup>287</sup>, me ndihmën e të cilëve është laruar, mandej

<sup>287</sup> Kau (demi)Apis është një ndër kafshët më të shenjta në Egjipt të Vjetër, demet Apis dhe Mnevis i kanë qenë të kushtuar Ozirisit dhe të gjithë Egjiptianët i kanë adhuruar si zotra, sepse këto kafshë më tepër nga të gjithë tjerat kanë ndihmuar në gjetjen e drithërat në mbjelljen e tokës dhe në arritjen e dobis të përgjithshme nga bujqësia. (*Фрејзеп, II. II. 1992: 462*).

qentë, macet<sup>288</sup>, dash, lopët, kuajë, gomarët, por me rezervë të rëndësishme ndaj dhive, që në mjaft mënyra i kanë identifikuar me djallin (gjavolot), për shkak të brirëve dhe mjekrës, si dhe me aftësitë e tyre akrobatike për tu ngjitur nëpër shpata. Me djallin janë identifikuar edhe minjtë.

Në kafshët e urryera kanë bërë pjesë: ujqit, arinjtë dhe kafshët e tjera që ju kanë shkaktuar dëme njerëzve dhe kafshëve shtëpiake. Gjarpri edhe pse ishte i urryer ka gëzuar edhe njëfarë respekti, si “pronar”-zotëri i shtëpisë. Prandaj, është besuar se gjarpri është mëkat të vritet, sepse e ruajtka shtëpinë, si dhe disa objekte të tjera (manastir, kishë, xhami, hardhi, çezmë etj.). Respekt të tillë të ngjashëm por edhe më të madh ndaj gjarprit ka pasur edhe në Egjipt të Vjetër të cilit i është kushtuar edhe zotreshë e veçantë Uazit. Gati në të gjitha maskat e faraonëve egjiptian, që mund të shihen sot në krye të kurorës doemos është i aplikuar gjarpër. Kobra ka përfaqësuar zotreshë supreme, fuqi dhe mençuri faraonase. Ka shënuar dituri dhe ar. Gjarpërinjtë rreth diskut të diellit kanë përfaqësuar zotra të cilët i kanë përzënë armiqtë e zotit të diellit Ra. Të dy gjarpërinjtë janë nus dhe logos, përkatësisht mendja dhe ligji. Gjarpri me kokë luani ka mbrojtur nga e keqja. Zotresha Buto ka marrë formë kobre (**Lampiç, M.** 1999: 162). Meqë gjarpërinjtë kryesisht në besimet tek të gjithë popujt indoevropian ka karakter negativ, si sinonime të të vdekurve dhe zotërive nëntokësore, dhe të lidhur me frymën e të keqes, por edhe Satana gjithmonë është shndërruar në formë gjarpri dhe dragua (**Приор, Ж.** 1993: 60), respekti për gjarprin si mbrojtës nga e keqja dhe pronar i shtëpisë, pas gjithçkaje siç duket në Gadishullin Ballkanik është ndikim egjiptian i cili me siguri është i tejbartur nga kolonistët egjiptian, të cilët deri më sot e kanë ruajtur këtë kult, dhe i pranuar tek disa popuj ballkanik. Kultu ndaj gjarprit në viset ballkanike, siç është e njohur me më ndikim paraqitet tek legjenda Helenase për Kadmon dhe Harmoninë, të cilët shndërrohen në gjarpërinj, ndërsa simboli klanik i

<sup>288</sup> Në traditën e vjetër egjiptian macja ka pasur domethënie lunare dhe i është e kushtuar Setit si errësirë, ndërsa mund të jetë edhe atribut i Izidës dhe Bast-Hënës. I përfaqëson gratë shtatzëne sepse edhe embrioni rritet dhe është nën ndikim të hënës. (**Lampiç M.** 1999: 84). Macja ka qënë e respektuar vetëm në Egjipt, ku çdokush, nëse ka vlarë macë është dënuar me vdekje (**Приор, Ж.** 1993: 31). Herodoti (II/66), për macat në Egjipt do të shkruaj: “Kur do të shpërthej zjarr, macet sillen disi çuditshëm. Derisa Egjiptianët radhiten rreth zjarrit që të kujdesen për macet, duke mos u kujdesur për shuajtjen e zjarrit, macet disi do të kishin kaluar nëpër njerëzit, do të kërcenin dhe do të hidheshin në zjarr. Kur do të ndodh një gjë e tillë Egjiptianët i kaplon pikëllim i madh. Ndërsa kur në cilën do qoftë shtëpi ngordh macë nga vdekje natyrale, të gjithë njerëzit në atë shtëpi do ti rruajnë vetullat, ndërsa nëse ngordh qen, do ta rruajnë krejt trupin dhe kokën. Macet e ngordhura i çojnë në shtëpi të shenjta, në qytetin Bubastis, ku i balsamojnë dhe i varrosin...”.

Enhelejëve-pasardhësit e Kadmos është gjarpri “ngjala”. Edhe qyteti Budvë në bregdetin malazias e ka marrë emrin nga zotresha egjiptiane në formë kobre-Buto (**Lisičar, P.** 1953: 248).

## MEDICINË POPULLORE

Në kornizat e luftës për kthimin e shëndetit të shembur, që ktheheshin në mënyra të ndryshme, njerëzit filluan ti akumulojnë dituritë që në agimet e ekzistimit të tyre.

Dituritë më të lashta nga kjo kulturë tek Ballkano Egjiptianët ndoshta kanë prejardhje nga Egjipti i Vjetër<sup>292</sup>. Në atë shtresë më të lashtë kulturore-medicinale filloj të ndërtohet kultura e “re” shëndetësore, që pas braktisjes së shumë-zotërisë ka qenë e nxitur nga krishterimi, e më vonë edhe nga religjioni islam tek ata që e kanë pranuar islamin.

Mosnjohja e fenomeneve globale natyrore, e ngushtonin vetëdijen tek njerëzit. Për atë në mënyrë subjektive i kanë shpjeguar shkaqet për paraqitjen e sëmundjeve dhe mjekimin e tyre. E ajo pashmangshëm çonte në strukturën e tyre psikike të shtresohen pamjet animiste-magjike. Prandaj, çlirimi nga padituria dhe mashtrimet, është zhvilluar ngadalë, gradualisht dhe nëpër shekuj, por pamjet e tilla nuk janë të tejkaluara krejtësisht as deri më sot. Ato janë përcjellës paradoksal edhe të njerëzve bashkëkohor, sidomos në rrethinat më pak të emancipuara.

Medicinën popullore e përbëjnë dy grupe kryesore. E para është ajo animiste-magjike, ndërsa e dyta ajo medikale, nga krahu i së cilës lindi shkenca e medicinës bashkëkohore.

---

<sup>292</sup> Nga shënimet e ruajtura hieroglifase nga piramidat, tempujt dhe papiruset shihet se Egjiptianët e Vjetër, kanë njohur shumë sëmundje dhe ilaçe për to. Mjekët janë stërvitur nëpër ushtrime të veçanta dhe studime në të ashtuquajturat “shtëpi të jetës”. Shumë tituj të punëtorëve shëndetësor kanë qenë të përcjella me fjalën e zotërisë Sekmet, zotreshës të shkatërrimit (destruksionit) dhe shëndetit. Nganjëherë, mjekët kanë përdorur magji shëndetësore. Por mjekët gjithashtu kishin shkathtësi të mira në formimin dhe përdorimin e pijeve dhe fashave të qullura. Medicina preventive gjithashtu ka qenë e praktikuar. Qepa ka qenë e dobishme në magjitë për mbrojtje të shtëpisë dhe të siguroj mbrojtje natyrale kundër mushkonjave. Rituatet e pastrimit kanë qenë të dobishme për infektimet preventive nga insekte dhe plesht (**Mc Dermott, B.** 2001: 97)..

## Medicina popullore animiste-magjike

Fenomeni i medicinës popullore tek paraardhësit e Ballkano Egjiptianëve të sotshëm është i lidhur me sakrifikimin. Në Egjiptin e Vjetër mjekimin e sëmundjes e kanë kërkuar në premtimin e viktimave të zotrave, posaçërisht të Izidës dhe Amonit. Për të qëllim kanë flijuar dema, viça, dash, ndërsa ata që kanë jetuar në rajonin e Tebës edhe dhi<sup>293</sup>. Besimet e tilla kolonistët egjiptian mesiguri i kanë sjellë edhe në Ballkan, për çka të ruajtura janë edhe shumë besime deri më sot. Ashtu për shembull Egjiptianët nga Pogradeci, Korça dhe fshatrat e rrethit e vizitojnë manastirin Sh. Marena, ku flijojnë viktimë, zakonisht qengj ose dash për të sëmurë në familje. Të njëjtën e bëjnë edhe Egjiptianët nga Ohri, Struga dhe Resnja me vizitë të manastirit Sh. Naum me flijimin e qengjit për njeriun e sëmurë në familje. Në të gjitha rastet e përmendura bëhet fjalë për popullatë të islamizuar, e cila për raste të tilla viziton objekte fetare ortodokse-krishtere. Kisha krishtere ishte e pafuqishme që ti çrrënjos disa doke pagane, midis të cilave edhe sakrifikimin, tek të gjithë popujt dhe bashkësitë, prandaj këtij doku të lashtë i kanë veshur pamje krishterë. Me hyrjen e Osmanlive në Ballkan sakrifikimi vazhdoi të jetoj nën sinonimin “kurban”, me të cilën fjalë arabe shënohet një kafshë e flijuar. Flijimi i kurbanit bëhej nëpër gjithë Ballkanin, dhe me të përveç përgjërimit për shërim të ndonjë njeriu të sëmurë, njerëzit kanë dashur të lusin për shëndet për veten dhe kafshët.

Besimet legjendare për shërimin e të sëmurëve të pashpresë, por edhe ringjalljen e të vdekurve i ushqente shikimi se sëmundjet vijnë nga fuqi misterioze. Atyre mund t’ju kundërshtojnë vetëm zotëritë ose Zoti. Prandaj besimet animiste-magjike nuk mund të çrrënjoseshin përkundër asaj që religjioni i krishterë dhe islam, i mohonin dhe distancoheshin nga to.

Me ndihmë të veprimeve magjike sipas besimtarëve të popullit, midis të tjerash, arrihej ruajtja e shëndetit. Prandaj, intervenimet për “mjekim” kryheshin me “magji të bardhë”, e cila ishte e kundërt nga “magjia e zezë” me të cilën, midis të tjerash shkaktoheshin edhe sëmundjet.

Numri më i madh i sëmundjeve vinin “nga Allahu” (“od Gospod”). Atyre nuk mund t’ju bëhej bisht sepse ishin të lidhura me fatin. Por edhe përkundër ndikimit defitistik, njerëzit atë nuk e pranonin me indiferencë. Ata luftonin kundër “të shkrojturës” (“od pisanoto”), nga melaqet gjatë natës së tretë pas lindjes, në mënyra të ndryshme, me çka pavetëdijshtëm, spontanisht i kundërshtonin “Dëshirës së Allahut” (“Bozhja volja”). Pikërisht bëhet fjalë për ndërrim të fatit, me ndihmë veprash magjike. Këto

<sup>293</sup> Herodot II/39-43.

vepra magjike, të cilat në shkencë janë të njohura nën kuptimin “magji imitative” mirrëshin që të tejkalohet ndonjë sëmundje ose problem në lidhje me shëndetin (shembull kundër komplikimeve të vështira gjatë lindjes të lehonës i këtheheshin disa pjesë të veshjes mbi kokë, lythat i mjekonin me numërimin e aq yjesh sa ka lytha etj.).

Ujrat (burimet, çezmat, përruat, lumejtë, liqenet, banjat etj.) luanin rol jashtzakonisht të rëndësishëm në ”mjekimin” me ndihmë të magjisë. Ujërat e tilla ishin të njohura si “mjekuese”, “të shenjta”. Kjo ndodhi nëpër gjithë Gadishullin Ballkanik. Disa nga to ndodhen në oborret e kishave, xhamive, manastireve, teqeve etj. Këta ujëra ishin veçanërisht të respektuara. Më shpesh i vizitonin para lindjes të djalit dhe sipas rregullit atje linin nga ndonjë “nishan” (pjesë të teshave) ose dhuratë. Nishanet vareshin në drunjtë ndryshëm me qëllim që sëmundja të kalojë mbi to.

Populli iu jepte veti mbinatyrore edhe llojeve të tjera të “magjisë së zezë”: “lidhje” (“vrzuvanje”)-që kanë shkaktuar sterilitet dhe impotentë tek dhëndurët, ndërsa është bërë nëpërmjet vjedhjes të ndonjë pjese nga teshat ose trupi (më shpesh qime), dhe lidhje të tyre në nyje me rituale magjike. Mandej “shkelje” (“nagazuvanje”) ose “ngjitje” (“nalepuvanje”) që më shpesh mendonin se është ethja ose ndonjë dhimbje e mushkërive të bardha. Mandej “më sysh” (“uroçuvaëe”), të cilën fuqi e kanë të gjithë njerëzit por më së tepërmi ata të cilët pas refuzimit të qumështit të nënës përsëri i kanë dhënë gjë fëmijës. Si mjet mbrojtës më efikas nga mësyshi llogariteshin hajmalitë e përmendura (prej hudhre, dhëmb, rruazë, pare) të cilat janë mbajtur në qafë ose të qepura për ndonjë pjese nga teshat.

Të posa lindurit, fëmijët dhe nuset e reja llogariteshin si më të kërcënuar nga mësyshi. Ashtu që çdokush që nuk ka dëshiruar ti marr më sysh ka qenë i detyruar të thotë “mashalla” dhe tre herë të pështyj.

Kundër sëmundjeve që kanë ardhur si rezultat i ndikimit të “magjisë së zezë” ose disa shkaqe të tjera, rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe ndalimet e lloj llojshme “tabu-e”. ata janë shënuar me fjalët “nuk bën” (“ne çini”)-si për shembull nuk bën që grua shtatzënë të shikoj njeri të vdekur, të pijë ujë në “zemër të uritur” etj.

Midis intervenimeve që kishin për qëllim ta përmirësojnë shëndetin e njerëzve, bëjnë pjesë edhe bekimet dhe lutjet si për shembull “Allahu shëndet” (“Gospod zdravje”). Lutjet ndahen në të vogla dhe të mëdha. Gjithashtu ekzistojnë edhe mallkime, nga të cilat më të hidhura janë: “Mos arriftë” (“da ne stasat”), “Damlla të rëntë” (“Damla da te udrin”) etj.

## **Medicinë popullore medikale**

Medicina popullore medikale kryesisht mbështetet mbi florën (botën bimore). Megjithatë, ajo ka edhe prejardhje animiste. Për atë dëshmon besimi i përparshëm se njeriu mund të lirohet nga sëmundja, nëse arrin atë ta hedh në ndonjë bimë.

Koha në të cilën u paraqitën llojet fillestare të medicinës medikale, nuk mund të përcaktohet saktësisht. Por, ajo padyshim të ishte e bërë në kohën e krijimit të lagjeve të para. Në atë kohë njerëzit jo vetëm që më mirë i njihnin cilësitë e bimëve të lloj llojshme por nga ato dinin me përvojë më të madhe ti ndajnë ato “që i ëmbëlsojnë simptomet e sëmundjeve të ndryshme” (Illustrovana enciklopedia “Covek”, 1983:116).

Fal këtyre njohurive si dhe zhvillimit të civilizimit, një varg principesh më të hershme magjike kanë filluar gradualisht të tejkalohej (por asnjëherë edhe deri në fund të çrrënjosen). Cilësitë mjekuese të bimëve ishin zbuluar gjatë mileniumesh. Njëpërmjet këtyre cilësive njerëzit arrinin ti zvogëlojnë vuajtjet e tyre dhe ta përmirësojnë shëndetin e tyre.

Zhvillimin më të shpejtë të medicinës popullore medikale e pengonte edhe diagnostika e pa ndërtuar. Njerëzit vështirë gjendeshin në caktimin e sëmundjes së vërtetë, midis atyre që i kanë njohur. Ajo ishte pengesë që të përcaktohet terapia e saktë. Megjithatë, ky problem pjesërisht tejkalohej me koncentrim të një varg sëmundjesh në grupe, mbi bazë të ngjashmërive të simptomave. Por, hyrja e tillë nuk kontribuoi që diagnostika të ngjitet në nivelin e domosdoshëm.

Problem të ngjashëm paraqiste edhe orvatja për përkufizim të shkaqeve, që i shkaktonin sëmundjet e ndryshme. Ajo edhe më tepër e komplikonte situatën. Prandaj njerëzit shumë sëmundjeve ju jepnin emra të përgjithshëm: shpo-bode, zjarr-ogan, dhimbje-bol, vjellje-povrakanje, ethe-treska, etj. Prandaj, kjo medicinë popullore kishte hyrje të kundërt, në vend që njëpërmjet simptomave sëmundja konkrete zbulohet njëpërmjet terapisë, ndërsa mjeti më përkatës zgjidhet me provimin e ilaçeve të ndryshme.

Tek njerëzit ishte i rrënjësuar besimi sepse numëri më i madh i sëmundjeve rrjedhin nga ftohja. Ata mbesin se çdo organ në organizëm mundet veças të ftohet. Për shkaktes serioz të sëmundjeve e llogaritin të ashtuquajturin “ujin e keq”, që nga shkaqet e ndryshme mbledheshin në trup, ndaj prandaj është besuar se djersimi është shenjë shërimi-hedhje e ujit të keq.

Në medicinën popullore medikale, përdorim të madh kishin frutat dhe bimët e lloj llojshme, si për shembull: bar hajdutësh, afioni, murrizi, kantaron, qepa, konopi, pelini, ricinusi, kumbulla, rrush i thatë, kungulli,



tutuni, biberi i zi, chemerika etj. Gjithashtu vend të rëndësishëm kanë pasur edhe materialet me prejardhje kafshësh, mineralesh dhe me prejardhje tjetër, si për shembull: gëlqere, lesh, dyllë, katran, nishadër, plumb, hekur, argjil, lëkurë gjarpëri, thundër kali, vezë (e verdha dhe e bardha), lëkurë vezësh, mjaltë, qumësht, krip, raki, uthull, shpirto, gjalpë, yndyrërat, dhjami etj. Në medicinën popullore medikale janë përdorur edhe disa gjëra absurde, si bajga prej kafshësh shtëpiake, urinë e kafshëve ose e njerëzve etj.

Gjithë gjërat e përmendura janë përdorur për bërje të ilaçeve të ndryshme popullore. Bimët dhe frutat kryesisht përdoren për zierje çajrash dhe supash të ndryshme. Ato janë pirë të “pastra” ose të përziera me lëngje dhe ushqime të tjera. Më shpesh janë dozuar me këto masa: lugëz ose lugë, gllënjë, filxhan, gotë ose enë.

Melhemet i kanë përgatitur në mënyrë më të komplikuar. Më së tepërmi i kanë përdorur për lyerje. Dozat e elementeve përbërëse të përfshira në melhem ishin aproksimative.

Përveç çajrave dhe supave dhe melhemeve janë përdorur edhe ilaçe prej lloji tjetër. Ato më shpesh kanë qenë gjëra të ndryshme të përziera, që janë përdorur për mbështjelljen e bullungave etj. (më shpesh prej qepe të fërguar ose të freskët, farë të zier prej leni etj.). shumë të dobishme dhe efikase kanë qenë edhe të ashtuquajturat “jakija”, që gjithashtu janë përdorur për ngrohje të krahavorit, shpinës etj., për ftohje më të mëdha, ndërsa janë bërë prej leshi të palarë të cilit i është shtuar raki e ngrohtë, me biber etj. Për ngrohje të shpinës është përdorur edhe pambuk i mbyllur në gota me grykën kah shpina. Pambuku digjet në shpinë, me çka është krijuar vakum dhe lëkura në shpinë është ngritur dhe është shëruar “ujti i keq”.

Për sëmundjet e fëmijëve “shytat” dhe “sëmundjen e vogël të dhenëve” janë përdorur këto veprime: Për “shytat” pjesët e ënjtura nën fyt janë vizatuar me laps të kaltër dhe mandej janë mbuluar me letër të kaltër. Për “sëmundjen e vogël të dhenëve” fëmijët janë mbajtur në dhoma të ngrohta dhe qëndronin në shtrirë në batanije të kuqe ose sixhade.

Në rast plagash më të mëdha, njolla të katërtë nëpër trup theret dash ose qengj dhe nga kafsha e therur e freskët, lëkura është vendosur si fashë.

Megjithatë, shumë shpesh ka ndodhur që me mjekim nga gjërat me prejardhje bimore ose tjetër, për shkak të përdorimit të parregullt, e para së gjithash për shkak helmimi, në vend shërimi është shkaktuar keqësim i shëndetit, e nga donjëherë edhe vdekje. Prej bimëve më toksike kanë qenë afioni, shtarë, tutuni, chemerika etj.

Statusi kategorik i veçantë kanë pasur njerëzit e sëmurë shpirtërisht. Fati i tyre ka qenë shumë tragjik, sepse “shërimi” i tyre ka qenë i lidhur me

qëndrime të paqëllimta nëpër spitale të ndryshme. Në to i mjekonin me lëxim të lutjeve të ndryshme mbi kokat e tyre.

Gjithashtu në kornizat e medicinës popullore medikale mund të përfshihet edhe “mjekimi” me lidhjen e kërthizës, me djegiet e plagëve, mandej inhalacionet e ndryshme për organet e frymëmarrjes, larja në ujëra minerale etj. Vend i veçantë i përkiste stomatologjisë dhe kirurgjisë popullore, përkatësisht traumatologjisë. Mjekimi i eshtrave të thyera, rregullimi i nyjeve të ndrydhura etj. ishin nga domethënie e veçantë për rehabilitimin e të sëmurëve.

Intervenimet e vërteta kirurgjike gjatë largimit të puqrra të ndryshme i kanë prerë me gërhshërë të skuqura ose i kanë djegur me gjilpërë të skuqur, hekur etj.

Pjesët e gërvishtura, të prera ose të djegura të trupit, gjithashtu i kanë mjekuar, në mënyra të ndryshme. Më e përhapur ishte përziera e bërë prej kantaroni në vaj ose raki 40 ditë. Ata i mjekonin edhe me tutun, rrëshirë pishe etj. plagët i kanë mjekuar me meleme të bëra prej kokrrash fasuleje të shtypura, të përziera me vaj. Kantariumi i lagur në raki është përdorur edhe si pije.

Me drejtimin e eshtrave të thyera, nyje e ndrydhura, kryqe të përdredhura, venë të përdredhura janë marrë të ashtuquajtur “ndreqës”. Ato ishin persona mjaft popullore me autoritet. Përveç me drejtim janë marrë edhe me shtypje, masazhe, fërkim, tërheqje etj. Pas “drejtimit” vendet e përdredhura i mbulonin me leckë të lagura me vezë të përziera, të cilët mundej të jenë të përziera edhe me hi ose kripë. Kjo leckë shërbente si një lloj zëvendësimi të vënies të gipsit të sotshëm ose lidhjes me fashë. Në disa vende edhe kjo leckë quhej “jakijë”.

Mjekët popullore i “lanin” plagët me raki ose verë, e ndalonin gjakderdhjen me tutun dhe bënin higjienë elementare gjatë intervenimeve.

Me nxjerrjen e dhëmbëve, më shpesh janë marrë berberët, të cilët kanë kryer edhe disa intervenime më të vogla kirurgjike. Berberët e kanë kryer edhe të ashtuquajturën “nxjerrje të gjakut”, me ushunjëza në rast se dikush ka pasur hipertension. Tek myslimanët synetin gjithashtu e kanë bërë berberët, berberët kanë shpuar veshë për të vënë vathët më së tepërmi tek vajzat.

Si anestezion mjekët popullore, më shpesh i kanë pirë pacientët me verë ose raki. Është përdorur edhe afion, konop dhe shtarë, si qetësues të dhimbjes, sidomos tek fëmijët e vegjël.

Midis atyre që merreshin me mjekim në sferën e medicinës popullore, më të shumta janë gratë. Ato shumë mirë i dallonin bimët mjekuese, që mandej me aftësi i thanin dhe përgatisnin për përdorim. Për

dallim nga ata me intervenime kirurgjike merreshin kryesisht meshkuj. Edhe gratë edhe burrat dituritë i trashëgonin nga prindërit, ndërsa jua tejbartnin vajzave ose djemve të tyre. Në atë mënyrë janë tejbartur prej brezi në brez dhe atë në mënyrë gojore.

## **KRIJIMTARIA POPULLORE GOJORE**

Valorizimi i kulturës shpirtërore i një bashkësie etnike, më shpesh sillet në lidhje me krijimtarinë popullore gojore. Sa krijimtaria popullore në madhësi dhe kualitet është më e lloj llojshme aq kjo pjesë përbërëse nga etno-kultura, e veçanërisht ajo shpirtërore, është më e pasur. Në këtë pamje edhe bashkësia etnike e Ballkano Egjiptianëve, nuk mund të jetë e lënë pas dore ose e nënçmuar, sepse krijimtaria popullore gojore e saj është e pasur dhe e lloj llojshme, edhe pse Ballkano Egjiptianët nuk kanë gjuhë të tyre të vetme.

Nga ana tjetër, bashkësitë e tjera etnike e kanë përvetësuar krijimtarinë popullore gojore të Ballkano Egjiptianëve, si të tyren, ashtu që numër i madh legjendash, tregimesh popullore, këngësh dhe vallesh popullore të cilat ende janë pjesë e krijimtarisë popullore të Ballkano Egjiptianëve, sot mund të gjenden në literaturën dhe folklorin e popujve të tjerë ballkanik dhe bashkësive të tjera etnike.

Stojan Risteski në librin e tij “Narodni prikazni, predanija i obiçai kaj Egipkanite/Egupcite vo Makedonija” publikuar në vitin 1991 ka shkruar: “Farkëtaria, përveç shitore në fshat ka qenë vend ku janë mbledhur njerëzit. Përveç për shërbim në shitore është ardhur edhe për këmbim mendimesh dhe përvojash. Koha e lirë është plotësuar me tregim rrëfimesh, dokesh, anekdotash, proverbash, gjëzash etj. Ashtu arrihej deri në “këmbim” të krijimtarisë popullore gojore.

Ai “këmbim” i tregimeve, këngësh, zamaresh, vallesh dhe folklorit tjetër arrinte edhe në jetën e përditshme të rrethit, sepse Egjiptianët ishin edhe vizitues të rregullt të pangjyrëve në të gjithë manastiret dhe lagjet krishtere. Farkëtari e respektonte çdo festë të rrethit. Kur nuk punonin bashkëfshatarët ose vendasit (për Krishtlindje, Pashkët dhe në festa të tjera krishtere), nuk punonte as farkëtari. Edhe ai me familjen festonte, duke i kryer ceremonitë e njëjta.

Kohën e lirë (në kushte pa elektrifikim, pa radio dhe televizion) farkëtarët, pikërisht Egjiptët e plotësonin duke rrëfyer tregime popullore dhe vepra mendore të tjera (përralla, gjëgjëza, fjalë popullore etj), mandej

me luajtje në instrumente, valle etj. nëpërmjet atij folklori është ruajtur tradita, tejbarteshin mesazhe dhe njohuri prej brezi në brez.

Folklori popullor tek Egjiptët është i pasur. Karakterizohet me autoktoninë e tij, por edhe me lidhjen dhe ndikimin e rrethit. Megjithatë, deri tani folklori egjiptas dhe mënyra e të jetuarit nuk janë mjaftueshëm të njohura, sepse edhe ajo që është e prezantuar dhe e përpunuar është e klasifikuar me pjesëtarë të tjerë. Tek ne numri më i madh i veprave mendore në lidhje me Egjiptët kanë vërejtur Marko Cepenkov, Kuzman Shapkarev dhe disa mbledhës të tjerë, por tek disa nga to ka indiferencë të pamjaftueshëm me grupet e tjera etnike.” (Ристески, С. 1991: 25-26).

Ekzistojnë më tepër shembuj ku mund të shihet se numër i madh i këtyre veprave janë përvetësuar dhe riemëruar në dëm të bashkësisë Ballkano Egjiptiane. Një shembull eklatant i tillë është legjenda për Feraonin të ashtuquajtur “car cigan” (Марушиакова, Е., Попов, В. 1994: 25-28), e cila në thelb është ndonjë variant popullor për tregimin që mund të gjendet edhe në Dhiatën e Vjetër për Faraonin dhe Mojsiun. Diçka të ngjashme ka vërejtur edhe Tihomir Gjorgjeviq me bashkatdhetarët e tij në lëvizjen prej Bosnjës Lindore, nëpër Serbi deri në Maqedoninë jugore, kuptohet në variante të ndryshme (Ђорђевић, Т. 1933: 122-144). Në tregimin, trim kryesor është i ashtuquajturi cari cigan Firaon, Farvan, i cili është transformuar edhe si Virga. Vetë emri “Faraon” dhe ndodhitë për të cilat flitet në gjithë këto tregime dhe legjenda ndodhin në Egjiptin e Vjetër, mijëra vite para se Ciganët/Romët e përjetojnë eksodin e tyre nga stëratdheu i tyre-Pengjapi dhe India veriperëndimore. Megjithatë, në shkencë deri tani askush nuk është munduar ta sqaroj këtë fenomen-pse tregimet dhe legjendat, të cilat përjashtimisht përkasin në rrethin e vjetër egjiptian, janë gjendur në kornizat e të ashtuquajturave tradita cigane/rome në të gjithë Evropën.

Situata të ngjashme konfuze kemi edhe kur bëhet fjalë për legjendat në lidhje me Aleksandërin e Madh, nëpërmjet të cilave vërtetohet se disa Romë kanë ardhur nga India, dhe atë si farkëtarë për nevojën e ushtrisë së tij (Петровски, Т. 2000).. Megjithatë, legjenda të tilla askund nuk janë të vërejtura në krijimtarinë popullore gojore të Romëve, dhe janë tendencioze të shpikura që të shërbejnë si kuazi argumente për plotësimin e disa vrimave të disa tezash “shkencore”, në përputhshmëri me disa raste ballkanike. Gjithashtu dihet se Aleksandari i Madh të gjitha betejat i ka fituar para se të mbërrij në pjesët perëndimore të Indisë, dhe kur është kthyer pasi ai fare nuk ka luftuar, ashtu që edhe fare nuk i janë nevojitur farkëtarë nga India për nevojat e ushtrisë.

Një konfuzion i ngjashëm ekziston edhe me disa legjenda të lidhura me krishterimin, përkatësisht me Jezu Krishtin. Pikërisht, sipas disa legjendave Ciganët/Romët janë të mallkuar në jetë me vuajtje-endacake, sepse sipas gjasës ata i kanë farkuar kunjat të cilët kanë qenë të vendosura për varjen e Jezu Krishtit . “Kreatorët” ose “përvetësuesit” e legjendave të tilla në të ardhmen do të duhet doemos të dinë se në sh.I kur Krishti ka jetuar në Jude, Ciganët/Romët ende nuk kanë pasur shkak ta braktisin stëratdhen e tyre, dhe fare nuk kanë qenë në Judenë me mijëra kilometra të largët. Legjendë shumë e ngjashme thotë se Ciganët kanë ikur nga Egjipti për shkak se kanë refuzuar ta pranojnë Shënmerinë me Krishtin, prandaj janë të dënuar në jetë të mjerë dhe endacake. Megjithatë, edhe kësaj here, siç thotë edhe Rade Bozhoviq, ky rrëfim është më afër traditës së monoteizmit egjiptian-koptik (**Божовић, Р.** 1996: 155).

Përveç Stojan Risteskit, i cili në vitin 1991 publikoj 24 tregime, 8 tradita dhe 13 doke të Ballkano Egjiptianëve nga Maqedonia, disa tradita, tregime, proverba dhe shprehje tek Ballkano Egjiptianët në Madan, në Bullgari ka shkruar edhe Anastas Primovski në punimin e tij nga viti 1955.

Marsell Kurtijade në vitin 2003 (**Courthiade, М.** 2003: 69-76), do të botoj 136 proverba të Ballkano Egjiptianëve nga Kosova. Këto proverba janë mbledhur në vitin 1980 nga Lumija Osmani-Kuç.

Një ndër traditat më të dashura të farkëtarëve Egjiptian në gjithë Ballkanin është ajo për krijimin e zanatit të farkëtarisë. Këtë traditë në variante të ndryshme e kanë vërejtur edhe Tihomir Vukanoviq, Anastas Primovski dhe Stojan Risteski (**Вукановић, Т.** 1983: 167; **ПРИМОВСКИ, А.** 1955: 249; **Ристески, С.** 1991: 31), por edhe ne nëpër hulumtimet terrenore nëpër gjithë Ballkanin. Ajo traditë thotë se farkëtar i parë ne botë ka qenë Hasreti Dauti (David), i cili hekurin e skuqur ka mundur ta mbaj dhe ta farkoj me duar të zhveshura, dhe gjatë asaj ka qenë shumë i aftë, ashtu që me një të goditur ka mundur ta farkoj hekurin. Që ta mbaj atë fuqi, askush nuk ka guxuar ta shikoj lëkurën e zhveshur të gruas së tij, as edhe gishtin e saj të vogël. Megjithatë, ndonjë njeri që është marrë me bërje simite (e diku thonë se kallfa i tij), i cili e ka ditur këtë sekret ka arritur nëpër një vrimë ta shikoj gishtin e vogël të bashkëshortes të Hasreti Dautit, derisa ai ka punuar. Atëherë dora e tij menjëherë është ngjitur në hekurin e skuqur dhe Hasreti Dauti nuk ka mundur më të punoj me duar të zhveshura. Duke u menduar çfar të bëj, ka parë ndonjë qen si han ndonjë eshtër, përkatësisht si i kryqëzon duart që të mos i ikin eshtrat dhe si me kokë e ka rrotulluar atë. Hasreti Dauti ka qenë pejgamber (i dërguar i zotit) duke e parë qenin i ka ardhur ideja të bëj darë prej dy pjesësh të hekurta që kryqëzohen, dhe të

bëj çekiç që ta godas hekurin. Prej atëherë edhe është krijuar zanati i farkëtarisë.

Gati tek gjithë popujt dhe bashkësitë ballkanike në Ballkan, vajtimet janë pjesë e rëndësishme e krijimtarisë popullore gojore. Vajtimet në Ballkan llogariten si një ndër shtresat më të vjetra paleoballkanike, ndërsa janë këngë pikëlluese për njeriun e vdekur. Herodoti për këtë paraqitje do të shkruaj<sup>302</sup>: “Këngë të vlefshme për kujtim ka edhe të tjera, por midis tyre ka edhe një këngë “Lin” që e këndojnë edhe në Feniki dhe Kipër edhe në vende të tjera; kuptohet tek popujt të ndryshëm nën emër të ndryshëm ndërsa del se është ajo që unë habitem dhe në shumë gjëra të tjera që takohen në Egjipt, midis të cilave edhe në atë se prej ku tek ata ai Lin. Ndërsa kuptova se e kanë kënduar kurdoherë. Ndërsa në këngën egjiptiane, Lin quhet Maneros. Egjiptianët thanë se ai djalë i vetëm i mbretit të parë të Egjiptit, ndërsa për shkak se ka vdekur nga vdekje e parakohshme, Egjiptianët me vajtime i kanë bërë nder. Thanë se tek ata ajo ka qenë këngë e parë dhe atëherë është kënduar vetëm ajo”. Sot tek Ballkano Egjiptianët ka edhe vajtime profesionale, të cilat angazhohen nga familja e personit të vdekur. Këto vajtime profesionale, posaçërisht mund të takohen në Shqipërinë jugore. Mbetet si përfundim se Ballkano Egjiptianët kanë krijimtari të pasur popullore gojore, e cila është e thurur me popujt dhe bashkësitë e tjera etnike në Ballkan. Gjithashtu, krijimtaria popullore gojore e Ballkano Egjiptianëve me qëllim ose pa qëllim është përvetësuar. Prandaj në hulumtimet e ardhshme shkencore, para së gjithash në ato folklorike e nevojshme është të rishqyrtohen shumë vepra të tilla tek të gjithë popujt ballkanik dhe bashkësitë etnike, me qëllim që të merret vesh e vërteta e drejtë dhe të mos përvetësohet trashëgimia kulturore e bashkësive të tjera.

### **Arti i zbatuar popullor**

Arti i zbatuar popullor i Ballkano Egjiptianëve, përkatësisht realizimet e tyre figurative, meritojnë vëmendje për shkak të lloj llojshmërisë së tyre dhe vlerave estetike. Kjo lloj krijimtarie specifike takohet në numër të madh gjërash të punuara nga materiale të shumë lloj llojshme (qime tekstili, dru, metal, argjil). Secila nga këto gjëra, varësisht nga karakteristikat natyrore të materialit janë stolisur në mënyra më të ndryshme.

Kultura e vjetër egjiptiane dhe civilizimi ndoshta është më shumë e pasur me veprat e artistëve nga arti i zbatuar popullor. Mbetje të ndryshme

---

<sup>302</sup> Herodot, II/79.

nga format e tilla janë zbuluar në piramidat dhe varrezat e faraonëve, ndërsa në muzeun e Kairit<sup>303</sup>, në të cilin në masë tepër të madhe janë të përfshira veprat artistike të gjetura në varrin e Tutankamonit mund të shihen numër tepër i madh nga ky art popullor. Duke filluar nga portrete impresive në gur, mobile nga forma dhe materiale të ndryshme, armë të stolisura dhe stoli-vepër e argjendarëve egjiptian, mandej saksii prej guri me vizatime të thjeshta gjeometrike, qafore të mrekullueshme, dorëza dhe unaza, të punuara me stil të lartë artistik. Kudo që të shikohet në këtë muze dhe në muzetë e tjera nëpër botë të cilat kanë departament të vjetër egjiptian<sup>304</sup>, duhet tju jepet mirënjohje njerëzve të cilët i kanë krijuar ato vepra artistike. “Egjiptianët e Vjetër kanë krijuar për amshim, ndërsa asgjë nuk është më e përhershme nga veprat artistike”<sup>305</sup>. Arti i zbatuar popullor i vjetër egjiptian kontinuitet të vetë ka në veprat e pasardhësve të tyre direkt, të cilët sot i quajnë Koptë, ndërsa arti i tyre karakteristik quhet Art koptik, në të cilin më ornamentet mbisundojnë dekorime nga religjioni krishterë<sup>306</sup>.

Formë më e përfaqësuar prezantimi figurativ tek të gjithë popujt ballkanik, por edhe midis Ballkano Egjiptianëve ishte ajo me qëndisjen kryesisht në pjesë të endura të caktuara për qepje të veshjeve popullore, si dhe pëlhura të tjera që janë shërbyer për nevoja të ndryshme shtëpiake. Qëndisjen e kanë bërë me shpuare dhe teknika të shumë llojshme. Në qëndisjen, e pjesshëm në pëlhurat dhe gjërat e thurura mbisundonte ornamentika me motiv nga bota bimore dhe gjeometria. Në motivet e huazuara nga flora, fuqishëm ndihej stilizim, i cili rast ishte edhe me figurat më rrallë të përfaqësuar zoomorfe dhe antropomorfe, që më së shpeshti paraqiteshin në kombinim me figurat nga bota bimore.

Nga figurat gjeometrike, përveç katrorit më të përfaqësuar ishin trekëndëshat, rombet, rrethet, vizat cik-cak, ikset, yje të ndryshme etj.

Disa nga paraqitjet e kryera përveç funksion estetik kishin edhe funksion magjik. Njerëzit fortë besonin se disa nga figurat e kryera të përfaqësuar në veshjet, me siguri mund ti mbrojnë nga më sysh dhe në përgjithësi nga “hijet e këqija”.

Me thurje janë kryer edhe tentene (tanteli), që më se tepërmi janë përdorur për zbukurimin e interierit shtëpiak, dhe me siguri të paraqitura janë në kohë më të re. Motivët që janë kryer dhe ende kryhen në to, me

<sup>303</sup> Vizitë të muzeut në Kajro, në Egjipt vizitë e realizuar në vitin 2002.

<sup>304</sup> Vizitë të muzeut arkeologjik në Athinë, ku ka departament egjiptian, realizuar në vitin 1997, ndërsa në departamentin në Luvër-Paris në shtator të vitit 2003.

<sup>305</sup> Egipatski muzej, Kajro, edicija muzeji sveta, Mladost, Zagreb, 1975, 1.

<sup>306</sup> Shiko, Umetnost Kopta, katalog nga përmbledhje e muzeut shtetëror në Berlin, Narodni muzej, Beograd, 1970.

përdorim teknike të veçantë, kryesisht janë parafytyrime të stilizuara në mënyrë luksoze nga bota bimore dhe gjeometria.

Zbukurimet prej druri-veprat artistike të gdhendura (thellë), Ballkano Egjiptianët nuk i kanë punuar vetë, por më shpesh atij i kanë blerë nga mjeshtrë që janë marrë me këtë zanat, me porosi ose prej në shitore, panaxhyre etj. Prodhime të tilla bukur të stolisura ndodhen nëpër tavane, dyer, dollapë etj.

Zbukurimi i metalit zakonisht ka qenë punë e argjendarëve të cilët kanë punuar zbukurime të mrekullueshme prej metali (vathë, pafta, hallka, unaza etj.). Këto prodhime gjithashtu kanë qenë të blera dhe shumë rrallë Ballkano Egjiptianët i kanë punuar vetë.

Si zbukurim karakteristik metali, mund të shihet në punimin e Anastas Primovskit, i cili na jep fotografi të një kurdhi nga Ustova të zbukuruar në mënyrë të mrekullueshme. Pikërisht, në të në mes janë të aplikuar dy diell me 8 cepa në anët janë të shënuara vija në lloj flatrash, ndërsa në pjesën e poshtme trekëndësha. Gati në të gjitha parafytyrimet e zotit Amon Ra, mbi të ndodhet diell me 8 cepa, ndërsa zoti Oziris gjithmonë është paraqitur me flatra të mëdha. Meqë trekëndëshat në shumë raste asocojnë në piramida, të gjitha krijimet e përmendura të kurdhit nga Ustova, fuqishëm tregojnë ndikimin mental artistit të vjetër egjiptian, i cili e ka zbukuruar kurdhin. Ky kurdh na hap dimensione të reja në mendimet për artin e zbatuar popullor të Ballkano Egjiptianëve dhe na jep shtytje për të gjetur shembuj të tjerë të tillë nga arti popullor nëpër vendet Ballkanike.

Në kornizat e artit të zbatuar popullor bënë pjesë edhe përpunimi i gurit dhe tokës. Posaçërisht prezentë tek Ballkano Egjiptianët janë zbukurimet në disa gjëra qeramike, të cilat janë të kryera me gërvishtje dhe prerje. Vëmendje më të madhe ju kushtojë disa nevojave ceremoniale.

Thënë përfundimisht, pjesëtarët e kësaj bashkësie, si vetë të mësuara dhe profesionalë, ndjenjat e tyre artistike në sferën e artit të zbatuar popullor, më së tepërmi i kanë shfaqur nëpërmjet përpunimit të qimeve prej tekstili, drurit, metalit, gurit dhe tokës.

Këto metale ju mundësojnë që t'i demonstrojnë prirjet e tyre ndaj estetikës dhe pikërisht për atë shkak ata mbajnë nishan veprash artistike karakteristike për periudhë të përcaktuar. Sot, numër më i madh i këtyre veprave e kanë tejkaluar përdorimin praktik.



## VALLE POPULLORE DHE MUZIKË POPULLORE

Valleve dhe vallëzimit në krijimtarinë popullore të Ballkano Egjiptianëve ju përket vend i veçantë. Ajo ka traditë të gjatë duke e marrë parasysh faktin se ndodhitë më të rëndësishme nga jeta e njerëzve ishin dhe janë të shoqëruara me valle. Rregullisht vallëzohet në dasma, por edhe në argëtime të tjera, sidomos nëpër mbledhjet popullore, për shkak të festave të ndryshme.

Për popullaritetin e traditës vallëzuese flet edhe njohuria sipas së cilës në vallëzim marrin pjesë përfaqësues të të dy gjinive dhe atë pavarësisht nga mosha (të rinjë, persona me moshë mesatare, të rritur, si edhe fëmijët).

Nga relievet dhe vizatimet e vjetra egjiptiane nëpër piramidat, tempujt dhe papiruset, mund të shihet se vallëzimi tek Egjiptianët ka qenë shumë prezent. Ai posaçërisht ka qenë i praktikuar gjatë festave religjioze, solemniteteve dhe procesione kultore për Ozirisin, Izidën dhe zotrat e tjerë për çka vërtetim gjejmë tek Herodoti<sup>308</sup>. Për argëtimet e sunduesve (faraonëve) dhe skllavopronarëve të tjerë, e njohur është se kanë vallëzuar valltarë të posaçëm profesional. Për fat të keq, nuk disponojmë me të dhëna konkrete për atë se si është vallëzuar në atë kohë. Gjëja e vetme që mund të supozohet dhe përfundohet nga relievet dhe vizatimet, me lëvizje të veçanta të bërrylave dhe bylyzikve të duarve, të cilat janë të vendosur në formë kobre (gjarpri). Por, gjithashtu në periudhën e Shtetit të Vjetër ka gjurmë vallesh ceremoniale dhe vallëzimi me maska ose armë (**Muzička Enciklopedija**, 1971: 506). Në periudhën e Shtetit të Mesëm vallëzimet e dikurshme magjike janë zhvilluar në pantonime, të përcjella me vallëzim dhe këndim. Disa vallëzime (sidomos ato akrobative) janë kryer vetëm me të rënat e duarve dhe rrahje të shkopinjve të drurit, derisa në hapa të qeta rregullisht ka marrë pjesë strukturë më e madhe instrumentale prej një ose më tepër flautesh të zgjatura, dhe një ose më tepër harpa në formë hudhre me 5-7 tela. Gjatë kohës së Shtetit të Ri lëvizjet e qeta vallëzuese të dikurshme, kanë pranuar karakter orgiastik, me siguri nën ndikim të Hiksëve (**Muzička Enciklopedija**, 1971: 506). Nga ajo që sot mund të shihet në Egjipt, edhe pse vallëzimi ka ndikim tepër të madh të Arabëve dhe Islamit, mund të ndjehen dhe supozohen disa elemente të vjetra egjiptiane. Ajo para

<sup>308</sup> Herodot, II/60

së gjithash është se, edhe pse në një vallëzim marrin pjesë më tepër persona ato vallëzojnë individualisht dhe nuk kapen për dore. Vallëzohet në ritëm jashtëzakonisht të shpejtë i cili krijohet nga instrumentet rënese, para së gjithash tarabuka dhe gratë sidomos i lëvizin kërdhokullat dhe duart. Për shkak të lëvizjes të kërdhokullave dhe lëvizjes mahnitëse të kryqeve, sot ky vallëzim ofendueshëm është i quajtur “vallëzim më bark” nën impresionet e ushtarëve Napoleonas të cilët kanë ardhur në Egjipt në fillimin e sh.XIX. edhe burrat sot në Egjipt më tepër vallëzojnë individualisht d.m.th. nuk kapen për dore dhe më tepër kërcëjnë me këmbët. Si vallëzim i meshkujve i njohur është i ashtuquajturi “vallëzim i dervishëve”, e ndoshta si valle specifike egjiptiane është rrotullimi i pafund i një burri rreth boshtit të tij, me fund të gjerë në formë korseti, i cili kur rrotullohet hapet në rreth shumë të madh. Mashkulli gjatë rrotullimit të pafund e nxjerr fundin dhe me të bën trupa të përcaktuar gjeometrik, që në fund të mbaroj me pelenë për fëmijë, që e mban në prehër.

Me vendosjen e kolonistëve egjiptian në Ballkan, me siguri vallet e tyre popullore kanë pësuar ndryshime nën ndikimin e popullatës të vjetër ballkanike të cilën e kanë gjetur aty. Ndryshimi kryesor përbëhet nga ajo që vallet individuale u zëvendësuan me valle kolektive, para së gjithash në kapjen për dore. Sot, midis Ballkano Egjiptianëve nuk mund të gjendet ndonjë valle e cila është individuale.

## **Vallet Popullore**

Vallja është valle e vetme popullore bartëse. Tek Ballkano Egjiptianët ekzistojnë valle në të cilat mund të marrë pjesë numër i pakufishëm personash, por edhe valle në të cilat numri është i kufizuar. Vallëzuesit qëndrojnë njëri pranë tjetrit, më shpesh të kapur për dore, pas brezi, nën krahë, për supesh, ndërsa shumë rrallë pa prekje reciproke.

Emrat për këtë kërcim janë: “oro” në gjuhën maqedonase dhe gjuhën bullgare, “kolo” në gjuhën serbe, ndërsa në gjuhën greke “horos” ose “sirtos”. Pjesëmarrja për plotësimin e valles quhet “vallëzim” ose “kapje në valle”.

Llojet e plotësimin të valles janë të ndryshme. Ato më shpesh kërcëhen në gjysmërreth të hapur, por edhe në kolona me më tepër ose më pak forma të parregullta, varësisht nga hapësira në të cilën vallëzohet.

Vallet e Ballkano Egjiptianëve kanë edhe specifikat e tyre në strukturat koreografike dhe metro-ritmike. Në variante të ndryshme të valleve këmba lëshohet në tokë me gjithë shputën ose vetëm me prekjen me

gishtat ose thembrën, me hapa të shkurtra, të mesme dhe të gjata, që hidhen përpara, pas ose anash (gjysmë majtas ose gjysmë djathtas).

Lloj më i përfaqësuar vallesh të cilat janë rreth qindra, kryesisht i përkasin në tipin “valle të lehta”, me tre hapa karakteristike vallëzimi, me lëvizje të ndryshme të vallëzuesve të cilët formojnë figura të lloj llojshme.

Megjithatë, midis valleve më karakteristike të Ballkano Egjiptianëve marrin pjesë të ashtuquajturat “valle të rënda”. Ato janë valle të ngadalshme, sensibile, të plotësuar me disa përmbajtje specifike të dramës. Për vallet e tilla thuhet se vallëzohen prej zemre, nga thellësia e shpirtit. Vallet e rënda karakterizohen me ritëm të ngadalshëm, hapa të matur, harmoni të hapave dhe çdo gjest dhe matje e trupit paraqet luks në vallëzimin popullor. Këto valle zakonisht janë valle meshkujsh, dhe këmbët, sidomos këmba e djathtë ngrihet lartë, disa herë këmbët mbahen me dhjetëra sekonda të ngritura në ajër, dhe ngrihen dhe lëshohen në sinjal të përcaktuar nga rënësi i daulles. Shpesh në këto valle gjunjëzohen por edhe vallëzohet (me hapa) në gjunjë. Valle mjaft specifike e tilla është ato nga Shqipëria jugore ku i pari (udhëheqësi i valles) shpesh herë kërcen lart dhe bie në gjunjë ose i gjunjëzuar, i mbajtur nga vallëzuesi i dytë. Gjatë vallëzimit në shumë raste këmbët i ngrenë lartë mbi kokë.

Shumë nga këto valle të rënda bartin ndonjë porosi me vete. Përmes tyre është treguar për jetën e vështirë të padurueshme dhe domosdoshmëria e mosdorëzimit në ato rrethana, por edhe të manifestohet gëzimi për shkak të martesave ose zgjerimit të familjes me anëtar të ri, si dhe të shënohet ndonjë festë ose ndonjë ngjarje që i ka bërë njerëzit me optimizëm.

Vallet sipas përbërjes të vallëzuesve mund të jenë mashkullore, femërore ose të përziera. Mashkulloret zakonisht janë valle të rënda, ndërsa ato femërore dhe të përziera kryesisht janë të lehta dhe të shpejta, me hapa të shkurtra, vallet mashkullore më shpesh janë të përcjellura me muzikë instrumentale (surla, klarinetë, daulle, harmonikë etj.) derisa ato femërore karakterizohen me atë që vetë gratë këndojnë dhe ju bien defeve.

Vallëzuesin e parë i quajtur udhëheqës i valles dhe i fundit i quajtur “bisht” ose “kec” më shpesh luajnë duke lëvizur dorën në ajër dhe duke rrotulluar shami.

Valle më të njohura janë: Beraçe, Devoliçe, Korçarçe, Gajdja, Babo, Sirto, Çashme e bardhë, Kërçovare, Çetvorka, Alësore, Gjangujica, Ibrahim Oxha, Teshkoto, Dibrane, Manastirase, Patruna, Kraj Varosha, Bilbi Dervish pasha, Zetnisko, Nevestinsko, Manuke, Çamçe, Moma na Voda dhe të tjera tek Egjiptianët në Maqedoni; mandej Bogovishte, Baba Kalendarit, Sirto, Ypa në një degë mbloodha ca qershí, Valle e zoçkës, Valle e Pajonit, Berate, Devole, Napolone, Osman Taka, Gorarçe, Valle e pijanëkut,

Valle e çiftetelit, Vallë Dushe Tiranase, Valle Dropulite dhe të tjera të Ballkano Egjiptianëve në Shqipëri; në Kosove më të njohura janë Vallja e Shotës, Vallja e Rugovës, Vallja Goca e Mallesise, Vallja e Kukësit, Vallja e Tropojës; në Greqi më të njohura janë Sirtos, Kalamatja, Pantazaliz (në Krit), Balos, Kasapikos dhe të tjera.

### **Muzika popullore vokale dhe instrumentale**

Muzika popullore e Ballkano Egjiptianëve përfaqëson trashëgim të pasur kulturor, e pasur me traditë muzikor të popujve të rrethit dhe bashkësive etnike.

Kulturën muzikore të Ballkano Egjiptianëve nga sfera e krijimtarisë tradicionale, e përbëjnë komponente vokale dhe instrumentale. Ajo domethënë se njëra nga pjesët e saj elementare i kushtohet këndimit popullor, ndërsa pjesa tjetër e muzikës popullore, që përkundër veçantive, në raste të dhëna paraqesin tërësi të pandarë, më saktë kompleks vokal-instrumental.

Sa i përket traditës vokale duhet të theksohet se ekzistojnë numër i madh stiles. Mënyra e interpretimit të këngëve popullore, sidomos në shekujt e mëparshëm, shpesh herë ndodhej në lidhje të ngushtë me doket, profesionin kryesor të popullatës, mundësinë më të madhe ose më të vogël për komunikim me mese më të afërta dhe më të largëta etj. Mënyrë mbisunduese gjatë plotësimit të këngëve është ajo monofone d.m.th. këndim i njëzëshëm ose polifone, përkatësisht këndim i dy zërash, por edhe këndim i trezëshëm.

Këndimi i trezëshëm është posaçërisht për Ballkano Egjiptianët nga Shqipëria jugore, Epiri dhe regjioni Ohër-Prepë. Këndimi trezëshëm këtu quhet: me iso, me kaba, me të mbajtur, me nande, me të rënkuar. Këndimi i trezëshëm këtu përbëhet prej zërit të parë që këndon vetëm një këngëtar, prej zërit të dytë që gjithashtu këndon vetëm një këngëtar dhe zërit të tretë që këndon grup këngëtarësh. Zëri i parë këndon prej fillimi deri në fund dhe atë melodi (zë udhëheqës). Zëri i dytë të cilin populli e quan zëri që e pret, nuk fillon bashkë me zërin e parë por diçka më vonë, pas fazës së parë, por edhe më vonë. Ai shpesh hyn edhe në mes fjalie dhe me zërin e parë krijojnë një lloj polifonie. Zëri i tretë fillon gjithashtu më vonë me zërin tjetër ose pas tij. Vazhdimisht mban ton të shtruar i cili është nota e fundit dhe këndohet me zanoren “e”. (**Muzička Enciklopedija**, 1971: 29).

Vetë këndimi dhe stili i tij, nga shkaqe të kuptueshme, mjaft varej nga ajo se a e plotësojnë këngën gratë, burrat ose të përzier. Ekzistojnë edhe

këngë fëmijësh që i plotësojnë fëmijët. Në Kosovë secili nga grupet (gra, burra dhe fëmijë) mbahen në këngët e veta. Asnjëherë nuk ka ndodhur që burrat të këndojnë këngë grash, ndërsa gratë këngë burrash. Ajo është llogaritur si turp më i madh. Këtu nuk ka pasur as edhe këndim të përbashkët të burrave dhe grave. Këngët e grave në Kosove këndohen me përcjellje të instrumenteve ritmike posaçërisht def (dajre). Ndërsa me përcjellje të instrumenteve melodike, kryesisht prej teli. Këndimi mund të jetë solo, në duet ose në grup.

Tradita instrumentale e Ballkano Egjiptianëve ka gjenezën e vetë prej kohrave të lashta e këtej. Ndarja kryesore e instrumenteve është në orkestër me kordha, frymore dhe rënëse.

Ballkano Egjiptianët nga Maqedonia perëndimore dhe Shqipëria veriore dhe disa pjesë të Kosovës, si instrumente kryesore i kanë surllet dhe daullet, të cilat luajnë në grupe (tajfa ose esnafe).

Grupet surlaxhike-daullase (tajfa ose esnafe) më shpesh përbëhen prej 3-4 luajtësve d.m.th. dy surlle dhe një ose dy daulle të mëdha. “Udhëheqësi i grupit është luajtës i vjetër me përvojë, i cili luan “solo” e quajmë “mjeshtër”. Luajtësi tjetër i surlës është bas-luajtës dhe e quajmë kallfë. Edhe për daullet ka mjeshtër dhe kallfë”<sup>313</sup>. Meloditë e këtyre përbërjeve tingëllojnë në madhësi prej dy oktavë në surlë melodike dhe përcjellëse. Kaluesi (kallfa) e përcjell melodinë me ton të pandërprerë, të shtrirë bordun, më shpesh me tonikën e melodisë (Линин, А. 1986: 121). Shembujt ritmik që i realizon daullja varen nga struktura e taktit të melodisë, ndërsa më shpesh është e përfaqësuar struktura e pa-trajtshme taktore. Nga strukturat e njëtrajtshme taktore të përfaqësuar janë vetëm ato dypjesëshe dhe katërpjesëshe (2/4 dhe 4/4) (Линин, А. 1986: 121).

Karakteristikë e përgjithshme e melodive të valleve është ndryshimi i tempos. Fillojnë me tempo të ngadalshme dhe pasi melodija do të përsëritet më tepër herë, tempoja përshejtohet, që të arrij deri në normale, të zakontë për atë lloj valle (Линин, А. 1986: 121)..

Repertori i tajfave surlaxhike-daullase është i lidhur me kushtet në të cilat veprojnë: dasmë, mbledhje, festë, synet. Në dasma dhe synete repertori është i lidhur me melodi të dokeve dhe valleve të cilat barten prej brezi në brez, ndërsa në mbledhje dhe festa me valle dhe melodi luftarake (pelivane).

Pjesa Dibrane-Mijake i ka dhënë përbërje më të njohura surlaxhike-daullase në Maqedoni, por edhe në Ballkan. Familja e madhe Majovci e cila është marrë me këtë profesion, ka qenë e njohur gjerë botës. “Majovcët më së miri e njohin traditat e Mijakëve”<sup>317</sup>. Kjo familje me shoqërinë më të

<sup>313</sup> Informues Petrit Isakovski.

<sup>317</sup> Informues Ramiz Zengo.

njohur kulturore-artistike maqedonase “Tanec” e ka prezantuar folklorin maqedonas në Francë, Belgjikë, Gjermani, Angli dhe në vende të tjera. Në vitin 1949 në Llangolen, Angli në Festivalin botëror folklorik, “Tanec” kur kanë luajtur (në instrumente) Majovcët në vallen “Teshkoto” e kanë fituar vendin e parë<sup>318</sup>. Turqët dhe Torbeshët e shpërngulur nga rajoni i Dibrës në Turqi, deri në ditën e sotshme i thirrin Majovcët që tju luajnë (në instrumente) në dasma dhe atë në: Izmir, Adapazar, Izmit dhe qytete të tjera. Por edhe Dibranët e shpërngulur në Libi i kanë thirrur për të njëjtin qëllim<sup>319</sup>.

Në të kaluarën tradita është tejbartur prej brezi në brez dhe gati çdo anëtar mashkull në familje ose ka luajtur në surlë ose i ka rënë daulles. Sa i përket luajtjes në surlë djali është dashur të ketë 13 vjet që të fillojë të mësojë të luaj në surlë, sepse përk shkak të mundimit të madh gjatë fryrjes mund të dëmtohet zemra. Në fillim mësohet të fryjë në surlë ashtu si duhet, përkatësisht të marrë frym dhe të fryjë “nga diafragma”.

Luajtjen e mësojnë si melodi, të cilat tejbarten si traditë, dhe secila melodi, sidomos ato që janë të lidhura me ceremonitë e dasmave kanë edhe emër të vetë si për shembull: “odenje na voda” (shkuarje për ujë), “kapenje na kumot” (larje e kumbarit), “briçenje na zetot” (rruajtje e dhëndrit) etj.

Gjithë melodinë e udhëheq “mjeshtri” në surlë, tjetri e ndjek, gjithashtu edhe rënësi kryesor i daulles e ndjek “mjeshterin”, ndërsa rënësi tjetër i daulles e “mbush zbrazëtinë”. Kur duhet të jetë atmosfera më e argëtuese atëherë daullexhinjtë e shpejtojnë ritmin dhe duke i rënë rrotullohen rreth vetes, gjatë çka fitojnë “bakshish” (shpërblim në të holla).

Sipas rastit të luajtjes, përkatësisht a luajnë në dasmë, mbledhje, festë ose synet, varet edhe sjellja e luajtësve, përkatësisht doket që janë të lidhura me luajtësit. Këtu duhet të theksohet se gjatë muajit të shënjtë të Ramazanit daullexhinjtë çdo ditë e shënojnë iftarin, përkatësisht se fillon koha e lejuar për të ngrënë. Për këtë “lajmërim” të tyre në fund të muajit të Ramazanit, ata fitojnë edhe shpërblim në të holla nga njerëzit.

Doket dasmore që janë të lidhura me tajfat surlagjike-daullase dallohen në varshmëri nga rajoni, përkatësia etnike dhe religjioni. Megjithatë në rajonin Dibran-Mijak vlen rregulla e rreptë “mos mund të merret nusja pa daulle”<sup>320</sup>.

Dok i veçantë arkaik i cili është i ruajtur mirë te Mijakët është “ftesa për të vdekurit në dasmë” që bëhet me surlë dhe daulle. Të dielën në mëngjes dy luajtës (më të vjetrit) shkojnë me dasmorët në varrezat që ti

<sup>318</sup> Mitko Aleksov, nga Shkupi, drejtor i dikurshëm i SH.K.A. “Tanec”.

<sup>319</sup> Informues Isakovska Lutvije, nga Dibra.

<sup>320</sup> Informues Ramiz Zengo.

“ftojnë të vdekurit”. Gjatë këtij doku arkaik surlaxhiu luan melodi të pikëllueshme speciale për këtë rast, ndërsa daullexhiu e vendos daullen në varrin dhe bie “ezgi” vetëm me dy thupra. Këtu muzika është ajo lidhje e cila, “kosmikiisht e lidh këtë botë me atë tjetrën”<sup>321</sup>.

Në meset qytetare, më popullore ishin tajfat çallgike. Ato luanin në qemane (violinë), klarinet, ut, def, kanun ose lahutë. Por për Ballkano Egjiptianët nga Shqipëria jugore dhe regjioni Ohrijan-Prespan klarineti (gërneta) paraqet një lloj instrument kulturi. Ekzistojnë virtuoze të vërteta popullore të këtij instrumenti. Me renome të veçantë është “artisti i popullit” Llaver Bariu nga Permeti, Shqipëria jugore. Ballkano Egjiptianët më së tepërmi i luajnë meloditë e ashtuquajtura “kaba”, që përfaqësojnë muzikë instrumentale, e udhëhequr nga klarineta, e cila fillon me ritëm të ngadalshëm, dhe gradualisht shpejtohet.

Instrumentet me tela Ballkano Egjiptianët gjithashtu i përdorin. Në Greqi janë të njohura instrumentet me tela buzuke, në Maqedoni përveç violinës gjithashtu edhe lahuta përdoret shumë, ndërsa në Kosovë, sidomos

---

<sup>321</sup> Borivoje Himrevski, “Kanenjeto na umrenite vo galička svadba kako muzička reminiscencija od kultot na mrtvite”, shkrim i lexuar në simpoziumin XIII ndërkombëtar për folklorin ballkanik, seksion 4-etnomuzikologji, në 7 korrik v.1997 në Ohër.

“Përmbajtja e muzikës instrumentale nuk është e definuar në mënyrë precize, ajo është “këngë pa fjalë”, por instrumenti muzikor ka fuqinë në mënyrë direkte të tejbart ndjenjat dhe porositë, të cekura në ceremoninë “ftim i të vdekurve”. Në atë mënyrë pa këngë gjegjëse, por me muzikë speciale, është arritur drejtpeshimi estetik në ceremoninë dasmore, mes pikëllimit dhe gëzimit dhe mes tradicionales, funksionale dhe të bukurës. Në popullin ekziston besim, se komunikimi i drejtpërdrejtë midis të gjallëve dhe të vdekurve vendoset me lidhje interzanore me ndihmë të instrumenteve muzikore...

...Pozita e shqetësuar gjeografike e f.Galiçnik, e folisur në malin e butë Bistra, sikur nga Zoti të jetë i krijuar për përjetim impresiv nëpër jehonën magjike malore, që në hapësirën kosmike shthuret dhe jehon nga të gjithë anët. Në atë eufori intenzive tingluese, nënvetëdijshëm në shpirtërat tona inicohet mendimi, se këtë zë dhe ritëm do ta dëgjojnë edhe të vdekurit, edhe ata do të gëzohen, përkatësisht papashëm do të marrin pjesë në gëzimin dasmor në familjen...

...Veprën rituale pasur të praktikuar “ftim i të vdekurve” në dasmën galiçnike e ndjejmë si aftësi të lartë kulturore, të plotësuar me principet thellë të respektuara tradicionale etnike, me të cilat në mënyrë relevante plotësohen nevojat shpirtërore të të gjallëve me të vdekurit.

Kulti ndaj të vdekurve, parë në distancë më të gjerë kohore është i vjetër sa edhe fisi njerëzor, dhe paraqet element instinktiv respekti ndaj reproduksionit njerëzor...”

në Rrafshin e Dukagjinit në qytetet Prizren, Gjakovë dhe Pejë, përdoren më tepër instrumentet me tela lahuta, çiftelia, sharkia dhe karadyzeni.

## **BESIMET POPULLORE DHE PËRKATËSITË KONFESIONALE**

Besimet popullore dhe religjionet janë element i rëndësishëm nga kultura e Ballkano Egjiptianeve.

I paraqitur në fillimin e llojit njerëzor, religjioni me shekuj është formuar si nevojë mbi bazë të shprehjes joadekuate të vetëdijes të njeriut të proceseve reale, objektive në natyrën dhe shoqërinë, në besimet dhe parafytyrimet religjioze, si dhe dogmat të krijuara për to, ose kultet dhe ritualet e kanë mbështjellë vetëdijen e njeriut me iluzione të pavërteta. Njeriu e ka pranuar botën në kuptim të gabueshëm të miteve fantastike dhe metamorfozave çuditëse, magji dhe mahnitje që e kanë nxitur të krijoj sisteme edhe më të çuditshme dhe më të ndërlikuara metafizike për votën dhe jetën pasvarrorë (Василјев, Л.С. 1987: 7). Megjithatë, disa besime bazohen edhe mbi bazë të disa përvojave popullore, të cilat janë rritur në të vërteta popullore-si mite, por disa besime kanë mbetur pa dëshmi si problematikë.

Religjioni është krijuar që nga njerëzit të tipit neadertal, në 10 mijë vite p.e.r. por me kalimin e kohës format religjioze dhe parafytyrimet janë rritur dhe komplikuar. Janë zhvilluar dhe përhapur kuptime magjike (besim në mundësinë që të ndikohet në mënyrë mbinatyrore në njerëzit, kafshët, dukuritë në natyrë) dhe besime totemistike (besim në afërsinë mbinatyrore të grupit të përcaktuar njerëzish me ndonjë lloj shtazor, bimë ose dukuri natyrore). Mandej paraqitet edhe animizmi (besim në hije, shpirta dhe shpirtësinë e tërësishme të natyrës), si shkallë fillestare e religjionit, mandej shamanizmi (besim në aftësinë e njerëzve të përcaktuar të vijnë në prekje me shpirtat, që të shfrytëzohet forca e tyre për mbrojtje dhe qëllime të tjera praktike) dhe fetishizmi (respektim i gjërave nga natyra e vdekur të cilave ju përshkruhen cilësi mbinatyrore). Besimet animiste gradualisht janë zhvilluar në drejtim të respektimit të paraardhësve shpirtëror dhe kultit ndaj natyrës dhe ndaj paraardhësve.

Me shkatërrimin e bashkësive fillestare dhe krijimin e shteteve të hershme, domethënie e veçantë filloj tju përshkruhet kultit të paraardhësve-mbrojtësit, udhëheqësit të fiseve të veçanta, kulteve agrare dhe blegtorale.



Është krijuar hierarki shpirttrash nga kornizat e të cilave veçohet një, të cilit i kushtohen cilësi të veçanta dhe shprehet respektim i veçantë. Në zhvillimin e mëtejshëm para së gjithash në shoqëritë klasore në religjionin gradualisht janë veçuar zotra të lartë dhe të ulët, ndërsa mandej edhe një zotri supreme. Në kornizat e disa religjioneve monoteiste ky proces do të sjell deri në një-zotësi, si formë e zhvilluar kuptimesh dhe besimesh religjioze, sidomos kur fiset bashkohen dhe krijojnë bashkësi fisnore, vëllazëri ose popujt e vjetër.

Në mileniumin e dytë p.e.r. zhvillohen edhe religjionet të cilat janë ruajtur deri në kohën e sotshme. Një besim i tillë është **judaizmi** (*hebraizmi ose mojsheizmi*) që u zhvillua në Azinë e përparshme, së pari si politeist, e mandej gradualisht të kaloj në religjion monoteist. Në fillimin e mileniumit të parë p.e.r. gjithashtu në Azinë e përparshme u zhvillua **zoroastrizmi** (sipas Zarastrust) në bazë të së cilit ndodhet mësimi për të mirën dhe të keqen. Në Indi u zhvillua mësimi politeist i quajtur **bramanizëm** (i cili më vonë u transformua në **hinduizëm**), i cili e ka klasifikuar sistemin e kasteve. Në Kinë rreth sh.VI dhe Sh. V p.e.r. gati njëkohësisht paraqiten dy mësimet filozofike-etnike-**taoizmi** dhe **filozofia e Konfuqies**. Në Japoni, nga respektimi i kultit ndaj paraardhësve dhe ndaj natyrës është zhvilluar religjioni **shintu**.

Disa religjione gradualisht do të rriten në përpjesë të mëdha gjeografike dhe deri në ditën e sotshme do të përfshijnë numër të madh popullsie me prejardhje të ndryshme etnike, dhe do të bëhen religjione të mëdha botërore. Ato janë **budizmi**, **krishterimi** dhe **islami**. Në Gadishullin Ballkanik si dhe për temën tonë dhe bashkësinë që e trajtojmë, Ballkano Egjiptianë, domethënie e madhe është krishterimi dhe islami, të cilat konfesione janë prezentë midis pjesëtarëve të kësaj bashkësie.

Megjithatë, periudha e vendosjes së kolonistëve Egjiptian në Ballkan, është periudhë **politeizmi**, ndaj sipas asaj e nevojshme është edhe të thuhet diçka edhe për religjionin dhe mitologjinë e vjetër egjiptiane. Për fat të keq respektimi i shumë zotrave të vjetër egjiptian në Ballkan, për çka ekzistojnë zbulime evidente arkeologjike, deri tani në shkencë është i trajtuar si import, pa analizë më detale shkencore dhe hulumtime të këtyre fenomeneve religjioze, sidomos në ato raste ku pa përmendshëm punohet për tempujt të zotrave të vjetër egjiptian. Për shkak se çdo religjion ka doktrinën e vetë (përbërje e besimit që jep shpjegim të plotë të realitetit), mandej mit (përralla për zotin dhe zotrat, për krijimin e botës dhe shpëtimin, për ngjarjet dhe personat me domethënie historike, dhe që është më e rëndësishme se miti nuk është shpikje), mandej etika (vlera dhe rregulla të sjelljes), ritualet (respektim, shenjtërim, “ceremoni në hyrje” në religjion, inicim, doke me të cilat rregullohet ushqimi dhe veshja), përvojë

(përjetime të individit për ndjenjën transadente dhe frikësuese ose ndjenjë përkatësie etnike dhe i përkushtuar ndaj ndonjërit më të madh nga vetja) dhe bashkësia (organizim institucional e njerëzve me ndihmën e të cilit organizim e përgjithësojnë religjiozitetin e vetë) (**Langen, Buteword, Alan**, 1988: 4), ndërtimi i tempujve të zotrave të vjetër Egjiptian në Ballkan në asnjë rast nuk mund të quhet import, sepse ato janë të ndërtuar edhe të ruajtur nga njerëz të cilët i kanë njohur këta zotra. Shpjegimi i dytë se bëhet fjalë për ndikim Helenas ose Romak, kjo tezë nuk mund të jetë e pranuar, sepse për shembull, tempuj të Izidës janë ndërtuar nga sh.IV por edhe më parë (**Selem, P.** 1997: 34), si dhe atë se disa statuja zotrash takohen në formë burimore egjiptiane, e jo në të helenizuar (**Selem, P.** 1969: 174).

Herodoti ka shkruar: “Madje emrat e gati të të gjithë zotrave në Heladë, kanë ardhur nga Egjipti”<sup>326</sup>, me çka dëshiron të na tregoj për ndikimin tepër të madh egjiptian në mitologjinë heliniste. Herodoti gjithashtu na përshkruan një legendë, që mund të na tregoj më shumë indikacione për përhapjen e besimeve të vjetra egjiptiane në Ballkan. Pikërisht, ai flet për një tregim që e ka dëgjuar nga priftëritë e Amonit në Teba, se dy gra priftëresha nga Teba kanë qenë të marra nga Fenikasit dhe njëra ka qenë e shitur në Libi, ndërsa tjetra tek Helenët, dhe se ato gra kanë themeluar profetësi tek këta popuj. Diçka e ngjashme është folur edhe nga priftërinjtë e Dodonës (afër Janinës së sotme), se dy pëllumbesha kanë fluturuar nga Teba, dhe njëra nga ato ka mbërrirë në Libi, ndërsa tjetra tek ata. Ajo është ndaluar në lis dhe me zë njeriu ka thënë se në atë vend duhet të themelohet profetësia e Zeusit (Amonit), dhe ata duke e pranuar atë si urdhër të zotit për ta, menjëherë e kanë kryer. Atë Herodotit i ja kanë treguar priftërinjtë e Dodonës, nga të cilat më e njohur është Prometeja, ajo pas saj Timareta dhe më e reja Nikandra, ndërsa me të janë dakorduar edhe priftërinjtë nga Dodona<sup>327</sup>. Në vazhdim Herodoti shpjegon se legjenda për pëllumbeshat tek Elinët është për shkak të asaj se me siguri gruan e cila ka arrit në Dodonë në fillim nuk e kanë kuptuar, sepse ka folur “barbarisht”, dhe ju është dukur si gragjitje shpendësh. Pasi pas një kohe ka filluar të flas në gjuhë të kuptueshme për to, kanë thënë se pëllumbesha ka folur me të folme njerëzore. Ndërsa ajo se pëllumbesha ka qenë e zezë, në realitet do të thotë se gruaja ka qenë Egjiptijane<sup>328</sup>. Mandej Herodoti krahason dhe thotë se “profetëritë, ajo në Teba në Egjipt dhe ajo në Dodonë janë shumë të ngjashme. Ndërsa shkathtësia për parashikim sipas kafshëve të flijuara është e ardhur nga Egjipti. Mbledhjet popullore, procesionet solemne dhe nderet

<sup>326</sup> Herodot II/50,

<sup>327</sup> Herodot II/54-55

<sup>328</sup> Herodot II/57

e tempujve të parë nga të gjithë popujt i kanë përgatitur Egjiptianët, ndërsa Helinët atë e kanë mësuar prej tyre. Se ajo është ashtu, kam dëshmi: ata e bëjnë atë që prej kohësh, ndërsa Helinët prej kohe më të re”<sup>329</sup>.

Nga krejt kjo rrjedh se ndikimi i kolonistëve egjiptian në besimet dhe mitologjinë e Elinëve, ndërsa edhe të fiseve tjera ballkanike në atë kohë (për shembull kulti i Dionisit, përkatësisht Ozirisit, tek Thrakët) është i madh.

*“Duke i studiuar tekstet religjioze të vjetra egjiptiane lexuesi mund të bindet se Egjiptianët e Vjetër kanë besuar në një Zot,...që ka jetuar vetëm nga vetja, ka qenë i pavdekshëm, i papashëm, i përjetsëm, gjithëditur, i gjithëfuqishëm, i paprekshëm; krijues i qiellit, tokës dhe botës nëntokësore;krijues i qiellit dhe detit, burrave dhe grave, kafshëve dhe shpezëve, peshqve dhe këmbëzvarrësve, pemëve dhe bimëve dhe i krijësave patrupsore-lajmëtarë-që i kanë plotësuar fjalën dhe dëshirat e tij. Askush nuk mund të tregoj prej ku ka arrit kjo karakteristike e rëndësishme e religjionit egjiptian dhe nuk ka asnjë dëshmi që do ta vërtetoj teorinë se në Egjipt e kanë sjellë shpërngulësit nga Lindja, siç duan disa të thonë, ose sipas mendimit të të tjerëve, ka qenë prodhim natyror i vendasve të cilët e kanë formuar popullatën në luginën e Nilit, para disa dhjetë mijë vjet. Ndryshe asgjë nuk dibet për kohën e krijimit të besimit në një Zot dhe të gjithëfuqishëm, shënimet thuan se kjo Vepër ka qenë e quajtur, me një emër diçka si Nētër (në gjuhën egjiptiane nuk ekziston e, dhe ky vokal shtohet vetëm që të mund të shqiptohet fjala), shenjë pitoreske e së cilit ka qenë mprehësja e sëpatës, me siguri prej guri, e ngecur në dorëz të gjatë prej druri...” (Volis Badž, E.A. 1985: 13-14; Rice, M. 2002: xxxvi).*

Ndoshta rastësisht ose jo, Ballkano Egjiptianët që flasin gjuhën shqipe për gjithësinë e shprehin me fjalën “Nētër”.

Në mitologjinë e vjetër egjiptiane krijimi i botës është llogaritur se ka rrjedhur nga oqeani botëror NU, ku ka ekzistuar Neb-er-çer (**Robinson, H.S., Wilson, K.** 1976: 7) (Zot deri në kufijtë më të gjerë) ose Nētër (**Volis Badž, E.A.** 1985: 13-14). Ai zot e mori formën e krijuesit-Khepri. Për shkak se e ka shqiptuar emrin e vetë dhe e ka caktuar vendin në të cilin do të qëndroj, Khepri ose Ra. Zoti i Diellit, është bashkuar me hijen e vetë dhe ashtu e ka krijuar Shun, zotin e atmosferës të thatë dhe Tefnutin zotin e ujit mbi qiellsinë). Mandej ato dy kundërshtime janë bashkuar dhe e kanë marrë brezin Nut (qielli) dhe Keb (Toka). Keb dhe Nut janë prindërit e Ozirisit dhe Izidës, Setit dhe Neftidës (**Robinson, H.S., Wilson, K.** 1976: 7-8). Zotrat e tjerë në mitologjinë Egjiptiane janë: Hor (djali i Ozirisit dhe Izidës, zot i dritës e cila fitoj errësirën), mandej Anibus (djali i Neftidës, zot i të vdekurve dhe i shkathtësisë të balsamimit), Tot (zot i shkrimit,

<sup>329</sup> Herodot, II/58,

procesmbajtës dhe kronist i Ozirisit, zot i muajit, shkencës dhe dijetar dhe zot i magjisë), Apis (zot i madh-kafshë e Egjiptit, dem i shenjtë), Net (nëna e Ra, zoteshë virgjëreshë), Ket (zot i lindjes dhe krijimit), Bubastida (vajzë e Izidës, zoteshë me kokë mace, dhe zoteshë e rrezeve të mira të diellit), Seket (motër e Bubastidës, me kokë luaneshe, zoteshë e rrezeve të forta të diellit e cila mundon dhe shkakton parahatshmëri), Sfinga (qenie shpirtmirë, siq është toka, e cila jep ushqim dhe fryte, zoteshë e diturisë) dhe shumë zotra të tjerë më të vegjël. Megjithatë zotra me respekt më të madh në mitologjinë Egjiptiane janë Ra (më vonë Amon, ose Amon Ra), Oziris dhe Izida. Legjenda për Ozirisin është rrëfim që tregon se Ozirisi ka qenë shumë i bukur dhe i mençur, i ka mësuar njerëzit ta punojnë tokën dhe ti shfrytëzojnë frytet e tokës. Por vëllai i tij lakmues Set, e ka vrarë dhe trupin e tij e ka copëtuar dhe pjesët e trupit i ka shpërndarë dhe i ka fshehur nëpër gjithë tokën. Izida-motra dhe gruaja e Ozirisit, me shumë dinakëri dhe dituri, fshehtazi nga Seti, ka arritur ti mbledh dhe ti bashkoj pjesët e Ozirisit, dhe ta ringjall d.m.th. përsëri ta ngjall. Me të Ozirisi është bërë zotëri i jetës pas vdekjes, i cili ka arritur ta fitoj vdekjen. Ai ka qenë gjygtar i cili i ka gjykuar shpirtat e të vdekurve, dhe nëse i vdekuri ka vepra të mira ai do të bëhet Oziris, d.m.th. do të jetoj përjetshëm, por nëse ka pasur vepra të këqija, ai do të ketë qenë i zhdukur, d.m.th. i ngrënë nga një kafshë-përzierje e kalit të ujit, luanit dhe krokodilit. Ky parafytyrim për Gjykimin e tmerrshëm ka jetuar që nga mitologjia e vjetër egjiptiane, ndërsa detajet nga ai mund të vëzhgohen në të ashtuquajturin libër i të vdekurve.

Izida motra dhe gruaja e Ozirisit, e cila i ja ka mbledhur pjesët e trupit dhe e ka ringjallur, përfshihet në ciklusin e madh të ripërtëritjes së natyrës, forcave shtazore, simbol i maternitetit. Karakteristikat universale të Izidës më së miri mund të takohen në tekstin e arkeologjisë nga Kuma, ku përveç të tjerash është e shkruar: “unë jam Izida, zonjë e krejt tokës, mua më ka mësuar Hermesi dhe unë bashkë me Hermesin e zbuluam letrën e popullit. Unë njerëzve ju kam dhënë ligje dhe e caktova atë që askush nuk mund ta ndryshoj. Unë jam e quajtur zotrëshë e grave. Për mua është i ngritur qyteti Babastis. Unë e ndava qiellin nga toka, dhe unë jua tregoj rrugën yjeve. Unë e shpika detarinë...Unë i bashkova gratë dhe burrat. Unë i obligova burrat ti dashurojnë gratë. Unë përcaktova që fëmijët ti duan prindërit e tyre. Me vëllaun tim Ozirisin e shkatërruam njerzngrenjen. Unë njerëzve jua zbulova misteret. Unë urdhërova të adhurohen statujat e zotrave. Unë i caktova tokat e tempujve zotror. Unë e përmbysa qeverinë e Tiranëve...Unë e caktova drejtësinë, e cila është më e fortë nga ari dhe argjendi. Unë e caktova atë që mbetet si e bukur dhe e mirë” (Selem, P. 1997: 18).

Siç dihet faraoni Amenhotep IV (1352-1336 p.e.r.)-është ai që bëri kthesë religjioze në Egjipt të Vjetër, më saktë ai e refuzoj Amonin si zot suprem dhe e vendosi Atonin (Aten) si zot të vetëm, duke e krijuar edhe qytetin Amarna si shenjtore të tij. Prandaj ky faraon ishte i quajtur edhe Eknaton-“ai që solli Atonin”. Besimi në Aton-një zot, llogaritet si religjion i parë monoteist në botë. Pas vdekjes të Eknatonit, priftërinjtë e Amonit, kanë arritur përsëri ta kthejnë dominimin e zotit Amon, nëpërmjet faraonit Tut-ank-amon (1336-1327 p.e.r.) përkatësisht në përkthim “ai që e ktheu Amonin”.

Besimi i tillë në mitologji, është sjellë në Ballkan nga kolonistët egjiptian, dhe në masë të madhe është i pranuar nga Helinët dhe disa pleme të tjera ballkanike. Por, Elinët në periudhë të përcaktuar historike kanë kryer edhe “përmbysje mitologjike” me çka i kanë hedhur disa kulte egjiptiane dhe mite si dominuese. Indikacione për këtë mund të gjinden edhe në mitin për Tezejin, djali i Egejit, i cili e ka vvarë Minaturin e Kritit, d.m.th. përbindëshin me kokë demi (Apis) në labirintin e tij. Mandej miti për Jazonin dhe Drakonin Kolhijas, të cilëve Herkulesi ka arritur t’ju marrë lëkurën e arit, që sundimtari i Kolhidës e kishte varur në një dru të ruajtur nga dragoi Kolhijas (**Приор, Ж.** 1993: 61). Gjithashtu shumë simpatik është zoti Helinas i zjarrit dhe mjeshtri kryesor, farkëtar i zotrave Hefes, i cili është djalë i Zeusit dhe Herës, por ka lindur i shqepuar (topall) dhe i shëmtuar dhe dy herë hidhet nga Olimpi, herën e parë nga e ëma e tij nga turpi dhe hidhërimi sepse ka qenë topall, ndërsa herën e dytë nga i ati sepse në zënkën midis babait dhe nënës ka qëndruar në anën e së ëmës (**Robinson, H.S., Wilson, K.** 1976: 153). Meqë kolonistët egjiptian janë marrë me përpunimin e metalit, hedhja e zotit Hefes nga Olimpi, mund të na tregoi për zbritje të ndikimit shoqëror dhe statusit të kolonistëve Egjiptian në botën helinase.

Megjithatë, ndikimi i mitologjisë të vjetër egjiptiane dhe kultit të zotrave të vjetër egjiptian, ka qenë i pranishëm edhe tek fiset e tjera dhe popujt e tjerë në Ballkan, para së gjithash tek Epirët (Epirotët) dhe atë jo vetëm për shkak të profetësisë në Dodonë, por edhe për shkak të legjendës se nëna e Aleksandërit të Madh, Olimpija ka mbetur shtatzëne për shkak të asaj që Amoni në formë gjarpri ka hyrë në të dhe e ka lënë shtatzëne, ndërsa shkak i asaj që Filipi ka parë nga dera ka mbetur pa një sy, si dhe atë se astrologu egjiptian dhe prifti Neftenah është babai i vërtetë i Aleksandërit.

Me zhvillimin e shtetit të Aleksandërit të Madh dhe hyrjen e tij në Egjipt, si dhe shkuarja e tij në profetësinë e Amonit në Oazën e Përhimtë, mitologjia e vjetër egjiptiane, tani në pamje të re, përsëri përhapet nëpër gjithë Imperinë e Aleksandërit, si dhe në Ballkan, ajo d.m.th. se në Ballkan

takohen forma të helenizuara të zotrave egjiptian. Edhe gjatë kohës së Imperisë më të vonshme Romake, kultet egjiptiane rëndësishëm respektohen jo vetëm në Ballkan por edhe në vetë Gadishullin Apenin dhe në Rome, edhe pse ka të dhëna se zotrat egjiptian në Gadishullin Apenin janë respektuar edhe para zhvillimit të Imperisë Romake, sidomos gjatë kohës së civilizimit Etruras.

Me paraqitjen dhe përhapjen e krishterimit, kultet dhe zotrate të vjetër egjiptian, edhe në Egjipt edhe në Ballkan, ngadalë shuhen deri në zhdukje totale nga skena religjioze. Megjithatë, edhe krishterimi në fillim më masivisht është pranuar në Egjipt, ku ishte e themeluar edhe kisha e parë nga ana e ungjillorit Marko. Edhe lëvizja monahe më herët dhe më masivisht u paraqit dhe u zhvillua në Egjipt, ndoshta si kontinuitet i priftërve më të hershëm politeist, të cilët jetonin jetë të rreptë monahike që në atë kohë, por edhe shkak religjionit të vjetër egjiptian se Zoti-krijuesi Nätër është zot i vetëm. Një-zotësia në Egjipt ishte e njohur edhe gjatë kohës së Eknatonit, përkatësisht besimit se Atoni është zot i vetëm.

Edhe në Ballkan nga shkaqet e njëjta, me siguri kolonistët Egjiptian shpejt e kanë pranuar krishterimin. Por, luftimet kishtarë gjatë kohës së Këshillave të mëdha ekumene kishtarë, për çka folëm në pjesën historike dhe sundimin përfundimtar të dogmës greke me kishën, por edhe me perandorinë Bizante, me siguri ka kontribuar që popullata Egjiptiane në Ballkan, të jetë e privuar nga jeta kishtarë.

Hyrja e Osmanlive dhe instalimi i islamit paraqet element të ri në Ballkan, por edhe midis popullatës me prejardhje Egjiptiane. Islami në Egjipt hyri që në sh.VII, ku gjithashtu ishte masivisht i pranuar, si revolt ndaj reprezaljeve Bizantine ndaj kishës Kopte, si dhe përparësitë që i dhuronte islami në besimin në një zot dhe normat dhe vlerat etnike. Me hyrjen e islamit në Egjipt, u krijua edhe procesi paralel, arabizimi, para së gjithash në gjuhë, letërsi dhe kulturë, me çka definitivisht ishte dhënë edhe goditja e fundit e civilizimit dhe kulturës të vjetër Egjiptiane. Kjo edhe më tepër që me ardhjen e kalifit Osman, në Aleksandri, muzeu dhe bibliotekat kanë qenë tërësisht të shkatërruara dhe të djegura nën pretekst: "Gjithçka që është e vlefshme është e shkruar në Kuran, për gjithçka që nuk është në Kuran nuk duhet të ekzistoj".

Islami në Ballkan siç thamë, hyri me Osmanlinjtë dhe popujt e parë që masivisht e kanë pranuar islamit janë ato që i kanë ndier reprezaljet e Bizantisë dhe shtetet krishtera mesjetare. Ata para së gjithash kanë qenë bogomilët (babunë, torbarë) në Maqedoni, pavlikijet në Bullgari dhe patarenët në Bosnjë. Nga ky shkak mendojmë se edhe Ballkano Egjiptianët të cilët islamizoheshin midis të parëve e kanë pranuar islamit, për çka edhe

midis Aguptëve në Bullgari thuhet se ata janë më të vjetrit e “din islamit”. Megjithatë, tek numër i madh pjesëtarësh të Ballkano Egjiptianëve të cilët e kanë pranuar islamin, deri sot janë të ruajtura numër i madh i festave krishtere dhe para-krishtere, të cilat ruhen si kult, për çka diçka folëm, ndërsa edhe diçka do të themi në pjesën për doket kalendarike.

Sot pjesa më e madhe e Ballkano Egjiptianëve i përkasin konfesionit islam dhe ata kryesisht i përkasin në degë sunitë. Numër i vogël përkasin në disa rende dervishe përkatësisht tarikate. Nga tarikatet midis Ballkano Egjiptianëve më të përfaqësuar janë rendi dervishas mevlatin dhe bektash.

Pjesëtarë të kësaj bashkësie me konfesion ortodoks-krishter ka në Shqipëri jugore dhe në Greqi, por edhe në pjesë të Republikës të Maqedonisë.

Me këtë mund të përfundojmë se pjesëtarët e Ballkano Egjiptianëve i përkasin më tepër bashkësisë konfesionale.

#

## **DOKE POPULLORE**

Doket (adetet, zakonet) popullore janë element shumë i rëndësishëm i etno-kulturës të gjitha bashkësitë. Në Gadishullin Ballkanik ato paraqesin institucion nëpërmjet të së cilit ruhet tradita, shprehjet identiteti, veçantia por edhe universaliteti.

Sipas karakterit dhe kushtimit doket ndahen në mënyra të ndryshme dhe sipas metodologjive të ndryshme. Por sistematizimi më i pranuar është ndarja e atyre nga ciklusi i jetës, mandej ciklusi kalendar, si dhe doke nga grupe të lidhura me punën dhe doke juridike.

## **DOKET NGA CIKLUSI I JETËS**

Doket nga ciklusi i jetës ju përkasin momenteve më të rëndësishme të një njeriu, lindja, martesja, por edhe doket gjatë vdekjes. Në doket nga ciklusi i jetës tek pjesëtarët me fe myslimane bëjnë pjesë edhe doket gjatë synetit.

### **Doke gjatë lindjes**

Besohet se nëse gruaja ciklusin e fundit menstrual e ka pasur në “risi” (hënë të re) atëherë ajo grua do të lind vajzë. Ndërsa në momentin e fillimit të embrionit babai ka qenë nën ndikim alkooli atëherë fëmija do të lind me të meta.

Kur ndonjë grua do të ketë mbetur shtatzënë, ndërsa ka dëshiruar të mos e lind foshnjën atë ka mund ta bëj deri në muajin e tretë të shtatzënisë. Kanë shkuar tek gra (babica) të “fërkohen nëpër bark”. Por shpesh herë ka pasur edhe pasoja të padëshirueshme kur gruaja edhe ka vdekur. Gjithashtu



nëse gruaja nuk ka dëshiruar të lind me qëllim ka ngritur gjëra më të rënda (barra). Tek “babicat” për fërkimin e barkut është shkuar edhe nëse gruaja nuk ka mund të mbetet shtatzënë. Në Kosovë atë e kanë bërë me shkuarje në disa tyrbe myslimane. Në Bar dhe Ulqin nëse nusja nuk ka mundur të mbetet shtatzënë ka mundur të vij deri në shkurorëzim. Në Kosovë, nëse kanë dëshiruar që foshnja të jetë djalë, atëherë babai dhe gruaja shtatzëne e kanë shpuar gishtin me gjilpërë që të rrjedh gjak dhe mandej kanë lënë gjak në trung të prerë.

Lindja është ngjarje solemne dhe e gëzueshme në çdo familje dhe të gjithë anëtarët me gëzim dhe padurim presin ardhjen e anëtarit të ri në botë. Kur nusja do të hynte në muajin e nëntë nga shtatzënia, njerëzit e shtëpisë asnjëherë nuk e kanë lënë vetëm në shtëpi. Çdoherë me të në shtëpi ka qëndruar ndonjë grua (vjehera, kunata). Më parë, kur gruaja shtatzëne i ka ndier dhimbjet e lindjes kanë filluar përgatitjet për lindjen. Është vendosur kutelli i ngrohët uji dhe janë përgatitur pelena prej leshi, ndërsa kur ato nuk i kanë pasur janë grisur këmisha. Është thirrur “babica”, ndërsa nëse nuk kanë qenë në mundësi që atë ta thirrën, lehonës i ka ndihmuar vjehera dhe gra të tjera më të vjetra. Të gjithë personat e gjinisë mashkullore, duke e përfshirë edhe babain e ardhshëm ikin nga shtëpia.

Nëse lindja ka qenë e vështirë njëra nga gratë prezentë i ka dhënë të pijë dhe e ka lagur me “ujë të kryqëzuar” ose “ujë të kënduar”. Kur foshnja ka lindur “babica” me gërshtëri i ja ka prerë këthizën dhe i ja ka dhënë vjehrrës, e cila mandej e ka hedhur. Vjehrra e lan dhe e mbështjell foshnjën në pelenë të bardhë prej leshi. Uji që herën e parë është larë foshnja është derdhur pas dere, ndërsa shtrati është varrosur në bajgat e kafshëve shtëpiake.

Foshnja është vendosur në këndin e dhomës, ku i kanë vendosur pe të bardhë, të rri varë, hudhër të bardhë dhe duaj prej fshese, që të mos e marrin mësysh “sytë e këqija”.

Tek ato me religjion ortodoks, kur ka mbaruar lindja lehonën (gruaja që ka lindur deri 40 ditë nga lindja) e kanë lënë të pushoj, ndërsa vjehera ka shkuar në kishë për ujë të shenjtë “Lutje të vogël”. Me atë ujë të shenjtë është larë lehona në fytyrë dhe në gjitë, ndërsa është shtir edhe pak në ujin me të cilin është larë foshnja. Vjehrra ka gatuar “petulica” dhe ka dërguar ndonjë fëmijë (pa dallim gjinie, por më mirë është të jetë mashkull) ti ja dërgoj lajmin e gëzueshëm babit, përkatësisht ti “marr myzhde” (mushtullo). Sipas besimit nëse në momentin kur i është “kërkuar myzhde” babai ka pasur të holla, ai fëmijë çdoherë do të disponoj me shumë të holla.

“Nata e tretë”, “Tretata nok” quhet “navigje” tek Egjiptianët në Maqedoni, sepse shkohet për ta parë foshnjën. Në “navigje” tek Ballkano

Egjiptianët në Maqedoni, sillen dhurata dhe gjëra të ëmbla, zakonisht të gatuar në shtëpi. Nëna e lehonës sjell djep si dhe dhurata për të bijën, dhëndrin dhe krushkën. Në regionin Ohrijan-prespan gjatë darkës nxirret tepsi me bukë të thërrmuar dhe foshnjën e mbajnë dy gjyshërit (ose farefisi më të afërt nga familja e babait dhe nënës), duke qëndruar njëri përball tjetrit. Ata e çojnë tre herë prej dore në dorë, ndërsa krushku e thotë emrin e foshnjës. Më parë për zgjedhjen e emrit janë vendosur tri fije prej shkrepse, secila me një emër për foshnjën, dhe është miratuar ai emër, përkatësisht fije e cila është djegur e fundit, si simbolikë se me atë emër foshnja do të jetoj më gjatë. Buka e thërrmuar nga tepsia vendoset në pelenat e foshnjës. Nëna e mjel qumështin e saj në gotë ku gatuhet me miell, tepsia me bukë të thërrmuar dhe përdoret që mysafirët të hedhin të holla. Në funksion “mbarsjeje” me fuqi të re për nënën, zbatohet doku në tepsi të zbrazët të vendosen copa bakllave nga tepsitë e plota, për mëndeshën. Atë e bën ndonjë nga farefisi, i cili duhet të marrë nga tepsitë por të jetë më pak i rënë në dorë nga njerëzit e tjerë rreth sofrës. Në Shqipëri për atë qëllim mëndesha han miell të gatuar veças i cili ziet në ujë (“bukë valle”).

Në atë natë nga kulloshtira lehona “ka kafshuar nga pak, që të ketë më tepër qumësht”. Që ta ruaj qumështin nëna ka ngrënë shumë qepë dhe ka pirë shumë ujë, nuk është përshëndetur me mysafirët, nuk i ka përcjellë, përkatësisht nuk ju ka thënë “me shëndet”, mandej nuk ka dalë jashtë pas perëndimit të diellit.

Në natën e tretë në Kosove kur i vendoset emri foshnjës ju dorëzohet prej dore në dore, njerëzve më të moshuar, ndërsa në sofrën në të cilën është ngrënë darka hidhen të holla. Emri i foshnjës më së tepërmi jepet nga Kurani, por tejbarten prej gjyshi në nip dhe prej gjyshes në mbesë. Hoxha ose ndonjë person tjetër i cili i di lutjet fetare islame, i këndon Ezan në veshin e djathtë, ndërsa nëse është djalë edhe Kiamet në veshin e majtë.

Në natën e tretë besohet se në mesnatë do të vijë melaqet ti ja caktojnë fatin foshnjës, prandaj asnjë nga personat e familjes nuk ka fjetur dhe shtëpia nuk guxon të jetë në errësirë. Nën jastëk foshnjës i është vendosur libër ose Kuran me besim se do të jetë “e ditur, e mençur”, ndërsa nëse ka qenë vajzë i është vendosur ndonjë pëlhurë e qëndisur “që të jetë amvise”.

Në Bar dhe Ulqin në Mal të Zi, emri foshnjës i është vendosur në natën e shtatë dhe ai solemnitet është quajtur “babinë”.

Në periudhën prej 40 ditësh ( gjashtë javë) lehona nuk ka guxuar vetë të dalë jashtë dhe të shkoj për mysafire. Në atë periudhë ajo llogaritet si e papastër (periudhë derisa ajo derdh gjak). Gjatë asaj kohe lehonës deri në tre herë i “falltohet prej unai” (bërje magji që të mos e sulmojnë zanat). Kur

foshnja do të ketë mbushur 40 ditë lehona bashkë me foshnjën, kanë mundur të shkojnë tek nëna e nuses, ndërsa tek ata me fe krishtere së pari bashkë me vjehrrën shkojnë në kishë në “Lutje të madhe” (“Golema molitva”). Në Mal të Zi, pas 40 ditë nusja dhe foshnja së pari kanë shkuar tek xhaxhai dhe farefisën e afërt të babait, ndërsa mandej ka shkuar tek familja e vetë në “pasija” ose “gosti”.

Nëse në ndonjë familje vdes foshnja e porsalindur, atëherë gjyshja e merr foshnjën, e ka lënë në rrugë ose në udhëkryq dhe kush do të ketë kaluar i pari ai ti ketë dhënë emër foshnjës dhe ti bëhet kumbar, pa dallim gjinie, feje ose gjendje sociale. Këtë dok posaçërisht e kanë praktikuar Ballkano Egjiptianët nga Kosova. Ndërsa në Mal të Zi foshnjës i është vendosur ndonjë emër i fshehtë, të cilin e ka ditur vetëm ai person që i ja ka vënë emrin, ndërsa emri publik ka qenë i ndonjë pejgamberi (lajmëtar i Zotit nga Kurani).

Më parë foshnjave detyrueshëm ju është dhënë gji prej 1-3 vjet. Nëse foshnja nuk ka dashur gji, ekziston një bar që quhet “bari i babicave” (babiçna treva), i cili përzihet me vaj dhe mandej lyhet nëpër gjithë pjesët e nënës dhe foshnjës, e sidomos goja dhe fytyra e fëmijës. Që të ndahet foshnja nga gjiri kanë ditur vetëm vjehrra dhe nëna. Nëna me gjirin e djathtë i bie foshnjës në qafë tre herë dhe ka shqiptuar “kur do ta shikosh qafën atëherë të kërkosh gji”. Për ta ndarë foshnjën është përdorur edhe metoda e lyerjes të gjirit të nënës, me biber të kuq. Nëse foshnja ka qarë shumë atëherë është “fryrë” (kushalo). Foshnja nuk ka guxuar përsëri të pi gji pasi të ketë qenë e ndarë nga gjiri, sepse “do të ketë shumë sy mësysh”.

Foshnja mund të merr mësysh edhe nga njeri që shumë dëshiron të ketë fëmijë. Në Kosove foshnja e marrë mësysh dërgohet tek ndonjë gjyshe që di të tres plumba duke kënduar lutje fetare në vete. Plumbi i shkrirë hidhet tre herë në ujë. Atëherë gjyshja mund të shohë sa nga çka është e sëmurë foshnja dhe mbi bazë të figurës që plumbi do ta bëjë në ujë. Plumbi i shkrirë vendoset nën jastëkun e foshnjës dhe sipas besimit ditën e nesërme foshnja do të jetë e shëndoshë. Në Shqipëri foshnja qohet në të kënduar dhe lahet me ujë që gjithashtu këndohet.

Kur do i dalë dhëmbi i parë gjithashtu duhet ta shikoj ndonjë femër dhe ti jap dhurata, ndërsa nuk ka guxuar e para ta shikoj e ëma e foshnjës, sepse besohet se nëse ajo ndodh, në të ardhmen kur do ti rriten dhembët do ti dhembin shumë.

Flokët për herë të parë foshnjë i janë prerë kur i ka bërë një vjet. Nëna e dërgon tek ndonjë burrë ose grua, pavarësisht kush e kryen atë punë dhe floku i parë ruhet, ndërsa berberit i dhurohet një rizë.

## **Doket gjatë lidhjes të kurorës (martesës)**

Më parë për zgjedhje e partnerit gjatë lidhjes së kurorës kanë vendosur prindërit për kë do ti martojnë fëmijët e tyre. Fjala e prindërve rreptë është respektuar. Ka ndodhur që bashkëshortët e ardhshëm për herë të parë të shihen në dasmë.

Djemtë janë martuar prej moshës 21-25 vjet, ndërsa vajzat prej moshës 16-18 vjet. Për djemtë është thënë se “ai tani nuk duhet ta ketë syrin tek vajzat” ose “se nuk duhet të shkoj nëpër shtëpitë e shokëve të cilët kanë motra në vjet”, ndërsa për vajzat është thënë se është “e arritur” (e stasano). Më parë për vajzat mbi 20 vjet, të cilat nuk kanë qenë të martuara është thënë se kanë mbetur (ostanala).

Më parë rendi ka detyruar që xhaxhallarët dhe dajallarët të mendojnë cilën vajzë “ta zënë” për nipin. Ndonjëherë është dëgjuar edhe mendimi i djalit, por fjalën e fundit e kanë pasur prindërit. Atëherë ata kanë dërguar shkues (mësit) ose (navodaxija), në shtëpinë e vajzës. Zakonisht shkuesi është njeri i afërt i të dy prindërve. Shkuesi kur ka shkuar në shtëpinë e vajzës ai me vetë ka marrë shkop dhe çdoherë është ulur pranë vatrës dhe pa e parë kush ka përzier me shkopin në prushin e zjarrit : “që të nxitet puna siç është nxitur edhe zjarri”. Pas bisedës të zakonshme midis të dyve, shkuesi i tregon nikoqirit pse ka shkuar, përkatësisht se është i dërguar nga “filan” djali që ta kërkoj dorën e vajzës së tij. Shkuesi gati asnjëherë prej herës së parë nuk ka marrë përgjigje pozitive. Më së shpeshti përgjigja e prindërve të nuses ka qenë ta pyesim familjen. Ka ndodhur gati çdoherë shkuesi të shkoj në shtëpinë e vajzës dhe nga tre herë. Në Shqipëri nëse prindërit e vajzës kanë pranuar, kanë dërguar ndonjë djalë tek shkuesi me fjalët “po urdhëroni në shtëpi ta merrni përgjigjen”. Ndërsa nëse përgjigja ka qenë negative takimi është caktuar në ndonjë kafene dhe i është dhënë përgjigje “vajzën e kemi të vogël”, “një herë jemi bërë miq”, ose “nga i njëjti gjak jemi”. Në Mal të Zi gjatë përgjigjes negative është thënë “Le tju jetë i gjallë dhe i shëndoshë nipi, ndërsa mua vajza, por vajzë për të martuar nuk kemi”.

Vajza asnjëherë nuk ka kundërshtuar në vendimin e babait të vetë pa dallim a ka dëshiruar të martohet për atë djalë ose jo. Atë natë pasi i është dhënë fjala shkuesit, babai i djalit dhe ai janë marrë vesh kur të vijnë në mënyrë “zyrtare” nga ana e djalit. Kur shkuesi është kthyer në shtëpinë e djalit dhe jua ka dërguar lajmin e gëzuar, për kohë të shpejtë, në periudhë prej dhjet ditësh duhet të hapet rruga, d.m.th. prindërit e djalit është dashur të shkojnë në shtëpinë e vajzës. Në Shqipëri kjo shkuarje e parë quhet “Shkelje”, ndërsa në Maqedoni “dhënia e fjalës” (davanje na zbor).

Për të dhënë fjalën nga ana e djalit shkojnë më të afërmit e tij: baba, vëllai, xhaxhai ose daja në shtëpinë e vajzës, ndërsa në disa vise në Ballkan kanë shkuar edhe persona nga gjinia femërore, sidomos nëna e djalit. Në këtë takim merren vesh për fejesën, ditën e dasmës, numrin e njerëzve për të cilët duhen dhurata, numrin e njerëzve që do të vijnë për fejesë, pas dasmës çifti i porsamartuar a do jetojnë bashkë me prindërit ose të ndarë.

Fejesa (veridba) është bërë pas një jave ose diçka më vonë. Si radhë fejeze zakonisht shkojnë persona nga gjinia mashkullore, farefisët më të afërt të djalit. Quhen rizaxhinjë, sepse në fund të fejesës marrin nga një rizë (peshqir) nga e fejuara. Nëna e djalit përgatit dhurata për vajzën (këpucë, sandale, çorapë, unazë, vathë, këmishë) si dhe dhurata për familjen e vajzës, sipas marrëveshjes. Krejt dhuratat janë vendosur në bofsha (tepsia)-njëra me dhuratat për vajzën, tjetra me dhurata për familjen dhe e treta me llokume, sheqerka dhe karamеле. Numri i njerëzve që shkojnë në fejesë doemos duhet të jetë tek. Tek myslimanët në përbërje të rizaxhinjëve janë vetëm burra, ndërsa tek krishterët shkojnë edhe gratë e tyre. Djali dhe nëna e tij nuk shkojnë, ata rrinë në shtëpi. Pasi i tregojnë dhe i ndajnë dhuratat, mysafirët shërbehen me ushqim dhe pije. Në kërkim të mysafirëve të shikojnë “mos shqepoj nusja ose mos jetë e verbër” del vajza e cila ju puth dorën mysafirëve, ndërsa ata i dhurojnë të holla. Mandej mysafirëve ju japin riza (peshqir). Në fund, e diku pas dhënies së dhuratave, krushqit-babai i djalit dhe vajzës pinë sherbet (ujë me sheqe), që jeta e çiftit të ri të jetë e ëmbël si sherbet. Nga ky çast vajza dhe djali llogariten si të fejuar.

Të fejuar të rinjtë më parë kanë qëndruar prej një deri tre vjet. Për atë periudhë vajza e ka përgatitur “çejzin” dhe dhuratat. Në periudhën kur të rinjtë kanë qenë të fejuar fare nuk janë parë dhe janë takuar, nëse ka ndodhur rastësisht të takohen në rrugë, vajza është fshehur ose i ja ka kthyer kurrizin djalit.

Më parë dasmat kanë zgjatur 7 ditë. Duke filluar prej të dielën ose të hënën deri të dielën tjetër. Çdo ditë tek Egjiptianët nga Shqipëria ka pasur emër të vetë varësisht nga aktiviteti që është kryer (ditë për të ftuar, dita e kënës, ditë e furrës dhe qiqrës, ditë e krushkave, ditë e nuses, ditë e berberit dhe e krushqve). Ftesa për dasmë zakonisht është bërë një javë para se të shkohet për krushk. Ftesën e ka bërë person i gjinisë mashkullore me sheqerka, për çka ka ftuar edhe shpërblim në të holla nga njerëzit që i ka ftuar. Tek krishterët kumbari ftohet nga baba i dhëndrit me pogaçe dhe me raki.

Gatimi i bukës zakonisht është bërë në ditën e mërkurë, por edhe në ditë tjetër. Janë mbledhur farefisi nga gjinia femërore, nuset dhe është gatuar dhe pjekur buka për dasmën. Gatimin e parë zakonisht e ka bërë nusja më e

re në familje, ndërsa diku edhe ndonjë vajzë “gati për tu martuar” që ta zë maja dhe të martohet.

Dita e enjte është ditë kur dërgohet fustani i nusërisë dhe këna (boja, prandaj njerëzit që i dërgojnë dhuratat quhen bojaxhi) në shtëpinë e nuses. Diku në këtë ditë dërgohet edhe çeji (prijeto, mirazot, paja) i nuses në shtëpinë e dhëndrit.

E shtuna është ditë e nuses. Atë e bëjnë gati kushërirat dhe shoqet e saj. Në mbrëmje shërbehet darkë, ndërsa mandej i ja ngjyrosin me këne flokët dhe thonjtë dhe e dërgojnë të flejë për herë të fundit në shtëpinë e saj. Në mëngjes para zbardhjes së ditës e zgjojnë dhe e dërgojnë të mbush ujë për herë të fundit në shtëpinë e të atit dhe të ëmës.

Të dielën në mëngjes tek dhëndri është mbledhur farefisnia, dhëndrin e kanë ulur jashtë në oborr i kanë shtruar qilim të endur sipas mundësisë të bardhë dhe aty e kanë rruar me brisk.

Pasi do të mblidhen krushqit (svatovite), ata janë nisur për ta marrë nusen. Në Shqipëri dhe Kosovë dhëndri ka qëndruar në shtëpi dhe nuk ka shkuar me krushqit. Nëna e dhëndrit-vjehrra (svekrvata) ka qëndruar në shtëpi. Për krushk zakonisht është shkuar në këmbë, nëse nuk është bërë fjalë për ndonjë vend më të largët, dhe janë kthyer në këmbë, por nuk kanë guxuar nëpër rrugën e njëjtë. Para se të arrijnë deri në shtëpinë e nuses është dërguar ndonjë djalë që ti lajmëroj se vijnë krushqit, për çka djali ka marrë “myzhde”. Farefisët e nuses në krye me atin e saj i presin krushqit të radhitur në varg. I vendosin zakonisht në oborrin e shtëpisë, në dy konake grash dhe burrash. Pasi krushqit (babai i nuses dhe babai i dhëndrit) e pinë sherbetin me duar të kryqëzuara, të gjithë krushqit “sajdisen” d.m.th. luajnë nga një valle si heqës të valles. Edhe në konakun e grave krushqit sajdisen. Midis krushqve ka edhe një bash krushk, e cila është hallë ose gjyshe e dhëndrit, e cila nënës të nuses i jep pogaçe, por edhe kujdeset për nusen kur e marrin nga shtëpia e saj. Para se të largohen krushqit, nusja nxirret para derës të shtëpisë nga vëllezërit ose farefisi më i afërt. Aty përshëndetet me farefisën dhe miqtë, ndërsa mandej ju puth dorë krushqve të cilët me rend vijnë te ajo. Nusen vëllezërit ose farefisët më të afërt e nxjerrin 20-30m jashtë nga shtëpia, ku e presin dhëndri dhe kunati, dhe aty e marrin nusen. Vjehri hedh oriz, sheqerka dhe pare pas çiftit. Në Kosovë nusen e shoqëron daja i saj dhe e vendos në veturë, sepse ajo nuk guxon të shkelë në tokë nga pragu i saj deri në pragun e shtëpisë të dhëndrit, ku përsëri e shoqëron daja i dhëndrit. Nusja guxon të qaj derisa e mbajnë njerëzit e saj, kur e merr dhëndri dhe farefisët e tij (daja) ajo nuk qan më.

Para shtëpisë nusen e pret vjehrra. Në Kosovë pasi dhëndri nuk shkon me krushqit, ai e pret nusen në shtëpi, por kur afrohet e shikon prej

së largu nëpër unazë. Vjehrra i jep nuses sherbet që tre herë ta lyej pragun. Mandej i vendos dy bukë nën sjetull dhe një bukë mbi kokë, dhe duke e kaluar pragun nusja me këmbën e djathtë duhet të derdh gjym plot me ujë. Mandej nusja dërgohet te oxhaku dhe tre herë i ja kanë rënë kokën në oxhak. Dhëndri i ja heq duvakun dhe me qese tri herë i ka rënë në kokë. Mandej nusja ulet në karrige dhe në prehër i ulet djali i vogël. Në Maqedoni vjehrra i ja lan nuses këmbët. Ndërsa në Shqipëri, një djalosh 7 vjeçar nga këpuca e djathtë i ka nxjerrë dhe i merr të hollat, djalosh tjetër ia merr shaminë nga krahu.

Nuses i ka dhuruar vjehrra një shami tjetër. Deri në mbrëmje nusja krejt kohës ka heshtur dhe ka nusëruar (guveela). Në mbrëmje nusen e kanë dërguar në dhomën e pagatitur për ta. Dhëndri pasi i është kënduar dova ju ka puthur dorë më të moshuarve dhe me vrapim ka ikur në dhomë tek nusja që të pranoj më pak të rëna në shpinë. Pasi i kanë mbyllur të rinjtë pas dere fëmijët ose të rriturit kanë parë nga dera dhe e kanë vënë veshin në derë që të dëgjojnë, me qëllim që fëmija mos jetë e verbër ose i shurdhët. Në mëngjes, patjetër ndonjë nga gratë më të moshuara ka hyrë e para në dhomë që të kontrolloj a ka qenë nusja virgjëreshë. Nëse ajo nuk ka qenë, atëherë ka mundur edhe të kthehet tek prindërit e saj me flokë të prera, e hipur në gomar mbrapsht, me qepë, ndërsa diku edhe me pogaçe me vrimë në mes. Në disa raste është kërkuar që babai i nuses ti mbuloj harxhimet e dasmës. Por nëse nusja ka qenë virgjëreshë, atëherë është bërë aheng i vërtetë, janë djegur këmisha, ndërsa dy më të afërt kanë shkuar tek prindërit e nuses që tju dërgojnë “haber” për çka kanë fituar edhe këmisha nga nëna e nuses.

Në Kosovë në mëngjes nusja është dërguar të mbush ujë nga tre bunarë, duke e përcjellë me muzikë me defa.

Pas dasmës tezet, hallat dhe gratë e tjera të fisit të dhëndrit i kanë dhënë nuses sitë, të gatuar, të bëjë petulla, me qëllim kanë derdhur kafe, sheqer etj. që nusja të pastroj, me qëllim që të shihet sa është nusja e aftë.

Të shtunën një javë pas dasmës, prej dhëndrit shkojnë në shtëpinë e prindërve të nuses për “prviçe” (vizita e parë që i bëhet nuses). Ahengu atje zgjat deri në çastet e hershme të mëngjesit. Këtë vizitë (prviçe) prindërit e nuses e kthejnë d.m.th. vijnë tek prindërit e dhëndrit pas një jave. Me “prviçe” mbarojnë doket dasmore.

## Doke gjatë synetit

Syneti tek fëmijët mysliman tek Egjiptianët bëhet në moshë prej 3-7 vjet, në vitin tek nga mosha e fëmijërisë.

Syneti paraqet ritual prerjeje të majës së lëkurës të organit seksual të meshkujve. Kjo ceremoni fetare ka qenë e njohur edhe në Egjiptin e Vjetër, që ka dëshmi mund të shihen edhe në disa vizatime të piramidave, për atë shkruan edhe Herodoti<sup>339</sup>, por edhe Bibla<sup>340</sup>. Në disa pjesë të Afrikës, para së gjithash në Sudan janë prerë dhe prehen edhe organet seksuale femërore d.m.th. klitoris.

Që të bëhet fëmija synet janë konsultuar familjet e të dy anëve edhe e nënës edhe e babait. Caktohet numri i mysafirëve të ftuar. Ftesa për Synet kryhet njëloj sikur edhe për dasmë, djalosh me sheqerka, një javë para synetit. Sot syneti praktikohet të bëhet më herët, ndërsa ahengu më vonë në ndonjë restorant.

Më parë Syneti ka filluar ditën e enjte. Kanë ardhur më tepër persona nga gjinia femërore e familjes ta rregullojnë-zbukurojnë krevatin e fëmijës. Të premtën është shkuar për “aheng” d.m.th. ardhje e mysafirëve të ftuar.

Për synet më parë më të afërmit kanë blerë dash me brirë. Nikoqiri i ka pritur me sheqerka dhe raki, duke uruar me fjalët: “Për ajër të jetë gëzimi edhe për dhëndërr të mbërrijmë”.

Dashi që është dhënë për synet ishte i ngjyrosur me ngjyrë të kuqe në brirë të varura dy molla dhe me pasqyre në ball. Zbukurimet e tilla sipas besimit popullor simbolizojnë: molla-bekim, pjellë dhe lumturi, pasqyrja-ardhmëri të pastër, rreze ndriqese dhe ngjyra e kuqe-liri dhe sukses.

Të shtunën pasdite fëmija është veshur me rroba solemne, me kapele dhe me muzikë shëtit deri në ndonjë vend. Pas kthimin nga shëtitja, fëmija është dërguar në dhomë speciale për synet. Muzika është ndaluar, ndërsa brenda në dhomë janë vetëm meshkuj. Dikush ka kënduar pjesë nga Kurani (Tegapir dhe Salavati sherif). Kur është dëgjuar fjala “Amin” d.m.th. syneti është kryer dhe përsëri ka filluar muzika. Synetin e ka kryer berberi, por në kohë më të re kryhet në qendra medicinale nga mjek.

<sup>339</sup> Herodot, II/36.

<sup>340</sup> Dhjata e Vjetër profet Jezekiil, nr.32/18.



Pas syneve jepet darkë, ndërsa mandej ka edhe aheng. Krejt mysafirët kanë shkuar në krevatin e fëmijës dhe i kanë dhuruar dhurata dhe të holla.

Ditët e tjera fëmijën e kanë vizituar edhe farefisi më të largët të cilët nuk kanë qenë të ftuar, si dhe miq dhe fqinjë, të cilët gjithashtu i japin dhurata.

## **Doke gjatë vdekjes**

Besohet se nëse galat shumë rrinë në ndonjë shtëpi ose nëse çukapiku në afërsi të shtëpisë çukit në dru, se dikush do të vdes. Gjithashtu nëse qeni vetë ulërin atëherë do të ndodh vdekje.

Nëse dikush është rëndë i sëmurë, atëherë është therur edhe kurban, që është ndarë në ditët e premtë për njerëzit e varfër me besim se i sëmuri do të shërohet. Besohet edhe në fuqinë e ujërave të shenjta “ujëra të kënduara”, se mund ta shërojnë të sëmurin. Por, kur shumë vështirë i sëmuri nuk mund të lëshoj shpirt, besohet edhe në fuqinë e të ashtuquajturave “uji për të përzënë” (voda poterica), që merren nga disa vende specifike.

Kur dikush ka vdekur, menjëherë janë marrë masa, së pari të rregullohet i vdekuri-tek myslimanët vendoset në dyshek, me çarçafë më të bukur, dhe i mbuluar me mbulesa më të bukura. Është vendosur ashtu që me krahun e djathtë të jetë i kthyer kah “Qabja” d.m.th. Meka. Tek krishterët i vdekuri vendoset në drejtim lindje-perëndim dhe atë me kokën në perëndim ndërsa këmbët në lindje, i shtrirë në sandëk.

Pasi e kanë rregulluar të vdekurin, është lajmëruar farefisnia, miqtë dhe fqinjët. Tek ortodoksët ” kambana” ose “klepala” ka dhënë lajmërim se dikush ka vdekur, ndërsa tek myslimanët hoxha nga minarja ka lajmëruar se dikush ka vdekur, edhe kohën për varrimin.

Tek myslimanët nëse personi ka vdekur në orët e hershme të mëngjesit, diku deri në orën 8, varrimi ka qenë ditën e njëjtë. Ndërsa nëse ka vdekur rreth drekës dhe më vonë varrimi ka qenë ditën e ardhshme. Tek krishterët rregull është që i vdekuri duhet të kalojë një natë në shtëpi. Në kohë më të re Egjiptianët nga Maqedonia dhe Kosova, për shkak se kanë numër të madh njerëz të shpërngulur në vendet e Evropës perëndimore, nëse ka vdekur babai ose nëna, pritët që djali ose vajza të vij me aeroplan, prandaj kjo edhe tek myslimanët më në masë të madhe bëhet rregull që i vdekuri të kalon një natë në shtëpi.

Në shtëpinë e të vdekurit vijnë farefisi, miq, fqinjë, menjëherë pasi marrin vesh për vdekjen. Myslimanët nuk dërgojnë asgjë, ndoshta më të

afërmit kafe, sheqer, cigare, leblebia të cilat jepen për shpirt, e tju ndihmohet njerëzve të shtëpisë në kuptim material, që ti shërbejnë njerëzit që vijnë për ngushëllim dhe për ta ruajtur të vdekurin. Tek krishterët njerëzit qojnë temjan dhe barëra të tjera, qiri të cilat ndizen dhe vendosen mbi kokën e të vdekurit. I vdekuri tek ata nganjëherë është edhe i zbuluar, ndërsa tek myslimanët nuk guxon të jetë i zbuluar.

I vdekuri ruhet tërë natën (bdeenje), njerëzit janë të zgjuar dhe kujdesen që rastësisht ndonjë macë ose qen mos kërce mbi trupin, sepse besohet se i vdekuri mund të bëhet vampir.

Ceremonia e varrimit, zakonisht fillon pasdite me ardhjen e hoxhës tek myslimanët dhe priftit tek krishterët. Hoxha e lan të vdekurin në dhomë të veçantë nëse është mashkull, ndërsa nëse e vdekura është femër atëherë larjen e kryejnë gra të stërvitura për atë. Tek krishterët larja është bërë menjëherë posa ka vdekur, ndërsa nëse është mashkull menjëherë edhe e kanë rruar.

Masë për varrimin është varri, ndërsa tek krishterët për sandëkun merret nga personi i vdekur me pe.

Tek myslimanët pas larjes hoxha e mbledh xhematin (njerëzit, bashkësinë) dhe pyet a i është bërë “hallall” të vdekurit që të shkoj në atë botë para Allahut, tre herë, ndërsa njerëzit tre herë përgjigjen ”hallall”. Mandej i vdekuri mbahet në krahë, i vendosur në sandëk prej druri të pa mbuluar (tabut). I vdekuri është i mbuluar me pëlhurë të gjelbër në të cilën të qëndisura janë citate nga Kurani. Varrimi kryhet sipas rregullave islame, ashtu që i vdekuri vendoset në tokë pa sandëk (tabut) i mbuluar me pëlhurë të pa qepur, ndërsa me krahun e djathtë i kthyer kah Meka. Tek krishterët i vdekuri vendoset në sandëk, xhemati (pogovorkata) ndalohet në disa herë (në udhëkryq, prona te të vdekurit, ose vende kult). Në vendin ku i vdekuri ka qëndruar i shtrirë në shtëpi mbërthehet gozhdë. Pasi largohet xhemati (pogovorkata) gjithë uji nga shtëpia është derdhur, ndërsa është mbushur ujë i ri. I vdekuri dërgohet në kishë, mandej në varreza. I vdekuri varroset në sandëk i veshur në rrobat më madhështore ose në kostum. Gratë zakonisht janë varrosur me fustanin e nusërisë, nëse ende e ka pasur të saktë.

Pas varrimit shkohet në shtëpinë e të vdekurit për shpirt, tek myslimanët këndohet Qelemeteyt ose Jasin, shërbehet darkë, ndërsa pas darkës tepsi me hallvë dhe përsëri këndohet lutje fetare. Tek krishterët, shkohet për ngushëllim, njerëzve ju epet darkë, ndërsa mandej largohen të gjithë.

Pas varrimit farefisi më i afërt ngelin të flenë prej 3-7 ditë. Të nesërmen pas varrimit shkohet në vizitë te varri dhe personit të vdekur i

këndohet lutje fetare. Në shenjë zie gratë (myslimane) më parë kanë mbajtur shami të bardha ndërsa tani më tepër me ngjyrë kafe të errët. Shamitë mbahen 40 ditë ose 6 javë, më të afërmit, prej 6 muaj deri një vjet. Meshkujt më së tepërmi të krishterë nuk janë rruar në shenjë zie. Herodoti ka shkruar se në rast vdekjeje popujt e tjerë i kanë qethur kokat, ndërsa Egjiptianët kanë lëshuar tju rritet mjekra dhe flokët, ndërsa deri atëherë janë qethur dhe rruajtur<sup>341</sup>.

Për shpirt është bërë 7 ditë, çdo natë, ndërsa tani praktikohet 3 ditë, por përsëri nata e 3-të quhet të shtatat (sedumte veçeri). Këndohet lutje fetare. Mevlud dhe ilahi, ndërsa jepet darkë. Farefisi më i afërt i të vdekurit e përgatisin darkën në harxhim të vetë, ashtu që është planifikuar që çdo natë harxhi të jetë i mbuluar nga shtëpi të ndryshme, nëse për atë ka pasur dëshirë nga farefisi. Për shpirt është bërë 40ditë (6 javë), 6 muaj, 1 vjet ose 3 vjet. Në gjithë këto ditë këndohet lutje fetare dhe shërbehet darkë për hatër të personit të vdekur.

\*\*\*

Në doket nga ciklusi i jetës tek Ballkano Egjiptianët mund të themi se të pranishme janë edhe doket rituale magjike-apatropeike që sigurohet mirëqenie, mbrojtje nga forcat e këqija, pjellshmëri (fertilitet) dhe mëshirë e Zotit. Kjo para së gjithash në doket gjatë lindjes, syetit dhe dasmës.

Tek popujt Ballkanik, e sidomos tek Ballkano Egjiptianët në ceremonitë fetare dhe doket i madh është përdorimi i numrave 3, 7 dhe 40.

Numri 3 është universal, paraqet natyrë numërore të botës-qiellit, tokës dhe ujit. Ajo është njeriu-trupi, fryma dhe shpirti; lindje, jetë dhe vdekje; Fillim, mes dhe fund; E kaluar, e tashme dhe e ardhme; Tre është numër qiellor. Bashkë me numrin 4 formojnë shtatë, ndërsa 3 shumëzuar me 4 jep 12, që paraqet muajt e vitit (**Lampić, M.** 1999: 15), numër i zotrave në mitologjinë egjiptijane<sup>343</sup>, shenjat e Zodiakut. Gati gjithë religjionet botërore kanë trijadë, trijada Egjiptiane Oziris, Izida dhe Hor ka qenë e krijuar ngjashëm si familja njerëzore: baba, nënë dhe djalë (**Приор, Ж.** 1993: 121). Në Egjipt të Vjetër ajo është simbol i tre rajoneve kozmike: Qiell- me të cilin sundon Amon Ra, Tokë- me të cilën sundon faraoni dhe Nëntoke (botë pasvarrore) me të cilin sundon Ozirisi (**Божовиќ, Р.** 1996: 158). Edhe krishterimi e pranon trijadën: Baba, Djalë dhe shpirt i shenjtë.

<sup>341</sup> Herodot, II/36

<sup>343</sup> Herodot, II/82,

Numri shtatë-është numër i gjithmirësisë dhe makrokosmosit. Simbolizon plotësi dhe përgjithësi. Numër i parë që e ka mbajtur shpirtësinë dhe shenjtësinë, sepse me qiellësinë dhe shpirtin, si numër tre dhe toka dhe trupi si numër 4, përbën bashkim. Përsosshmëri, sigurim, pjesëmarrje në krijimin, begati, reintegrim dhe sintezë (*Lampiç, M. 1999: 17*). Në mitologjinë Egjiptiane të shtatë vajat e Ra kanë bërë 7 nyje në 7 fustanet (që i kanë veshur në Rome femrat), të shtatë petritët e Ra janë të shtatë dijetarët, shtatë lopë me dem tregojnë pjellshmëri, shtatë shtëpi ka në botën e poshtme, ndërsa tre herë nga shtatë dyer. Shtatë është numri i kushtuar Ozirisit (*Lampiç, M. 1999: 18*). Numri shtatë është prezent edhe në krishterimin. Zoti e ka krijuar botën për 7 ditë, mandej 7 mendohet në Krishtin në kryq, 7 lumturi, 7 dhimbje, 7 mendime të Shënmerisë, Apokalipsa është vepër e numrit 7 (7 kisha, 7 vula, 7 enguj, 7 bori, 7 jaze, 7 koka të bishës). Edhe islami është i ndarë në 7 bota: e para për muslimanët, e dyta për krishterët, e treta për hebrejet, e katërta për savejët, e pesta për magjistarët, e gjashta për adhuruesit e idoleve dhe e shtata për njerëzit e dyfjyrtë (*Приор, Ж. 1993: 125-126*).

Numri 40 shënon provim (joshje). Përmbytja ka zgjatur 40 ditë. Në mitologjinë Egjiptiane Seti e ka vrarë Ozirisin dhe e ka copëtuar në 40 pjesë, të cilët i ka fshehur në 40 vende nëpër tokë, ndërsa Izidës i janë nevojitur 40 ditë që ti gjej, ti bashkoj pjesët dhe ta ringjall Ozirisin. Me të Ozirisi ka munduar 40 ditë dhe ajo ka qenë periudhë e agjërimit në Egjiptin e Vjetër. Edhe në krishterimin kreshmëritë e Krishtlindjes dhe Pashkëve zgjasin 40 ditë. Krishti ka qendruar 40 ditë në provë të Zotit në shkretëtirë. 40 ditë është edhe ringjallja e Krishtit prej Pashkëve deri në Dit Shpëtimi. Në Dhiatën e Vjetër Mojsiu 40 ditë ka qenë në pyllin Sinaj, Hebrejët 40 vjet kanë bredhur nëpër shkretëtirat. Në islamin Muhamedi 40 vjet “e ka pranuar Kuranin-shpalljen” Kurani duhet të lexohet çdo 40 ditë. Me atë numri 40 është provë, iniciacon dhe vdekje. Numër i dyshimit, përgatitjes së ngasjes ose dënimit. Si prodhim i numrit 4 paraqet plotësi dhe përgjithësi.

Për doket pas vdekjes tek Ballkano Egjiptianët vlen të përmendet si komparacion ajo se ngelja e anëtarëve të familjes të flenë në shtëpinë e të vdekurit 3-7 ditë ka reminiscencione të veta tek Egjiptianët e Vjetër dhe tek Koptet e sotshëm. Pikërisht dihet se në piramidat bashkë me faraonin kanë mbetur të gjallë në piramidat gratë dhe bashkëpunëtorët më të afërt. Tek njerëzit e thjeshtë afër varrit janë ndërtuar instalime në të cilat është kaluar nata, por edhe është jetuar që ti bëhet shoqëri njeriut të vdekur. Është besuar se me të vdekurin edhe pas vdekjes mund të komunikohet (*Божовиќ, Р. 1996: 158*).

Përshkrimi i dokeve nga ciklusi i jetës tek Ballkano Egjiptianët dhe analiza e tyre dhe elaborimi shkencor, në asnjë mënyrë me këtë punim nuk janë të shterura, as që kishim pretendim, ndërsa në të ardhmen në hulumtimet e më tutjeshme presim njohuri të tjera dhe të reja në këtë fushë.

## **DOKE NGA CIKLUSI VJETOR (KALENDAR)**

Midis Ballkano Egjiptianëve posaçërisht janë të përhapura doket festuese, përkatësisht doke nga ciklusi vjetor, të cilat për shkak të asaj që janë të lidhura me festat fetare quhen edhe doke fetare.

Për shkak se, në numër më të madh Ballkano Egjiptianët janë myslimanë së pari do të flasim për doket e lidhura me festat fetare myslimane.

Muajin i agjërimit Ramadan ose siç është i njohur gjerësisht si Ramazan, e respektojnë të gjithë myslimanët të cilët janë më të moshuar prej 15 vjet, përveç nëse nuk janë të sëmurë. Agjërimi përbëhet në atë që njerëzit përmbahen nga ushqimi, pija, larja dhe marrëdhëniet seksuale prej agimi deri në perëndimin e diellit. Prandaj në muajt verore agjërimi zgjat më tepër (edhe deri në 12 orë dhe më tepër), ndërsa në muajt e dimrit më shkurtër. Për Ramazan njerëzit vizitohen midis veti, ndërsa sevap i madh (vepër e mirë, që vlerësohet nga Allahu) është të shkohet te ndonjë për iftar (fund i agjërimit të një dite dhe mund të hahet dhe pihet), ndërsa nikoqiri të mos e pres atë gjë. Ajo vlerësohet sepse nikoqiri nuk do të ketë përgatitur asgjë, por do të han atë që ka. Në mbrëmje gjithashtu shkohet nëpër shtëpi për vizita dhe bisedohet për tema në lidhje me agjërimit dhe fenë islame.

Agjërimi zgjat 28 ditë (sipas kalendarit lunar 4 shumëzuar me 7) dhe atë deri në festën Ramazan Bajrami, që festohet tre ditë. Ditën e parë burrat shkojnë në xhami për ta falur Bajramin, mandej i vizitojnë varrezat, dhe kthehen në shtëpi, ku të gjithë midis veti e urojnë festën. Urimin e bëjnë më të rinjtë më të vjetërve me radhë, me puthjen e dorës. Fëmijëve ju dhurohen të holla. Pas drekës të madhe, vizitohen fafëfisnia më të afërt, duke filluar nga më të vjetrit (gjysh, gjyshe, xhaxha, dajë, teze, hallë etj.). Më të vjetrit ditën e parë qëndrojnë në shtëpi që të presin mysafirë, ndërsa ditën e dytë dhe të tretë edhe ato shkojnë nëpër shtëpitë e tjera të familjes. Për festën e Bajramit në vizitë vijnë edhe miq, fqinjë nga feja e krishterë.

Shtatëdhjetë ditë pas Ramazan Bajramit është Kurban Bajrami kur theret dash, ndaj edhe festa quhet Kurban Bajram. Kurban ndahet në tre

herë nga tre pjesë d.m.th. nëntë pjesë. Gjashtë pjesë d.m.th. dy herë nga tre pjesë ju epen familjeve të varfra ose farefisit, ndërsa tre pjesët e tjera mbahen për vete. Nëse familja është e pasur edhe pjesa e tretë ju epet të varfërve. Lëkura e Kurbanit thahet dhe dërgohet në xhami ose teqe dhe shërben si shtresë gjatë faljes. Për Kurban Bajram, persona të caktuar (më të pasurit) shkojnë në haxhillëk në Mekë dhe Medinë. Ceremonitë dhe doket edhe për këtë Bajram janë të njëjta si edhe për Ramazan Bajram, ndërsa Kurban Bajrami festohet 7 ditë.

Nga festat islame vlen të përmendet edhe festa Sulltan Nevruzit më 25 mars, 10 ditë pas festës Ditë Vere (marts), kur përgatitet asher (ashur) misër i zier me qumësht dhe rrush të thatë, që shpërndahet nëpër farefis dhe fqinjë.

Festat e tjera myslimane, që kanë prejardhje nga paganizmi dhe krishterimi, mund të ndahen në dy cikluse në ato nga nënciklusi veror dhe ato nga ai dimëror. Ditët kufitare midis këtyre dy nëncikluseve janë Shëngjergji (6 maj) dhe Shënmitri (8 nëntor).

Që të shënohet kalimi prej dimri në verë, festohet Shëngjergji (Erdelezi) me dëshirë për shëndet, verë të mirë, punë të mbarë dhe bereqet. Atë ditë sipas rregullit është therur qengji, ndërsa ai që ska pasur mundësi ka blerë mish qengji. Qengji është pjekur edhe në furrë. Për këtë ditë diku përgatitet edhe pogaçe ceremoniale “qai”. Besohet se vesa e mëngjesit për Shëngjergj është mjekuese dhe prandaj disa edhe janë rrokullisur nëpër bar për atë ditë. Në mëngjes fëmijët lahen për shëndet, ndërsa diku edhe luhaten në dru të fortë (thanë, arrë, gështenjë etj.), që fëmijët të jenë të shëndoshë si thanë. Në ujën në të cilin lahen fëmijët në Kosovë janë shtirë vezët nga Pashkët që jua kanë dhënë ortodoksët, ndërsa janë shtier edhe të holla prej metali dhe bar i këputur. Në disa shtëpi janë vënë dega të gjelbërta dhe hithër në prag. Nëna simbilokisht i ka rrahur fëmijët me hithër që të jenë të shëndoshë si hithra. Egjiptianët nga Kosova për atë ditë kanë ngrënë vetëm bukë të thërrmuar me qumësht, nuk kanë shkuar për urim dhe nuk kanë therur qengj. Në ditën e tretë të Shëngjergjit të cilën në Kosovë e quajnë “Dita e Shmarkut”, është shkuar në Tyrben e Muratit në Obiliç, ku gratë sterile kanë shkuar me lutje që të mbesin shtatzëne, ndërsa të pamartuarat të martohen. Atje shkohet tre herë rreth varrit të tyrbes, gratë sterile ngrenë një gur dhe pinë ujë “mjekues”. Besohet se kjo tyrbe ka edhe fuqi mjekuese, ndaj gratë i vendosin këmbët në tyrben që mos t’ju dhëmbin më. Diçka e ngjashme kryhet edhe në Ohër, ku shkohet në Tyrben Sinan Çelebi, përkatësisht në Imaret, por një ditë para Shëngjergjit. Atje ndizen qiri mandej ulen në livadhin ku hanë bukë ceremoniale “qai” me djathë. Vajzat

e pamartuara kanë shkuar rreth kishës të shembur Sh.Pantelejmon, e cila më vonë është rindërtuar në xhami.

Për Egjiptianët nga regjioni Ohrijan-Prespian, domethënie e madhe është festa Sh. Naum (Sv. Naum) që festohet më 3 korrik. Të gjithë Egjiptianët në këtë festë shkojnë në manastirin rreth liqenit të Ohrit, në burimet e lumit Drini i Zi. Besohet se Shën Naumi ka qenë me prejardhje nga kjo bashkësi etnike, ndërsa vërtetim për këtë njerëzit gjejnë në atë që në freskën “svetite sedumçislenici” nga ana e majtë të hyrjes në kishën, vetëm Shën Naumi është i pikturuar me ngjyrë të errët të lëkurës. Shën Naumi ka jetuar në shekullin e nëntë dhe ka qenë një ndër nxënësit e Shën Kirilit dhe Metodij, e ka ndërtuar manastirin e tij në Liqenin e Ohrit dhe ka vdekur në vitin 910. Besimit se Shën Naumi ka pasur prejardhje nga bashkësia e Ballkano Egjiptianeve njerëzit shpjegim të tyre gjejnë edhe në atë se vetëm Egjiptianët, si myslimanë e festojnë këtë të shenjtë, dhe japin dhurata të mëdha, por edhe këmbana<sup>350</sup>. Por, Egjiptianët janë edhe më të numërtë në fjetjen në oborrin e manastirit Shën Naum për këtë festë. Ata atje kanë edhe konak të tyre-Egjupana, atje hanë, argëtohen dhe flejnë<sup>351</sup>. Egjiptianët për shëndet bëjnë nijet qengj, e rrotullojnë tre herë rreth kishës, duke e mbajtur në dorë, me muzikë (surle ose klarinetë dhe daulle), ndezin qiri hyjnë deri në varrin e Shën Naumit, falen por nuk kryqëzohen, dhe dalin jashtë nga kisha duke ecur mbrapsht deri në dalje.

Sh. Marena e cila sipas besimit llogaritet si motra e Sh.Naumit gjithashtu festohet nga Egjiptianët në Pogradec dhe Korçë. Atëherë shkohet në manastirin Sh. Marena më 28 korrik-Shënmëri.

Shën Mëria është gjithashtu një festë kulturore për Ballkano Egjiptianët në Maqedoni. Festohet me ahkuarje, vallëzim dhe fjetje në manastirin Sh.Mëri Virgjër në Kërçovë, si dhe në manastirin Sh.Mëri në Kalishtë. Ndërsa Egjiptianët nga Kosova, në Shën Mëri më 28 gusht, shkojnë dhe e vizitojnë manastirin Sh.Mëri në Graçanicë.

Shën Mitr (8 nëntor) llogaritet për fillimin e dimrit. Shënohet si kult me çka përgatitet drekë e pasur, në të cilën duhet të ketë 3 lloje ushqimi, e sidomos sarma, që dimri të kalohet në të ngrohtë, “të mbuluar si sarma”.

Buzmin tek një pjesë e Egjiptianeve me fe myslimane e festojnë si një lloj tradite, sidomos në Kërçovë. Zihet misër dhe kungull, blihet bozë,

<sup>350</sup> Për listën e njerëzve të cilët kanë dhuruar në manastirin Sh.Naum shiko: Naum Celakoski, Sveti Naum Ohridski çudotvorec, Shkup, v.1997

<sup>351</sup> Ndoshta edhe ky dok për argëtim dhe fletje ka rrënjë të veta nga Egjipti i Vjetër, kur është shkuar në qytetin Bubastis për çka Herodoti (II/60,) do të shkruaj:”Kur arrinë në Bubastis, nderojnë duke flijuar kurbane të mëdha. Në atë solemnitët harxhohet më tepër verë vreshti sesa gjatë tërë vitit...”

ndërsa në tavolinë (sofër) vendosen arrëza, gështenja, molla etj. si dhe misër i zier. Në Kosovë Egjiptianët që janë me fe myslimane gjithashtu e kanë ruajtur si kult. Ata thonë se Krishtlindja festohet për mirëqenie dhe bereqet.

Domethënie e posaçme për Ballkano Egjiptianët është festa Sh. Atanas, më 30 dhe 31 janar. Më 29 janar doemos është blerë gjel, i cili është dashur të kaloj natën në shtëpinë dhe të këndoj në mëngjes. Është therur më 30 janar dhe është përgatitur darkë e pasur. Në sofër janë vënë tre pogaçe, më e madhe, e mesme dhe më e vogël, njëra mbi tjetrën. Në to janë vendosur tre qirinj dhe janë ndezur. Me misër të zier ose oriz janë bërë tre rrethe me duar rreth pogaçeve duke i lëshuar kokrrat si shi, me fjalët “për shumë vjet, të jemi gjallë e shëndoshë, deri në vitin e ardhshëm më mirë dhe me më tepër bereqet”. Shën Atanasi në Ballkan është e njohur si festë e farkëtarëve, hekurtarëve, punuesve të thikës dhe nabatët (**Бенина-Маринкова, В., Паприкова-Крутилин, З., Антонова, З.** 2000: 7). Kjo festë e ka marrë emrin sipas peshkopit të Aleksandërit, Atanasije i Madh (295-373) kundërshtar i madh i erezit arian, i cili nga cari Konstantin dhe trashëgimtarët e tij ka qenë tre herë i persekutuar. Atanasije ka predikuar për fenë dhe kapjet e eremitëve egjiptian dhe është bërë simbol i vetë-refuzimit dhe rreptësisë krishtere (**Enciklopedija živih religija**, 1992: 62-63). Kult i madh ndaj Anastasijes tek Ballkano Egjiptianët udhëzon në mundësi se ata e kanë pranuar mësimin monofizit të shkollës Aleksandrike, kur janë krishterizuar.

Ditë Vera (mars) e cila ka qenë më 15 mars gjithashtu është festë nga paganizmi e cila festohet shumë tek Ballkano Egjiptianët. Një ditë para, fëmijët shkojnë të mbledhin kukurek dhe të presin dega prej thane. Në mëngjes çdokush merr nga një fiq brenda vendos lule prej thanës dhe i han. Nëna në mëngjes merr degë prej thane dhe simbolikisht i rreh fëmijët (“që të jenë të shëndoshë si thanë”). Një ditë para është përgatitur pogaçe, në të cilën është shtirë pare. Ditën e Verës pogaqja është prerë në aq pjesë sa ka anëtar në familje. Sipas besimit atë vit më i lumtur do të jetë ai të cilit do ti ketë rënë parja. Për drekë ahët petë, lakror (komad, pita) me vezë dhe kos, si dhe fasule me mish.

Këto ishin disa nga doket më të rëndësishme nga ciklusi i kalendarit, dhe prezantuar vetëm ato që ishin më karakteristike, pas asaj që i festojnë myslimanët ndërsa llogariten si festa krishtere ose parakrishtere. Doket nga ciklusi i kalendarit tek Ballkano Egjiptianët me fe të krishterë, janë të ngjashme me ato nga popullata krishtere e rrethit në tërë Ballkanin.



## DOKE NË LIDHJE ME PUNËN

Ballkano Egjiptianët vëmendje të madhe ju kushtojnë dokeve të lidhura me mundin, ndërsa në lidhje me veprimtarinë e lloj llojshme ekonomike. Midis tyre bënë pjesë ato në lidhje me dhënien “hallall”, argatim, huazim dhe lloj tjetër borxhesh, kaparimi, shit-blerja, ortakimi, tregtimi, këmbimi etj. Një pjesë nga këto doke, sipas sistematizimit të tyre ishin të përfshira në drejtësinë më të vonshme tregtare.

Tek ata që janë marrë me bujqësi nga doket më të përhapura ishin lëvruarit dhe korrësit. Gjatë lëvrimit mjaft është kujdesur që të filloj pas një shtatorit dhe të mbarohet diku rreth 15 shtator. Në lëvrimin e parë të arës është shkuar me veshje festuese, me brinjë të stolitura të kive. Mbjellësi është përmbajtur nga marrëdhënie seksuale, është çuar herët, është veshur në rroba të pastra dhe është përpjekur të mbërri në arë deri në agim, çka është kujdesur që mos i ja pres dikush rrugën ose të takohet me dikë që ka “sy të këqija”. Doket korrëse, gjithashtu kanë qenë të pasura dhe të lloj llojshme. Është guxuar të korret të hënë, të mërkurën ose të enjten. Korrjen është dashur ta filloj personi me të ashtuquajturën “dorë të lehtë”. Doke ka pasur edhe gjatë bartjes të duajve deri në lëmë, shirjes, hedhjes etj.

Shumë të përhapura kanë qenë edhe doket të lidhura me ndihmë reciproke të njerëzve për punët e bujqësisë.

Ndihmë të njerëzve ka pasur edhe për ndërtimin e shtëpive, prerje dhe përgatitje të materialit ndërtues ose bartje gurësh. Ndihmë sidomos është dhënë gjatë hedhjes së themeleve dhe vënien e çatisë.

Kategori të veçantë dokesh kishin zanatçinjtë dhe esnafet e tyre. Ata ishin në lidhje me pranimin e çirakëve në punë, përparimin e tyre në kallfa, ndërsa të kallfëve në mjeshtëri.

Te farkëtarët të cilët janë myslimanë, nuk mund të vërehet ndonjë kult ndaj kurdhit ose vatrës, përveç që kallfa ose çiraku duhet në mëngjes doemos ta pastrojë krejt farkëtarinë, para se të vij mjeshtri në punë.

Tek farkëtarët vërehet ndalim punimi të premtën (në xhuma), para faljes dhe gjatë faljes të xhumasë. Atëherë besimtarët më të mëdhenj shkojnë në xhami, ndërsa të tjerët rrinë pranë farkëtarisë dhe nuk punojnë deri sa të mbaroj falja e xhumasë. Farkëtarët thonë se “nuk bën të punohet në kohën e “xhumasë” sepse ajo paska qenë mëkat ndaj Allahut, dhe në të kaluarën një farkëtar ka punuar në kohën e “xhumasë” dhe ka mbetur pa dorë”<sup>354</sup>.

<sup>354</sup> Informues Bajram Mustafa-Krosi.

Ndalim i ngjashëm ekziston edhe për atë se mund të punohet derisa ka diell, ndërsa mandej është kot të punohet sepse hekuri nuk mund të zie<sup>355</sup>. Më siguri kulti ndaj Diellit si burim i energjisë tek farkëtarët ende jeton nëpërmjet këtij ndalimi.

Në doket nga puna mund të llogaritet edhe ndarja e objekteve ekonomike publike (si mulli, mal etj.) të cilat janë përdorur në periudhë të përcaktuar sipas orari të caktuar më herët.

Edhe tek Ballkano Egjiptianët është paraqitur kurbeti si dukuri, sidomos tek ata nga Maqedonia dhe Kosova. Më parë ka pasur një varg dokesh në lidhje me ikjen në kurbet, qëndrim në vend të huaj dhe kthimin pas.

Secila nga doket e lidhura me punën (mundin) kishte domethënie të vetë konkrete. Me kurbanin mbrohej nga anatema (fatkeqësia) eventuale ; me borzilok dhe citate nga Kurani janë larguar hijet e këqija, me hudhër janë neutralizuar sytë që marrin mësysh etj. Edhe vënia potkua mbi derën hyrëse të shtëpisë së re ose në pragun e shitores, kishte për qëllim të sjell fat.

## **DOKE DREJTËSIE**

Doket lidhur më Drejtësinë tek Ballkano Egjiptianët ka traditë të gjatë. Ato janë zbatuar në praktikë sidomos në periudhën kur njerëzit rrallë janë përcaktuar ta kënaqin drejtësinë mbi bazë të aktdënimit të sjellë nga kadi të ryshfetur në periudhën Osmane, por edhe gjatë shteteve ballkanike mesjetare.

Në fshatrat ku kanë jetuar pjesëtarë të Ballkano Egjiptianëve drejtësia e dokeve është rregulluar në të ashtuquajtura gjyqe fshatare dhe popullore. Në përbërjen e tyre në mënyrë demokratike dhe atë më së shpeshti para gjykimit, janë zgjedhur fshatarët më autoritarë. Gati në të gjitha kontestet farkëtarët kanë qenë anëtarë të këtyre gjyqeve popullore, bashkë me kryeplakun dhe priftin ose hoxhën. Është gjykuar publikisht para të gjithë fshatarëve. Aktdënimet janë sjellë mbi bazë rregullash të pashkruara të pranuar nga sistemi i dokeve të drejtësisë, të mbledhura nga përvojat shekullore. Në fshatrat në të cilat ka jetuar popullatë myslimane ndikim të madh ka pasur sheriatit përkatësisht drejtësia sheriata.

Gjykimi ka filluar me nxjerrjen e dëshmimeve, me qëllim të vërtetohet a është i akuzuari fajtor ose jo ajo është kryer me gojë, me zë dhe me pyetje të dëshmitarëve, të cilët janë betuar në Allahun (Gospod) dhe betime të tjera. Prandaj gjykimi në masë të madhe nuk është varur nga faktet por nga një

---

<sup>355</sup> Njësoj.

lloj fati. Vetë-pranimi i fajit është llogaritur si dëshmi më e fortë, por edhe është caktuar dënim më i vogël.

Në procedurën dëshmuese janë shërbyer edhe me metoda të përcaktuara, si për shembull: “svod” njohje të gjësë së vjedhur ose kafshë, mandej dhënie garanci për pafajësinë e të akuzuarit, megjithatë garantë nuk kanë mundur të jenë persona të gjinisë femërore dhe të miturit. Garantët i bartin pasojat nëse më pas vërtetohet e kundërta nga vërtetimi i tyre. Betimi, është zbatuar në raste kur kanë munguar fakte ose dëshmitarë. Njerëzit janë betuar me vënien e dorës mbi Biblën ose Kuranin, në Zot, në jetën e vetë dhe shëndetin, si dhe në jetën e anëtarëve të familjes së vetë. Njerëzit vështirë kanë vendosur që rrejshëm të betohen, sepse besonin se në rast të tillë do ti ndjek fatkeqësi deri në fund të jetës.

Si procedurë dëshmuese më delikate ishte “Gjykimi i Zotit” midis të cilave më i njohur ka qenë “Mazija”. Është vendosur hekur i skuqur në ujë të zier, dhe nëse i akuzuari ka qenë i pafajshëm kur do ta ketë marrë hekurin lëkura e tij nuk do të ketë qenë e dëmtuar, që gati asnjëherë nuk ka ndodhur. Në disa vise Ballkanike persona të përcaktuar të gjinisë femërore të cilat kanë qenë të akuzuara se janë “magjistare” ose motra të djallit (shejtanit) ishin të lidhura pas njëres këmbë me litar dhe të hedhura në ujë në thellësi deri në gjë. Nëse gruaja ka qenë e pafajshme, ajo nuk do të ketë reaguuar, për shpëtimin e saj dhe do ta nxirrnin, por nëse ka lëvizur me trup dhe ka thirrur për ndihmë (që është reagim normal) ata me dhunë e kanë mbytur. Për të akuzuarit për vrasje është zbatuar metoda “rrjedhje e gjakut” ashtu që i akuzuari ka qenë i detyruar të kaloj pranë trupit të njeriut të vrarë, dhe nëse ka rrjedhur gjak nga goja e personit të vrarë, i dyshimi është shpallur si i fajshëm.

Në sferën e dokeve të drejtësisë ka bërë pjesë edhe hakmarrja me gjak dhe e ashtuquajtura heqje dorë nga hakmarrja. Gjatë hakmarrjes me gjak ka arritur që të humbin jetë numër i madh personash të gjinisë mashkullore nga të dy familjet e hidhëruara. Por në periudhë të caktuara ka ardhur deri në pajtim. Kjo posaçërisht ka qenë e pranishme në Mal të Zi, Kosovë, Shqipërinë Veriore. Hakmarrja me gjak nuk i ka përfshirë gratë.

Si dënim kanë qenë të zbatuara këto metoda: paralajmërim, turpërim publik, dënim me rrahje, rrahje me shkop, pas thembrave të këmbëve, tregim të gjërave të vjedhura në qafën e vjedhësit dhe shëtitje me to nëpër fshat, të cilët i kanë qëndruar edhe në gomar të kthyer mbrapsht. Nga dënimet më të rënda ka qenë nemi ose natema, të cilat janë deklaruar për vrasësit e vëllait ose babait. Dënime të tjera kanë qenë sakatimi, mandej prerje e veshit, gjuhës ose hundës kryesisht për gratë të cilat janë zënë duke e tradhtuar burrin. Përzënia gjithashtu ka qenë një ndër dënimet më të

rënda. Ata më nuk kanë pasur të drejtë të kthehen në bashkësinë, por nuk kanë qenë të pranuar as nga bashkësitë e tjera.

Dënimi më i rreptë ka qenë ai me vdekje. Është deklaruar shumë rrallë dhe është kryer me vrarje, djegëje, copëtim dhe gurëzim.

Disa nga veprat penale, si për shembull vjedhje më të vogla, sipas drejtësisë së dokeve janë zgjedhur edhe me paqe, pa gjykim ashtu që nëpërmjet ndërmjetësve janë kthyer ose janë zëvendësuar gjërat e vjedhura të pronarit.

## **DOKE TË TJERA**

Nga doket e tjera të cilat janë të vlefshme të përmenden janë ato me të cilat janë rregulluar marrëdhëniet e përditshme të njerëzve midis veti në familjen, sojin, lagjen etj. Me këto doke janë zgjedhur ndarja e pronës të lëvizshme dhe të palëvizshme, mandej ato në lidhje me disa veprimtari ekonomike etj.

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe doket në lidhje me premtimin, përkatësisht plotësimin e dëshirës së personit të vdekur të shprehur gjatë jetës ose amanete. Për realizim konsekuent të amanetit seriozisht është llogaritur.

Marrëdhëniet e familjes dhe sojit janë rregulluar me seri dokesh që ka qenë të detyrueshme të respektohen. Joformalisht është bërë llogari si për çdo person veças ashtu edhe për anëtarët e një familjeje, soji etj. Me ato saktë ka qenë e caktuar si dhe sipas cilit rend duhet të kryhet përsëritja, si të sillen kur lëvizin nëpër rrugë, kur janë vetëm ose në grup. Gjatë kohës ka qenë e pranishme që bashkëshortët të mos ecin bashkë, por burri para, ndërsa gruaja pas. Kur kanë ecur më tepër burra dhe gra, burrat kanë ecur në grup para, ndërsa gratë gjithashtu në grup, pas.

Një ndër doket më të rëndësishme ishte edhe ai në lidhje me mikpritjen. Vëmendje e posaçme ju është kushtuar mysafirëve, e sidomos nëse ata kanë ardhur për herë të parë dhe janë të panjohur. Gjatë ndejës së tyre nikoqiri jo vetëm që ju ka dhënë shtrat dhe ushqim, por edhe sigurim të plotë. Me qëllim që të mbrohet mysafiri, sidomos në Mal të Zi, Shqipërinë Veriore dhe Kosovë nikoqiri e ka sakrifikuar edhe jetën e vetë, nëse i ka dhënë fjalë mysafirit se do ta mbroj.

Kategori të veçanta dokesh kanë ekzistuar në lidhje me marrëdhëniet midis bashkëshortëve, mandej në lidhje me sjelljen e nuses ndaj prindërve dhe familjes të dhëndrit, por edhe të sjelljes të dhëndrit ndaj

prindërve dhe familjes të nuses. Me doke të veçanta ishin të rregulluara edhe marrëdhëniet midis familjeve të krushqëzuara, ose marrëdhëniet midis djalit të adoptuar dhe thjeshtrës me njerkun dhe njerkën. Interesante kanë qenë edhe doket në lidhje me adoptimin e djalit ose vajzës, si dhe në lidhje me vëllamërimin dhe motërzimin.

Praktikisht, rrallë cila fushë nga jeta e njerëzve nuk ishte e mbuluar me plotësim të ndonjë doku. Megjithatë jo numër i vogël nga ata kishin edhe karakter joracional. Këtu kryesisht bëhet fjalë për doke të shoqëruara me veprimtari të lloj llojshme magjike dhe manifestime të ngjashme, të cilat në kryesi kanë karakter besëtytnitë.

## **PËRFUNDIMI**

Hulumtimi i plotë që shkencërisht e trajton bashkësinë e Ballkano Egjiptianëve nga aspekti historik dhe etnografik, është i rëndësishëm jo vetëm për pjesëtarët e Ballkano Egjiptianëve, por edhe për popullatën tjetër në Ballkan, Evropë dhe më gjerë, ndërsa para së gjithash për zhvillimin e mendimit shkencor dhe zgjidhjen e shumë pyetjeve në shkencën në lidhje me këtë bashkësi. Kjo bashkësi në literaturën shkencore dhe tjetrën nga arsye të panjohura ose tepër të njohura është e përshkruar në kornizat e popujve dhe bashkësive tjera në Ballkan, e sidomos në kornizat e bibliografisë Cigane/Rome. Thamë se është e përshkruar sepse nuk mund të themi se është shkencërisht veçanërisht e vëzhguar, e hulumtuar dhe e analizuar, deri në dekadën e fundit të sh.XX. Shkakun për atë mund ta kërkojmë në zgjimin relativisht të vonshëm të vetëdijes etnike për veçanti tek kjo bashkësi në gjithë Ballkanin, i cili proces ende vazhdon, në disa pjesë të Ballkanit është në fazën fillestare, ndërsa diku edhe akoma nuk ka filluar. Por, në mendimin shkencor ekziston edhe një konfuzion tepër i madh para së gjithash tek ata shkencëtarë të cilët dëshirojnë që pyetjen e Ballkano Egjiptianëve ta shikojnë në kornizat e bashkësisë Cigane/Rome.

Konfuzioni më i shpeshtë ndodh, kryhet por edhe mbaron në problematikën e etnonimeve, e cila është një ndër pyetjet më komplekse për bashkësinë e veçantë etnike të Ballkano Egjiptianëve, varësisht nga fusha e përdorimit në Ballkan, gjuha dhe domethënia etimologjike. Etnonimet e pjesëtarëve të kësaj bashkësie mund të klasifikohen në: etnonime të cilat tregojnë direkt në Egjiptin (Gjupci, Egjupci, Jupci, Ojupcinë Maqedoni, Aguptë në Bullgari, Gjup, Egjup, Evgjit, Jevg në Shqipëri ndërsa Magjup në Kosovë në gjuhën shqipe, Giftos-në gjuhën greke, Kopt, Kiptijanë-në disa pjesë të Bosnjës); etnonime të lidhura me profesionin (Kovaçë në Mal të Zi, Ashkali në Fushën e Kosovës, Esnafë në Maqedoni, Kosovë, Serbi (Sanxhak) dhe; etnonime të tjera: Faraonë, “Ciganë të Bardhë”. Me disa nga etnonimet, para së gjithash me ato të cilat tregojnë drejtë në Egjiptin,

identifikohen edhe Ciganët/Romët. Konfuzion me etnonime është bërë në sh. XIV, me hyrjen masive të Ciganëve/Romëve në Ballkan dhe Evropë, shkak i nevojës për integrim në shoqëri dhe për prestigj më të madh.

Për lashtësinë e bashkësisë së Egjiptianëve në viset ballkanike mund të dëshmojnë edhe numër i madh toponimesh të cilat tregojnë në prezencë njerëzish me prejardhje nga Egjipti. Pikërisht në literaturën shkencore mund të gjenden shumë toponime, që janë të shkruara në monografi të ndryshme dhe harta arkeologjike, që datojnë që nga kohërat më të lashta neolite, nëpër kohën e hekurit, periudhës antike, heliniste, romake, bizantine dhe osmane.

Në burimet historike, arkeologjike dhe të tjera, ekzistojnë numër i madh të dhënave dhe i dëshmimeve për prezencën e kësaj bashkësie në Ballkan. Me zbatimin e metodës kulturore-historike dhe sqarimin e fakteve historike, arkeologjike dhe të tjera, me vënien e kësaj bashkësie në kontekst ndodhish të përcaktuara historike dhe procese shoqërore, arritëm deri në përfundim se arsyeja për ardhjen dhe kolonizimin e kolonistëve egjiptian në Gadishullin Ballkanik është eksploatimi i pasurisë xeherore, sidomos i metalit. Për atë shkak faraoni egjiptian Sezostrit siç e quan Herodoti ka ardhur deri në Thraki dhe Skiti. Kontinuitetin historik e gjetëm në disa lëvizje migruese të këtyre kolonistëve egjiptian, që mund të ndiqen nëpërmjet legjendës për Danajin, Ajgipin dhe Kadmon, si dhe mite dhe legjenda të tjera nga periudha antike, që na zbulojnë njohuri të përcaktuara për lëvizjet dhe gjendjen e kolonizatorëve egjiptian. Nga kjo periudhë janë edhe tempujt e parë të respektimit të zotrave egjiptian në Ballkan. Koha e imperializmit maqedonas dhe pushtimet e Aleksandërit të Madh, na vërtetojnë se lidhjet midis Egjiptit dhe Ballkanit në periudhën antike kanë qenë mjaft të fuqishme, para së gjithash nëpërmjet legjendës për Ozirisin dhe djalin e tij Makedon, legjenda për shtatzëninë e nënës të Aleksandërit Olimpia, deklarin e Aleksandrit si Pasardhës të Amon Ra dhe trashëgimtar të faraonëve si dhe sjelljen e tij më pas. Edhe gjatë Perandorisë Romake, kemi zbulime arkeologjike solide për prezencë kultesh nga Egjipti në Ballkan, si dhe njohuri për popullatë egjiptiane në Ballkan e cila “merret me zanatet e veta dhe kanë ditur të qëndrojnë të izoluar në bashkësitë e tyre”. Me paraqitjen e krishterimit dhe zhvillimin e Mbretërisë Lindore Romake d.m.th. Bizantit, në luftën për riqeveri me kishën, e me të edhe me Mbretërinë, Këshilli I kishës ekumene në Halkedon në vitin 451 dhe gjykimin e monofizitizmit egjiptian, me siguri ka pasur pasoja të veta negative edhe mbi popullatën me prejardhje egjiptiane në Ballkan. Në shekullin e mesëm të dhëna të rëndësishme për këtë bashkësi na jep arkipeshkopi i arkipeshkopisë së Ohrit Teofillakt, në sh.XII. Por sh.XIV është periudhë kur Ciganët/Romët masivisht hyjnë në Ballkan dhe në

Evropë, prej kur edhe fillojnë konfuzionet dhe paqartësitë, të cilat zgjasin deri sot, në lidhje me ngatërrimin e Ballkano Egjiptianëve me Ciganët/Romët. Gjatë kohës së Perandorisë Osmane, paralelisht me procesin e islamizimit kemi edhe procesin e deetnizimit, që edhe më shumë e keqëson gjendjen me identitetin etnik të kësaj bashkësie. Edhe pse Osmanlinjtë paralelisht përdorin dy terme të ndryshme “Çingene” dhe “Kiptijane”, nga dokumentet nga ajo periudhë shihet se me të dy termet nënkuptohen njerëz që nuk janë raja (bujkrobër) por jetojnë jetë endacake, përkatësisht ekziston konfuzion nëpërmjet të së cilit nuk mund të bëhet identifikim i pjesëtarëve të kësaj bashkësie. Të dy etnonimet janë edhe stereotip racor, sepse edhe përkrah procesit të deetnizimit, dallimet racore d.m.th. ngjyrës së lëkurës, nuk kanë mundur të barazohet. Konfuzione ndihen edhe tek udhëpërshkruesit e huaj, por edhe tek disa rilindës më të vonshëm. Në periudhën e krijimit të shteteve nacionale në Ballkan, Ballkano Egjiptianët janë ndarë në disa shtete ballkanike dhe kanë qenë të ekspozuar në asimilime dhe majorizime të ndryshme. Situata e njëjtë ka qenë edhe gjatë midis dy luftërave botërore.

Me zhvillimin e të ashtuquajturit “mendim shkencor” dhe ideologjinë e “progresit”, që e afirmojnë nacional-romantikët të shekullit e XIX, e bazuar në modelin Arian, paragjykimet racore ndaj Egjiptianeve të Ballkanit morën edhe dimension “shkencor”. Duke marrë parasysh se një numër shumë i madh i intelektualëve të Ballkanit, prej shekullit XIX janë shkolluar në universitetet e Evropës Perëndimore, çështja e paragjyqimeve racore dhe stereotipet ndaj Egjiptianëve në Ballkan, jo vetëm që nuk u përmirësuan, por dhe prej memories kolektive në mënyrë “shkencore” ishte fshirë fakti se në Ballkan jeton popullatë me origjinë nga Egjipti. Mohimi i prezencës Egjiptiane dhe elementit semito-hamit në Ballkan dhe Evropë, dhe sistematizimi i tyre në grupe të Romëve, ishte dhe është princip epistemologjik i shkollave të shumta Evropiane, por dhe strategji e politikave të disa shteteve dhe organizatave ndërkombëtare deri në ditët e sotme.

Pas luftës së dytë botërore njerëzve iu është garantuar liria e identitetit, fjalës, shtypit, publikimit, fesë, besimit, bindjes politike dhe mbledhjeve. Por, gati të gjitha vendet, që u bënë republikë (disa socialiste disa kapitaliste) nuk i plotësonin plotësisht këto të drejta dhe liri të qytetarëve. Me ndryshimet e Kushtetutës të Jugosllavisë të atëhershme nga viti 1974, nenet 166 dhe 170 iu garantohej qytetarëve lirisht të deklarohen ashtu siç ndihen, sipas vetëdijes së tyre. Pikërisht këtë garanci kushtetuese, pjesëtarët e kësaj bashkësie nga Ohri, Struga, Resnja dhe qytetet tjera të Maqedonisë jugperëndimore, e përdornin gjatë deklarimit për përkatësi



etnike në regjistrimin e popullatës nga viti 1981, ku deklarohen si “Egjiptianë”. Më 24 qershor 1990 në Ohër u mbajt Kuvendi Themelues i Shoqatës Egjiptiane në Jugosllavi. Me atë filloi edhe procesi i organizimit të pjesëtarëve të kësaj bashkësie në Ballkan në organizata shoqërore-politike, për kërkim dhe realizim të drejtave të tyre. Prosesi i zgjimit të vetëdijes etnike dhe organizimi në organizata qytetarësh dhe parti të Ballkano Egjiptianëve u zhvillua edhe në Kosove, Serbi, Shqipëri, si dhe në vendet e Evropës perëndimore, por si diasporë e Ballkano Egjiptianëve.

Bashkësia etnike e Ballkano Egjiptianëve është e shpërndarë gati nëpër gjithë Gadishullin Ballkanik d.m.th. në bashkësi të vogla ose më të mëdha lokale ose regionale, me vetëdije të zgjuar ose të pa zgjuar etnike, mund të takohen nëpër pjesën më të madhe të Gadishullit, ndërsa në pjesë më të madhe në pjesën e tij jugore dhe jugperëndimore. Jetojnë në Shqipëri, Greqi, Turqi, Bullgari, Maqedoni, Kosove, Serbi, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë. Varësisht nga ajo se a kanë vetëdije për veçanti ose jo, sipas klasifikimit të Bromlejit, e mundshme është të bëhet klasifikim në grupe dhe bashkësi më të vogla etnografike dhe etnike. Sipas njohurive tona nëpër gjithë Gadishullin Ballkanik jetojnë mbi 1 milion Ballkano Egjiptianë me vetëdije të zgjuar ose të pa zgjuar. Ballkano Egjiptianët sot nuk kanë gjuhë të tyre të vetme. Ata si gjuhë “amtare” ose “shtëpiake” e flasin gjuhën e rrethit ku jetojnë ose gjuhën e rrethit nga i cili kanë emigruar në ndonjë të kaluar më të afërt. Ky fenomen gjuhësor sqarohet me faktin se ata kanë jetuar dhe jetojnë jetë të stacionuar si pakicë etnike e rrethuar me shumicë tjetër etnike, nëpër qytetet ose fshatrat, ku kontaktet ndëretnike janë direkte, ndërsa pasojë e saj është asimilimi gjuhësor, me pranimin e gjuhës së shumicës. Megjithatë, gjuha e krijon edhe dallimin dhe kufirin më të dukshëm midis Ballkano Egjiptianëve dhe Romëve. Meqë identiteti etnik është kategori subjektive, numër i madh shkencëtarësh e kanë pranuar qëndrimin e Veberit se grupi etnik në thelb është besim subjektiv në prejardhje të përbashkët dhe se burimi i thellësisë së dallimeve, rëndësia objektive e së cilit nuk mund të jetë e matur pavarshëm nga domethënia që i japin disa individë në marrëdhëniet e tyre shoqërore. Me të identiteti etnik ndërtohet mbi bazë të dallimeve. Ndërsa Bart ka treguar për kufijtë etnik si aspekt i etnicitetit që e përfaqëson thelbin e problemit. Ajo që tejbartet me kohën nuk është arsenali kulturor por kufiri i grupit të përcaktuar, përmbajtja e brendshme ndryshohet, ndërsa kufijtë mbesin. Kufijtë etnik implikojnë marrëdhënie ndëretnike: identiteti etnik formohet dhe mbijeton pikërisht nëpërmjet prekjeve me grupet e tjera etnike. Në këtë kontekst në analizën shkencore i vëzhguar është edhe identiteti etnik i Ballkano Egjiptianëve i cili identitetet ka mbijetuar dhe është treguar pikërisht

nëpërmjet dallimeve dhe kufijve etnik. Me mënyrën e jetesës, me doket dhe shprehjet bëjnë dallim kryesor midis bashkësisë së tyre mjaftueshëm të mbyllur dhe TË TJERËT me të cilët vijnë në prekje. Ata llogariten se janë një dhe të vetmit në bashkësinë e tyre lokale ose regjionale, dhe ndiejnë lidhje vetëm me llojin e tyre. Kusht i parë për këtë ka qenë dhe ende është në disa pjesë të Ballkanit, përmbajtja ndaj endogamisë etnike.

Një domethënie e madhe tek Ballkano Egjiptianët sidomos tek ato me vetëdije të pa zgjuar është fenomeni i mimikrisë etnike, ose identiteti i preferuar ose identitetet përkushtimi, që pjesëtarët e kësaj bashkësie e sqarojnë me gjuhën e përbashkët dhe në masë të madhe me religjionin e përbashkët me bashkësinë dominuese. Në raste të tilla pjesëtarët e kësaj bashkësie çdoherë janë “Brenda të Tjerët” për bashkësitë dominuese nëpër Ballkan, e cila më së shpejti vërehet nëpërmjet asaj që ato rrallë, gati asnjëherë nuk lidhin kurora me “të tjerët tonë”. Por përvojat botërore tregojnë se kur rastet shoqërore do të ndryshojnë dhe kur ideologjia e identitetit të preferuar më nuk mund të shpjegojë antagonizmat pragmatik midis “Brenda të tjerëve”, “identiteti i përkushtimit” i preferuar e humb kuptimin e vetë dhe individët e bashkësisë pakicë ndiejnë nevojë për solidaritet sa më të madh dhe homogjenitet në “in-grupin” e tyre në të cilën nuk ka “brenda të tjerë”.

\*\*\*\*\*

Profesion themelor tradicional i numrit më të madh të Ballkano Egjiptianëve ka qenë përpunimi i metalit dhe zanati i farkëtarisë. Ajo ka qenë edhe shkaku për kolonizimin e tyre në Ballkan. Për përpunimin e metaleve, e sidomos për zanatin e farkëtarisë në Gadishullin Ballkanik ekziston material bibliografik i varfër, edhe pse paraqitja e metaleve paraqet një ndër periudhat më të rëndësishme në historinë e njeriut. Njohuritë tona janë se nga periudha e ashtuquajtur arkaike në Ballkan, çdo kund ku ndodhen xeherore për eksploatim metalit si dhe atje ku ka nevojë për përdorje përkatësisht shfrytëzimin e metalit, me mundësi të madhe mund të supozohet dhe të ndjehet popullatë me prejardhje egjiptiane, për çka indikacione gjejmë tek numër i madh autorësh, të cilët flasin për eksploatimin dhe tregtinë më pasurinë xeherore dhe metalin në Ballkan. Me hyrjen dhe pushtimet e Keltëve nga Perëndimi, në Gadishullin Ballkanik si bartës të kulturës latine, bëhet revolucion në përpunimin dhe përdorimin e hekurit. Me rënien e Gadishullit Ballkanik nën Perandorinë Romake, përpunimi dhe përdorimi i metalit, sidomos hekurit fitojnë domethënie edhe më të madhe. Xehetaria, gjithashtu zhvillohej dhe luante rol të rëndësishëm në ekonominë Romake. Në shekullin e mesëm tokë-pronaria dhe bujkrobëria e fshatarëve është themeli i ekonomisë, e me të përpunimi i

metalit, e sidomos zanati i farkëtarisë janë një ndër profesionet shërbyese të bronzit në çdonjëren nga shtetet mesjetare. I ngjashëm është rasti edhe gjatë kohës së Perandorisë Osmane ku farkëtarët gjithashtu ishin trajtuar si bujkrobër përkatësisht si raje, pa dallim a kanë punuar nëpër fshatrat ose qytetet. Mjetet e farkëtarisë për punë, prodhimet e tyre dhe procesi i përpunimit nëpër gjithë Gadishullin Ballkanik janë gati të njëjta, për dallim nga terminologjia e tyre në gjuhët e ndryshme ballkanike.

Zanat i dytë sipas përfaqësimit tek Ballkano Egjiptianët është bujqësia. Gati të gjithë Ballkano Egjiptianët janë marrë me bujqësi, e sidomos ata nga Kosova. Edhe farkëtarët, si zanat alternativ e kanë pasur bujqësinë për t'u plotësuar nevojat e tyre familjare. Numri më i madh kanë pasur prona të veta personale, ndërsa disa kanë punuar edhe si argatë në prona tjera.

Muzikaliteti është gjithashtu një ndër profesionet e rëndësishme të Ballkano Egjiptianëve në Ballkan. Numër i madh virtuozë ballkanik kanë prejardhje nga kjo bashkësi.

Nga profesionet e tjera vlefshëm është të përmenden zanati për endjen e rrogozave, për bërjen e fshesave, poçeria, për bërjen e blloqeve për ndërtim, bërjen e qymyrit, xehetaria etj.

Ballkano Egjiptianët jetojnë jetë sedentare dhe asnjëherë në historinë e tyre në Ballkan nuk kanë jetuar si nomad-endacakë, por kanë qenë popullatë e përhershme në vende të banuara, në mëhalla ose kuarte të tyre, që kryesisht janë në qendrat e lagjeve të qyteteve dhe nëpër fshatrat.

Shtëpitë dhe interieri i brendshëm shtëpiak i Ballkano Egjiptianëve në masë të madhe janë varur dhe varen para së gjithash nga kushtet natyrore-gjeografike dhe rajoni etnografik në Gadishullin Ballkanik, ku jetojnë. Megjithatë si një karakteristikë kryesore për Ballkano Egjiptianët që jetojnë nëpër lagjet e qyteteve dhe janë marrë me zanatin e farkëtarisë ose tjetër, është se shtëpitë e tyre janë në kate, ku pjesa përdhese ju shërben si punëtori, shitore ose magazinë, ndërsa kati i lartë ose katet janë pjesë për të jetuar. Shtëpitë fshatare janë te përshtatura për kushte bujqësore, përkatësisht kanë shtëpi me oborr të gjerë dhe më tepër objekte ndihmëse. Interieri i brendshëm tradicional i Ballkano Egjiptianëve gjithashtu është ngushtë i lidhur me atë se ku jetojnë, si jetojnë dhe me përkatësinë religjioze.

Ushqimi tradicional i Ballkano Egjiptianëve është varur nga shumë faktorë, siç janë kushtet natyrore-gjeografike, zhvillimi i përgjithshëm ekonomik i shoqërisë, mundësitë materiale të familjes, ndalimet fetare dhe rregullat, të ardhurat bujqësore etj. Tek Ballkano Egjiptianët ushqimi është shumë i pranishëm gjatë dokeve dhe ceremonive të ndryshme, që quhet

edhe ushqim ceremonial, i plotësuar me rregulla, tabu-e (ndalime), kurbane etj.

Duke pasur parasysh se stolia në Gadishullin Ballkanik, mund të takohet që nga kohërat më të lashta, nëpërmjet zbulimeve arkeologjike dhe varrezave në të cilat takohet stoli, mund të themi se në Gadishullin Ballkanik kemi prezencë të dukshme të ndikimit të ornamentikës egjiptiane në stolinë, që nga koha e hekurit, si pasojë e migrimit të substratit popullor egjiptian. Këtu sidomos duhet të theksohen amuletet e shumta me aplikim të skarabeiut.

Ballkano Egjiptianët nuk kanë veshje të tyre specifike të plotë në Gadishullin Ballkanik por në rajone etnografike veças mund të takohet se si me anë të veshjes krijojnë kufi etnik nga bashkësitë e tjera. Por, edhe këto pjesë të veshjeve me të cilat krijohet kufi etnik, janë në përputhje me kushtet natyrore-gjeografike të rajonit veças, si edhe me karakteristikat etnografike dhe ndikimeve të jashtme të rajonit të përcaktuar.

Kultura shoqërore e Ballkano Egjiptianëve sot është e njëjtë ose e ngjashme me kulturat përkatëse të bashkësive dhe popujve tjerë ballkanik nëpër gjithë Ballkanin, varësisht nga rajoni etnografik. E krijuar është gjatë mileniumesh, shekujsh dhe dekadash pas ardhjes të tyre në Gadishullin Ballkanik. Në shtresën e vjetër egjiptiane të kulturës shoqërore, nga çka sot akoma mund të ndjehen gjurmë, të pranuarra janë një varg komponentë nga ndikimet e jashtme, të shkaktuara nga kolonizimi dhe kalimi i popujve tjerë në Ballkan, si dhe nga ndryshimet religjioze dhe shoqërore në këtë periudhë të gjatë kohore. Për jetën shoqërore domethënie e madhe janë familjet inokose, familjare të zgjeruar të mëparshme si dhe organizatat esnafe të mëparshme.

Kultura shpirtërore e Ballkano Egjiptianëve është mjaft e pasur dhe e lloj llojshme. Kjo kulturë tek kjo bashkësi në përqindje të madhe është e ngjashme ose e njëjtë me kulturën përkatëse të popujve dhe bashkësive tjera etnike të afërta dhe fqinje ose gjithë Gadishulli Ballkanik. Megjithatë në kulturën shpirtërore të popujve dhe bashkësive në Ballkan ekzistojnë numër i madh karakteristikash që janë analoge në disa nga Egjipti i Vjetër, të cilat elemente me siguri në Ballkan janë sjellë nga kolonistët egjiptian.

Dituritë popullore si shumë njohuri dhe besimes për gjithçka që na rrethon d.m.th. për natyrën, njeriun dhe shoqërinë është fushë mjaft interesante për hulumtim dhe analizë. Në këto dituri popullore nëpërmjet një komparacioni me dokumentet e shkruara nga Egjipti i Vjetër, mund të gjenden numër i madh lidhjesh, por edhe kontinuitet jo vetëm të Ballkano Egjiptianët por edhe tek popujt dhe bashkësitë tjera ballkanike. Nëpërmjet analizës komparative, lidhjet e tilla mund të shihen në dituritë popullore për

Tokën dhe Gjithësinë, për stinët e vitit dhe paraqitjet atmosferike, në demonologjinë si dhe në dituritë popullore të lidhura me bimët dhe kafshët.

Tek Ballkano Egjiptianët elemente të vjetra egjiptiane mund të ndjehen edhe në medicinën popullore animiste-magjike dhe atë në amuletet, “syte e këqij”, të ashtuquajturat “magji të bardha” etj. Por pjesa më e madhe e elementeve nga medicina popullore, sidomos nga ajo medikale janë me prejardhje ballkanike, duke parë barërat që përdoren për mjekim, ndërsa varësisht nga kushtet natyrore-gjeografike dhe klimatike në Ballkan.

Krijimtaria popullore gojore e Ballkano Egjiptianëve është e pasur dhe zë vend të rëndësishëm në kulturën shpirtërore. Megjithatë, bashkësitë e tjera etnike e kanë përvetësuar krijimtarinë popullore gojore të Ballkano Egjiptianëve, si të tyren, ashtu që numër i madh legjendash, tregime popullore, këngë dhe valle popullore, që ende janë pjesë e krijimtarisë popullore të Ballkano Egjiptianëve, sot mund të gjenden në literaturën dhe folklorin e popujve tjerë ballkanik dhe bashkësi etnike. Por sot ekzistojnë edhe më shumë publikime që e kanë vërtetuar këtë trashëgim kulturor. Një ndër traditat më të dëshiruara nga farkëtarët Egjiptianë në tërë Ballkanin është ajo për krijimin e zanatit të farkëtarisë lidhur me disa ndodhi nga jeta e Azreti Dautit (David).

Arti i zbatuar popullor i Ballkano Egjiptianëve përkatësisht realizimet e tyre figurative, meritojnë vëmendje përkatëse për shkak të lloj llojshmërisë të tyre dhe vlerave estetike. Kjo lloj krijimtarië specifike takohet në numër të madh gjërash të punuara nga materiale të shumë llojshme (qime tekstili dru, metal, argjil). Në disa raste mund të takohen edhe ornamente që paraqesin edhe simbole etnike të Ballkano Egjiptianëve ndërsa asocojnë në Egjiptin e Vjetër, siç janë piramidat, Dielli me 8 cep, fletët e Ozirisit etj.

Valleve popullore dhe vallëzimit në krijimtarinë popullore të Ballkano Egjiptianëve ju përket vend i veçantë. Ka tradita të gjata duke e marrë parasysh faktin se ndodhitë më të rëndësishme nga jeta e njerëzve, ishin dhe janë të shoqëruara me valle. Rregullisht vallëzohet në dasmat, por edhe në ahengjet e tjera, sidomos nëpër mbledhjet popullore me rast të mbledhjeve të ndryshme. Midis kësaj bashkësie ka disa virtuozë të vërtetë të muzikës popullore vokale dhe instrumentale. Nga ata mund të veçohen familja Majovci nga Dibra-Maqedoni, që luajnë në surle dhe daulle, si dhe Lavër Bariu nga Përmeti-Shqipëri, i cili luan në klarinetë. Instrumente të tjera që i përdorin Ballkano Egjiptianët janë: violina, lahuta, çiftelia etj. Mënyrë mbisunduese gjatë plotësimit të këngëve është ajo monofone d.m.th. këndim i njëzëshëm ose polifonik, përkatësisht këndim i dy zërave,

ndaj edhe këndim i trezëshëm. Këndimi i trezëshëm sidomos është karakteristik për Ballkano Egjiptianët nga Shqipëria jugore, Epiri dhe rajoni Ohër-Presepë.

Besimet popullore dhe religjionet janë element i rëndësishëm nga kultura shpirtërore e Ballkano Egjiptianëve. Periudha e shpërnguljes së kolonistëve egjiptian ka qenë periudhë politeizmi, për çka në Ballkan edhe takojmë tempuj të zotrave të vjetër egjiptian. Ballkano Egjiptianët shumë shpejtë i kanë pranuar religjionet monoteiste-krishterimin, ndërsa më vonë edhe islamin. Sot pjesëtarët e Ballkano Egjiptianëve i përkasin disa bashkësive konfesionale, por numri më i madh janë me fe myslimane.

Në doket nga ciklusi i jetës tek Ballkano Egjiptianët, mund të thuhet se prezentë janë doket dhe ritualet magjike-antropike që të sigurohet mirëqenie, mbrojtje nga forcat e këqija, pjellshmëri (ferilitet) dhe mëshirë nga Allahu (Gospod). Kjo para së gjithash në doket gjatë lindjes, syetit dhe dasmave. Tek popujt Ballkanik, e sidomos tek Ballkano Egjiptianët, në ceremonitë dhe doket i madh është përdorimi i numrave: 3, 7 dhe 40, që simbolikë dhe përdorim të tyre të madh kanë pasur edhe në mitologjinë dhe kulturën e vjetër egjiptiane, por edhe në kulturën dhe besimin e gati të gjithë popujve dhe bashkësive në të kaluarën dhe sot.

Midis Ballkano Egjiptianëve posaçërisht janë të përhapura doket e festave, përkatësisht të ashtu quajturat doke nga ciklusi i vjetor (kalendar). Përveç festave islame Ramazan dhe dy Bajramet, vlen të përmenden Sh. Atanas, ditë vere, Shëngjergj, Sh. Naum, Sh Mëri, Shëmitër dhe Krishtlindja te cilat përshtatshëm festohen edhe pse pjesa më e madhe e pjesëtarëve të kësaj bashkësie janë myslimanë.

Nga domethënie e madhe janë doket gjatë mundit (punës), doket e drejtësisë si dhe doket e tjera, para së gjithash të lidhura me mirëpritjen.

Si përfundim i rëndësishëm i tezës tonë mund të thuhet se Ballkano Egjiptianët e kanë vendin e tyre të veçantë në “melting pot”-in, etnik dhe kulturor. E pashmangshme është veçantia e tyre etnike, sepse ajo tregohet nëpërmjet kufijve etnike që vendosen dhe mbahen edhe përkundër kontakteve me të TJERËT, ndërsa nëse një grup e mban identitetin e vetë edhe përkundër kontakteve ose midis kontakteve, ajo doemos duhet të ketë kriteriume mirë të definuara për sinjalizim të përkatësisë.

Nëpërmjet një qasjeje interdisciplinare, me ndihmën e etnologjisë, arkeologjisë, etnoonomastikës, mendojmë se krijuam një bazë shkencore solide për përgjigje të më shumë pyetjeve lidhur me historinë e Ballkano Egjiptianëve, para së gjithash datimin e shpërnguljes të kolonistëve egjiptian

në Ballkan. Atë e lidhëm me zhvillimin e xehetarisë dhe kohën e hekurit, nga dinastia XIX në Egjiptin i Lashtë për eksploatim të sa më shumë sasi xeherore për nevojat e tyre. Për tentimin e bërë për rekonstruim të historisë etnike të Ballkano Egjiptianeve në kontinuitet të përcaktuar, e cila histori doemos duhet të pranojmë se është shumë ekzistuese, tragjike dhe e fshehur, përsëri mund të arrihet deri në përfundimin e protagonistëve të qasjes antropologjike-historike se nuk mund të jepet përgjigje e pyetjes pse historia e një bashkësie është e ndryshme nga historia e bashkësive të tjera dhe pse, si për shembull, të ashtuquajturit popuj të marginalizuar dhe të diskriminuara nuk kanë histori të tyre. Megjithatë, ne do të kishim shtuar se Egjiptianët në Ballkan kanë gjurmë për historinë e tyre, por nuk kanë pasur historianë të cilët atë do ta kishin shkruar. Ajo është mjaft e ndryshme nga historia e të tjerëve –bashkësive dhe popujve dominues në Ballkan.

Në etno kulturën e Ballkano Egjiptianeve, përkatësisht në bashkësitë e tyre veçase nëpër krejt Ballkanin mund të faktohen dukuri të cilat kanë ndodhur nën ndikim të bashkësive dhe popujve fqinjë me të cilët jetojnë në rajon të përcaktuar etnografik, para së gjithash ndikimi në gjuhën. Ata në Shqipëri dhe Kosovë janë nën ndikim e të ashtuquajturës etno-kultura shqiptare, ata në Beograd nën ndikim të kulturës serbe, ato në Bullgari nën ndikim të asaj bullgare, ata në Greqi nën ndikimin Grek etj. Edhe religjioni ka ndikim të fuqishëm, myslimanët kanë simbole të rëndësishme të kulturës islame ndërsa krishterët të kulturës ortodokse-krishtere. Por, me analizë të kujdesshme dhe detale, mund të vërehet edhe ndikimi i përafërt i Ballkano Egjiptianeve mbi bashkësitë dhe popujt fqinjë në Ballkan, që janë të pranishëm si shtresa të inventarit të tyre kulturor. Kuptohet se analogjitë e disa elementeve të kulturës në Ballkan me ato që mundemi t'u takojmë nëpërmjet literaturës dhe gjurmëve të ruajtura kanë qenë të pranishme edhe në Egjipt të Vjetër, nuk do të thotë se direkt tregojnë në lidhje etnogjenetike. Por, sipas teorisë të difuzionistëve thuhet se „përbërësit kulturorë kryesisht përhapen nëpërmjet migrimeve, përkatësisht kontakteve deri në të cilat arrihet midis bashkësive të ndryshme etnike”. E ajo do të thotë, padyshim të se përbërës të përcaktuar kulturor të kulturës të vjetër egjiptiane dhe civilizimit në Ballkan janë përhapur nëpërmjet migrimit dhe ndikimit të kolonistëve egjiptian në Ballkan.

Analiza e etno-kulturës në Ballkan, e midis të cilave edhe e Ballkano Egjiptianeve para së gjithash ajo shpirtërore, tregon se në të janë prezentë dy komponentë të rëndësishëm kulturor: njëra është e ashtuquajtur mediterane, ndërsa tjetra indoevropiane. Ato kryesisht janë në lidhje simbolike dhe disa herë është vështirë që të dallohen, e akoma më vështirë

të ndahen. Hulumtimet sa më të thella dhe më të gjëra arkeologjike, etnologjike dhe kulturologjike e vërtetojnë këtë supozim në kopsht shumë më të gjërë kulturor, duke zbuluar vija mediterane si më të vjetra dhe vendase, ndërsa ato indoevropiane si më të reja dhe të ardhura. (Антонијевић, Д. 1982: 173).

Etnografia komparative e popujve të Mediteranit zbulon lidhje të fuqishme të Egjiptit dhe Lindjes së Afërt me Ballkanin, prej nga sipas mendimit të shumicës së shkencëtarëve është e sjellë edhe bujqësia edhe blegtoria në Ballkan dhe Evropë. Mund të thuhet se Ballkano Egjiptianët e sotshëm paraqesin ndoshta hallkat e fundit të atij zinxhiri të gjatë i cili lëshohet nga prapa, duke e lidhur Ballkanin me Lindjen e Afërt dhe Egjiptin. Përzierja e magjive, besëtytnive egjiptiane dhe lindore, misticizmit, demonologjisë, astrologjisë dhe paraqitjeve eskatologjike me paleoballkaniken dhe filozofinë më të vonshme greke-romake sjell deri në sinkretizëm të fuqishëm. Gjatë analizës tregonim se në etno-kulturën e Ballkano Egjiptianëve ruhen shumë gjurmë nga fazat e ndryshme të zhvillimit të njeriut. Diku i zbuluam edhe fillimet e para dhe arketipat e disa besimeve, ceremonive dhe dokeve që jetojnë dhe funksionojnë deri sot. Edhe pse disa arketipa mund të jënë të përbashkëta tek të gjitha bashkësitë dhe popujt ballkanike, por edhe gjithë njerëzimit, Ballkano Egjiptianët i përdorin në mënyrë të vetë. Disa mite dhe ceremoni simbolike që kanë ekzistuar në kohërat e lashta në Botën e Vjetër tek Ballkano Egjiptianët as sot nuk e kanë humbur domethënien. Duke e mbajtur pas traditën, ata kanë ruajtur lidhje të përcaktuara midis jetës të tyre të përditshme tradicionale dhe botës të vjetër të magjive dhe besimeve. Vendbanimi funksional, shenjtëria e zjarrit, rregullat e mirëpritjes, forca e familjes, vlera mbrojtëse e farefisnisë, ndikimi i familjes udhëheqëse, autoriteti patriakal, respektimi i gruas, kushtimi i gruas ndaj detyrave familjare, kujdesa për nderin dhe famën etj. krejt kjo është thellë e rrënjësuar në prapavijën e jetës së përditshme të periudhës antike klasike në Ballkan, për çka edhe pjesë e madhe “janë marrë nga Egjipti” siç thotë edhe Herodoti.

Nganjëherë qartë i theksuam edhe ato elemente të kulturës që krishterimi dhe islami me ndikimet e tyre të fuqishme kanë vënë vulë të fuqishme në etno-kulturën e Ballkano Egjiptianëve. Kjo duket para së gjithash te shtresat kulturore osmane-orientale, bizantine, mesjetare. Nuk ka dyshim se nëpërmjet elementeve të ndryshme të etno-kulturës, e sidomos në elementet e kulturës shpirtërore insistimet njerëzore që në mënyra të ndryshme të kundërshtojnë mosnjohjen e vetë të realiteteve natyrore dhe shoqërore dhe atë botë ta shikojnë, shpjegojnë dhe sundojnë në bashkimin e



shumë ndryshimeve kundërthënëse. Me tekstin e shkruar dhe tezën që e përfaqësonim mendojmë se i vendosem bazat mbi të cilat do të vijojnë mendime të ardhshme, hulumtime dhe punime, që plotësojnë dhe pasurojnë historinë dhe etnologjinë e Ballkano Egjiptianëve.

## SUMMARY

A scientific research about historical and anthropological aspects of Balkan Egyptians is important not only for the members of Balkan Egyptian community, but also for other people in the Balkans and Europe. Such research is important and for the development of scientific thought and to resolve many issues related with them. This community in the scientific and other literature, for unknown (or very much known) reasons is described in the framework of other peoples and communities in the Balkans, especially in the bibliography frames of Gypsies/Roma. We said it is described, because we cannot say that particularly scientifically was surveyed, researched and analyzed, until the last decade of XX century. Reason for such situation we may to find in a relatively late awakening of the consciousness of this particular ethnic community in the Balkans, which process still continues in some parts of the Balkan Peninsula, in some parts is in the initial stage, while in some have even not started, yet. But, in science opinions also exists a great confusion, primarily among those scholars who the issue of Balkan Egyptians wants to see into the frames of Gypsy/Roma community.

Confusion often is made, but also ends on the issue of ethno-names, which is one of the most complex questions about the particular ethnic community of Balkan Egyptians. Dependently on the scope of usage in the Balkans, language and its etymological meaning, ethno-names related with this community can be classified into: a) the *ethno-names which point directly to Egypt* (Gjupci, Egiupci, Jupci, Ojupci in Macedonia; Agupti in Bulgaria, Evgjit, Gjyp, Egjyp, Maxhup in Albania and in Kosovo; Giftos-in Greece, Kopti, Kiptijanë-in some parts of Bosnia and Hercegovina); b) the *ethno-names related to profession* (Kovachi in Montenegro; Ashkali in Kosovo, Esnafi (Guilds) in Macedonia, Kosovo, Serbia (Sandžak); and c) the *other ethno-names*: Pharaohs, "White Gypsies" etc.. With some of ethno-names, primarily with those that point to Egypt, some of Gypsies / Roma

communities are identifying, too. The confusion with ethno-names is done in XIV century, with the massive entry of Gypsies / Roma in the Balkans and Europe, due to their need for integration in society and greater prestige.

For the antiquity of the Egyptian community in the Balkans can testify the number of toponyms, which showing to the presence of people with origin from Egypt. Indeed, in the scientific literature can be found a great number of toponyms, which are evidenced in various monographs or archaeological maps, dating back from the Neolithic times through the Iron time, Ancient period, Hellenistic period, Roman period, Byzantium until Ottoman time.

In historical, archaeological and other sources, there are a large number of data and evidence for the presence of this community in the Balkans. With using of the cultural-historical method and clarification of historical, archaeological and other facts, by searching of this community in the context of historical and social processes, we came to the conclusion that the reason for Egyptians colonization in the Balkan Peninsula is the exploitation of mineral wealth, especially the metal. For that reason Egyptian Pharaoh Sesostris, came until "to the Thrace and the Scythians". The historical continuity we found in several migratory movements of these Egyptians colonist, which can be followed through the legends of Danaus, Aegyptus and Cadmo, as well as from the other myths and legends from the mythological period, which help us to gain some knowledge about the movements and the social positions of Egyptians colonists. From this period are dated the first temples that respecting Egyptians gods in the Balkans.

The time of Macedonian imperialism and conquests of Alexander the Great, confirms that relations between Egypt and the Balkans in Ancient and Hellenistic period have been very strong, primarily through the legends of Osiris (or Zeus) and his son Macedon, the legend of conception of Alexander's mother Olympia, Alexander's declaration as successor of Ammon and decedent of pharaohs, as well as his behavior afterwards. From the time of Roman period we can found solid archaeological findings of related with Egyptians cults in the Balkans, as well as knowledge about the presence of Egyptian population in the Balkans which "deals with their crafts and knew to stay isolated in their communities". With the establishment of Christianity and the development of the Eastern Roman Kingdom or Byzantium, in a fight for the supremacy of the Church, and of course through the Church with the Empire, the decisions for judgment of Monophysitism in the Ecumenical Council of Chalcedon in 451, certainly had its negative consequences on the population with Egyptian

backgrounds in Balkan areas. In Medieval period data relevant to this community gives us the Archbishop of Ohrid Archdiocese Teophylact in the XII century. The XIV century is a period when Gypsies / Roma massively entering the Balkans and in Europe, when the confusions and uncertainties about Balkan Egyptians and Gypsies/Roma started, which last even until nowadays! During the Ottoman Empire, in parallel with the process of Islamization was the process of De-ethnicitization, which furtherer worsens the situation with the ethnic identity of the community of Balkan Egyptians. Although that parallel the Ottomans used two different ethno-names "Çingene" and "Kiptijan", the documents from that period shows that the two ethno-names point to the people whose didn't had a status of "raya" (serfs) but lived nomadic life. For that reasons in Ottoman documents the confusion continuing to exists, through which the identification of the members of the Balkan Egyptians community in this period is impossible. The both ethno-names (Çingene and Kiptijan) also are racial stereotypes, because despite the process of De-ethnicitization, the racial differences or the skin color, could not be equalized. Confusions in the identification can be felt also among the entries of the foreign travel-writes, but also and among some recent enlightenment writes. With the creation of nation-states in the Balkans, Balkan Egyptians territorially were divided into more of Balkan countries and they have been exposed to assimilation and majorization. The situation was the same during the period between two world wars.

With the development of the so-called "Scientific opinion" and the ideology of "Progress", affirmed by the national-romantics of the nineteenth century, based on the so-called Aryan model, racial prejudices against the Balkans Egyptians took the "scientific" dimension. Bearing in mind that a great number of Balkan intellectuals from the nineteenth century were educated at universities in Western Europe, laughter racial prejudices and stereotypes against Balkan Egyptians not only wasn't improved, but also "in scientific way" from the collective memory was deleted a fact the in the Balkans lives population with origin from Egypt. Denying the presence of Egyptians and Semite-Hamitic elements in the Balkans and Europe, and their systematization in a group of Gypsies/Roma, was and is an epistemological principle of numerous European schools, but and strategic policy of some countries and international organizations until today.

After the World War II freedom of thought, conciseness, identity, freedom of speech, press, publishing, peaceful assembly and association are guaranteed. However, almost all Balkan countries, which became republics,

didn't fully fulfill these rights and freedoms of citizens. The amendments to the Constitution of the SFR Yugoslavia since 1974, or precisely the articles 166 and 170 guaranteed the freedom of freely identity declaration of people, according to their conscience. Exactly these Constitutional guarantees were used by the members of Balkan Egyptian community from Ohrid, Struga, Resen and other cities in southwestern part of Macedonia, to freely declare their ethnic identity as Egyptians in the census of population in 1981.

On 24 June 1990 in Ohrid was held the Founding Assembly of the Association of Egyptians in Yugoslavia (SFRJ). With that act started the process of organizing of this community on socio-political organizations for requesting and realization of their rights. The process of awakening of ethnic consciousness and establishment of citizen's organizations of Balkan Egyptians developed in Kosovo, Serbia, Albania and the countries of Western Europe as the diaspora of Balkan Egyptians.

\*\*\*

Balkan Egyptians are spread across almost all Balkan Peninsula, in small or large, local or regional communities with the awakened or unawaken ethnic consciousness. The greater part can meet in the southern and southwestern part of the Peninsula. They live in Albania, Greece, Turkey, Bulgaria, Macedonia, Kosovo, Serbia, Montenegro, and Bosnia and Herzegovina. Dependent on whether they have particular awareness or not, according to Bromley's classification, it is possible to categorize groups on ethnic or ethnographic communities. To our knowledge across the Balkan Peninsula Balkan live over 1 million Balkan Egyptians with awakened or unawaken ethnic consciousness.

Nowadays, Balkans Egyptians haven't their own unique language. As "native" or "mother tongue" they speak the language of the locality where they live or of the district from which they migrated in any closer past. In many cases members of this community in the Balkans are bilingual or polyglots. This linguistic phenomenon is explained by the fact that they are living as a stationed ethnic minority surrounded by other ethnic majorities, in cities or villages, where ethnic contacts are direct and intensive, and it causing the linguistic assimilation or the acceptance of the majority language. However, the language phenomenon creates the most visible border between the Balkan Egyptians and Roma, because the Balkan Egyptians never spoke or speaking the Roma language, which is one of ethnic markers for Roma people.

Since that ethnic identity is subjective category, the number of scientists have accepted the Weber's position that basically ethnic group is the subjective belief in common origin and the source of ethnicity shouldn't be ask on possession of ethnographic characteristics but on creating, cultivating and deepening the differences, which objective values can't be measured, without to the importance that some individuals are devoting to the social relationships. So, the ethnic identity is built on the basis of differences. On other side, Barth has shown to the ethnic boundaries as the main aspect of the ethnicity that represents the essence of the problem. It is not the cultural arsenal that transferring through the time, but ethnic boundaries: the internal contain is changeable and the ethnic boundaries remain. Ethnic boundaries are causing inter-ethnic relations: ethnic identity is formed and survives just by touching with other ethnic groups. In this context, through the scientific analysis is also observed ethnic identity of Balkans Egyptians, which identity has survived and verified exactly through the differences and ethnic bounders. With the lifestyle, customs and habits they are making the distinction between their own much "closed" community and the "Others" with whom are coming in contact. They are counting themselves as "the one and the only" in their local community or region, and they are feeling close relation only with their own kind. The first condition for what has been and still is in some parts of the Balkans, the adhered to endogamy.

With a great importance for Balkan Egyptians especially those with the unawaken consciousness is the phenomenon of ethnic mimicry or *preferred identity* or *identity of commitment*, which the members of the community explain with the common language and largely with the common religion with the dominant community. In such cases members of the Balkan Egyptians community are always "Other insiders" for the dominant communities in the Balkans, which can be very well noticed by the rarely, almost never associated marriages with "Other ours". But global experience shows that when social circumstances are varying and the ideology of preferred identity cannot explain the pragmatic antagonisms between "Other ours", the preferred "identity of commitment" loses the sense, than the individuals of minority community are feeling a need for greater solidarity and homogeneity in the "in-group" in which there is no "other insiders".

\*\*\*

The basic traditional profession of the greatest number of Balkan Egyptians has been metalwork and blacksmith craft. For the metal processing, especially for the blacksmith craft in the Balkan Peninsula bibliographic material is very poor, although the appearing of metals is one of the most important periods in human history. Our knowledge is that in the so-called Archaic period in the Balkans, everywhere where the mines exploitation of metal existed and where was a need for using or use of the metal, with great possibility can be assumed or felt a population with Egyptian origin. Indications we may find in a large number of authors, who speak for the exploitation and trade with mineral goods and metals in the Balkans. With the entry and invasion of the Celts from the West, as holders of a Latent culture in the Balkan Peninsula, revolution in the processing and use of iron was made. In the time of Roman Empire in the Balkan Peninsula, processing and use of metal, especially iron, gain even greater importance. The mining profession was improved and also played an important role in the Roman economy. In Medieval period the landlordism, the servitude of peasants and the cultivation of the land were the base of the economy, which implicated the metal processing, especially the blacksmith craft, to be one the most important service in each of the medieval states. The similar situation is during the Ottoman Empire where blacksmiths were also treated as serfs or as *Raya*, regardless of whether they worked in villages or towns. The blacksmith's tools and products, as well as, the process of processing are almost the same throughout the Balkan Peninsula, unlike their terminology in different languages of the Balkans.

The second profession among the Balkans Egyptians is the agriculture. Almost all Balkans Egyptians were occupied with farmer activities, especially those from Kosovo. Even the blacksmiths, as an alternative profession worked in agriculture with reasons to meet the needs of their family. The largest number of the people had their own land property, but some have worked as laborers on other properties.

Musician vocation is also one of the important professions for Balkan Egyptians. Large number of Balkan music virtuous originates from this community.

As other professions we may to mention the weaving craft mat, the broom making, the pottery, the brick-making, the coal-making, the mining etc.

Balkan Egyptians live sedentary life and never in their history in the Balkans they lived as nomadic/ wanderers or travelers, but always have

been permanent population in the occupied inhabited settlements, in their quarters or “mahalas”, which are mainly in centers of cities or villages.

Houses and traditional furniture of the Balkan Egyptians are largely dependent and depend primarily on natural conditions, geographical and ethnographic region, where they live of the Balkan Peninsula. However, as a main characteristic of Balkan Egyptians living in cities and neighborhoods, is that their homes are with two or more floors, where the ground floor serves as workshop, store or warehouse, while the upper floors are residential part for living. Rural homes are adapted to farming conditions, respectively, are home with the large yard and outbuildings, too. Traditional interior of Balkan Egyptians is also closely related with the area where they live as well as with religious affiliation.

Traditional nutrition of Balkan Egyptians is dependent on many factors, such as natural and geographical conditions, general economic development of the society, the ability of the family, religious prohibitions and regulations, agricultural income etc. Among the Balkan Egyptians nutrition has very important role on the different rituals and customs, or so-called the ritual nutrition, accompanied with many rules, taboos (prohibitions), sacrifices (Kurban) etc.

Bearing in mind that in the Balkan Peninsula, through the archeological findings we may meet jewelry since the most ancient times, we can say that in the Balkan Peninsula we have the significant presence of Egyptians influence on the ornament, starting from the Iron time, as a result of a migration of Egyptian human substrate. In this context we should particularly emphasize the large number of “amulets” with scarab application.

Balkan Egyptians haven't their specific traditional folk costumes in the Balkan Peninsula, but in particular ethnographic regions we can meet that through tradition costumes they made boundaries with other ethnic communities. These parts of clothing that mark the ethnic boundaries, are in accordance with natural and geographical conditions of the particular region, as well as with ethnographic characteristics and external influences to the region.

Social culture of the Balkan Egyptians today is the same or similar to the respective cultures of other Balkan peoples and communities throughout the Balkans, depending of the ethnographic region. The social culture is formed over millennia and centuries, after their colonization in the Balkan Peninsula. Up to the Ancient Egyptian layer of social culture, from which today can still feel some trails, the array of components of external influences are accepted, caused by colonization and passaging of



the other people in the Balkans, as well as by religious and social changes in this large period of time. From the social life of great importance are nucleus families, former extended families and former guilds organizations (esnaf).

Spiritual culture of Balkan Egyptians is very rich and diverse. This part of the culture of this community at large proportion is similar or the same as the relevant culture of other ethnic communities at the Balkan Peninsula. Indeed, at the spiritual culture of the people and communities in the Balkans there are large number of features that are analogous to some that were noticed by classical authors in Ancient Egypt, which elements in the Balkans are brought by the Egyptian colonists.

Folk Knowledge, known as a summary of knowledge and beliefs about everything that exist around us or knowledge about the nature, man and society is very interesting realm for research and analysis. Under the comparative method of this folk knowledge in the Balkans and with written documents of practices from Ancient Egypt we may find a lot of connections and even continuity, not only among the Balkan Egyptians, but also among the other Balkan peoples and communities. Through the comparative analysis such connections can be seen in folk knowledge about Earth and the Space, the year seasons and weather phenomenon, in demonology and in a folk knowledge related to plants and animals.

Elements of the ancient Egyptians spiritual heritage among the Balkan Egyptians can be felt into the magical-animistic folk medicine, more precise in amulets, believing in "the evil eye" and in the so-called "white magic" etc. But the most of the elements of folk medicine, especially from medical medicine are with Balkan origin, bearing in mind the diversity of plants that are used for medication treatment, on dependence of the natural and geographical conditions and climate in the Balkans.

Oral Folklore of Balkan Egyptians is a rich and took an important place in the spiritual culture. But, other ethnic communities have adopted some elements of the oral folklore of Balkan Egyptians as their own, so the number of legends, folk stories, folk songs and dances that are still a live part of the Balkan Egyptians culture, nowadays can be found in a literature and folklore of other Balkan peoples and ethnic communities. One of the most famous legends desired by blacksmiths with Egyptian origin in the Balkans is that one for establishment of the blacksmith craft related with several fragments from the life of "Azreti Daud" (David).

Applied Folk Art of the Balkan Egyptians or their figurative realizations deserves appropriate attention due to their diversity and of aesthetic values. This kind of special creativity can be found in a big number

of creative handy-made products made by very diverse materials (wood, wool textile, metal, clay). In some cases they can meet on the ornaments that represent ethnic symbols of Balkan Egyptians while associating to the Ancient Egypt, such as pyramids, sun with the eight rays, wings of Osiris etc.

To the Folk Dances and Dancing is reserved a special place among the folk creativity of Balkan Egyptians. They have a long tradition by considering the fact that the most important events of people's lives were and are associated with dance. Regularly, dancing is present at the weddings, but also in other parties, especially on popular meetings on occasion for various holidays. Among this community we may find some extreme virtuosos of the vocal and instrumental folk music. Among the others we may point to the family Majovci from Debar/Dibra in Macedonia, who are playing on surle (rostrum) and drum, as well as Llavër Bariu from Permet, Albania, who plays clarinet. Other instruments that are used by Balkan Egyptians are: violin, accordion, "lahuta", "qiftelia" etc. Prevailing way of singing is monophonic or one-voice singing. Very usual is and so-called polyphonic singing or singing with two voices or even with three voices. Singing with three voices is especially characteristic for the Balkan Egyptians from the southern Albania, Epirus and Ohrid-Prespa region.

Folk believing and religions are important elements of the spiritual culture of Balkan Egyptians. The period of migration of Egyptian colonists was a period of polytheism, which caused to meet the traces of old temples of Egyptian gods in the Balkans. Later, Balkan Egyptians had accepted monotheistic religions-Christianity and Islam. Nowadays members of the Balkan Egyptians community belong to more religious groups, but the majority of people are Muslims.

For the customs from the life cycle of Balkan Egyptians, we may say that there are present magical-apotropaic ceremonies and rituals to ensure the welfare, fertility, mercy from the God as well as the protection from evil forces. This is especially present in customs and rituals during the birth, circumcision and weddings. Among the Balkan people, especially among the Balkan Egyptians, in ceremonies and rituals is a large use of numbers: 3, 7 and 40! These numbers had the symbolism and their great use in the mythology and culture of Ancient Egyptians, but also in culture and believing of almost all peoples and communities in the past and nowadays.

Among Balkan Egyptians holiday's traditions are in practice, too, respectively the so-called customs of the annual (calendar) cycle. Besides the Islamic holiday of Ramadan and two Eid Mubareks, worth is to mention the St. Athanasius, the Summer Day, the St. George, the St. Naum, the St.

Demetrius etc., which are celebrate in special (non-Christian) way although most of the members of this community are Muslims.

Of great significance are the customs during the labor, customs and traditions of Juridical practice, and other custom primarily related to the hospitality.

\*\*\*

As an important conclusion of our thesis is that the Balkan Egyptians have their special contribution into the Balkan's ethnical and cultural "melting pot". Undisputable is their ethnic particularity, because it is verified through the ethnic boundaries that are established and maintained despite contacts with the others, and if one group keeps its own identity despite contacts or between contacts, it must have well-defined criteria that are signaling the belonging.

Through an interdisciplinary approach, with the help of social and cultural anthropology (ethnology), archeology and other sciences, we are thinking that created a solid scientific basis to answer the most of the questions about the history of the Balkan Egyptians, primarily the dating of Egyptian colonization in the Balkans. We linked the colonization with the development of mining and the Iron time, as well as we with the desire of the pharaohs from the nineteenth dynasty of the Ancient Egypt to exploit as much as possible ore quantities for their needs. With this attempt to reconstruct the ethnic history of Balkan Egyptians with a certain continuity, which history is very exciting, tragic and covered, we may come to the position of the protagonists of the historical-anthropological approach: "that is not possible to answer the question why the history of certain community is different from history of other communities and why, for example, the so-called "natural peoples" (primitive) haven't their history?" Indeed, we would add that the Balkans Egyptians have very valuable traces of their history, but they hadn't the historians who would write it. Their history significantly is different from the history of the others, dominant communities and peoples in the Balkans.

In the ethno-culture of Balkan Egyptians, or into their particular local or regional communities through the entire Balkans can meet the phenomenon that are occurred under the influence of neighboring communities and peoples who live in the proper ethnographic region. The first and foremost is the influence on the language. Those Balkan Egyptians who live in Albania and Kosovo are under the influence of the Albanian ethno-culture, those in Belgrade under the influence of Serbian culture,

those in Bulgaria under the influence of Bulgarian and so on. The religion has a strong influence, too. The Balkan Egyptians that are Muslims have significant symbol of Islamic culture and Christians of the Orthodox - Christian culture. However, with careful and detailed analysis, can be notice and a pretty influence of Balkan Egyptians to the culture of other communities and neighboring peoples in the Balkans, which are present as layers in their cultural inventory. Of course that the analogies in some elements of culture in the Balkans with ones that we can meet through the literature and preserved traces from the Ancient Egypt, does not mean direct ethno-genetic relations. However, according to the theory of cultural diffusion "the cultural elements mostly can spread through migrations, respectively through the contacts between different ethnic communities", it is mostly possible that the cultural components of Ancient Egypt are spread in the Balkans through the migration and the influence by the Egyptians colonists.

The analysis of the ethno-culture in the Balkans and among which the Balkan Egyptians culture, primarily the spiritual culture, shows that two important cultural components are present: one is the so-called Mediterranean, and the other Indo-European. Mainly, they are in symbolic link and sometimes is very difficult to distinguish, and even more difficult to separate. The deepest and most extensive archaeological, ethnological and cultural researches are confirming this hypothesis in a much broader cultural garden, by revealing the Mediterranean lines as older and indigenous, while the Indo-European as younger and incoming (Антонијевић, А., 1982: 173).

Comparative anthropology of the peoples from the Mediterranean reveals strong ties between the Egypt, the Middle East and the Balkans, from where according to the opinion of the majority of the scholars the agriculture and the livestock were brought in the Balkans and Europe. It can be said that nowadays members of Balkan Egyptians community probably represent the last link of a long chain which stretched from the behind, linking the Balkans with the Near East and Egypt. Mixing of the Egyptian and Eastern magic, superstition, mysticism, demonology, astrology and the eschatological figures of the Ancient Balkan and later the Greek-Roman philosophy brings up to the strong syncretism.

During the analysis we show that in the ethno-culture of Balkan Egyptians are stored traces from the different stages of human development. Somewhere we discovered the very begging and archetypes of some beliefs, ceremonies and customs that live and functioning until today. Although that some archetypes may to be in common to all Balkan peoples

and communities and also to all humanity, Balkan Egyptians are using them in their own way. Some of myths and symbolic rituals that have existed in ancient times in the “Old World” didn’t lose the importance among the Balkan Egyptian even nowadays. By holding the tradition, they kept some ties established between their daily life and traditional old world of magic and beliefs.

Functional habitat, the holiness of fire, rules of hospitality, the strength of a family, kinship protective value, influence of leadership family, patriarchal authority, respect of women, women's devotion to the family duties, care for the honor and reputation and so on, are deeply rooted in the background of everyday life of ancient classical period in the Balkans, for which the major part "were taken out of Egypt" as Herodotus wrote.

In some parts we clearly highlighted those elements of culture that Christianity and Islam with their powerful effects gave the powerful seal on Balkan Egyptian ethno-culture. Among the others the most remarkable are the Byzantine, the Medieval and the Ottoman-Oriental cultural layers. There is no doubt that through the various elements of ethno-culture, especially in the elements of the spiritual culture, are visible the human efforts on different ways to challenge the self ignorance of the natural and social realities and to watch, to explain and to overruled the unity of many controversial amendment.

## **Bibliografia**

**Allam, S.** 1990, Everyday life in Anciet Egypt-The status of women and marriges in Ancient Egypt. Guizeh.

**Allport, G.** 1976, Formation of In-Groups, Ethnic identity in Society, Chicaqo.

**Андреев, М.** 1979 Българското обичайно право. София.

**Анђелковић, В.** 1991, Arheolo{ki materijal bliskoisto~nog porekla u Srbiji, Glasnik Srpskog arheolo{kog dru{tva. br. 7, Beograd;

**Андерсон, Б.** 1998, Нација: замишљена заједница, Београд

**Andrejiћ, Q.** 1970, Prilog bibliografii o Ciganima, Glasnik etnografskog muzeja br. 22, Beograd.

**Антонијевић, Д.** 1982, Обреди и обичаи балканских сточара, Београд.

**Антонијевић, Д.** 1990, Ритуални Транса, Београд.

**Arnaudov, M.** 1969, *Очерци по българския фолклор. София*

**Arnaudov, M.** 1971-1972, *Студии върху българските обреди и легенди.*

**Ашури Р., Земон Р.** 1996, Краток осврт на историјата на движењето на Египќаните на Балканот и во Македонија, Зборник на трудови за етногенезата на Египќаните во Македонија, Скопје, 9-85.

**Бајрајтаровић, М.** 1960, Ругова, Српски етнографски зборник, LXXIV, Београд.

**Бајрајтаровић, М** 1968 Традиционалне друштвене заједнице на Косову и Метохији, Зборник Филозофског Факултета, књ. X1, Београд.

**Бакс, К.** 1986 Богатство земных недр. Москва

**Bandić, D.** 1982 Etnos. Etnološke sveske, 4, Beograd.

**Barth, F.** 1969 Introduction. – In: Barth, F. (Ed.) *Ethnic Groups and Boundaries: The Social Organization of Cultural Difference*. London, pp. 9-38. ; Etničke grupe i wihove granice, vo Putinja, P., Stef-Fenar, Ž. *Teorije o etnicitetu*, Beograd, 1997.

**Bastian, A.** 1869 *Der mensch in der Geschicte*. Berlin.

**Bel~ev, T.** 1992, 4000 godini makedonska civilizacija i kultura, Skopje.

**Benina-Marinkova, V., Paprikova-Krutilin, Z., Antonova, I.** 2000, *Kalendarni praznici i obi~ai na V~lgarite*. Енциклопедия, София.

**Berisha, A.T.** 2000, *Gjurmave te stergjusheve- mbi etnogjenezen e Egjiptjaneve Ballkanik*, Novi Sad

**Bernal, M.** 1987, *Black Athena: The Afroasiatic Roots of Classical Civilization, Volume I, Fabrication of Ancient Greece 1785-1985, Free Association Books Ltd, London (translated in Macedonian in 2009, Tabernakul, Skopje)*.

**Birget-Smith, K.** 1960, *Putevi Kulture, Opsta Etnologija, Matica Hrvatska, Zagreb*.

**Biris, K.** 1954, *Rrom kai Gyftoi: ethnografia kai istoria ton Tsinganon*, Athens.

**Bitrakova-Grozdanova, V.** 1978, *Egipetski kultovi vo Makedonija, @iva antika, tom 1-2, Skopje*.

**Bogoeski, K.** 1997, *Patepiscite za ishranata vo Makedonija. Etnolog br. 7-8, Skopje*.

**Bo`ovi}, R.** 1996, *Kulturno-religiski obrasci na makedonskite Egip}ani, Zbornik na trudovi za etnogenezata na Egip}anite vo Makedonija, Skopje*.

**Ботвинник, Н.** 1979, *Египетский фараон Нектанеб в новой редакции "Романа об Александре"* - В: *Проблемы античной истории и культуры*. II, Ереван.

**Бромлей, Ю.** 1976 *Етнос и этнография*. София.

**Vakarelski, Hr.** 1974, *Етнография на България*. София

- Vasiljev, L.S.** 1987. Istorija Religija istoka, Beograd.
- Veber, M.** 1976, Privreda i društvo, Beograd.
- Veselinoviĥ, M.,** 1894. Kroz Kosovo (od Skopqa do Kosova). Beograd.
- Veĥoviĥ, R.** 1935. *Pleme Vasojeviĥi, Sarajevo.*
- Vilken, U.** 1988. Aleksandar Makedonski, Misl, Skopje.
- Vlahoviĥ, P.** 1984, Narodi i etniĥke zajednice sveta, Beograd.
- Vlahoviċ, P.** 1996, Ĉovek u vremenu i prostoru - Antopologija, Beograd.
- Volis BadŹ, E.A.** 1985. Egipatska Religija - egipatske ideje o zagrobnom zivotu. Beograd.
- Voss, Ch.** 2004, Language attitudes of a phantom minority. – In: Скривене мањине на Балкану. Београд, 51-61.
- Vukanoviĥ, T.** 1961. Virxine, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, kw. VI, Priština.
- Vukanoviĥ, T.** 1966. Preĥevo, Vrawski glasnik, kw. II, Vrawe.
- Vukanoviĥ, T.** 1983, Romi (Cigani) u Jugoslaviji, Vrawe.
- Vukmanoviĥ, J.** 1932. Me|u Barskim Ciganima, Zapisi za oktobar 1932, Cetiwe.
- Vuliĥ, N.** 1932, Jedan nov grob kod Trebeniĥta, Glasnik Skopskog nauĥog društva, kw. 5, Skopqe.
- GaraŹanin, M.** 1988, Nastanak i poreklo Ilira. – B: Iliri i Albanci, SANU, Beograd.
- Gavela, B.** 1978. Etrurci - istorija, kultura, umetnost, Beograd.
- Genĥev St.** 1989, Terenoto etnografsko izsledvane, Veliko Търново.



**Георгиев, Г.** 1953 Желязодобивната индустрия в Мървашко (планината Али ботуш и съседните ѝ планини). – В: Рударството в Югозападна България и Югоизточна Македония. София, с. 1-125.

**Georgieva, R., Spiridonov, T., Reho, M.** 1999, Етнология на траките. София.

**Геров, Н. I,** 1975/ 1895; II, 1976/ 1897; VI, 1978/ 1906 Речник на българския език. София/ Пловдив.

**Gerc, K.** 1973/ 1998 The interpretation of cultures/ Tumačenje kulture. Beograd.

**Георгиева, Цв.** 1999 Пространство и пространства на българите XV – XVII век. София

**Golubic, M.** 1970. *Istorija hriscanske crkve, Beograd.*

**Gossiaux, J.-F.** 2002 Pouvoirs ethniques dans les Balkans. Paris

**Griffe, M.** 2001, “Egypt - from 3200 BC till present day”, *Tableaux Synoptiques De L’Historiere (TSH), Le Cannet, France.*

**Daglas, M.** 1990, *Natural Symbols- Exploration in Cosmology/ Prirodni simboli, Novi Sad-Pogdorica.*

**Denich, B.** 1974 *Sex and Power in the Balkans.* – In: **Rosaldo, Z., Lamphere, L.** (ed.) *Woman, Culture and Society, Staford, 243-262.*

**Dino, L.** 1997. *Rromet dhe Egjiptjanet - dy etni me prejardhje te ndryshyme, Tirana- ръкопис*

**Dino, L.** 1998. *Adetet e dasmes te Egjiptjanet e Permetit, Tirana- ръкопис.*

**D`ud`ev, S.** 1975. Българската narodna muzika, том 2, София.

**Drqa`a, D.** (red.) 1989, *Prilozi prou`avawa etni`kog identiteta, SANU, Boegrad.*

**Drobwakovih, B.** 1960, *Etnologija naroda Jugoslavije*, Beograd.

**Duijizing, G.** 2000. *Making of Egyptians in Kosovo and Macedonia, Religion and Politics of identity in Kosovo*, London.

**Ђorђевић, T.** 1932, *Na{ narodni `ivot, kn. VI*. Beograd.

**Ђorђевић, T.** 1933, *Na{ narodni `ivot, kn. VII*. Beograd.

**Ђurić, R.** 1987, *Seobe Roma- krugovi pakla i venac sreće*, Beograd.

**Elijade, M.** 1991. *Istorija verovanja i religijskih ideja, tom. 3*, Beograd.

**Erikson, E.** 1968 *Identity, Youth and Crisses*. New York.

**Eriksen, T. H.** 1993, *Ethnicity and Nationalism*, London.

**Zemon, R.** 1996, *Etno-demografski karakteristiki na Egip}anite vo Makedonija, Zbornik na trudovi za etnogenezata na Egip}anite vo Makedonija, Skopje*

**Zemon, R.** 1997, *Ishranata vo obredite i obi~aite kaj Egip}anite/E|upcite vo Makedonija, Etnolog br. 7-8, Spisanie na Zdru`enieto na etnologite na Makedonija, Skopje, 233-240.*

**Zemon, R.** 1997, *Tradicionalnite zanimawa na E|upcite vo Debar, diplomatska rabota, PMF, Skopje*

**Zemon, R.** 2000, *Egip}anite/E|upcite vo migraciite na naselenieto i etni~kite procesi vo zapadna Makedonija, Etnolog br. 9, Skopje, 226-232.*

**Zemon, R.** 2001, *Balkanski Egip}hani - istina o Egip}hania sa Kosova i Metohije*, Beograd.

**Zemon, R.** 2003, *Balkan Egyptians- a short presentation about their history of Identity Building, Migartion waves and Ethno-cultural characteristics. Paper ciruclated at the Council of Europe Seminar on Identity, Strasbourg 15-16 September 2003.*

**Zeqo, M.** 2003, *Aleksandri - ose profeti i rreme*, Koha Jone, Tirane, 26/07/2003

**Zigler, Ch.** 2002, *The Louvre - Egyptians Antiquites*, Paris.

**Zogovi}, S.** 1997. *Ishranata i tradicijata niz vekovite, Etnolog 7-8, Skopje.*

**Ivanoski, R.** 2000. *Starite Egipjani govorele so t.n. slovenski jazik, Večer, Skopje.*

**Ions, V.** 1968/ 1985, *Egyptian Mythology/ Egipatska mitologija (prevod), Ljubljana.*

*Ilustrovana istorija sveta, Stari svet, Beograd, 1983.*

*История на България 5, 1985; 6, 1987 БАН, София.*

*Istorija na Makedonskiot narod, kn. II, Skopje, 1969.*

*Istorija na kulturata na Makedonija, MANU, 1 - 4, Skopje 1995-1996.*

**Isajiw, W.** 1974, *Defenition of Ethnicity, Ethnicity 1, New York and London.*

**Jelaviñ, V.** 1906, *Francuska izveřha o Bosni, Glasnik Zemaqskog Muzeja XVIII, Sarajevo.*

**Jurkic-Girardi, V.** 1981, *Skarabej- mitoloski simbol Sunca, Arheoloski muzej Zagreb& Arheoloski Muzej Istre Pula, Zagreb-Pula, (katalog od izloba Egiptaski skarabeji od 3. VI-5.VII. 1981)*

**Kaser, K., Halpern, J.M.** 1997 *Contemporary research on the Balkan family, anthropological and historical approaches. – In: Гласник Етнграфског института САНУ, Београд, 63-72.*

**Katapano, Gj. Falaschi, N.V., Rizaj, S.** 1996, *Shqiparet popull i ndare, Peje.*

**Kazer, K.** 2002 *Porodica i srodstvo na Balkanu. Beograd.*

**Kenrick, D.** 1998, *Historical dictionary of Gypsies, London.*

**Kerns, Ъ.** 1988, *Християнството през вековете. София*

**Kolarić, J.** 1982. *Istocni kršćani, Zagreb.*

**Kolarih, M.** (ur.) 1970, *Umetnost Kopta - iz zbirke dr`avnog muzeja- Berlin, Narodni muzej, Beograd.*

**Kovacs, J.** 1997. *No Record of the Case, European Roma Right Center, Budapest.*

**Konstantinov, D.** 1982, *Etni~kite odliki na bitolskite Romi, Etnolo{ki pregled br. 17, Sojuz na etnolo{kite dru{tva na SFRJ, Beograd.*

**Константинов, М.** 1986, *Op{ta etnologija. Скопје.*

**Konstantinov, M.** 1992, *Makedonci, Skopje.*

**Courthiade, M.** 2002, *Vous avez dit Ashkali? J'avais compris Egyptien. Bulletin de l'INALCO, Paris.*

**Courthiade, M.** 2003, *Quelques Proverbes Des Ashkalo-Egyptiens De Prishtrina- recueillis en 1980 par Lumia Osmani Kuc et suivis de quelques <<poemes>> recents d'auteurs divers, INALCO, Paris.*

**Courthiade, M.** 2003-2004, *Elements de reflexion sur les Balkano-Egyptiens ou Albano-Egyptiens, Yougo-Egyptiens, Ashkalis, Jevgs, Evgjits, Rlie, Arliua etc,INALCO, Paris.*

**Kotrel, L.** 1988, *Iz~eznatite faraoni, Skopje.*

**Krasnihi, M.** 1957. *Orahovac - antropogeografska monografija varo{ice, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, kw. II, 99-132.*

**Kuzman, P.** 1985, *Tri ~elusti i vrtquka, Ohrid,*

**Kuzman, P.** 1996, *Arheolo{ki tragi za Egip}anite vo jugozapadnaMakedonija, Zbornik na trudovi za etnogenezata na Egip}anite vo Makedonija, Skopje.*

**Kuzman P.** 1998. *Migracionite dvi`ewa i etni~kite promeni vo regionot na Ohridskoto Ezero od najstarite vremiwa do krajot na prviot milenium pred. n,e., Uzdraje Dragoslavu Srejovihu, Beograd.*

**Kuzman, P.** ( ur.) 2001, *Aleksandrida, redakcija Dimitar Pandev, Ohrid.*

**Кь~нов, V.** 1900/1996, *Makedonija, Etnografija, statistika. Sofija.*

**Langen, Buteword, Alan,** 1988, "Religije, Kultovi i Misterije- sve sto ljudi veruju", Zagreb.

**LampiĆ, M.** 1999. Mali Recnik Tradicionalnih Simbola, Beograd.

**Laslett, P.** 1972 La famille et le ménage: approches historiques. – In: ANNALES. Économies. Sociétés. Civilisations. Paris, 847-872.

**Levi-Strauss, Cl.** 1958 Anthropologie structurale. Paris

**Lisićar, P.** 1953, *Legenda o Kadmu i veze Lihnida s Egejom i Jadranim, @iva Antika, god III, br. 1-2, Skopje, 245-261.*

**Limanoski, N.** 1992, *Problemite na etni~kiot identitet na islamiziranite Makedonci, Etnolog br. 1, Skopje.*

**Limanoski, N.** 1993, *Islamizacijata i etni~kite promeni vo Makedonija, Skopje.*

**Linin, A.** 1986, *Narodni muzi~ki instrumenti vo Makedonija, Skopje.*

**Lukoviñ-Pjanoviñ, O.** 1993-1994, *Srbi...narod najstariji, tom 1-3, Beograd.*

**Mamudoski, E.** 1995, *Rodot moj ma~en, Kuboa, Prilep.*

**Mamudoski, E.** 1996, *Egip}anite/ E|upcite vo Ki~evo i Ki~evijata, Zbornik na trudovi za etnogenezata na Egip}anite, Skopje.*

**Maru}iakova, E., Popov, V.** 1993. *Ciganite v B}lgarija, Sofija*

**Maru}iakova, E., Popov, V.** 1994. *Studii Romani, tom I, Sofija.*

**Maru}iakova, E., Popov V.** 1995. *Studii Romani, tom II, Sofija.*

**Maru}iakova, E., Popov, V.** 2000. *Ciganite v Osmanskata imperia. Sofija*

**Marushiakova, E., Heuss, H. ...,** 2001. *Identity formation among the minorities in the Balkans: The case of Roms, Egyptians and Ashkali in Kosovo. Minority Studies Society Studii Romani, Sofia.*

**Maslov, A.** 1943, A theory of human motivation, Psychological Review, New York.

**Matkovski, A.** 1978, *Krepostivoto vo Makedonija, Skopje.*

**Mauss, M.** 1973, *Sociologie et antropologie/ Sociologija i antropologija (prevod) Beograd 1998.*

**Mc Dermott, B.** 2001, *Decoding of Egyptian Hieroglyphs, London.*

**Miladinovci, D. i M.** 1983. *Zbornik na Bŭlgarski narodni pesni (original), Zbornik na narodni pesni- pod redakcija na Haralampie Polenakovi} i Todor Dimitroski, Makedonska kniga, Skopje.*

**Miladinov, K.** 1980, *Izbor, Skopje, 1980*

**Mitreski, P.** 1983, *Zanaetivoto vo Ohridsko-stru{kiot region 1918-1970, NIO "Studentski zbor", Skopje.*

**Монтеп, П.** 1946/ 1989 *Египет Рамзесов. Москва.*

**Morgan, L.** 1877 *Ancient society. New York.*

**Mostwin, D.** 1972 *In search of Ethnic Identity, Social case-work.*

**Muçaj, A.** *Zbullime sociologjike te Egjiptajaneve e Shqiperise, Qendra per te drejtatat e njeriut, Tirana, 1999.*

**Nathanaili, A.** 1975. *Studime historike, Nr.2, Tirane.*

**Naumović, S.** 1998 *Romanticists or Double Insiders? An Essay on the Origins of Ideologised Discourses in Balkan Ethnology. – In: Ethnologia Balkanica. 2, pp. 101-120*

**Nedeljković, S.** 2000, *"Antropološko" istraživanje jednog "etnologa" u "domaćoj" sredini: Egipćani u Beogradu.- рѣкопис.*

**Ortayli, I.** 2004, *Imaratorlugun en Uzun Yuzyili, Istanbul (translated in Macedonian by Институт за национална историја и сојуз турски невладини организации во Р. Македонија, Скопје 2009)*

**Ostogorski, G.** 1959, *Istorija Vizantije*, Beograd.

**Ostogorski, G.** 1969, *Privreda i društvo u Vizantijskom Carstvu*, Beograd.

**Павловић, М.** 1989 *Испољавање етничког идентитета Срба у Чикагу. Зборник САНУ. Прилози проучавања етничког идентитета. Београд.*

**Рапов, В.** 1971/ 1985. *Теофилакт Охридски- како извор на средновековната историја на Македонскиот народ, Скопје.*

**Реџић, Р.** 1996. *Zavera Poricawa*, Beograd.

**Petrova, E.** 1996, *Brigite na centarlniot Balkan vo II i I milenium p.n.e., Muzej na Makedonija, Skopje.*

**Petroviћ, E.** 1989, *Teorijske pretpostavke istra`ivawa etni`kog identiteta, SANU- Prilozi prou`avawu etni`kog identiteta, Beograd, 1989.*

**Petroviћ, Ђ.** 1958. *Drveni topovi u na{ojoj pro{losti, Vesnik br. 5, Vojni muzej JNA, Beograd.*

**Petroviћ, Ђ.** 1975. *Cigani u sredwovekovnom Dubrovniku, Beograd.*

**Petroviћ, Ђ.** 1992, *Nau`na istra`ivawa Roma u Jugoslaviji, Razvitak Roma u Jugoslaviji, SANU, Beograd,*

**Petrovski, T.** 2000, *Romite od pratatkovinata do denes, feqton vo vesnik Nova Makedonija, Skopje, juni-juli.*

**Pinsent, J.** 1969, *Greek Mythology, London.*

**Pirraku, M.** 1999, *Kush jane Shqiptaret Egjiptijanve albanofone?, Prishtina- рџкопис.*

**Плутарх,** 1981, *Успоредни животописи. Софија*

**Polansky, P.** 1999, *The Gypsies of Kosovo - a survey of their communities after the war, Society for threatened peoples international.*

**Роповић, Л.В.** 1975, *Arhajska Grčka kultura na srednjem Balkanu/ Archaic Greek culture in the middle Balkans, Beograd.*

**Poulton, H.** 1995. *Who are the Macedonians?*, London.

**Prior, @.** 1993, *Universalnite simboli, Енциклопедия, Sofija.*

**Primovski, A.** 1955, *Kovačite Agupti v gr. Madan, Izvestia na etnografskiū institut s muzej, kniga II, Izdanie na Bŭlgarskata Akademiā na naukite, Sofija.*

**Pukson, G.** 1974. *Romite vo Makedonija i Vizantija, Glasnik, br. 2, Institut za nacionalna istorija, Skopje.*

**Rice, M.** 1999, *Who's who in Ancient Egypt, Routledge, London.*

**Risteski, S. Q.** 2000, *Etničkite simboli i politikata, Etnolog br. 9, Skopje.*

**Risteski, S.** 1991, *Narodni prikazni, predanija i običaji kaj Egipćanie/E|upcite vo Makedonija, Ohrid.*

**Risteski, S.** 1999, *Običaji i obredi pri novorodenēe kaj Egipćanite/ E|upcite vo Ohrid i Struga, Literaturno-folklorni prilozhi, Ohrid.*

**Risteski, S.** 2000, *Kon zbornikot za etnogenezata na Egipćanite vo Makedonija, Navraćawa na istoriski temi, Ohrid.*

**Rizaj, S.** 2003, *Me ćfare kuptimi po perdoren emrat Egjiptijane, Ashkalinj dhe Rrome?! , Prishtina - рѣкопис.*

**Robinson, H.S., Wilson, K.** 1976, *Mythes and legends of all nations/ Mitovi i legende svih naroda, Beograd.*

**Saliu, A.** 1996, *Rogozinarstvoto vo Ohridsko- strućkiot region (1940-1968), Zbornik na trudovoi za etnogenezata na Egipćanite vo Makedonija*

**Svetieva, A.** 1998, *Erotskite elementi vo obredite so maski kaj Makedoncite, Običaji so maski, Muzej na Makedonija, Skopje.*

**Svetieva, A.** 2000, *Migracii-praćawa na identitetot, Etnolog br. 9, Skopje.*



**Selem, P.** 1969, Egipatski kultovi i njihovi spomenici u rimskom Iliriku, Filozofski fakultet, doktorska disertacija, Zagreb.

**Selem, P.** 1997, *Izidin Trag*, Knjizevni krug, Split.

**Smit, D. A.** 1998, *Nacionalni Identitet/ National identity*, Beograd.

**Scheel, B.** 1989, *Egyptian Metalworking and Tools*, Shire Publication LTD, Bucks, UK.

**Shkorda, Z.** 1973, *Esnafet Shiptar*, Tirana.

**Срејовић, Д., Цермановић, А.** 1979 *Речник грчке и римске митологије*. Београд.

**Stipčević, A.** 1974, *Iliri- povijest, život, kultura*, Zagreb.

**Stojkoviћ, M.** 1996, *Istorijski razvoj i zaštite mawina, Polo`aj mawina u Saveznoj Republici Jugoslaviji, SANU, Naučni skupovi, kw. 84, Odeqewe društvenih nauka, kw. 19, Beograd.*

**Tolev, V.** 2000, *Istoria na religiite*, Sofija.

**Тачева-Хитова, М.** 1982 *История на източните култове в Долна Мизия и Тракия V в. пр.н.е. – IV в. от н.е. София.*

**Таџева, М.** 1996, *Etničkiot identitet i etničkiot status: Američki iskustva, Sociološka revija, Skopje.*

**Тенева, Н.** 2003 *Родопски занаяти. София.*

**Тодорова, М.** 2002 *Балканското семејство. Историческа демографија на българското общество през османскиот период. София.*

**Tomorad, M.** 2003, *Egipat u Hrvatskoj*, Zagreb.

**Trifunovski, J.** 1953, *Debar-antropogeografska ispitivawa, Glasnik Etnografskog Instituta SAN, kw. II-III, Beograd.*

**Trifunovski, J.** 1979, *Strumički kraj- narodni život i obi`aji, Skopje.*

**Trifunoski, J.** 1988, *Albansko Stanovništvo u Socijalističkoj Republici Makedoniji, Beograd.*

**Truhelka, T.** 1919, Pabirci iz jednog jajaškog sixila, Glasnik Zemaqskog Muzeja, HHH, 1918, Sarajevo.

**Tylor, E.** 1871, *Primitive culture, London.*

**Tzaneva, E.** 2000 *Interpreting Ethnicity.* Sofia.

**Filipović, M.** 1932, *Visocki Cigani, Narodna Starina, Časopis za istoriju i etnografiju Južnih Slovena, Zagreb.*

**Filipoviĥ, M.** 1937, Etničke odlike u Ju`noj Srbiji, Spomenica dvadesetgodi{wice osloboĥewa u Ju`noj Srbiji, Skopqe.

**Filov, B.D., K. Schkorpil, K.** 1927, *Die archaise nekropole von Trebenische am Ochrida-see, Berlin und Leipzig.*

**Fraser, A.** 1995, *The Gypsies, Blackwell Publisher, London.*

**Frashëri, S.** 1988, *Vepra 1, Tirana.*

**Frejzer X. X.** 1992, *Zlatna Grana- prou{avawe magije i religije/ The Golden bough-a stady in magic and religion, Beograd.*

**Hadzi Halil, K.** *Gjurmave te prejardhjes, Mulhaim an der Ruhr, 2000*

**Hadžijahić, M.** 1985, *Bosanski Romi 1941-1942 godina, Glasnik Zemaljskog Muzeja, Sarajevo.*

**Han, J.G.** 1876, *Kroz pore{inu Drima i Vardara. Beograd.*

**Haxi Risti}, M.** 1992, *Pra{aweto na Egip}anite (prilog na prou{uvaweto na etni{kiot identitet), Etnolog 2, Skopje, 72-81.;*

**Haxi Risti}, M.** 1995, *Egip}anite vo Makedonija, feqton, vesnik Nova Makedonija, Skopje.*

**Haxi Risti}, M.** 1996, *Pra{aweto na etnogenezata na Egip}anite vo Makedonija, Zbornik na trudovi za etnogenezata na Egip}anite vo Makedonija, Skopje, 88-149.*

**Hasluck, M.** 1938, "The Gypsies of Albania", *Journal of Gypsy Lore Society.*

**Henderson, G.** 1971 *Anthropology. Encyclopedia Americana 2, New York.*

**Херодот I**, 1986; II, 1990 *История. София.*

**Hiti, F.** 1976, *Istorija Arapa, Sarajevo.*

**Hesiod** 1970, *Poslovi i dani, MH, Zagreb.*

**Христов, П.** 2004 *Сравнителното изучаване на граничните региони на Балканите – проблеми и перспективи. – В: Етно-културолошки сборник. Књ. IX, Сврљиг, 83-88.*

**Celakoski, N.** 1997, *Sveti Naum Ohridski ^udotvorec, Skopje.*

**Celakoski, N.** 2002, *Prilozi na etnografijata na Makedonija, Ohrid.*

**Cепенков, М.** 1959, *Makedonski narodni prikazni, kn. III, Ко~o Racin, Skopje.*

**Cепенков, М.** 1972, *Narodni realisti~ni prikazni kn. V, Makedonska kniga, Skopje.*

**^ubranoviћ, A.** 1950, *Jeћupka, Dubrova~ka poezija, Beograd.*

**^ukiћ, D.** 1971, *Kosovo-znamenitosti i lepote, Pri{tina.*

**Ximrevski, B.** 1997, *Kaneweto na umrenite vo gali~ka svadba kako muzi~ka reministencija od kultot na mrtvite, rakopis pro~itan na XIII me|unaroden simpozium za balkanski folklor, sekcija 4-etnomuzikologija, Ohrid.*

**[irokogorov, S.M.** 1998, *Etnos- istra`ivawe osnovnih principa promjena etni~kih i etnografskih pojava 1923, Podgorica.*

**Waitz, Th.** 1859, *Anthropologie der naturvolker, Leipzig.*

**Kolektivni trudove, сборници с извори i enciklopedii:**

**Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë**, "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1980

*Arheolo{ka Karta na Republika Makedonija, tom II, MANU, Skopje, 1996*

**ГИБИ 1954** – Гръцки извори за българската история. (под ред. на В. Бешевлиев), София, 1954, Т. I, София

**ГИБИ 1994** – Гръцки извори за българската история. Т. IX (под ред. на Ив. Божилов), Произведения на Теофилакт Охридски, архиепископ български, отнасящи се до българската история. Част II, София, 1994

*ERRC 2003, Cleaning Operation-excluding Roma in Greece, Budapest.*

*Enciklopedija živih religija, 1992, Beograd.*

*Етнография на България,, том 1- 1981; том 2-1983; том 3- 1985.*

*Muzička Enciklopedija, 1971, JLZ, Zageb.*

**OSCE, 1999.** *Public relation document on Roma, Askalie and Egyptians - Booklet project of OSCE-Mik.*

**OSCE. 2002,** *Ninth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo (Period covering September 2001 to April 2002).*

*Stari Svet (The Ancinet World), Narodna Knjiga Vuk Karadzic, Beograd, 1983.*

*Християнската мисъл през вековете. 1999, София.*

**Council of Europe- Parliamentary Assembly. 2001,** *Humanitarian situation of returnees to Kosovo, Doc. 9007, 23 April 2001.*

**Council of Europe - ADVISORY COMMITTEE ON THE FRAMEWORK CONVENTION FOR THE PROTECTION OF NATIONAL MINORITIES. 2003.** *COMMENTS OF THE GOVERNMENT OF ALBANIA ON THE OPINION OF THE ADVISORY COMMITTEE ON THE IMPLEMENTATION OF THE FRAMEWORK CONVENTION FOR THE PROTECTION OF NATIONAL MINORITIES IN ALBANIA, GVT/COM/INF/OP/I(2003)004, 10 February 2003.*

**UNMIK. 2002**, Press Release, A choice for Mitrovica-the seven point plan-, by Michael Steiner, **Special Representative of the Secretary-General**, **UNMIK/PR/837, 1 October 2002.**

## Lista e informatorëve

### Republika e Maqedonisë:

1. Bajram Mustafa- Krosi, l. 1917, Dibër.
2. Lutvie Isakoska, l. 1939 Dibër.
3. Sulejman Ibrahim- Kapush l. 1926. f. Zhirovnica, Dibër.
4. Islail Biçak, l. 1913 Strugë.
5. Ekuran Memdoski l. 1935, Strugë
6. Ramadan Bizat, l. 1941 Strugë
7. Dalip Rabijan, l. 1925, Ohër
8. Rapo Zylfije, l. 1931 Ohër
9. Rapo Refije, l. 1933, Ohër
10. Ismet Osamani, l. 1937 Ohër, nga Dibra
11. Mirka Kamberoski, l. 1891 f. Pribilci (Demir Hisar) nga Resnja
12. Xhavit Husoski, l. 1932 Kërçovë

### Republika e Shqipërisë

13. *Xheko Duraliu, Vasie dino dhe Manushe Islami, nga Përmeti, ne moshë 60-75 vjet, të intervistuar nga filologu Luan Dino.*
14. Nexhmije Gjoleka, l. 1950, Korça
15. Resul Duro, l. 1948, Korça
16. Shaban Kelo, l. 1939, Tirana
17. Asan Arapi, l. 1935, Fier.

### Republika e Bullgarisë:

18. Shukri Halilov Karamisirov, l. 1934 Madan
19. Bekir Sadekov Karamisirov, l. 1941, Madan
20. Adem Ademov Xhislamov l. 1950, Madan

### Republika e Kosovës

21. Sulejman Kaloviçi l. 1915, Alashi i vogël.
22. Sabit Abazi, l. 1935, Kastrioti/ Obiliç
23. Rahime Ramadani, l. 1930, Magura
24. Hava Berisha, l. 1940, Kastrioti/Obiliç
25. Akile Alija, l. 1903, Magure
26. Rahman Miftari, l. 1935, Fushë Kosovë
27. Haki Abazu, l. 1940, Kastrioti/Obiliç

**Republika e Malit të Zi**

28. Badzdoviç Jashar, l. 1949, Stari Bar
29. Mustafa Adzheboviç, l. 1943, Ulqinj
30. Huho Behareviç l. 1923, Stari Bar.

# Fototeka





**“Porta e Luanit” ose “Akeri” në Mikenë, Peloponez, Greqi**



**Statua e zotneshes Izida në Ohër, Maqedoni**



**Familje Egjiptiane nga Struga, Maqedoni, që janë marrë me bujqësi, 1974**



**Familje Egjiptiane nga Resnja, Maqedoni, farketare, 1997**





**Familje Egjiptiane nga Dukagjini, Kosovë, 1969**



**Autori me Egjiptianët e Stari Bar, Mali i Zi, 2001**





**Hadi Bajrami dhe grupi i tij muzikor, Gjakovë, Kosovë,  
1967**



**Autori me Egjiptianët e qytetit Madan, Bullgari, 2004**





**Familja dhe grupi Majovci, nga Dibra, e cila në vitin 1946  
e ka marrë vendin e parë në Festivalin Folkloristik  
Botëror, në Langolen, Britani e Madhe**



**Familje Egjiptijane nga Korca, Shqiperi, 1985**





**Dr. Rubin Zemon** është lindur në Strugë, Republika e Maqedonisë, në vitin 1970 ku edhe ka mbaruar shkollën fillore. Gjimnazin e ka mbaruar në Ohër. Diplomoi në Fakultetin e Etnologjisë në Universitetin e Shën Qirilit dhe Metodit në Shkup. Ka doktoruar në Sofje, Republika e Bullgarisë, në Institutin Etnografik me muze pranë Akademisë Bullgare të Shkencave.

Ai është i punësuar në Universitetin "Shën Apostulli Pali" në Ohër dhe profesor në vizitë në Univerzitetin "Euro-Balkan" në Shkup. Hulumtimet e tij janë në fushën e antropologjisë kulturore dhe shoqërore, etnologjisë, arkeologjisë, shkencave humane, multikulturalizmit, etnicitetin etj. Kohët e fundit hulumtimi i tij është i drejtuar drejt zhvillimi të humanistikës digjitale, antropologjisë digjitale dhe vizuale, 3D- arkeologjisë dhe komunikimet inter-kulturore.

Ky botim "Antropogjija socio-kulturore e Egjiptianëve në Ballkan", është rezultat i hulumtimit shumëvjeçar në më shumë troje Ballkanike dhe qendra shkencore në botë, e cila përfundoi me mbrojtjen e tezes së doktoraturës në Akedeminë Bullgare të Shkencave. Me këtë disertacion për herën e parë në mënyrë shkencore është vërtetuar ekzistenca, kolonizimi dhe etno-kultura e Egjiptianëve në Gadishullin Ballkanik.

**Dr. Rubin Zemon** është sekretari i përgjithshëm i Unionit të Egjiptianëve të Ballkanit, anëtar i Kryesisë së Shoqatës maqedonase etnologjike, dhe anëtar i disa OJQ-ve në Maqedoni dhe jashtë vendit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare. Disa herë ishte i angazhuar nga Këshilli i Evropës dhe OSBE si ekspert vendor dhe ndërkombëtar për pakicat kombëtare.